RAPORTI I AUDITIMIT

Auditim Financiar dhe Përputhshmërie

Tiranë, shtator 2026

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale
AK	Autoritet Kontraktor
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PF	Pasqyrat Financiare
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SH.A.	Shoqëri Anonime
SH.P.K.	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
UP	Urdhër Prokurimi
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

		PËRMBAJTJA	Faqe
SHKURTIME			**2-2**
I		**PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**4-12**
	1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	4-5
	2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-8
	3	Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	9-12
II.		**HYRJA**	**13-18**
	1	Objektivat e auditimit dhe Qëllimi i auditimit	13-13
	2	Identifikimi i çështjes	13-14
	3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	14-14
	4	Përgjegjësitë e audituesve	14-15
	5	Kriteret e vlerësimit	15-16
	6	Standardet e auditimit	16-17
	7	Metodat e auditimit	17-17
	8	Dokumentimi i auditimit	18-18
III.		**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**18-176**
	1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	18-19
	2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	19-176
	2.1.1	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm	19-34
	2.1.2	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm	34-41
	2.2.1	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	41-55
	2.2.5	Auditimi mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre	55-63
	2.3	Vlerësimi Raportimit Financiar	63-80
	2.4	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	80-147
	2.4.3	Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike	147-154
	2.5	Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit	154-156
	2.6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit, Mbrojtjes së Territorit	156-159
	2.7	Mbi administrimin e aseteve, procedurat e inventarizimit e regjistrimit	159-172
	2.8	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	172-176
IV.		**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**176-195**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e Has është njësi vendore, institucion i pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim i ish Bashkisë Krumë dhe tre ish-komunave.

Për periudhën objekt auditimi 2023-2025, Bashkia Has është e ndarë në Bashkinë Has (ish Bashkia Krumë) dhe njësitë administrative si vijon: Njësinë Administrative Gjinaj (Ish Komuna Gjinaj), Njësinë Administrative Golaj (ish Komuna Golaj) dhe Njësinë Administrative Fajza (ish Komuna Fajza).

Bashkia Has shtrihet në pjesën Verilindore të Shqipërisë, pjesë e Qarkut Kukës. Qyteti Krumë është kryeqendra e rrethit të Hasit.

Ekonomia në Bashkinë Has është e orientuar në fushën e agrikulturës, ekonomitë pyjore si dhe industrinë minerare dhe atë energjetike.

Misioni i Bashkisë Has është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Has si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore", nenit 50 "Auditi i jashtëm", pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Has si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Has. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm;*
- *mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit;*
- *mbi burimin dhe krijimin e të ardhurave për vitin 2024-2025;*
- *mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2025;*
- *mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve;*
- *mbi administrimin e pronës publike;*
- *mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;*

- mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit, Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV);
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.
Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. ***Vlerësimi i riskut të kontrollit*;**
Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin 2025 niveli i materialitetit pranohet në vlerën 17,467 mijë lekë dhe gabimi i lejuar *(10% - 20%)* në vlerën 1,747 mijë lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli);
Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% té transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. **Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 29 gjetje dhe ka dhënë 31 rekomandime, nga ku masa organizative me 21 gjetje dhe 22 rekomandime, masa shpërblim dëmi 4 gjetje dhe 4 rekomandime si dhe masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhurat e munguara 4 gjetje dhe 5 rekomandime.
f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me*:*

- ***Procedurat e prokurimit publik*** për punë publike, mallra dhe shërbime:

Blerje me vlerë të vogël nën 1,000,000 lekë
- Në **1 (një) rast,** u konstatua copëzim fondi për procedurat e prokurimit.
- Në 10 raste nuk argumentohet përllogaritja e fondit limit.
- Në 1 rast fatura tatimore nuk është likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", edhe pse pa efekt financiar.

Procedurat e Prokurimit me Vlerë të Lartë;
Nga grupi i auditimit mbi bazën e riskut dhe të materialitetit nga **<u>36</u>** procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit prej **491,057** mijë lekë, ka vlerësuar për auditim **<u>12</u>** procedura me fond limit prej **425,296** mijë lekë ose **<u>87 %</u>** e fondit të prokuruar, nga ku kanë rezultuar disa parregullsi në shkelje apo mos zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore të LPP. Skurtimisht po pasqyrojmë disa mangësi;
Nga auditimi i **12** procedurave me fond limit **425,296** mijë lekë, janë konstatuar në shkelje të LPP

dhe akteve nënligjore, gjithsej **12** procedura, nga të cilat:
a. - Në **7 raste** u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar si;
- Kërkesa për inxhinier jo në përputhje me preventivin;
- Kërkesa për drejtues teknik të angazhuar gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimeve për investime nën 30 milion lekë;
- Kërkesa për kategori licence sidomos ato që lidhen me mjedisin NP-12 për punime që nuk lidhen me këtë licencë;
- Kërkesa për disponimin e licencës për mbrojtjen nga zjarri jo në përputhje me objektin e prokurimit, si dhe në raste tjera pa e mundësuar të disponohet edhe me kontraktim;
- Kërkesa për certifikata ISO të prodhuesve të cilat nuk janë ofertues;
- Kërkesa për mjete të panevojshme si kontejnerët stacionar ose kërkesa për impiant betoni duke përcaktuar distanca largësie;
b - Në **3 raste** nuk është dokumentuar llogaritja e fondit limit, duke mos argumentuar nevojat reale.
c. Në **9** procedura, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK.
d. Në 3 procedura, mungon oponenca teknike, në kundërshtim me nenin 6 pika 1 germa (a) të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.
e. Në 2 procedura, nuk disponohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit apo treguesit e testimit të tregut.
f. Në **1** procedurë, konkretisht me objekt *"Blerje automjetesh (Kamion vetëshkarkues, rrul me vibrim hekur – gomë"* procedura duhej ndarë në lote.
g. Në një procedurë prokurimi, konkretisht procedura me objekt *"Organizim i konferencave shkencore ndërkombëtare në kuadër të projekteve të Ndërkombëtarizimit" nuk është mbajtur sigurimin e ofertës, e cila është në vlerën **399,992 lekë,** si dhe të raportohet pranë APP.*
gj. Në 3 procedura prokurimi, vlerësimi i ofertave është bërë përtej afatit 15 ditë të përcaktuar për procedurat nën kufirin e lartë monetar.
h. Dosjet e procedurave janë të pa inventarizuara, pa numerizuar dhe pa arkivuar, në kundërshtim me *Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*, neni 21 dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8 germa (g).

Në lidhje me investimet, është audituar zbatimi i 3 kontratave me fond limit 226,838,843 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 216,022,553 lekë pa TVSH si më poshtë;
1. Rikonstruksion i gjimnazit "Skënderbeu", Bashkia Has 97,431,542 lekë pa TVSH.
2. Rehabilitim me qëllim mbingritjen e digës së rezervuarit, Helshan-2 me fond limit 40,496,392 lekë pa TVSH.
3. Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme të Fshatit Golaj me fond limit 88,910,909 lekë pa TVSH.
Në mënyrë të përmbledhur po paraqesim dëmin ekonomik të konstatuar nga auditimi i zbatimit të 3 kontratave, në buxhetin e Bashkisë Has;
"Rikonstruksion i gjimnazit "Skënderbeu", Bashkia Has;
Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Has në vlerën 1,768,287 lekë pa TVSH.
Rehabilitim me qëllim mbingritjen e digës së rezervuarit, Helshan-2", Bashkia Has;

Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt ose punime të llogaritura jo sipas projektit te zbatimit, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Has në vlerën 888,271 lekë pa TVSH.

"Sistemim asfaltim i rrugëve të mbrendshme të Fshatit Golaj ", Bashkia Has;

Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt ose punime të llogaritura jo sipas projektit te zbatimit, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Has në vlerën 740,379 lekë pa TVSH.

Pra rezulton një total prej 3,396,937 lekë pa TVSH me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Has.

- ***Procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit***

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan disa mangësi si më poshtë:

- Në 4 raste nuk evidentohet mënyra e përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, por përcaktohet vetëm vlera;
- Në 2 raste kartela e pasurisë nuk është e rifreskuar 3 muajt fundit;
- Në 2 raste ka mangësi në planvendosjen e paraqitur, ku në një rast rezulton se gjurma e objektit pasqyron vetëm konturet por nuk evidentohet objekti, ndërsa në një rast sipas hartës së paraqitur në pasaportën e njësisë me nr. HS_UB_A1_1/31, rezultojnë disa objekte brenda parcelës, të cilat nuk janë pasqyruar në planvendosje;
- Në një rast mungojnë licencat e projektuesve dhe policat e sigurimit të projektuesve për mbulimin e përgjegjësive profesionale, si dhe mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore;
- Në një rast nuk administrohet kërkesa për t'u pajisur me leje ndërtimi sipas formatit të përcaktuar.

- ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave***

- Në Bashkinë Has vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2025 është 191,609 lekë, si në raportimin në MFE ashtu dhe në rakordimet me Degën e Thesarit, në kundërshtim me përcaktimet në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1. Në raport me shpenzimet e vitit të cilat janë në shumën 450,253 mijë lekë detyrimet zënë 0.04%, pra bashkia nuk është me vështirësi financiare. Nga auditimi konstatohet se deri në vitin 2025, vlera e likuiduar për vendimet gjyqësore është 1,209,479 lekë, janë hapur procese gjyqësore nga 28 ish punonjës të larguar nga puna, nga të cilët 1 punonjës ka përfunduar procesin gjyqësor për kthim në pozicionin e mëparshëm dhe shlyerjen e detyrimit në shumën 2,208,004 lekë.
- Për periudhën 2024-2025, në territorin e Bashkisë Has janë evidentuar 5 subjekte të pajisura me autorizim bazë për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të hidrokarbureve. Nga auditimi i dosjeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin "Tregtim me pakicë i karburanteve dhe lëndëve djegëse" rezulton se subjektet nuk kanë paraqitur dokumentacionin ligjor, teknik dhe mjedisor, por vetëm NIPT. Ushtrimi i aktivitetit nga këto subjekte dhe pajisja me autorizimin nga Bashkia është kryer në kundërshtim me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre" dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj
- Nga auditimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Has, u konstatuan 6 subjekte të cilët janë të regjistruar në QKB dhe të pajisur me NIPT por nuk kanë shlyer detyrimet për taksat vendore, vlera e detyrimit nuk është evidentuar me pretendimin se nuk ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Has

- ***Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve***

-Nga auditimi mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës u konstatua se kjo njësi vendore ka mangësi theksuara në

procesin e inventarizimit, regjistrimit dhe përdorimit të aseteve të saj. Deri më 31.12.2025, nga 993 prona të transferuara përmes VKM-ve, vetëm 33 prej tyre janë pajisur me certifikate pronësie ndërsa 20 prona janë regjistruar në ASHK dhe janë në pritje të certifikatës së pronësisë.
Për ish Komunën dhe aktualisht **Njësinë Administrative Golaj dhe për** ish Komunën dhe aktualisht **Njësinë Administrative Fajza** është miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike por mungon lista përfundimtare e pronave të cilat duhet të transferohen në pronësi të kësaj bashkie. Për ish Komunën dhe aktualisht **Njësinë Administrative Gjinaj** është miratuar lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në ish komunën Gjinaj, me VKM nr. 792, datë 16.11.2006 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Gjinaj" të qarkut të Kukësit, por mungon lista përfundimtare e pronave të cilat duhet të transferohen në pronësi të kësaj bashkie.
h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- **Bashkia Has *në lidhje me të ardhurat,***

- Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 191,609 lekë, si edhe të planifikojë detyrimet nga vendimet gjyqësore duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, dhe të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike.-Bashkia Has, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për të përmirësuar procesin e planifikimit të të ardhurave bazuar në analizë realiste të performancës historike dhe të dhëna të verifikueshme. Po ashtu, të hartojë dhe të mbajë një listë analitike të saktë për të ardhurat e trashëguara nga burimet e veta, për të garantuar transparencë dhe kontroll mbi burimin dhe përdorimin e tyre.
- Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të kryej procedurat bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 44 "Kalimi në status pasiv" pika1, germa a dhe b.

- ***Bashkia Has në lidhje me procedurat e prokurimeve publike*** të marrin masat e nevojshme, që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet. AK për punët/mallrat/shërbimet të cilat është e mundur ndarja e saj në lote, të marrë masa për hartimin e kërkesave të veçanta për secilin lot, për rritjen e konkurrencës dhe efikasitetin. Në procedurat e prokurimit në vijim, të kryejë përllogaritjen e saktë të vlerës së kontratës. Gjatë hartimit të regjistrave të prokurimit, të grupojë emërtimin e procedurave me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve buxhetore. Titullari i AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST në kualifikimin e OE, e cila përben risk real për mos realizimin me sukses të kontratës.

- ***Nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve (DPULMI*)** ***në lidhje me lejet e ndërtimit***, të kërkojë çdo subjekti që aplikon për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi dhe të ngarkuar në sistemin elektronik.

- ***Në lidhje me inventarizimin, përditësimin dhe regjistrimin e aseteve në ASHK***

-Bashkia Has të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi pune, me qëllim garantimin e organizimit institucional dhe koordinimit të proceseve të regjistrimit, inventarizimit dhe shfrytëzimit të pronave publike.
- Gjithashtu Bashkia Has të marrë masa të krijojë grupe pune të përhershme me përfaqësues teknikë, juridikë dhe financiarë, për të kryer verifikimin fizik dhe juridik të pronave të paluajtshme

(toka, ndërtesa, pyje, kullota), për përgatitjen e dokumentacionit të regjistrimit në ASHK dhe për hartimin e regjistrit unik kontabël të aseteve.
-Bashkia Has të marrë masa të përfundojë procesin e hartimit dhe miratimit të listave përfundimtare të pasurive për njësitë administrative që ende nuk e kanë këtë dokument, si dhe të identifikohen sipërfaqet e pashpërndara të tokës bujqësore dhe fondit pyjor/kullosor, për t'i regjistruar dhe përfshirë në menaxhim të rregullt ekonomik dhe financiar.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Has për periudhën ushtrimore 2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Has janë evidentuar devijime apo gabime materiale të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një ***opinioni të kualifikuar****, e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

***Baza për opinion e kualifikuar, me rezervë*:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Has, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 është 17,467 mijë lekë.

Në dhënien e opinionit, janë marrë në konsideratë parregullsitë e mëposhtme:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2025, paraqiten si më poshtë:

- *Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm"* paraqitet me gjendje 0, nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe verifikimit të llogarive u konstatua se në këtë llogari nuk është pasqyruar dhe kontabilizuar vlera 2,208,004 lekë, e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna.
- Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 89,782,727 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën 90,027,867 lekë. Referuar analizës së llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm"* dhe lëvizjeve të gjendjes shtesa pakësime gjendja e debitorëve progresiv të vitit 2025, rezultoi në vlerën 90,027,867 lekë, ku gjatë vitit 2025 janë paguar detyrime në total

në vlerën 4,547,924 lekë, janë shtuar debitorë në vlerën 1,310,538 lekë, duke pakësuar debinë progresive me 3,237,386 lelë, duke sjellë një vlerë të detyrimeve në fund të viti 2025, në shumën 86,545,342 lekë, por shtuar edhe detyrimet e punonjësve për paga dhe kontribute të muajit dhjetor 2025 në shumën 3,482,526 lekë dhe si rrjedhojë totali i debitorëve progresivë në 31.12.2025 rezultoi të jetë 90,027,867 lekë .

- Gjendja e llogarisë *423-429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* paraqitet në të njëjtën vlerë prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2024 dhe në fund të vitit 2025. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunat me reformën territoriale të vitit 2015. Kjo vlerë i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, dhe përbëhet nga shuma 96,451 lekë që janë detyrime të ish punonjësve pa listë emërore dhe shuma 818,498 lekë, janë fonde të ndihmës ekonomike të ish komunës te grabitura gjatë transportit në vitin 1997, pa autor.

- Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare "*Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës SH.A.*" me NIPT M.....I, u konstatua se Bashkia Has zotëron 6.06% të aksioneve të kësaj shoqërie. Kjo shoqëri është krijuar sipas akt marrëveshjes se Bashkive Tropojë, Has dhe Kukës dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë e përfaqësuar nga AKUM me nr. 3206.prot., datë 19.07.2022 protokolluar nga AKUM me nr. 1574.prot., datë 26.07. 2022. Vlera e kapitalit të kësaj shoqërie është 10,000,000 lekë, ku bashkia Has zotëron ose 6,06% të tyre ose në vlerën total 606,000 lekë e pa pasqyruar kjo në Llogarinë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet", e cila për vitin 2025 është në vlerën 0 lekë.

II. Opinion i auditimit të përputhshmërinë.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Has, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Has, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës. *"Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Has, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e* **një opinioni të kualifikuar.**

Baza për opinionin:

Opinionin e dhënë mbi përputhshmërinë e mbështesim në konstatimet e mëposhtme, sipas fushave të auditimit:

Procedurat e prokurimit publik **për punë publike, mallra dhe shërbime:**

Procedurat me vlerë të lartë:

- Në **7 raste** u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.
- Në **3 raste** nuk është dokumentuar llogaritja e fondit limit, duke mos argumentuar nevojat reale.
- Në **9 raste** kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së të gjitha kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.

Procedurat me vlerë të ulët:

- Në **1 rast** u konstatua copëzim fondi për procedurat e prokurimit.
- Në **10 raste** konstatua se nuk është administruar asnjë shkresë nga drejtoritë apo sektorët përkatës, për të justifikuar sasitë e mallrave objekt prokurimit.
- Në **1 rast** KBV ka përdorur kriter që nuk lidhet ngushtë me natyrën dhe objektin e kontratës.

Në **1 rast** KBV duhet të kishte skualifikuar OE e shpallur fitues për shkak të mosdorëzimit të dokumentacionit të kërkuar në ftesën për ofertë.

- Në **3 raste,** në zbatimin e kontratave**,** u konstatuan diferenca ndërmjet projektit dhe punimeve të financuara por të pa kryera, të konsideruara dëm ekonomik, në vlerën **3,396,937 lekë**.
- Në **1 rast**, nuk është arkëtuar shuma prej 41,867 lekë, konsideruar dëm ekonomik, përllogaritje e gabuar e TNI.

Procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan disa mangësi si më poshtë;
- Në 4 raste nuk evidentohet mënyra e përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, por përcaktohet vetëm vlera;
- Në 2 raste kartela e pasurisë nuk është e rifreskuar 3 muajt fundit
- Në 2 raste ka mangësi në planvendosjen e paraqitur, ku në një rast rezulton se gjurma e objektit pasqyron vetëm konturet por nuk evidentohet objekti, ndërsa në një rast sipas hartës së paraqitur në pasaportën e njësisë me nr. HS_UB_A1_1/31, rezultojnë disa objekte brenda parcelës, të cilat nuk janë pasqyruar në planvendosje
- Në një rast mungojnë licencat e projektuesve dhe policat e sigurimit të projektuesve për mbulimin e përgjegjësive profesionale, si dhe mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore
- Në një rast nuk administrohet kërkesa për t'u pajisur me leje ndërtimi sipas formatit të përcaktuar.

Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave

Nga auditimi konstatohet se, në Bashkinë Has familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore si dhe Sektori i Tatimeve nuk disponon informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet dhe taksa e tokës bujqësore. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 23 dhe VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021" pika 4/b. Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore janë rastet kur qytetarët paraqiten në bashki në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifat vendore apo për të marrë shërbime dhe nga Sektori i Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokës me vlerë 700 lekë/ha/vit kur bashkia ka të dhëna. Gjatë vitit 2024 janë mbledhur 70, 520 lekë rreth 10 ha dhe gjatë vitit 2025 janë mbledhur 184,070 lekë rreth 263 ha.
- Në Bashkinë Has vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2025 është 191,609 lekë, si në raportimin në MFE ashtu dhe në rakordimet me Degën e Thesarit, në kundërshtim me përcaktimet në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1. Në raport me shpenzimet e vitit të cilat janë në shumën 450,253 mijë lekë detyrimet zënë 0.04%, pra bashkia nuk është me vështirësi financiare. Nga auditimi konstatohet se deri në vitin 2025, vlera e likuiduar për vendimet gjyqësore është 1,209,479 lekë, janë hapur procese gjyqësore nga 28 ish punonjës të larguar nga puna, nga të cilët 1 punonjës ka përfunduar procesin gjyqësor për kthim në pozicionin e mëparshëm dhe shlyerjen e detyrimit në shumën 2,208,004 lekë. - - - Nga auditimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Has, u konstatuan 6 subjekte të cilët janë të regjistruar në QKB dhe të pajisur me NIPT por nuk kanë shlyer detyrimet për taksat vendore, vlera e detyrimit nuk është evidentuar me pretendimin se nuk ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Has.

Niveli I realizmit të të ardhurave në Bashkinë Has për vitin 2024 është 35,324 mijë lekë apo në masën 97 % ndërsa për vitin 2025 është 38,875 mijë lekë apo realizimi faktik i të ardhurave është në masën 101% krahasuar me parashikimin e tyre.
- Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 191,609 lekë, si edhe të planifikojë detyrimet nga vendimet gjyqësore duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, dhe të raportojë periodikisht në MFE vlerat e

detyrimeve të prapambetura faktike.-Bashkia Has, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për të përmirësuar procesin e planifikimit të të ardhurave bazuar në analizë realiste të performancës historike dhe të dhëna të verifikueshme. Po ashtu, të hartojë dhe të mbajë një listë analitike të saktë për të ardhurat e trashëguara nga burimet e veta, për të garantuar transparencë dhe kontroll mbi burimin dhe përdorimin e tyre.

Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve

- Pra rezulton se nga një total prej 993 prona të transferuara ne Bashkinë Has vetëm 33 prona kanë marrë certifikatë pronësie dhe 20 prona janë regjistruar dhe pritet të marrin çertifikatë.
- Për ish Komunën dhe aktualisht **Njësinë Administrative Golaj dhe për** ish Komunën dhe aktualisht **Njësinë Administrative Fajza** është miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike por mungon lista përfundimtare e pronave të cilat duhet të transferohen në pronësi të kësaj bashkie. Për ish Komunën dhe aktualisht **Njësinë Administrative Gjinaj** është miratuar lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në ish komunën Gjinaj, me VKM nr. 792, datë 16.11.2006 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Gjinaj" të qarkut të Kukësit, por mungon lista përfundimtare e pronave të cilat duhet të transferohen në pronësi të kësaj bashkie.

Mungesa e vazhdimit të procedurës për miratimin e listës përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Has. krijon një hendek të theksuar ligjor dhe administrativ.

Procedurat e ndjekura mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025, janë mbajtur **160 procesverbale konstatimi** për subjekte që lidhen me shkelje për ndërtimet pa leje, nga të cilat rezulton se Bashkia Has ka aplikuar vetëm shkresë për njoftimin e subjektit kundërvajtës për pezullimin e punimeve, ndërkohë rezulton se në asnjë rast nuk është shoqëruar me vendim për vendosjen e gjobës, në kundërshtim me nenin 52 pika 1 germa (e) të ligjit nr. 107 "Për planifikimin e territorit" i ndryshuar.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore mbi veprimtarinë e IMTV Bashkia Has, u konstatua se ka ushtruar funksionet e veta jo në përputhshmëri të plotë me detyrimet që përcakton ligji, si vijon:

- Në strukturën organizative të Bashkisë Has, rezulton se nuk është ngritur Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, por aktualisht janë 4 punonjës në cilësinë e inspektorit, pranë secilës njësi administrative por pa strukturë dhe pa Kryeinspektor.
- Nga 11 punonjës inspektor që kanë punuar ose punojnë aktualisht, vetëm njëri prej tyre ka arsimin e duhur, ndërsa gjithë të tjerët nuk kanë arsimin e nevojshëm për këtë pozicion pune;
- Në procedurat e mbajtura për ndërtimet dhe punimet pa leje, në të gjitha rastet mungojnë vendimet e gjobave për subjektet kundërvajtës;
- Në procedurat e mbajtura për ndërtimet dhe punimet pa leje, në të gjitha rastet mungojnë vendimet e pezullimit për subjektet kundërvajtës;
- Në procedurat e mbajtura për ndërtimet dhe punimet pa leje, në të gjitha rastet mungojnë vendimet e prishjes së ndërtimeve;
- Nuk ka asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi;
- Mungojnë planet vjetore dhe mujore të punës;
- Nuk ka kallëzime penale për subjekte/shtetas që kanë kryer ndërtime pa leje;
- Në procedurat e mbajtura për vitin 2023 mungojnë fotografitë e kundërvajtjes;
- Për periudhën objekt auditimi, nuk disponohej informacioni periodik 3 – mujor drejtuar IKMT për masat e marra;

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 4, neni 5 germat (a, b, ç, dh, f), neni 11 të Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar, Ligjin nr.107/2014

"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, neni 51, neni 52 pika 1 germa (e), Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", neni 41, si dhe me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore"

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot. 106/1, datë 28.01.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 02.02.2026 deri në datë 04.05.2026, në subjektin Bashkia Has për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2025 u krye auditimi "Mbi auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë", nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.V., *Përgjegjës grupi,*
2. M. B., auditues;
3. Sh. H., auditues;
4. A. S.**,** auditues;

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024-2025, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

Në përfundim të auditimit, hartohet Projekt Raporti i Auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Has.

2. Identifikimi i çështjes.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 "*Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi*", duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.
Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Has, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe Kifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Has.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Kryetari i Bashkisë Has ***(****Administratori i Përgjithshëm)*, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Has, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.
NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.
Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.
Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.[1]
Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

[1] Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni
15

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Has dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth Kave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Kifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Has është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm publik*"; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*"; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*"; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*"; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 "*Për miratimin e manualit të MFK*"; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 "*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*".

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:

Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 "*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*"; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*" i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 "*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*"; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*"; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*" i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "*Për përgatitjen e buxhetit vendor*"; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*".

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

VKM nr. 248, date 10.4.1998 "*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre*" i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*"; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*"; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 "*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*", udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 "*Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore*" .

- Në fushën e prokurimeve publike:

Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik*", i ndryshuar;

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar*"; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 "*Për sistemin e taksave lokale*", i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*", me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "*Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave* " i ndryshuar; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.

- Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:

Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 "*Për kundërvajtjet administrative*"; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*"; Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "*Për lejet e mjedisit*"; Ligji Nr. 107-2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*"; Ligji nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "*Për miratimin e manualeve të ndërtimit*"; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar*"; VKM nr. 894, datë 4.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i*

njësisë vendore"; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 "*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*" dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, "*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*", i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë*", i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, "*Për pagat e vetëqeverisjes Vendore*", i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit

ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*"; ISSAI 2300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*"; INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*"; ISSAI 400 "*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*", i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*"; si dhe ISSAI 4200 "*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*"; INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*" etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, Kifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "*jashtë normales*", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "*Dokumentimi i Auditimit*", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt-konstatimeve dhe Projekt Raportit të auditimit, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Has u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E në fushën e prokurimeve dhe menaxhimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, menaxhimin, inventarizimin dhe hipotekimin e pronave/aseteve.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Zona Gjeografike: Bashkia Has kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Krumës.
Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2023, bashkia numëron 11,684 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 21,764 banorë. Bashkia e Hasit ka një sipërfaqe prej 399.62 km2.
Historik i zhvillimit ekonomik: Bashkia Has përbëhet nga 4 Njësi Administrative. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 29 Fshatra. Pasuritë nëntokësore të këtij rajoni kanë nisur të shfrytëzohen në vitet '30 nga italianët. Deri në mesin e viteve '90 ka funksionuar miniera dhe fabrika e pasurimit të bakrit në Golaj, 6 kilometra larg qytetit të Krumës si dhe disa miniera më të vogla, ku ishin të punësuar mbi 3000 punëtorë. Jo vetëm banorët, por edhe specialistët thonë se nëntoka ende nuk është prekur. Për mineralin e bakrit dallohen zona Nikoliq Golaj, Krumë dhe Zahrisht në rrethin e Hasit. Relievi i zonës shtrihet nga rreth 300 metra mbi nivelin e detit deri në malet e larta të Gajrepit, Pashtrikut dhe Maja e Kunorës, të cilat gjenden në lartësitë 1400-1900 metra mbi nivelin e detit.
Sfidat me të cilat përballet: Bashkia përballet me një sërë sfidash të rëndësishme janë: Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sistemimi i rrjetit të kanalizimeve; Ndërhyrja në infrastrukturën e rrugëve dytësore të qytetit dhe Fshatrave përreth, mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe shëndetësore; Mbështetja dhe nxitja më tej e turizmit, rritja e të ardhurave nëpërmjet politikave fiskale dhe qiradhënies për menaxhimin e mirë të resurseve që ka kjo bashki; Ripërtëritja e jetës kulturore dhe artistike të zonës, por dhe zhvillimi i ambienteve dhe aktiviteteve sportive për rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën sociale të qytetit, etj.
Rendesia e këtij auditimi është sepse, auditimi është pjesë jetike e një sistemi rregullator, që ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efiçencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik për vitin 2025.

2.1.1. Mbi Identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike për periudhën e aktivitetit viti 2025.
Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga Bashkia Has, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem i rëndësishëm politikash i cili , i cili bazohet në krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, për të ndihmuar menaxherët në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve të përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e tyre. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të

mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Titullarët e njësive të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:
1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:
- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga stafi i Bashkisë Has, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se:

I. Komponenti "Mjedisi i kontrollit"

Mjedisi i kontrollit i jep tonin njësisë, duke influencuar vetëdijen kontrolluese të njerëzve të saj. Ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë duke siguruar disiplinën dhe strukturën. Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.
Menaxhimi ka rolin kyç në miratimin dhe mbështetjen e mjedisit të kontrollit. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë; filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës; mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon dhe zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike;
Parimi 2 - Titullari/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje;

Parimi 3 - Titullari/ Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë;
Parimi 4 - Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave;
Parimi 5 - Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Parimi 1 *- Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike.*
Titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 përcakohtet se "*Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje"*. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", institucionet duhet të hartojnë kod etike.
Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Has në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
-Bashkia Has ka miratuar Kodin e Etikës me shkresën nr. 1447 prot, datë 25.04.2024.
Për zbatimin e tij bashkia mbështetet në *Ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike",* i ndryshuar si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik.
-Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se bashkia vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me shkresën nr.586/1.prot, datë 18.02.2025 me Urdhër nr.68, datë 18.02.2025 "Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin e administratës së Bashkisë Has".
Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për strukturat e institucionit. Konstatohet se është rishikuar rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore për Njësinë e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Has, e miratuar me Urdhrin nr. 02, datë 19.11.2024 "Për Ndryshim të Rregullores së Brendshme për Njësinë e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Has" dhe ndryshimet janë kryer me urdhrin nr.75, datë 04.02.2026 "Për miratimin e ndryshimeve në rregulloren e NJAB".
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga sektori i burimeve njerëzore rezulton se struktura e Bashkisë Has është miratuar me urdhrin nr.12, datë 14.01.2025 dhe në rregulloren e brendshme përfshihen pozicione pune të strukturës aktuale përkatësisht:

- 8 pozicione pune me statusin i zgjedhur dhe funksionarë kabineti;
- 69 pozicione pune me status të nëpunësit civil; nga të cilët 49 janë pa status
- 226 pozicione pune janë punonjës administrativë dhe rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

-Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nuk ka asnjë procedurë për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj.
-Mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës.
-Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Has në përputhje me *ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit" e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me Urdhër nr. 27, datë 27.01.2025*

"Për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Mbrojtjen e Konfidencialitetit në Institucionin e Bashkisë" .
Gjatë vitit 2025 nuk janë dhënë masa disiplinore për punonjësit.
-Për rastet e raportimit lidhur me ankesat për korrupsion, funksionon sektori i çështjeve të anti korrupsionit, ngritur pranë bashkisë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike", i ndryshuar.
-Njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore bashkëpunon me zyrtarët raportues dhe zyrtarin autorizues në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil.
Procesi i vlerësimit për 20 punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil nuk është kryer sipas formularit tip një herë në 6 muaj (ose dy herë në vit). Po ashtu nuk ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Parimi 2 *- Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.*
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstron dhe nxit kompetencën dhe sjelljen etike. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në nenin 8, pika 8/a të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, përcaktohet se *"Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave*". Për sa më sipër rezulton se Bashkia Has nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.
-Për vitin 2025, situata paraqitet pjesërisht efektive, ajo që vlen të theksohet është mungesa e raportimeve të rregullta periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion. Evidentohet se ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.
Titullari i Bashkisë mbikëqyr projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Rezultojnë Raporte nga Njësia e Auditimit të Brendshëm lidhur me monitorimin e kontrollit të brendshëm të institucionit të cilat janë të miratuara nga titullari.
-Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.
Në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se "*GMS duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike"*. Për sa më sipër, për vitin 2025, rezulton 1dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS.

Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, përcaktohet se "*Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës*".
Mungon plani i menaxhimit të risqeve të nivelit të lartë e të mesëm për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
Parimi 3 *- Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.*

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit te delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit/Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.
- Bashkia Has ka rregullore të brendshme të miratuar dhe publikuar nga titullari për veprimtarinë e institucionit, përfshirë të gjitha autoritetet, përgjegjësitë menaxheriale dhe operacionale, linjat e raportimit sipas strukturës organizative si dhe bazën ligjore për të gjithë veprimtarinë e bashkisë.
- Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.
-Me Vendimin nr. 1, datë 04.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Has" për vitin 2025, titullari ka miratuar strukturën e përbërë nga 300 (treqind) punonjës,
Kjo strukturë ka ndryshuar me vendimin nr. 01/3, datë 22.08.2024, e përbërë nga 303 punonjës.
-Përgjatë vitit 2025 janë rekrutuar 47 punonjës të rinj dhe janë larguar 43 punonjës. Referuar strukturës së miratuar rezultojnë 7 vende vakante, si: 2 specialistë në Sektorin e Auditit të Brendshëm, 1 specialist në sektorin e burimeve njerëzore, 1 përgjegjës në sektorin e turizmit dhe 3 punonjës shërbimi.

Tabela nr.1: Struktura e Bashkisë Has për vitin 2025

		Nëpunës Civilë	69
Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	303	Nëpunës me kontratë	226
		Të zgjedhur	8

Burimi: Sektori i Burimeve Njerëzore Has, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Nga auditimi konstatohet se është rishikuar rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë ka çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të mire përcaktuara.
- Rezulton se delegohen përgjegjësitë brenda bashkisë nga ana e menaxherëve nëpërmjet urdhrave të delegimit por nuk analizohen risqet që lidhen me funksionet dhe kompetencat e deleguara.
- Evidenca të analizës së riskut ka vetëm nga Njësia e Auditit të Brendshëm.
Bashkia Has nuk disponon përshkrime pune, dhe procedura e ndjekur për hartimin e tyre nuk është bërë në përputhje me nenin 24, të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 "*Për përshkrimin dhe Kifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*" në të cilin përcaktohet se "Procesi i vlerësimit të punës ndjek këto faza: a) krijimi i komitetit të vlerësimit; b) identifikimi i pozicionit/ pozicioneve të punës që do të vlerësohen; c) vlerësimi me faktorë dhe pikëzimi sipas metodologjisë së vlerësimit të pozicionit të punës; ç) Kifikimi i pozicionit të punës në kategorinë, Kën dhe grupin përkatës". Gjithashtu, këto përshkrime pune nuk

janë miratuar nga DAP, sikurse përcaktohet në nenin 35 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 "Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës shtetërore: a) miraton propozimin për Kifikim të pozicionit/pozicioneve të punës; b) kthen për rivlerësim pozicionin/pozicionet e punës dhe vendos një afat të arsyeshëm për plotësimin e rivlerësimit".
-Sekretari Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore nuk kanë kryer vlerësimet 6- mujore dhe vjetore të punonjësve, rezultojnë vetëm 7 punonjës me vlerësim pune për vitin 2025 nga 20 punonjës me status të nëpunësit civil.
Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku Bashkia Has përdor fare pak procedurat për delegimin e detyrave, kryesisht atë të delegimit në mungesë.

Parimi 4 *- Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave.*
Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.
-Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.
Nga Sektori i Burimeve Njerëzore është ngritur Komiteti i Vlerësimit dhe të Përshkrimeve të Punës më shkresën nr. 3286.prot, datë 15.10.2024 me Urdhër nr. 455/1, datë 15.10.2024 Përshkrimet e punës nuk janë rishikuar periodikisht edhe pse bashkia ka ndryshuar strukturën e saj. Nuk janë kryer vlerësimet periodike të punonjësve nga menaxherët në lidhje me arritjen e objektivave dhe respektimin e Kodit të Etikës dhe ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil". Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatuan mangësi në plotësimin e dokumentacionit si: dokumentacioni i arsimimit kualifikimin, akti emërimit dhe procedura e ndjekur, trajnimet, raporte mjekësorë, certifikata familjare, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, etj, në kundërshtim me VKM nr.833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".
-Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Burimeve Njerëzore mbi rekrutimet dhe largimet, rezultoi se përgjatë vitit 2025 janë rekrutuar 103 punonjës të rinj dhe janë larguar 55 punonjës. Bashkia Has nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.
-Për sa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, gjatë vitit 2024 për vitin 2025, bashkia ka hartuar një plan vjetor të trajnimeve për të gjithë punonjësit pjesë e Shërbimit Civil me shkresën nr. 3383/1.prot, datë 22.10.2024 drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) të cilët bëjnë vlerësimin e nevojave për trajnim, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Për vitin 2025, janë kërkuar të kryhen 83 tema trajnimi sipas nevojave të drejtorive dhe sektorëve dhe është kryer vetëm 1 temë trajnimi "Për Shërbimin Civil" nga sektori Burimeve Njerëzore.
-Bashkia Has nuk disponon një regjistër të detajuar për regjistrimin e trajnimeve të kryera nga nëpunësit e institucionit por parashikohen fonde në buxhet për trajnime në fusha. të ndryshme.
-Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të *ligjit 114/2015 "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit".*

***Parimi 5** - Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale*

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.
-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi, rezulton se bashkia nuk i ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale për hartimin dhe monitorimin e objektivave strategjikë në dokumentin e rregullores së brendshme.
-Gjithashtu, evidentohet se Bashkia Has, nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë.
Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.
Për vitin 2025, është hartuar shkresa me nr. 79 prot., datë 08.01.2024 me Vendimin nr. 1, datë 08.01.2024 "Për Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA-së 2024-2026, Bashkia Has" si dhe ndryshimet e bëra me shkresën nr.3734.prot., datë 19.11.2024, me Vendimin nr. 02, datë 19.11.2024 "Për Ndryshim në Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për Hartimin e PBA-së 2024-2026, Bashkia Has".
Gjatë vitit 2025 është mbajtur 1 mbledhje e GMS me procesverbal nr.3897, datë 28.10.2025.
GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.
Për vitin 2024, është përcjellë në MFE "Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Has dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm" me shkresën nr. 728.prot, datë 28.02.2025.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 20.
-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", Kreu II. "Dosja e Personelit";
-"*Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.1, Kapitulli IV "Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit", Kapitulli V, Anekset.*

I. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.
Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 6 - Specifikimi i objektivave të përshtatshëm.
Parimi 7 - Identifikimi dhe analiza e risqeve.
Parimi 8 - Mundësia e riskut të mashtrimeve.
Parimi 9 - Identifikimi dhe analiza e ndryshimeve të rëndësishme.

Parimi 6 *- Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.*

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Është e rëndësishme që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.

Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Nga analiza e të dhënave, duke marrë në konsideratë se Bashkia Has duhet të specifikoj dokumentet e planifikimit, njësia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm, në të cilin evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Bashkia Has nuk ka plan-veprime vjetore operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

Parimi 7 *-Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.*

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

-Regjistri i riskut ku përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Has si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre është hartuar me shkresën nr.4375, datë 02.12.2025.

-Titullari i bashkisë ka ngritur Urdhër nr. 3/1, datë 16.01.2025 për "Menaxhimin dhe Koordinimin e Riskut në Bashkinë Has" për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimit mbi risqet.

Gjithashtu, ky institucion për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar.

Mungesa e një strategjie risku dhe e identifikimit të risqeve me qëllim marrjen e masave për eliminimin apo zbutjen e efektit të tyre, cenon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale.

Parimi 8 *- Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve*.

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

-Nga auditimi evidentohet se Bashkia Has nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi 9*- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme*

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.
-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel jo të mirë sa i takon plotësimit të strukturës me auditues.
-Bashkia Has ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, b, c ,ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 21, pika 2;
-Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 3 "Përgjegjësitë dhe detyrat e KR", pika 3.2.1 "Titullari i njësisë publike" pika 4 "Hapat për ngritjen e sistemit të MR"
-"Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.2, Kapitulli V, Anekset.

II. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 10 - Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit.
Parimi 11 - Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.
Parimi 12 - Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe proçedurave.

Mungesa e identifikimit të risqeve, mungesa e një strategjie institucionale në të cilën të jenë përcaktuar objektivat dhe planet e veprimit, si dhe mungesa e qartë e ndarjes së detyrave në Bashkinë Has, vështirësojnë kryerjen efektive të kontrolleve, identifikimin e parregullsive dhe nxjerrjen e përgjegjësieve.
Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.
Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

-Në vijim të auditimit të kryer, mund të themi se ka problematika për t'u adresuar, të cilat lidhen kryesisht me mungesën e hartave apo manualeve të proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive.
Përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.
-Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezulton se asnjë prej drejtorive nuk ka hartë dhe manual të proceseve të punës.
-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
-Nga komunikimi me punonjësit e Drejtorisë së Burimeve rezulton se ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person. Detyrat janë të ndara. Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga nëpunësi zbatues, regjistrohet nga specialisti i buxhetit dhe miratohet nga nëpunësi zbatues. Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga specialisti për kontabilitetin dhe autorizimi i pagesës kryhet nga nëpunësi autorizues.
-Në zbatim të *ligjit nr. 162 datë 23.12.2020"Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, bashkia ndjek procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj..
-Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP dhe krijimi i tyre në sistemin e PP" është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve.
-Bashkia Has ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.
-Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Nuk ka asnjë procedurë të miratuar nga titullari dhe gjurmë auditi për inventarizimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale. Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" i ndryshuar.
Gjurma e auditimit
Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.
Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësisë. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.
Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar përcaktohet se "*Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.*

Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi". Për sa më sipër, rezulton se Titullari i Bashkisë Has për vitin 2025 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.
-Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se, bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.
Gjurma e auditimit duhet të ndërtohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.
Në Drejtorinë e Financës janë përcaktuar dhe ndarë detyrat për çdo specialist, dhe miratohen konform ligjit nga përgjegjësi i sektorit dhe n/zbatues në vijim nga nëpunësi autorizues.
Specialisti i buxhetit kryen gjithë procedurën për regjistrimin e çeljeve të fondeve dhe pakësimit të tyre në Microsoft Access.
Specialisti i kontabilitetit kryen gjithë regjistrimet e aktiveve në sistemin Acces, shtesat pakësimet, amortizimet, etj., janë të regjistruara në këtë sistem.
Specialisti i pagave mban liste pagesat për çdo sektor kontabilizimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP, harton dhe nënshkruan gjithë urdhërpagesat që kryhen nga ky sektor. Në vijim çdo dokument kontrollohet dhe miratohet pastaj regjistrohet në sistem konform Udhëzimit të MF Nr. 24, datë 29.08.2019 "*Për Përdorimin e Arkivës Elektronike në Procesin e ekzekutimit të Buxhetit të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme''*, të ndryshuar.

Parimi 11 **-** Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë
Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.
- Bashkia Has ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra sisteme qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS).
- Nga auditimi rezulton se bashkia nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it. Bashkia Has për vitin 2025 ka vendosur procedura për të siguruar vazhdimësinë e veprimeve kundrejt risqeve kryesore që mund të pengojnë këtë veprimtari. Pra, ka plane të vlerësimit të riskut për Bashkinë Has, për sigurinë e aktiveve nga zjarri/përmbytjet dhe rimëkëmbjet nga fatkeqësitë miratuar nga titullari i institucionit me nr. 874/1.prot, datë 26.09.2024.

Parimi 12 **-** Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.
Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.
-Bashkia nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. Nuk ka procedura të shkruara operative për vlerësimin, përzgjedhjen, konstatimin dhe monitorimin e investimeve.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;

-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 5.2.7 "Monitorimi dhe Raportimi";
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

IV Komponenti: "Informimi dhe komunikimi"

Komponenti i katërt i kontrollit të brendshëm ka të bëjë me çështjet e informacionit dhe të komunikimit. Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 13 - Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor.
Parimi 14 - Komunikimi i brendshëm
Parimi 15 - Komunikimi i jashtëm

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Has ka një faqe zyrtare ëeb në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen ëeb Bashkia Has ka programin e transparencës, në zbatim me *ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ku në nenin 4 përcaktohet se 'Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga 19 hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim të një program institucional të transparencës*, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni". Gjithashtu, Bashkia Has ka edhe regjistrin me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në zbatim me këtë ligj ku në nenin 8 përcaktohet se "Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.

Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër".

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Në vijim të auditimit, rezulton se bashkia i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit. Bashkia ka një sistem komunikimi si brenda dhe jashtë institucionit dhe ky sistem jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.
-Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.
-Institucioni operon me program të vetin të kontabilitetit, në përputhje me udhëzimet dhe ligjin e kontabilitetit të pasqyrave financiare.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm
Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.
-Për sa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, proces verbalet e mbledhjeve komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare.
-Faqja zyrtare e institucionit përditësohet rregullisht dhe punonjësit kanë e-mail zyrtar.
-Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.
-Bashkia Has siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.
-Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.
Për vitin 2025 janë zhvilluar 12 dëgjesa publike në Bashkinë Has. Dëgjesa Publike janë zhvilluar në lidhje me konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, miratimin e Buxhetit të Bashkisë Has, Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, Miratimi i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has për vitin 2025 për vitin 2025 dhe Plani i Përmirësimit të Arsimit Parashkollor, etj.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 23, "Informacioni dhe Komunikimi" pika 2;
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

V. Komponenti: "Monitorimi"
Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm. Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 16 - Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe/ose të veçanta
Parimi 17 - Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm
Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herë pas hershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

-Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucion nuk ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.
-Bashkia Has monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE.
Për periudhën nën auditim, rezulton se Bashkia Has ka plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit i cili i është dërguar Ministrisë së Financave (DHMFK) me shkresën nr.776 prot, datë 25.02.2026. Për vitin 2025 rezulton se nëpunësi autorizues i Bashkisë Has ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në zbatim me nenin 18, të ligjit për MFK-në. Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm nuk është gjithëpërfshirës, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet. Bashkia Has nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.
Për vitin 2025 nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has është hartuar plani vjetor i trajnimeve në përputhje me *Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe "Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".*
-NJAB ka hartuar Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2025.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë
Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.
-Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por ecuria e zbatimit të tyre është e ngadaltë.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 24, "Monitorimi" pika 1;
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.

Sa më sipër, arrihet në konkluzion se:
Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:
Komponenti "Mjedisi i kontrollit"
-Nga auditimi konstatohet se është rishikuar Rregullorja e Brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë ka çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të mire përcaktuara;

-Ka procedurë për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj. Mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës;
-Titullari i bashkisë nuk ka miratuar plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm e të lartë.
-Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor;
- dosjet personale të punonjësve të rekrutuar kanë mangësi në dokumentacion dhe mungesa si: librezat e punës, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, etj.
-Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë;
Komponenti "Menaxhimi i Riskut"
-Për vitin 2025 nuk është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Has si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre;
Titullari i bashkisë ka ngritur Urdhër nr. 3/1, datë 16.01.2025 për "Menaxhimin dhe Koordinimin e Riskut në Bashkinë Has" për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimit mbi risqet.
Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"
-Bashkia Has ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale nuk janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës;
-Mungojnë hartat dhe manualet e proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive;
- Bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.
Komponenti: "Informimi dhe komunikimi"
-Faqja zyrtare e institucionit përditësohet rregullisht dhe punonjësit kanë e-mail zyrtar.
-Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.
Komponenti: "Monitorimi"
-Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara. Bashkia Has nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.
-Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

***Konkluzion**:*
Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se Bashkia Has nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe nuk ka hartuar plane vjetore të punës për të gjitha drejtoritë.
-Për vitin 2025 nuk është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Has si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve

me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre si dhe nuk ka hartuar plan-veprime për menaxhimin e riskut.
-Mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatorë apo kodin e etikës. Titullari i bashkisë nuk ka miratuar plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm e të lartë.
-Nuk është plotësuar struktura për 7 vende pune.
-Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë.
Mungojnë hartat dhe manualet e proceseve të punës çka sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive. Bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"; Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"; Manualin e MFK-së, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

2.1.2. Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm

Për organizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm, u auditua dokumentacioni si më poshtë:
-Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Has;
-Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
-Programimi i auditimeve për vitin 2025
-Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
-Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
-Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre;
-Vlerësimi i auditimeve.

Auditimi u krye referuar akteve ligjore e nënligjore si më poshtë:

-Ligji Nr.114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar;
-Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 "*Për Arkivat*";
-VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*";
-Manuali i "*Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*" miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016;
-VKM nr.160, datë 02.03.2016 "*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike*" i ndryshuar;
-Udhëzimi Nr.42, datë 27.10.2020 "*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik*";
-Urdhëri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë *"Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016";*
-Normat Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Auditimi u fokusua kryesisht në këto çështje:
-Organizimi dhe funksionimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm/Komitetit të Auditimit, niveli profesional i audituesve, çertifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme, bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, niveli i raportimit në këtë drejtori,
-Realizimi i treguesve të planifikuar nga NJAB,
-Sigurimi i cilësisë së auditimit, me qëllim vlerësimin nëse veprimtaria e auditit të brendshëm është në përputhje me kriteret ligjore dhe standardet e auditimit, konkretisht Ligjin Nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e *brendshëm në sektorin publik*", "*Manualin e Auditimit të Brendshëm*", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar.

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e NJAB të Bashkisë Has, rezultoi se:

- **Organizimi dhe Funksionimi:** Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve për ngritjen e NJAB në sektorin publik" Bashkia Has ka ngritur NJAB.

Për vitin 2025 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 2 (audituesi). Sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Titullari i Bashkisë me *Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 136, datë 23.12.2024,"Për Numrin e Punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, Njësive Administrative dhe Kifikimin e Pagave të Administratës dhe Punonjësve të Tjerë për vitin 2025 - Bashkia Has"*, struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm është e përbërë nga 3 punonjës.
Struktura e Bashkisë Has është miratuar me shkresën nr. 102 prot, datë 14.01.2025 me Urdhër nr. 12, datë 14.01.2025 *"Për miratimin e Strukturës, Organigrama e Bashkisë Has, viti 2025".*
Detyrat dhe kompetencat e Njësisë së Auditimit të Brendshëm janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Has nr. 586/1 datë 18.02.2025 me Urdhër nr. 68, datë 18.02.2025 *"Për Miratimin e Rregullores për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Bashkisë Has".*
Njësia e Auditimit të Brendshëm me Urdhër nr. 75, datë 04.02.2026 ka miratuar Rregulloren e Brendshme *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Bashkia Has",* mbi bazën e të cilës funksionojnë struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm.
Struktura e NJAB, niveli i arsimit, certifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës si më poshtë:

Tabela nr.1:

Nr	Periudha 2025	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	**E. Z.**	Audituese	I lartë Master Shkencor	4	2	JO	PO
2	**S. Sh.**	Audituesi	I Lartë Master Shkencor	1	1	JO	JO

Burimi: Bashkia Has.

Audituesi S. Sh. është larguar nga detyra në muajin Tetor 2025, i cili është punësuar pa plotësuar vjetërsinë e punës prej 3 vjet në profesion, po kështu edhe audituesja në detyrë në kundërshtim me ligjin nr.114, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" neni 11 "Punësimi i audituesit të brendshëm" pika 2 germa "a" dhe "c" ku kërkohet: a) *audituesit e brendshëm të kenë diplomë të arsimit të lartë të ciklit të dytë të studimeve në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet; c) audituesi i brendshëm duhet të këtë përvojë pune jo më pak se 3 vjet në profesion dhe të jetë i certifikuar si "Auditues i brendshëm në sektorin publik";*

Konkluzion: Për vitin 2025 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 2(dy) auditues, jo sipas strukturës organizative të miratuar nga Titullari i Bashkisë me *Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 136, datë 23.12.2024,"Për Numrin e Punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, Njësive Administrative dhe Kifikimin e Pagave të Administratës dhe Punonjësve të Tjerë për vitin 2025 - Bashkia Has"*

Pra, struktura e miratuar me *Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 136, datë 23.12.2024,* është në mbështetje të VKM nr.83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik" pika 3 e cila përcakton se: "*Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3(3) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë. Në strukturën e Njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si audituesë të brendshëm në sektorin publik*", por nuk është e plotësuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes të punonjësit të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se 1 nga punonjësit nuk ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnime për kualifikimin profesional dhe 1 audituese nuk është e certifikuar, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" nenet 11, "Punësimi i Auditit të Brendshëm" neni 19 "Çertifikimi i audituesve të brendshëm" dhe neni 20 "Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm".

- **Komiteti i Auditimit të Brendshëm**, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj, nuk është krijuar nga Bashkia Has.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e organit që bashkërendon, harmonizon dhe monitoron veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, me shkresën nr.13893.,prot, datë 22.07.2019 *"Mbi krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm,* ka ofruar asistencë në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Kukës nëpërmjet propozimit të disa hapave konkrete.

Referuar ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 12, pika b, përcakton se *Titullari i Njësisë Publike është përgjegjës për vendimmarrjen e krijimit të Komitetit të Auditimit.*

Nga auditimi rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 13 "Komitetit të Auditimit të Brendshëm" *i cili përcakton se:"Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:*

a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;

b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;

c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;

ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;

d) duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;

dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.

3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

Konstatim: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 të ligjit 114/2015 *"Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik".*

- **Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik**

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik" në Bashkinë Has, e cila është miratuar nga titullari me Urdhër nr. 02, datë 08.01.2025.

Karta e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has është dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 32 prot, datë 08.01.2025.

- **Kodi i Etikës për Audituesit e Brendshëm.**

NJAB në mbështetje te Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" ka hartuar "Kodin e Etikës për Audituesit e Brendshëm" në Bashkinë Has, e cila është miratuar nga titullari me Urdhër nr. 3, datë 08.01.2025.

Kodi i Etikës për Audituesit e Brendshëm në Bashkinë Has është dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 34 prot, datë 08.01.2025.

- **Planet Strategjike dhe Vjetore:**

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

Për vitin 2025 me shkresën nr. 3300 prot, datë 16.10.2024 është miratuar Plani Strategjik për vitet 2025 - 2027 dhe Plani Vjetor i auditimeve për vitin 2025.

Plani Vjetor 2025 dhe Plani Strategjik për vitet 2025 - 2027 është dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 3299 prot, datë 16.10.2024 në përputhje me *Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* i ndryshuar, *si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar.

Njësia e AB në Bashkinë Has mbulon me auditim ***25 subjekte:*** ku 5 subjekte janë drejtori, sektorë e inspektorate të tjera në juridiksionin e Bashkisë Has, si Sektori i Edukimit dhe Shërbimeve në Konvikt, Arsimi Parashkollor + QKF, Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH), Administrimi i Pyjeve, Bordi i Kullimit, Gjendja Civile si edhe ***3 subjekte Njësi Administrative*** në juridiksionin e Bashkisë Has si: NJA Golaj, NJA Fajza, NJA Gjinaj.

- **Realizimi i Planeve Vjetore:**

Sipas Planit Vjetor të miratuar**,** janë realizuar gjithsej 4 misione auditimi në 5 subjekte auditimi, sipas planifikimit.

Tabela nr.2: Realizimi e auditimeve

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
				Përputhshmëri	Financë	Kombinuar	Performancë	Zb.Rek
1	Viti 2025	5	4	2	-	-	1	1

Burimi: Bashkia Has

Për vitin 2025, janë planifikuar për t'u audituar 5 subjekte, ose 20% e subjekteve nga të cilat mbulon me auditim Bashkia Has.

- **Raportimi:** Për veprimtarinë e NJAB Në Bashkinë Has për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB (Ministrinë e Financave) raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht: Me shkresën nr.

574.prot, datë 10.02.2026, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Bashkia Has për vitin 2025. Të dhënat për realizimet e angazhimeve nga AB për auditimet e kryera paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3: Realizimi i angazhimeve të auditimit.

Nr	Subjektet e Audituara	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit		
			A. të përputhshmërisë	A. të performancë	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara			Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces
1	Zbatimi rekomandimeve 2024	27								**1**	
2	Sektori Juridik dhe Prokurimet Publike	1	**1**	-	-	-	-	-	-	**1**	-
3	Njësitë Administrative Golaj, Fajza & Gjinaj	1	**1**	-	-	-	-	-	-	**1**	-
4	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Utilitare	1	-	**1**		-	-	-	-	**1**	-

Burimi: Bashkia Has, përpunuar nga grupi i Klsh-së.

Referuar realizimit të angazhimeve për vitin 2025, konstatohet se janë audituar 12% e subjekteve nga të cilat mbulon me auditim Bashkia Has.
Plani i auditimeve është realizuar në masën 80%, ose 1 angazhim auditimi pa u realizuar.
Statusi i nivelit të realizimit të rekomandimeve të dhëna nga auditi i brendshëm për vitin 2024 paraqitet: nga 27 rekomandime gjithsej, 19 janë realizuar, 6 janë në proces zbatimi dhe 2 janë pa zbatuar.

- **Gjetje - Rekomandime**

Për vitin 2025, Nga auditimet janë evidentuar 42 gjetje, për të cilat janë dhënë 90 rekomandime, nga të cilat 26 rekomandime për përmirësimin e sistemit, 11 rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor, 26 janë rekomandime të karakterit organizativ, 14 rekomandime për arkëtime, dhe 13 rekomandime të tjera, të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Tabela nr.4: Gjetje - Rekomandimet nga A.B

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
4	Viti 2025	90	-	90	-	-	-	-	-
TOTALI		**90**	-	**90**	-	-	-	-	-

Burimi: Bashkia Has

Tabela nr.5: Të dhënat e gjetjeve sipas fushave të auditimit dhe subjekteve të auditimit

Nr	SUBJEKTI AUDITUAR	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE NE NUMER	

		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig. Shoq. sig,shendetesore, përkujdesje shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave vendore, doganave	Sistemet e administrimit pronës,/ territorit pasurisë	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Sistemet e legalizimeve,Urbanistikës, IMTV kthim pronash	Sistemet e kreditimit, subvencioneve (Ndihma Ekonomike)	Të tjera	Audituesi mbuluar me auditim
1	Sektori Juridik & Prokurimet Publike	**6**	**2**	-	-	-	-	-	-	-	**3**	
2	Njësitë Administrative Golaj, Fajza & Gjinaj	-	**1**	-	**2**	**2**	-	-	**2**	**1**	**7**	"
3	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Utilitare	**1**	**1**	-		**6**	-	-	-	-	**8**	"
	Totali	**7**	**4**		**2**	**8**			**2**	**1**	**18**	

Burimi: Bashkia Has, përpunuar nga grupi i Klsh-së.

Ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve te manualit të A.B. NJAB u ka dërguar Akt Verifikime për zbatimin e rekomandimeve të vitit 2024 me shkresa zyrtare të protokolluara tek zyra e Protokoll- Arkivit, po ashtu u janë dërguar edhe Raportet Finale njësive të audituara për informim e zbatim mbi nivelin e zbatimit të tyre dhe në auditimin e radhës është çështja e zbatimit të rekomandimeve trajtohet si çështje kryesore.
Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.7: Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara,

Nr	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2025	STATUSI I REKOMANDIMEVE				REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT				
			Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të përmirësimin e sistemeve	Rekomandime të përmirësimin e kuadrit ligjor	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtime	Rekomandime të tjera
1.	Sektori Juridik & Prokurimet Publike	26	26	26	-	26	8	4	7	2	5
2	Njësitë Administrative Golaj, Fajza & Gjinaj	25	25	25	-	25	6	4	4	5	6
3	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Utilitare	39	39	39	-	39	12	3	15	7	2
	Totali	**90**	**90**	**90**		**90**	**26**	**11**	**26**	**14**	**13**

Burimi: Bashkia Has, përpunuar nga grupi i Klsh-së.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se nga 90 masa të rekomanduara, janë pranuar 90 rekomandime të cilat janë në proces zbatimi.
Nga auditimi rezulton se Njësia e Auditimit të Brendshëm ka marrë në shqyrtim dhe ka mbikëqyrur procesin e monitorimit e ndjekjes së rekomandimeve të dhëna nga struktura e auditimit të brendshëm.

Grupi i auditimit ka analizuar ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm me Raportimin Vjetor të Nivelit të Zbatimit të Rekomandimeve me nr. 1147/1 prot, datë 07.04.2025 i cili është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në MF me shkresën përcjellëse me nr.1147prot, datë 07.04.2025, kjo për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.

- **Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.**

Nga auditimi i detajuar i dosjeve të auditimeve të kryera në subjektet:

Për vitin 2025, janë audituar dosjet si mëposhtë:
1. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm.
2. Njësitë Administrative Golaj, Fajza dhe Gjinaj
3. Sektori Juridik dhe Njësia e Prokurimeve
4. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Utilitare

Referuar dokumentacionit të dosjeve të audituara nga njësia e Auditit të Brendshëm konstatohet se janë identifikuar mangësitë në drejtim të funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, strategjisë së riskut, procedurave të prokurimit, organizimin e burimeve njerëzore, etj, për të cilat janë dhënë rekomandime për përmirësimin e gjendjes.

Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:
- Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2025, është hartuar me shkresën nr.3992 prot, datë 20.10.2025, dhe është dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MF me shkresën nr. 3771 prot, datë 20.10.2025.

Nga auditimi rezulton se NJAB ka marrë në shqyrtim dhe ka mbikëqyrur procesin e monitorimit e ndjekjes së rekomandimeve të dhëna nga struktura e auditimit të brendshëm. Grupi i auditimit nuk ka analizuar arsyet e mosrealizimit të rekomandimeve të mëparshme, referuar Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.13.3 përcaktohet se: *Një njësi e mirë menaxhuar vendos procedura për t'u siguruar se çdo rekomandim i bërë nga njësia e AB, zbatohet ashtu siç duhet. Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkëpunim me menaxhimin cakton një punonjës me përvojë që të evidentojë të gjitha rekomandimet e bëra nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë, monitorojë dhe informojë për progresin që është bërë për zbatimin e tyre. Kjo do të ndihmojë që të sigurohet se përmirësimi i kontrolleve të brendshme është përgjegjësi e menaxhimit të njësisë publike dhe jo rol i Njësisë së Auditimit të Brendshëm"*

Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:
a- Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit;
b- Letrat e punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Projekt Raportit dhe Raportit Final nga audituesit;
c- Bazueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standartet e auditimit, rezultoi se:
- Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016.
- Subjektet e audituara kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12. Hapi 11, "Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar".

- Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare në përgjithësi është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit.
- Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2025 është hartuar, miratuar dhe dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MFE me shkresën nr. 515.prot, datë 13.02.2026

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion u konstatua se:

-Për vitin 2025, Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 2(dy) audituesi *(deri në tetor 2025 dhe më pas me 1 audites)* në kundërshtim me strukturën organizative të miratuar nga Titullari i Bashkisë me *Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 136, datë 23.12.2024,"Për Numrin e Punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, Njësive Administrative dhe Kifikimin e Pagave të Administratës dhe Punonjësve të Tjerë për vitin 2025 - Bashkia Has"*

-Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes të punonjësit të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se 1 nga punonjësit nuk ka ndjekur trajnime për kualifikimin profesional nuk është trajnuar në fushat e planifikuara në Planin Strategjik të Auditimit, si edhe nuk ka kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut; dhe 1 audituese nuk është e certifikuar, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" nenet 11, "Punësimi i Auditit të Brendshëm" neni 19 "Çertifikimi i audituesve të brendshëm" dhe neni 20 "Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm".

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";*

-Për vitin 2025, janë planifikuar për t'u audituar 5 subjekte, ose 20% e subjekteve nga të cilat mbulon me auditim Bashkia Has, plani i auditimeve është realizuar në masën 80%, ose 1 angazhim auditimi pa u realizuar. Referuar realizimit të angazhimeve për vitin 2025, konstatohet se janë audituar 12% e subjekteve nga të cilat mbulon me auditim Bashkia Has.

- Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve nuk është dhënë asnjë opinion apo analizë mbi arsyet e mos realizimit të rekomandimeve të mëparshme si dhe mungon konkluzioni nga audituesit për masat që duhet të marrë menaxhimi i subjektit të audituar për realizimin e tyre.

Veprimtaria e Njësisë së Auditit të Brendshëm, nuk është e plotë sepse nuk pasqyron mangësitë në aktivitetin ekonomik dhe financiar të njësive varëse pasi nuk janë audituar 22 subjekte nga 25 që ka në varësi Bashkia Has, si pasojë e mos plotësimit të strukturës me audituesi, në përbërje të saj është 1 audites prej muajit Tetor të vitit 2025.

Për sa më lart është mbajtur Akt konstatimi nr. 2, datë 04.05.2026.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit për periudhën 2024-2025.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;

2.2.5. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, është si vijon:
-Projekt-buxheti i miratuar për vitet 2024- 2025;
-Vendimet e KB "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Has" për vitet 2024 - 2025;
-Vendime të tjera të KB, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
-Situacioni i shpenzimeve për vitet 2024- 2025 rakorduar me Degën e Thesarit;
-Situacioni i të ardhurave për vitet 2024 - 2025 i rakorduar me Degën e Thesarit;
-Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
-Raportimet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura të Bashkisë Has;
-Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.
Baza Ligjore:
-Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
-Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
-Ligji nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024";
-Ligji nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025";
-Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar;
-Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".
-Udhëzimi i MFE nr.3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor"
-VKB nr.22, datë 31.03.2023 "Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të buxhetit afatmesëm 2024-2026".
-VKB nr. 35, datë 22.12.2023, "Buxheti i Bashkisë Has për vitin 2024 dhe PBA vitit 2024-2026", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 2/46, datë 04.01.2024.
-VKB nr. 137, datë 23.12.2024, "Buxheti i Bashkisë Has për vitin 2025 dhe PBA vitit 2025-2027", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 2/34, datë 08.01.2025.

-Programimi i PBA-së 2024-2026 dhe programi i buxhetit vjetor
Për hartimin e PBA-së për periudhën 2024-2026, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Has janë ndjekur dhe realizuar fazat e përgatitjes duke filluar me ngritjen e Grupit të Manaxhimit Strategjik (GMS) me Vendimin nr.1, datë 08.01.2024 dhe grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit, ekipeve të menaxhimit të programeve, miratimin e tavaneve buxhetore, miratimin me VKB nr. 35, datë 22.12.2023, "Buxheti i Bashkisë Has për vitin 2024 dhe PBA vitit 2024-2026", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr.2/46, datë 04.01.2024.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.
Kryetari i Bashkisë Has ka miratuar udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë me shkresën nr.739, datë 05.04.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026".
Tabela nr. II.1.1: Programimi i shpenzimeve për vitin 2024-2026 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2024		Viti 2025		Viti 2026	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	53,797	14.30%	56,200	13.80%	58,810	17.33%
2	Shërbimet e Policisë Vendore	5,740	1.53%	6,680	1.64%	7,016	2.07%
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	27,605	7.34%	28,640	7.03%	29,653	8.74%

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2024		Viti 2025		Viti 2026	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
4	Shërbimet Bujqësore, inspektimi, ushqimi	4,787	1.27%	4,887	1.20%	5,035	1.48%
5	Menaxhimi I Infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit	13,173	3.50%	13,375	3.28%	13,484	3.97%
6	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	19,875	5.28%	20,076	4.93%	20,405	6.01%
7	Rrjeti rrugor rural	28,827	7.66%	29,332	7.20%	30,026	8.85%
8	Menaxhimi i Mbetjeve	7,026	1.87%	7,382	1.81%	7,752	2.28%
9	Planifikimi Urban dhe Vendor	4,831	1.28%	5,244	1.29%	5,395	1.59%
10	Shërbimet publike vendore	50,891	13.53%	48,540	11.92%	49,950	14.72%
11	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	66,449	17.66%	87,648	21.52%	7,042	2.08%
12	Sport dhe argëtim	2,911	0.77%	3,269	0.80%	3,744	1.10%
13	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	4,266	1.13%	4,606	1.13%	4,800	1.41%
14	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	56,670	15.06%	60,873	14.94%	64,010	18.87%
15	Arsimi Mesëm i Përgjithshëm	18,828	5.01%	19,705	4.84%	20,698	6.10%
16	Përkujdesi social	10,196	2.71%	10,600	2.60%	11,156	3.29%
17	Strehimi Social	300	0.08%	300	0.07%	300	0.09%
	TOTALI	**376,172**	**100%**	**407,357**	**100%**	**339,276**	**100%**

Burimi: Bashkia Has

-Dërguar në MF me shkresën nr.1118, datë 29.05.2023 kthyer përgjigje "Analiza e PBA 2024-2026" nga MF me shkresën 11099, datë 19.06.2023

Tabela nr. II.1.2: Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2024-2025

Nr	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	190,510	50.64%	235,973	59.53%
2	Sigurime (601)	29,220	7.77%	39,610	9.99%
3	Shpenzime operative (602)	70,912	18.85%	64,895	16.37%
4	Shpenzime (603)				
5	Shpenzime (604)			100	0.03%
6	Shpenzime (606)	20,000	5.32%	11,609	2.93%
7	Shpenzime (609)			3,568	0.90%
8	Shpenzime për investime)230-231)	65,530	17.42%	40,642	10.25%
	Total	**376,172**	**100%**	**396,397**	**100%**

Burimi: Bashkia Has

Tabela nr. II.1.3: PBA 2024-2025 tendenca e të ardhurave, në mijë lekë

A	Të ardhurat	2024	2025
1	Nga taksat	36,847	36,637
2	Jo tatimore		
I	**Totali**	**36,847**	**36,637**
1	Transferta e pakushtëzuar	180,583	235,536
2	Transfertë specifike	99,078	122,378
3	Tjera…(per projekte)	61,403	
4	Transfertë e kushtëzuar		
II	**Shuma e transfertave**	**341,064**	**357,914**
III	**Transferta te pritshme (FZHR e tjera)**		**1,845**
	Totali i burimeve të veta (I +II+III)	**377,911**	**396,396**

Burimi: Bashkia Has

<u>Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.</u>

Për vitin 2024, në Bashkinë Has buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 17 programeve, si: Shërbime të Përgjithshme Publike, Rendi dhe Siguria Publike, Çështje Ekonomike, Mbrojtja e

Mjedisit, Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit, Shëndetësia, Argëtimi, Kultura dhe Feja, Arsimi dhe Mbrojtja Sociale.

Rezulton se buxheti i viteve 2024-2026 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

Tabela nr. II.2.1: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2024

Planifikimi i të ardhurave 2024		**Planifikimi i shpenzimeve 2024**	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2024	36,780	Art. 600 Paga	185,372
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm	12,665	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	30,924
Total të ardhurat e veta	**49,445**	Art.602 Shpenzime operative	74,641
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.		Art.604 Transferime korrente të brendshme	100
Të ardhura të trashëgua nga granti i kushtëz (transfe specifik 600, 601, 602 etj.).		606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	10,744
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2024	227,308	Art.230-231 Investime	76,675
Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2024	104,803	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	3,100
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit	**332,111**		
TOTALI TË ARDHURAVE	**381,556**	**TOTALI SHPENZIMEVE**	**381,556**

Burimi: Bashkia Has

Tabela nr. II.2.2: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2024

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2024				**Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2024**			
Burimi i të ardhurave	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**	**Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB**	**Vlera në 000/lekë**	**Emërtimi i zërave**	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**	**Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB**	**Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)**
	1	**2**	**1+2**		**3**	**4**	**3+4**
Të ardhura të planifikuara për vitin 2024	36,780	-1,457	35,323	Art. 600 Paga	185,372	27,103	212,475
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2024	12,665		12,665	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	30,924	4,236	35,160
Total të ardhurat e veta	**49,445**	**-1,457**	**47,988**	Art. 602 Shpenzime operative	74,641	-4,044	70,597
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	22,168		22,168	Art. 604 Transferime korrente të brendshme	100	2,892	2,992
Të ardhura të trashëguara nga transferta specifike	0			Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	10,744	354,560	365,304
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2024	205,140	22,873	227,977	Art. 230-231 Investime	76,675	79,291	155,966
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2024	104,803	5,101	109,904	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	3,100	11,683	14,783
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit	**332,111**	**27,938**	**360,049**				
Total të ardhurat nga transfertat e kushtezuar	0	449,240	449,240				
Total transfertat e kushtezuar	**0**	**449,240**	**449,240**				
TOTALI TË ARDHURAVE	**381,556**	**475,721**	**857,277**	**TOTALI I SHPENZIMEVE**	**381,556**	**475,721**	**857,277**

Burimi: Bashkia Has

Gjatë këtij viti, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë bashkia, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin

e vlerës totale, me VKB nr. 58, datë 29.01.2024, "Një shtesë në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2024" (të ardhura të trashëguara) në shumat 22,168 mijë lekë dhe 12,665 mijë lekë, me shkresën nr.104, datë 27.08.2024 "shtesë e transfertës sektoriale për rritje pagash zjarrfikëse dhe arsimi" në vlerën 5,101 mijë lekë, me shkresën nr.111, datë 25.09.2024 në vlerën 22,873 mijë lekë "Për rritjen e nivelit të pagave dhe pagesën e detyrimeve të prapambetura".

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2024

Për vitin 2024 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën 857,277 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 797,233 mijë lekë, ose në masën 93%.

Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë më të detajuar në tabelën në vijim.

Tabela nr. II.2.3: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2024

	Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Has për vitin 2024, në mijë lekë						
Nr.	**Përshkrimi i shpenzimeve Bashkia pa njësitë vartëse**	**Plani 2024**	**Fakti 2024**	**Realizimi në %**	**Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta (fakti)**	**Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti (fakti)**	**Vlera e mbuluar nga Fondi i kushtezuar**
1	Artikulli - 600 Paga	212,475	210,453	99 %	13,813	192.973	3,667
2	Artikulli – 601Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	35,160	34,751	99%	106	34,033	612
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	70,597	56,814	80%	4,507	52,147	160
4	Artikulli - 604 Transferta korrente të brendshme	2,992	2,993	100%		1	2,992
5	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (PAK)	365,304	362,701	99%		7,365	355,336
6	Artikulli - 230 Projekte						
7	Artikulli - 231 Investime	155,966	129,521	83%	10,209	38,328	80,984
8	Artikulli 609 (fond rezervë + kontigjencës	14,783					
	TOTAL	**857,277**	**797,233**	**93%**	**28,635**	**324,847**	**443,751**

Burimi: Bashkia Has

Me VKB nr. 35, datë 22.12.2023, "Buxheti i Bashkisë Has për vitin 2024 dhe PBA vitit 2024-2026", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut.

Nga bashkia ndarja e plan buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së pakushtëzuar sektoriale, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Me VKB nr. 78, datë 30.04.2024 "Rishpërndarje në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2024; VKB nr. 97, datë 29.07.20254, "Rishpërndarje në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2024",VKB Nr.105 date 27.08.2024 "Rishpërndarje në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2024"

Sipas përcaktimit të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 472, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 443, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c, *"...Si rregull ndryshimet duhet të jenë minimale. Ndryshimet duhet të jenë të papranueshme në tremujorin e parë të vitit pasi kjo periudhë është shumë afër kohës së parashikimit fillestar*".

2 Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse përndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin evitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor.

3 Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

- Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit

Treguesit e buxhetit për vitin 2024, është planifikuar në shumën 857,277 mijë lekë prej të cilit janë realizuar 797,233 mijë lekë ose i shprehur në përqindje plani është realizuar në masën 93%, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 28,635 mijë lekë ose në masën 3.5 % të buxhetit faktik, si edhe buxheti 8 % ndaj transfertave buxhetore.

Nga Drejtoria e Financës është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas Kifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktuara nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44 dhe ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48, Bashkia Has ka përgatitur:

Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e vitit 2024 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 1667/1 prot., datë 20.05.2024;

Raportin e monitorimit të buxhetit për 8-mujorin e vitit 2024 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 2970 prot., datë 18.09.2024;

Raportin e monitorimit të buxhetit për 12-mujorin e vitit 2024 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 585 prot., datë 19.02.2025.

Tabela nr. II.3.1: Realizimi i treguesve buxhetor dhe pasqyrimin në raportet e monitorimit për vitin ushtrimor dhe mënyra e përdorimit të të ardhurave

Nr	Emërtimi	Viti 2024							
		Plani fillim Viti Sipas VKB	Çelja Thesarit sipas akt rakordimit	Fakti sipas aktrakordimit	Të ardh veta	Grand	Trans. pakushtez Specifike	Tran. Kusht. Funk Deleg.	Tra. Kush Për Inv.
1	Paga (600)	185,372	212,475	210,453	13,813	111,065	81,908	3,667	
2	Sigurime (601)	30,924	35,160	34,751	106	20,269	13,764	612	
3	Shpenzime (602)	74,641	70,597	56,814	4,507	45,178	6,969	160	
4	Shpenzime (604)	100	2,992	2,993		1		2,992	
4	(609) F. Rezervë	3,100	14,783						
6	Fondi Veçantë								
7	Inv (230 +231)	76,675	155,966	129,521	10,209	38,328			80,984
8	Transferta 606	10,744	365,304	362,701		5,560	1,805	355,336	
	Totali	**381,556**	**857,277**	**797,233**	**28,635**	**220,401**	**104,446**	**362,767**	**80,984**

Burimi: Bashkia Has

Në datën 30.01.2025 është kryer akt rakordimi me Degën e Thesarit Has.

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve

Në Bashkisë Has vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2023 kanë qenë në vlerën 586,787 lekë, si në raportimin ne MFE ashtu dhe në rakordimet me Degën e Thesarit.

Tabela nr. II.4.1: Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Has viti 2024

					Vlera e kredisë			Vlera e detyrimit

Nr.	Emërtimi i Objektit të Prokurimit	Emërtimi i Subjektit Kreditor	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	(detyrimit) në 31.12.2023	Shtesat gjatë vitit 2024	Shlyerjet gjatë vitit 2024	me 31.12.2024
1	Vendim gjyqësor dhe shp. përmbarimi				395,178		395,178	
2	Vendim gjyqësor dhe shp. përmbarimi					468,800	468,800	
4	Kolaudim punimesh Rruga Zahrisht	"Xh." & "Mr." SH.P.K.	-	Nr. 32, datë 21.11.2018	28,200	-	-	28,200
5	Ndërtim Ujësjellesi Zahrisht (vazhd shtesa)	"L." SH.P.K.	-	Nr. 75, datë 24.09.2018	163,409	-	-	163,409
Totali i detyrimit					**586,787**	**468,800**	**863,978**	**191,609**

Burimi: Bashkia Has

Nga auditimi konstatohet se, sipas të dhënave të paraqitura në tabelën mësipërme, detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2024 janë në vlerën 191,609 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, "*Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore..."*, neni 40, pika 3, *"Projektbuxheti vjetor përfshin...informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore...detyrimet kontingjente dhe mundësinë e shfaqjes së tyre si detyrime në vitin buxhetor pasardhës"*. Udhëzim i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 101, "*Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim*".

Mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore në Bashkinë Has

Nga auditimi rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore në vitin 2024 është 395,178 lekë, për të cilën Bashkia Has ka Vendimin e Gjykatës nr. 940 dhe nr. 1011, datë 16.12.1994 rezulton e paguar vlera 395,178 lekë. Po kështu është paguar edhe vlera e vendimit gjyqësor të vitit 2024 në shumën 468,800 lekë.

Vështirësia Financiare e Bashkisë Has

Në UMFE nr.26, datë 27.03.2019 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore", trajtohet shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive. Gjithashtu në ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", datë 27.04.2017, kreu XI vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 Probleme Financiare, pika 1.

Për Bashkinë Has, totali i shpenzimeve të miratuara për vitin 2024 ka vlerën 381,555,448 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2024, ka vlerën 191,609 lekë, sipas raportimit në MFE me shkresë nr. 630 prot., datë 20.02.2025. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 0.05%, shifër që e Kifikon Bashkinë Has në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare, paraqitur si në tabelën mëposhtë:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale Të miratuara të NJQV-së
I	**Borxhe (a+b)**			
a	**Hua afatgjatë**			
a,1	Marrëveshje financimi			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	**Hua afatshkurtër**			
b,1	Marrëveshje financimi			

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale Të miratuara të NJQV-së
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**	191,409		
Llog. ekonomik				
4864100	Vendime gjyqësore			
4864200	Detyrime të prapambetura për shërbime	28,200		
4864201	D.P. energji elektrike			
4864300	D.P. mirëmbajtje			
4864400	D.P. investime	163,409		
4864500	D.P. rimbursim TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	D.P. të tjera			
4864601	D.P. sigurime shoqërore			
4864602	D.P. sigurime shëndetësore			
4864603	D.P. ardhura personale			
4864604	D.P. tatime			
4864901	Paga			
4864902	Shpronësime			
4864903	Transferta individuale			
4864904	Transferta subjektet			
III	**Totali (I+II)**	**191,609**	**381,555,448**	**0.05 %**

- Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHSH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre

Për vitin 2024 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën 857,277 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 797,233 mijë lekë, ose në masën 93%. Nga këto janë realizuar nga të ardhurat e veta 28,635 mijë lekë dhe vlera e mbuluar nga buxheti dhe transfertat e tjera është 768,598 mijë lekë, ose 96%. Nga këto, fondi i pagave (llogaria 600) është realizuar me 99%, sigurime shoqërore dhe shëndetësore (llogaria 601) është realizuar me 99%, shpenzimet operative (llogaria 602) është realizuar me 80%, transferta korente të brendshme (llogaria 604) është realizuar me 100%, transferime tek buxhetet familjare (llogaria 606) është realizuar me 99% dhe fondi i investimeve (llogaria 231) është realizuar me 83 %, pasi nuk janë realizuar brenda vitit 2024, investimet e parashikuara si:

-Kontrata nr.3846, datë 02.12.2024 dhe vlerë 100,741,795 lekë me objekt "Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme të Fshatit Golaj"

-Kontrata nr.3152, datë 01.10.2024 dhe vlerë 113,400,000 lekë me objekt "Rikonstruksion i Gjimnazit Skënderbeu Has"

- Programimi i PBA-së 2025-2027 dhe programi i buxhetit vjetor

Për hartimin e PBA-së 2025-2027 nga Bashkia Has janë ndjekur dhe zbatuar hapat e më poshtëm:
VKB nr. 137, datë 23.12.2024, "Buxheti i Bashkisë Has për vitin 2025 dhe PBA vitit 2026-2028"
VKB nr. 33 datë 26.05.2025 "Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të buxhetit afatmesëm 2026-2028";
Dërgimi i miratimit të draftit projekt dokumentit të PBA 2026-2028 me shkresën nr. 1768 prot., datë 26.05.2025 në MFE;
Dërgimi i PBA i rishikuar 2025-2027, me shkresën nr.3481 datë 29.09.2025 në MFE;

VKB nr. 63 datë 29.08.2025, "Për tavanet përfundimtare të shpenzimeve të buxhetit afatmesëm 2026-2028";

Nga auditimi konstatohet se: Për hartimin e PBA-së për periudhën 2025-2027, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Has janë ndjekur dhe realizuar fazat e përgatitjes duke filluar me ngritjen e Grupit të Manaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhrin nr.3, date 16.01.2025 dhe ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit, ekipeve të menaxhimit të programeve, miratimin e tavaneve buxhetore, miratimin me VKB nr. 137, datë 23.12.2024, "Buxheti i Bashkisë Has për vitin 2025 dhe PBA vitit 2025-2027", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr.2/34, datë 08.01.2025

-Nga Këshilli Bashkiak, Bashkia Has nuk është marrë asnjë vendim për kalendarin orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore të vitit 2025, të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027, në kundërshtim me neni 33, të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; Kreu VII "Përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit"

- Nuk është hartuar udhëzimi i brendshëm për PBA, i cili duhet të hartohet brenda 5 ditëve nga miratimi i tavaneve buxhetore, në kundërshtim me Ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; neni 35 "Udhëzim për përgatitjen e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore".

Tabela nr. II.1.1: Programimi i shpenzimeve për vitin 2025-2027 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	82,354	20.78%	62,500	15.38%	68,200	16.37%
2	Shërbimet e Policisë Vendore	7,693	1.94%	7,039	1.73%	8,049	1.93%
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	34,717	8.76%	27,346	6.73%	27,674	6.64%
4	Shërbimet Bujqësore, inspektimi, ushqimi	6,564	1.66%	6,535	1.61%	6,594	1.58%
5	Menaxhimi Infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit	14,344	3.62%	14,789	3.64%	14,641	3.52%
6	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	20,507	5.17%	26,613	6.55%	28,347	6.81%
7	Rrjeti rrugor rural	48,600	12.26%	73,162	18.00%	75,939	18.23%
8	Menaxhimi i Mbetjeve	5,876	1.48%	7,953	1.96%	8,483	2.04%
9	Planifikimi Urban dhe Vendor	7,929	2.00%	11,271	2.77%	10,966	2.63%
10	Shërbimet publike vendore	51,308	12.94%	58,539	14.40%	58,103	13.95%
11	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	5,285	1.33%	6,065	1.49%	5,974	1.43%
12	Sport dhe argëtim	7,740	1.95%	3,489	0.86%	3,450	0.83%
13	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	4,723	1.19%	6,516	1.60%	6,635	1.59%
14	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	57,750	14.57%	56,980	14.02%	58,499	14.04%
15	Arsimi Mesëm i Përgjithshëm	26,686	6.73%	24,359	5.99%	22,450	5.39%
16	Përkujdesi social	14,020	3.54%	13,048	3.21%	12,217	2.93%
17	Strehimi Social	300	0.08%	300	0.07%	300	0.07%
	TOTALI	**396,396**	**100%**	**406,504**	**100%**	**416,521**	**100%**

Burimi: Bashkia Has

-Programimi i shpenzimeve në total për 17 programet është parashikuar me rritje (+10,108 mijë lekë) për vitin 2026 dhe (+ 20,125 mijë lekë) për vitin 2027 krahasuar me vitin 2025.

Tabela nr. II.1.2: Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2024-2025

Nr	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	190,510	50.64%	235,973	59.53%
2	Sigurime (601)	29,220	7.77%	39,610	9.99%
3	Shpenzime operative (602)	70,912	18.85%	64,895	16.37%
4	Shpenzime (603)				
5	Shpenzime (604)			100	0.03%
6	Shpenzime (606)	20,000	5.32%	11,609	2.93%

7	Shpenzime (609)			3,568	0.90%
8	Shpenzime për investime (230-231)	65,530	17.42%	40,642	10.25%
	Total	**376,172**	**100%**	**396,397**	**100%**

Burimi: Bashkia Has

Në programimin e shpenzimeve për vitin 2025 peshën më të madhe e zenë shpenzimet për paga me 60%, ndërsa shpenzimet për investimet 10 % të totalit të shpenzimeve.

Tabela nr. II.1.3: PBA 2024-2025 tendenca e të ardhurave, në mijë lekë

A	Të ardhurat	2024	2025
1	Nga taksat	36,847	36,637
2	Jo tatimore	-	-
I	**Totali**	**36,847**	**36,637**
1	Transferta e pakushtëzuar	180,583	235,536
2	Transfertë specifike	99,078	122,378
3	Tjera…(per projekte)	61,403	
4	Transferte e kushtezuar		
II	**Shuma e transfertave**	**341,064**	**357,914**
III	**Transferta te pritshme (FZHR e tjera)**		**1,845**
	Totali i burimeve të veta (I +II+III)	**377,911**	**396,396**

Burimi: Bashkia Has

Tendenca e të programimit të të ardhurave është në rritje me 18,485mijë lekë, krahasuar me vitin 2024.

- *Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.*

Për vitin 2025, në Bashkinë Has buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 20 programeve, përkatësisht: Shërbime të Përgjithshme Publike, Rendi dhe Siguria Publike, Çështje Ekonomike, Mbrojtja e Mjedisit, Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit, Shëndetësia, Argëtimi, Kultura dhe Feja, Arsimi dhe Mbrojtja Sociale.

Rezulton se buxheti i viteve 2025-2027 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

Tabela nr. II.2.1: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2025

Planifikimi i të ardhurave 2025		**Planifikimi i shpenzimeve 2025**	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2025	38,482	Art. 600 Paga	235,973
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm	18,655	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	39,609
Total të ardhurat e veta	**57,137**	Art.602 Shpenzime operative	80,537
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.	35,201	Art.604 Transferime korrente të brendshme	100
Të ardhura të trashëgua nga granti i kushtëz (transfe specifik 600, 601, 602)	-	606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	13,809
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2025	235,536	Art.230-231 Investime	76,656
Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2025	122,378	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	3,568
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit	**393,115**		
TOTALI TË ARDHURAVE	**450,252**	**TOTALI SHPENZIMEVE**	**450,252**

Burimi: Bashkia Has

Tabela nr. II.2.2: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2025

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2025				**Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2025**			
Burimi i të ardhurave	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**	**Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB**	**Vlera në 000/lekë**	**Emërtimi i zërave**	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**	**Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB**	**Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)**
	1	**2**	**1+2**		**3**	**4**	**3+4**
Të ardhura të planifikuara për vitin 2025	38,482			Art. 600 Paga	235,973	11,189	247,162

Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2025	18,655			Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	39,609	1,784	41,393
Total të ardhurat e veta	**57,137**		**57,137**	Art. 602 Shpenzime operative	80,537	-3,057	77,480
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	35,201			Art. 604 Transferime korrente të brendshme	100	3,572	3,672
Të ardhura të trashëguara nga transferta specifike	0			Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	13,809	336,052	349,861
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2025	235,536			Art. 230-231 Investime	76,656	97,611	174,267
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2025	122,378	2,046	124,424	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	3,568	-1,300	2,268
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit	**393,115**	**2,046**	**395,161**				
Total të ardhurat nga transfertat e kushtezuar		443,805					
Total transfertat e kushtezuar		**443,805**	**443,805**				
TOTALI TË ARDHURAVE	**450,252**	**445,851**	**896,103**	**TOTALI I SHPENZIMEVE**	**450,252**	**445,851**	**896,103**

Burimi: Bashkia Has

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2025

Për vitin 2025 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën 896,103 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 875,243 mijë lekë, ose në masën 98%. Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë më të detajuar në tabelën në vijim.

Tabela nr. II.2.3: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2025

	Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Has për vitin 2025, në mijë lekë						
Nr.	**Përshkrimi i shpenzimeve Bashkia pa njësitë vartëse**	**Plani 2025**	**Fakti 2025**	**Realizim i në %**	**Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta (fakti)**	**Vlera e mbuluar nga Fondi i kushtezuar**	**Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti (fakti)**
1	Artikulli - 600 Paga	247,162	246,628	99%	4,914	4,297	237,416
2	Artikulli – 601Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	41,393	40,645	98%	2,493	717	37,434
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	77,480	73,940	95%	4,651	1,627	67,662
4	Artikulli - 604 Transferta korrente të brendshme	3,672	3,580	97%		3,581	
5	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (PAK)	349,861	340,130	97%	40	332,079	8,011
6	Artikulli - 230 Projekte						
7	Artikulli - 231 Investime	174,267	170,320	98%	37,688	97,447	35,186
8	Artikulli 609 (fond rezervë + kontigjencës	2,268		0			
	TOTAL	**896,103**	**875,243**	**98%**	**49,786**	**439,748**	**385,709**

Burimi: Bashkia Has

VKB nr. 137, datë 23.12.2024, "Buxheti i Bashkisë Has për vitin 2025 dhe PBA vitit 2026-2028", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut.

Nga bashkia ndarja e plan buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së pakushtëzuar sektoriale, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Gjatë këtij viti, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë bashkia, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale si më poshtë:

- VKB nr. 16, datë 24.02.2025 *"Një shtesë në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2025" (të ardhura të trashëguara),*
- VKB nr. 120, datë 24.12.2025 *"Dhënie fondi nga buxheti i Bashkisë Has për disa familje në nevojë për vitin 2025",*

- VKB nr. 57, datë 21.07.2025, *"Rishpërndarje në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2025";*
- VKB nr. 64, datë 29.08.2025 *"Rishpërndarje në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2025";*
- VKB nr. 76, datë 29.09.2025, *"Rishpërndarje në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2025";*
- VKB Nr.93 datë 25.11.2025 *"Një shtesë në transfertën sektoriale në buxhet për vitin 2025";*
- VKB nr. 81, datë 27.10.2025 *"Rishpërndarje në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2025*".

Sipas përcaktimit të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 474, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*" shtojca 4, pika c, *"...Si rregull ndryshimet duhet të jenë minimale. Ndryshimet duhet të jenë të papranueshme në tremujorin e parë të vitit pasi kjo periudhë është shumë afër kohës së parashikimit fillestar*".

2.2.3. Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit

Treguesit e buxhetit për vitin 2025, janë planifikuar në shumën 896,103 mijë lekë, prej të cilit janë realizuar 875,243 mijë lekë ose i shprehur në përqindje plani është realizuar në masën 98%, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 49,786 mijë lekë, ose në masën 5.6 % të buxhetit faktik si edhe buxheti ndaj transfertave buxhetore në masën11 %.

Nga Drejtoria e Financës është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas Kifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktuara nga grandet e deleguara nga pushteti qendror.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44 dhe ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48, Bashkia Has ka përgatitur:

-Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e vitit 2025 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 1711 prot., datë 21.05.2025;

-Raportin e monitorimit të buxhetit për 8-mujorin e vitit 2025 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 3354 prot., datë 22.09.2025;

-Raportin e monitorimit të buxhetit për 12-mujorin e vitit 2025 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 612 prot., datë 12.02.2026.

Tabela nr. II.3.1: Realizimi i treguesve buxhetor dhe pasqyrimin në raportet e monitorimit për vitin ushtrimor dhe mënyra e përdorimit të të ardhurave

Nr	Emërtimi	Viti 2025							
		Plani fillim Viti Sipas VKB	Çelja Thesarit sipas akt rakordimit	Fakti sipas aktrakordimit	Të ardh veta	Grand	Trans. pakushtez Specifike	Tran. Kusht. Funk Deleg.	Tra. Kush Për Inv.

4 Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse përndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin evitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor.

1	Paga (600)	235,973	247,162	246,628	4,914	142,661	94,755	4,297	
2	Sigurime (601)	39,609	41,393	40,646	2,486	22,861	14,574	718	
3	Shpenzime (602)	80,537	77,480	73,940	4,651	55,744	11,918	1,627	
4	Shpenzime (604)	100	3,672	3,580				3,580	
4	(609) F. Rezervë	3,568	2,267						
6	Fondi Veçantë		7,898						
7	Inv (230 +231)	76,656	174,267	170,320	37,687	35,186			97,447
8	Transferta 606	13,809	349,862	340,130	40	6,106	1,905	332,079	
	Totali	**450,252**	**904,001**	**875,244**	**49,786**	**262,558**	**123,152**	**342,301**	**97,447**

Burimi: Bashkia Has

Në datën 30.01.2026 është kryer akt rakordimi me Degën e Thesarit Has.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve

Në Bashkisë Has vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2025 është 191,609 lekë, si në raportimin në MFE ashtu dhe në rakordimet me Degën e Thesarit.

Tabela nr. II.4.1: Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Has viti 2025

Nr.	Emërtimi i Objektit të Prokurimit	Emërtimi i Subjektit Kreditor	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Vlera e kredisë (detyrimit) në 31.12.2024	Shtesat gjatë vitit 2025	Shlyerjet gjatë vitit 2025	Vlera e detyrimit me 31.12.2025
1	Kolaudim punimesh Rruga Zahrisht	"Xh." & "Mi." SH.P.K.	-	Nr. 32, datë 21.11.2018	28,200	-	-	28,200
2	Ndërtim Ujësjellesi Zahrisht (vazhd shtësa)	"L." SH.P.K.	-	Nr. 75, datë 24.09.2018	163,409	-	-	163,409
Totali i detyrimit					**191,609**			**191,609**

Burimi: Bashkia Has

Nga auditimi konstatohet se, sipas të dhënave të paraqitura në tabelën mësipërme, detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2025, janë në vlerën 191,609 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, "*Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore..."*, neni 40, pika 3, *"Projektbuxheti vjetor përfshin...informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore...detyrimet kontingjente dhe mundësinë e shfaqjes së tyre si detyrime në vitin buxhetor pasardhës"*. Udhëzim i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 101, "*Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim*".

Mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore në Bashkinë Has

Nga auditimi rezulton se vlera e likujduar për vendimet gjyqësore në vitin 2025 nga Bashkia Has është 1,209,479 lekë, për 4 vendimet e Gjykatës nr. 406, datë 27.03.2024 në shumën 253,255 lekë, nr.940, datë 16.12.1994, në shumën 31,200 lekë, nr.3780, datë 25.10.2024 në shumën 121,526 lekë dhe nr.59, datë 13.06.2024 në shumën 803,498 lekë.

Nga auditimi konstatohet se deri në vitin 2025, janë hapur procese gjyqësore nga 28 ish punonjës të larguar nga puna, nga të cilët 1 punonjës ka përfunduar procesin gjyqësor z. A. M. për kthim në pozicionin e mëparshëm dhe shlyerjen e detyrimit në shumën 2,208,004 lekë. Nga Bashkia Has me shkresën nr.4617, datë 17.12.2025 drejtuar Ministrisë së Pushtetit Vendor është dërguar praktika për shlyerjen e detyrimit për të cilën ende nuk është kthyer përgjigje.

Vështirësia Financiare e Bashkisë Has

Në UMFE nr.26, datë 27.03.2019 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore", trajtohet shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive. Gjithashtu në ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", datë 27.04.2017, kreu XI vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 Probleme Financiare, pika 1.

Për Bashkinë Has, totali i shpenzimeve të miratuara për vitin 2025 ka vlerën 450,252,776 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2025, ka vlerën 191,609 lekë, sipas raportimit në MFE me shkresën nr. 687 prot., datë 19.02.2026. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimet totale të miratuara, ka vlerën 0.04%, shifër që e Kifikon Bashkinë Has në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare, paraqitur si në tabelën mëposhtë:

NR	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale Të miratuara të NJQV-së
I	**Borxhe (a+b)**			
a	**Hua afatgjatë**			
a,1	Marrëveshje financimi			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	**Hua afatshkurtër**			
b,1	Marrëveshje financimi			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**			
Llog. ekonomik		191,609		
4864100	Vendime gjyqësore			
4864200	Detyrime të prapambetura për shërbime			
4864201	D.P. energji elektrike			
4864300	D.P. mirëmbajtje	163,409		
4864400	D.P. investime	28,200		
4864500	D.P. rimbursim TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	D.P. të tjera			
4864601	D.P. sigurime shoqërore			
4864602	D.P. sigurime shëndetësore			
4864603	D.P. ardhura personale			
4864604	D.P. tatime			
4864901	Paga			
4864902	Shpronësime			
4864903	Transferta individuale			
4864904	Transferta subjektet			
III	**Totali (I+II)**	**191,609**	**450,252,776**	**0.04%**

Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHSH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre

Për vitin 2025 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën 896,103 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 875,244 mijë lekë, ose në masën 98%. Nga këto janë realizuar nga të ardhurat e veta 49,786 mijë lekë dhe vlera e mbuluar nga buxheti dhe transfertat e tjera është është 825,458 mijë lekë, ose 98%. Nga këto, fondi i pagave (llogaria 600) është realizuar me 99%, sigurime shoqërore dhe shëndetësore (llogaria 601) është realizuar me 98%, shpenzimet operative (llogaria 602) është realizuar me 95%, transferta korrente të brendshme (llogaria 604) është realizuar me

97%, transferime tek buxhetet familjare (llogaria 606) është realizuar me 97% dhe fondi i investimeve (llogaria 231) është realizuar me 98 %.
Për sa më lart është mbajtur akt konstatimi nr. 4, datë 04.05.2026.

2.2.5. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has bëhet mbështetur në legjislacionin si më poshtë:
-Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
-Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
-Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar;
-VKB nr. 33, datë 22.12.2023 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2024", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Has me shkresën nr.2/46, datë 04.01.2024.
-VKB nr. 135, datë 23.12.2024 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2025", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Has me shkresën nr. 2/34, datë 04.01.2025

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore është si vijon:
Vendimet e Këshillit Bashkiak Has për miratimin e paketave fiskale të vitit 2024-2025;
Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifat vendore;
Dokumentacioni i Drejtorisë së Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset, për taksat dhe tarifat vendore;
Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
Dokumentacion i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve
Për vitin 2024 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has është miratuar me VKB nr. 33, datë 22.12.2023, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2024", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Has me shkresën nr.2/46, datë 04.01.2024 dhe VKB nr. 135, datë 23.12.2024 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2025", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Has me shkresën nr. 2/34, datë 04.01.2025

-Sektori i Taksave në Bashkinë Has, kryen funksionet në varësi të Drejtorisë Ekonomike dhe Financës dhe përbëhet nga 3 punonjës, arsimimi dhe vendimet e emërimit te punonjësve të Sektorit të Taksave, janë si më poshtë:

Nr	Emri Mbiemri	Funksioni	Arsimimi	Urdhër emërimi	Urdhër largimi	Pozicioni
1	F. Q.	Përgjegjës	Ek.Lartë	188, dt 23.05.25		
2	D. Ç.	Përgjegjës	Ing.Agromjedis	276, dt 03.06.24	187, 23.05.25	P/Nd.Ek.
3	U. H.	Përgjegjës	Ek.Lartë	47912,dt 05.07.19	174, dt 12.04.24	
4	S. Xh.	Sp/Ardhurash	Financë	6, dt 07.01.20		
5	E. Z.	Insp.tregu. familje	Financë	402, dt 03.08.21	429, dt 03.01.24	Audit
6	E. D.	Sp.kadastre fiskale	Marketing	502, dt 29.08.21	24.12.25	Leje lindje
7	A. R.	Sp.kadastre fiskale	Punë Sociale	30, dt 06.01.26		

(Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2024, paraqitet në aneksin nr.1)

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën e *Parashikimit dhe realizimit të të ardhurave*, realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Has për vitin 2024 është në masën 96% nga 36,847 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 35,324 mijë lekë.
Për vitin 2024, në disa zëra kemi mosrealizim të parashikimeve ndërsa në disa kemi tejkalim të parashikimeve si psh:
- të ardhurat nga taksat lokale janë realizuar në nivelin 53% të planit, me 2,669 mijë lekë të arkëtuara nga 5,082 mijë lekë të planifikuara, duke reflektuar një realizim më të ulët krahasuar me planin vjetor;
- të ardhurat nga taksat e ndara paraqiten me një realizim 126% të planit, nga 13,905 mijë lekë të planifikuara janë arkëtuar 17,519 mijë lekë, duke tejkaluar planin e parashikuar;
- të ardhurat e tjera janë realizuar në nivelin 84% të planit, ku nga 6,160 mijë lekë të planifikuara janë arkëtuar 5,195 mijë lekë, kryesisht nga qiratë e aseteve në pronësi të bashkisë;
- të ardhura të tjera të kësaj kategorie. Të ardhurat nga tarifat vendore janë realizuar në nivelin 85% të planit, ku peshën kryesore e zë tarifa e menaxhimit të mbetjeve.

(Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2025, paraqitet në aneksin nr.2)

Për vitin 2025, të ardhurat nga burimet e veta të Bashkisë Has janë realizuar në masën 101% të planit. Nga një plan prej 38,482 mijë lekë, janë arkëtuar në total 38,875 mijë lekë.
Të ardhurat nga taksat lokale janë realizuar në nivelin 52% të planit, me 3,728 mijë lekë të arkëtuara nga 7,188 mijë lekë të planifikuara.
Të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar në nivelin 133% të planit, ku nga 14,824 mijë lekë të planifikuara janë arkëtuar 19,736 mijë lekë, duke kontribuar ndjeshëm në tejkalimin e planit të përgjithshëm të të ardhurave.
Të ardhurat nga tarifat vendore janë realizuar në nivelin 73% të planit, me 8,676 mijë lekë të arkëtuara nga 11,904 mijë lekë të planifikuara, ku të ardhurat kryesore lidhen me tarifat për shërbimet administrative të bashkisë.
3.2.5. Të ardhurat e tjera janë realizuar në nivelin 148% të planit, ku nga 4,566 mijë lekë të planifikuara janë arkëtuar 6,735 mijë lekë, kryesisht nga qiratë e aseteve në pronësi të bashkisë.
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, si dhe të VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerat vetëzbatueshme për legalizim", pika 5.
Në Bashkinë Has, struktura përgjegjëse për administrimin e dokumentacionit dhe përllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, në përputhje me kërkesat ligjore të sipërcituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë, është Sektori i Urbanistikës.
Në kuadër të procesit të legalizimeve gjatë vitit 2024, lidhur me ecurinë e pagesave të kryera nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezulton se gjatë vitit 2024 janë legalizuar 39 objekte me një vlerë totale të detyrimit prej 1,698,702 lekë.
Nga ndërtimet e reja gjatë vitit 2024, janë arkëtuar 119,764 lekë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, ndërsa gjatë vitit 2025 janë arkëtuar 182,419 lekë. *Nga auditimi konstatohet se vlera 1,243,926 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has.*
Për qëllim plotësimi të informacionit dhe në funksion të bashkëpunimit ndërinstitucional, me shkresën nr.2151, date 25.06.2025, Bashkia Has i është drejtuar ASHK me kërkesë për vënie në

dispozicion të informacionit për lidhur me listën e subjekteve të ndërtimit pa leje dhe detyrimet përkatëse për periudhën Janar-Qershor 2025 por ende nuk ka përgjigje.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Has kryhet në programin Excel. Drejtoria e Financës dhe Taksave gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) dhe të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore. Bashkia Has nuk disponon një regjistër të veçantë të mbylljes së bizneseve, pas dërgimit për tarifim, mbyllje e aktivitetit është regjistruar vetëm për subjektin "Xhaferi" dhe për subjektet e tjerë është kryer verifikim në QKB.

Tabela nr.3: Numri i bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Has 2024

Nr.	Lloji Biznesit	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	130	11	15	126
2	Biznesi Madh	48		8	40
	Gjithsej	178	11	23	**166**

Burimi: Bashkia Has

Tabela nr.4: Numri i bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Has 2025

Nr.	Lloji Biznesit	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	126	6	1	131
2	Biznesi Madh	40	4	1	43
	Gjithsej	166	10	2	**174**

Menaxhimi i borxhit. Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar niveli i lartë e debitorëve. Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Has, rezulton nivel i lartë debitorësh në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët, *(për taksën e ndërtesës, tabelës, truallit, reklama, zënie hapëS publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie, tarifa e qirasë për objekte, toka, pyje, dru zjarri etj)*, i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të vitit 2024, vlera e debitorëve është 63,371,335 lekë dhe në fund të vitit 2025 vlera e debitorëve është 60,737,826 lekë. Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresiv paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.5: Debitorët progresiv, biznese dhe familjarë 2024, në lekë

Nr		Periudha (14 VJECARE) 31.12.2011 deri me 31.12.2024						
	LLOJI I DEBITOREVE	Lloji i Detyrimeve		Shuma e Detyrimeve Progresiv 2023	Sistemime	Shtesa	Pakësime	Shuma e Detyrimeve Progresiv 2024
1	Biznes i Vogël	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi, Taksë ndërtese, Taksë tabele	12,636,841		957,106	314,615	**13,279, 332**
2	Biznes i Madh	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi, reklame, Tarife leje e licenca, Taksë ndërtese, Taksë Tabele, Qira fondi pyjor kullusor	15,215,917		656,248	2,077,838	**13,794,327**
3	Fond Pyjor	Qera fond pyjor	Kontrate qiraje			18,326,880		**18,326,880**
4	Institucione Shtetërore	Taksa e Tarifa vendore		206,600			-	**206,600**

5	Kryefamiljarë të pajisur me leje legalizimi	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale të legalizuara	Taksa e ndikimit në infrstrukture	10,254,853		1,698,702	815,146	**11,138,409**
6	Qiramarrës të ambienteve të tregut (Markata)	Qira të ambienteve të tregut (Markata)	Qira ambienti hapsira publike	5,364,207	(76,000)	818,315	75,800	**6,030,722**
7	Qira Tokë Bujqësore	Tokë bujqësore		272,145	-	**322,920**		**595,065**
TOTALI				**43,950,563**	**(76,000)**	**22,780,171**	**3,283,399**	**63,371,335**

Burimi: Bashkia Has

Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Has paraqitet:

Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2024 është 22,780,171 lekë nga të cilat:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për biznesin e vogël në shumën 957,106 lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për biznesin e madh në shumën 656,248 lekë
- Detyrime nga qiratë e tregut (markata) në shumën 818,315 lekë;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore të pandarë në vlerën 322,920 lekë.
- Detyrime nga leje legalizimi në shumën 1,689,702 lekë
- Detyrime nga kontratat e qirasë fond pyjor në shumën 18,326,880 lekë

Gjendja e debitorëve progresiv në fund të vitit 2023 rezulton në vlerën 43,950,563 lekë. Gjatë vitit 2024 janë likuiduar detyrime në shumën 3,283,399 lekë, si dhe janë kryer mbajtje në pagë në vlerën 76,000 lekë për punonjës të bashkisë që rezultojnë debitorë në regjistrat e taksave dhe tarifave vendore. Ndërkohë, gjatë këtij viti janë evidentuar detyrime të reja në vlerën 22,780,171 lekë, si rezultat i shtesave të regjistruara në sistem. Si rrjedhojë e këtyre lëvizjeve, gjendja progresive e debitorëve në fund të vitit 2024, rezulton në vlerën 63,371,335 lekë, e cila përfaqëson stokun e detyrimeve të papaguara ndaj Bashkisë Has për taksat, tarifat vendore dhe detyrimet kontraktore.

Tabela nr.6: Debitorët progresiv, biznese dhe familjarë viti 2025 në lekë

Nr		**Periudha (14 VJECARE) 31.12.2011 deri me 31.12.2024**						
	LLOJI I DEBITOREVE	**Lloji i Detyrimeve**		**Shuma e Detyrimeve Progresiv 2024**	Sistemime	Shtesa	Pakësime	**Shuma e Detyrimeve Progresiv 2025**
1	Biznes i Vogël	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi, Taksë ndërtese, Taksë tabele	13,279,332		701,123	713,001	13,267,454
2	Biznes i Madh	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi, reklame, Tarife leje e licenca, Taksë ndërtese, Taksë Tabele, Qira fondi pyjor kullusor	13,794,327	(16,690)	430,490	722,671	13,485,456
3	Fond Pyjor	Qera fond pyjor	Kontrate qiraje	18,326,880			1,189,760	17,137,120
4	Institucione Shtetërore	Taksa e Tarifa vendore		206,600			-	206,600
5	Kryefamiljarë të pajisur me leje legalizimi	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale të legalizuara	Taksa e ndikimit në infrstrukture	11,138,409	(23,246)		1,017,981	10,097,182
6	Qiramarrës të ambienteve të tregut (Markata)	Qira të ambienteve të tregut (Markata)	Qira ambienti hapsira publike	6,030,722		129,408	240,834	5,919,296
7	Qira Tokë Bujqësore	Tokë bujqësore		595,065	-	49,517	19,864	624,718

TOTALI		**63,371,335**	**(39,936)**	**1,310,538**	**3,904,111**	**60,737,826**

Burimi: Bashkia Has

Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Has paraqitet:

Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2025, është 1,310,538 lekë nga të cilat:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për biznesin e vogël në shumën 701,123 lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për biznesin e madh në shumën 430,490 lekë
- Detyrime nga qiratë e tregut (markata) në shumën 129,408 lekë;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore të pandarë në vlerën 49,517 lekë.

Gjendja e debitorëve progresiv në fund të vitit 2024, rezulton në vlerën 63,371,335 lekë. Gjatë vitit 2025 janë likuiduar detyrime në shumën 3,904,111 lekë, Ndërkohë, gjatë këtij viti janë evidentuar detyrime të reja në vlerën 1,310,538 lekë, si rezultat i shtesave të regjistruara në sistem. Si rrjedhojë e këtyre lëvizjeve, *gjendja progresive e debitorëve në fund të vitit 2025 rezulton në 60,373,826 lekë*, e cila përfaqëson stokun e detyrimeve të papaguara ndaj Bashkisë Has për taksat, tarifat vendore dhe detyrimet kontraktore.

Taksat dhe tarifat familjare Në Bashkinë Has familjet nuk ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, sipas të dhënave që disponon Sektori i Taksave rezulton se kanë paguar detyrimet për këto 2 taksa/tarifa 743 familje në vlerën 519,618 lekë, për vitin 2024 dhe 1133 persona me vlerën 785,800 lekë për vitin 2025.

Sektori i Tatimeve nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitore ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifat e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifën e gjelbërimit, detyrimet për këto taksa dhe tarifa nuk evidentohen në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme por arkëtohen rast pas rasti në momentin që qytetarët paraqiten pranë Bashkisë për marrje vërtetimesh, shërbime/procedura të ndryshme nga institucioni. Bashkia Has nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet, por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësive administrative për të marrë shërbime të ndryshme. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitore nuk ka regjistër. Në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Has nuk ekziston një regjistër i unifikuar për të gjitha familjet, ku të evidentohen në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme tarifimet për çdo vit. Kjo për arsye se tarifat vendore familjare aplikohen dhe arkëtohen vetëm për familjet që përfitojnë shërbime konkrete nga bashkia, dhe jo në mënyrë të përgjithshme për të gjitha familjet e regjistruara në territorin administrativ Për qëllim plotësimi të informacionit, me shkresën nr. 2789, datë 12.08.2025, Bashkia Has i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile, me kërkesë për vënien në dispozicion të informacionit lidhur me listën e familjeve të regjistruara në Bashkinë Has. Megjithatë, nuk është siguruar bashkëpunimi i kërkuar, me argumentimin se këto të dhëna nuk mund të ndahen, për shkak të kufizimeve ligjore mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

Si rezultat, procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitore dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet e në kundërshtim me përcaktimet e VKB nr. 33, datë 22.12.2023 dhe VKB nr.135, datë 23.12.2024, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has", me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 9 pika1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10

Taksa mbi tokën bujqësore *Taksa* mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 235.
Sipas Aneksit 1 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", Bashkia Has Kifikohet në kategorinë e katërt ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën mëposhtme:

Tabela nr.7: Vlera e taksës së tokës së tokës bujqësore në lekë/hektar/vit

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	1,400
II	1,200
III	1,100
IV	1,000
V	900
VI	800
VII-X	**700**

Referuar VKB-në nr. 33, datë 22.12.2023, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2024", dhe VKB-në nr. 135, datë 23.12.2024, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2025" toka bujqësore në Bashkinë Has Kifikohet në kategorinë VII-X me detyrim 700 lekë/ha/vit.
-Regjistri i abonentëve familjarë për tokën bujqësore dhe taksat e tarifat vendore, vitet 2024-2025;

Nr.	Emri Fshatit	Tokë gjithsej	Nga kjo		Numri familjeve me tapi	Sipërfaqja e Tokës, Ndarë në fakt	Sipërfaqja e tokës së pa ndarë	Sipërfaqja e dhënë me qira
			Arë	Pemëtor				
1.	Nj.ad.Krumë	1476	614	33	737	860	S'ka info	-
2.	Nj.ad.Golaj	2500	1205	106	2010	1640	S'ka info	-
3.	Nj.ad.Fajza	2116	670	31	882	886	S'ka info	-
4.	Nj.ad.Gjinaj	367	1	0.9	319	183	S'ka info	-
	Shuma	**6545**	**2490**	**170.9**	**3948**	**3569**		

Burimi: Bashkia Has

Nga auditimi konstatohet se, në Bashkinë Has familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore si dhe Sektori i Tatimeve nuk disponon informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet dhe taksa e tokës bujqësore. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 23 dhe VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021" pika 4/b. Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore janë rastet kur qytetarët paraqiten në bashki në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifat vendore apo për të marrë shërbime dhe nga Sektori i Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokës me vlerë 700 lekë/ha/vit kur bashkia ka të dhëna. Gjatë vitit 2024 janë mbledhur 70, 520 lekë rreth 10 ha dhe gjatë vitit 2025 janë mbledhur 184,070 lekë rreth 263 ha.

Masat e marra për uljen e borxhit. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has është përgjegjës për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë",

5Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 23, pika 1, ankesi 1.

i ndryshuar neni 89, 90, 91, 93 dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara.
Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me zbatimin e hapave të ndjekur për mbledhjen e detyrimeve, rezulton se janë njoftuar bizneset debitore në përputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 4, pika 1 dhe 2; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 89, i ndryshuar; si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", pika 89, i ndryshuar.
Pas kalimit të afatit për pagimin vullnetar të këtyre detyrimeve, Drejtoria e Financës dhe Taksave gjatë vitit 2024, me shkresën nr. 1668 prot., datë 21.05.2024, ka njoftuar 39 subjekte përfituese të lejeve të legalizimit për detyrimet e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu, me shkresën nr. 387 prot., datë 07.08.2024, janë njoftuar 264 subjekte përfituese të lejeve të legalizimit, debitorë progresivë ndër vite, për detyrimet e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Me shkresën nr. 543 prot., datë 08.02.2024, janë njoftuar 40 subjekte të biznesit të madh për detyrimet tatimore që kanë ndaj Bashkisë Has, ndërsa me shkresën nr. 910 prot., datë 06.03.2024, janë njoftuar 124 subjekte të biznesit të vogël. Më datë 13.09.2024, me shkresën nr. 2911 prot., janë rinjoftuar 21 subjekte të biznesit të madh për detyrimet e pashlyera, ndërsa me shkresën nr. 2507 prot., datë 28.08.2024, janë rinjoftuar 77 subjekte të biznesit të vogël për shlyerjen e detyrimeve.
Gjatë vitit 2025, pas kalimit të afatit për shlyerjen e detyrimeve, janë ndërmarrë rinjoftime të tjera: me shkresën nr. 2201 prot., datë 30.06.2025, janë rinjoftuar 91 subjekte të biznesit të vogël për shlyerjen e detyrimeve; me shkresën nr. 3229 prot., datë 12.09.2025, janë njoftuar 289 persona debitorë për detyrimet e taksës së ndikimit në infrastrukturë, debitorë progresivë deri në vitin 2025; me shkresën nr. 2260 prot., datë 02.07.2025, janë rinjoftuar 24 subjekte të biznesit të madh; ndërsa me shkresën nr. 2262 prot., datë 02.07.2025, janë rinjoftuar 14 subjekte debitorë që kanë kontrata qiraje me Bashkinë Has.
-Në Bashkinë Has nuk ka regjistër të veçantë të subjekteve me sanksione për mospagesën e detyrimeve brenda afatit si edhe nuk aplikohen kamatëvonesa.
-Bashkia Has për periudhën 2024-2025 nuk ka dërguar shkresa zyrtare me lista dhe vlera të subjekteve në Policinë Bashkiake ose institucione të tjera.
-Gjatë viteve 2024-2025, nuk janë ndërmarrë masa shtrënguese administrative për vjeljen e debitorëve, si bllokim llogarie bankare, sekuestro, bllokim aktiviteti ose njoftime për bllokim.
-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon regjistër të veçantë dhe të përditësuar për subjektet e mbyllura dhe me status pasiv.
Gjithashtu, më datë 11.08.2025, me shkresën nr. 2776 prot., është lëshuar urdhër bllokimi i llogarive bankare për tatimpaguesin "H." sh.p.k., i cili nuk ka shlyer detyrimin për qiranë e fondit pyjor, detyrim që duhej të ishte paguar brenda datës 27.05.2024.

<u>Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve.</u>
Tabela nr. 9: Subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë debitorë

Nr	Operatori Ekonomik	NIPTI	Adresa	Autorizimi Bazë	Detyrime për t'u paguar	Pagesa	Debitor	Shënime
1	"S." SH.P.K.	K.....E	Krumë	10.09.2020 - 10.09.2025 22.10.2025 - 22.10.2029	*1,000,000*	*200,000*	*800,000*	
2	"D. H." SH.P.K.	J.....M	Krumë	17.11.2023 - 17.11.2024	*1,000,000*	*1,000,000*		

				17.11.2025 - 17.11.2026				
3	"V. P." SH.P.K.	K.....K	Krumë	01.11.2021- 16.10.2026	*1,000,000*	*800,000*	*200,000*	
4	"E." SH.P.K.	J.....E	Krumë	19.11.2020-19.11.2025	1,000,000	100,000	900,000	Mbyllur 01.06.2021
5	"K. L." SH.P.K.	L.....U	Golaj	18.04.2018 - 17.04.2021 20.08.2021- 17.04.2023	1,000,000	293,000	707,000	Mbyllur 01.01.2023
6	"X. P." SH.P.K.	L.....V	Vranisht	19.04.2019 - 18.04.2024	1,000,000	600,000	400,000	Mbyllur 01.06.2025
7	"G ." SH.P.K.	K.....H	Vranisht	16.03.2021 - 16.03.2026	*1,000,000*	*800,000*	*200,000*	
8	"H." SH.P.K.	J.....P	Golaj	14.01.2020 - 13.01.2025	1,000,000		1,000,000	Mbyllur 08.06.2022
9	"D. M." SH.P.K.	L.....M	Krumë	23.09.2025 - 22.09.2026	*20,000*	*20,000*		
	Shuma				**8,020,000**	**3,813,000**	**4,207,000**	

Burimi: Bashkia Has

Për periudhën 2024-2025, Në territorin e Bashkisë Has janë evidentuar 5 subjekte të pajisura me autorizim bazë për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të hidrokarbureve, me detyrime totale për pagesë prej 4,020,000 lekë, janë arkëtuar 2,820,000 lekë dhe duhet të arkëtohet diferenca për 1,200,000 lekë nga subjektet të cilat kanë nxjerrë autorizimin në vitin 2025, ndërsa në total nga autorizimet e dhëna rezulton detyrimi për t'u paguar 8,020,000 lekë, pagesa e realizuar prej 3,813,000lekë, duke lënë një detyrim të *papaguar prej 4,207,000 lekë.*

Nga të dhënat konstatohet se nga Bashkia Has nuk është aplikuar saktë taksa për rinovim të lejes së autorizimit në masën 1,000,000 lekë në 8 raste të licencimit të pikave të shitjes me pakicë të karburanteve dhe nënproduktet e tyre, pasi nga Bashkia Has janë lëshuar autorizime për licencim apo rinovim licence kundrejt pagesave nga subjektet të tarifës në vlerën 200,000 lekë, pra në masën prej 1/5 e tarifës së miratuar për licencim prej 1,000,000 lekë, duke sjellë të *ardhura të munguara në shumën prej 4,207,000 lekë.*

Në mënyrë të detajuar, situata e secilit subjekt është si vijon:

1. "S." sh.p.k., autorizim 22.10.2025-22.10.2029: detyrim 1,000,000 lekë, pagesa 200,000 lekë, debitor 800,000 lekë.
2. "D.H." sh.p.k., autorizim 17.11.2023-17.11.2024 dhe 17.11.2025-17.11.2026: detyrim 1,000,000 lekë, pagesa 1000,000 lekë.
3. "V. P." sh.p.k., autorizim 01.11.2021-16.10.2026: detyrim 1,000,000 lekë, pagesa 800,000 lekë, debitor 200,000 lekë.
4. "E." sh.p.k., autorizim 19.11.2020-19.11.2025: detyrim 1,000,000 lekë, pagesa 100,000 lekë, debitor 900,000 lekë (mbyllur më 01.06.2021).
5. "K.L." sh.p.k., autorizime 18.04.2018-17.04.2021 dhe 20.08.2021-17.04.2023: detyrim 1,000,000 lekë, pagesa 293,000 lekë, debitor 707,000 lekë (mbyllur më 01.01.2023).
6. "Xh. P." sh.p.k., autorizim 19.04.2019-18.04.2024: detyrim 1,000,000 lekë, pagesa 600,000 lekë debitor 400,000 lekë (mbyllur më 01.06.2025).
7. "G." sh.p.k., autorizim 16.03.2021-16.03.2026: detyrim 1,000,000 lekë, pagesa 800,000 lekë, debitor 200,000 lekë.
8. "H." sh.p.k., autorizim 14.01.2020-13.01.2025: detyrim 1,000,000 lekë, pa pagesa të kryera, debitor 1,000,000 lekë (mbyllur më 08.06.2022).
9. "D.M." sh.p.k., autorizim 23.09.2025 - 22.09.2026: detyrim 100,000 lekë, pagesa 40,000 lekë, Autorizimi jepet çdo vit, subjekti paguan 20,000 lekë në vit.

Ushtrimi i aktivitetit nga këto subjekte dhe pajisja me autorizimin nga Bashkia duhet të kryhet bazuar në ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre" dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" pajisur me dokumentacionin si më poshtë:
-Licenca për tregtim karburanti nga MIE
-Certifikata e cilësisë
-Burimi i furnizimit me karburant
-Leje mjedisore
-Certifikate sigurie kundër zjarrit
-Ekstrakt nga QKB
-NIPTI
-Akt themelimi, statut.
-Leje dhe kërkesë pranë bashkisë për ushtrim aktiviteti
-Certifikata e pajisjeve
-Certifikatë cilësie e karburantit
-Certifikatë sigurie nga zjarrfikësja
-Distanca nga banesat
-Rezervuar dhe pajisje të kolauduara
-Verifikimi në terren para miratimit të lejes, etj.
Nga auditimi i dosjeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin "Tregtim me pakicë i karburanteve dhe lëndëve djegëse" rezulton se subjektet nuk kanë paraqitur dokumentacionin ligjor, teknik dhe mjedisor, por vetëm NIPT.

Nga auditimi konstatohen 6 subjekte të cilët janë të regjistruar në QKB dhe të pajisur me NIPT, dhe vlera e detyrimit nuk është evidentuar dhe kontabilizuar, me pretendimin se nuk ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Has, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr.05 datë 21.02.2022*;*
Tabela e personave fizik të regjistruar të cilët nuk kanë paguar taksat vendore

Emër mbiemër	Aktiviteti	Viti	NIPT
L.G.	Shërbim restorant dhoma	2023	M.....E
E.N.	Akomodim Bujtine	2023	M.....F
D.G.	Mbjellje pemë arra, lajthi	2023	L.....P
M.A.	Parukeri	2023	M.....B
A.I.	Transport mallrash	2014	L.....J
B.R.	Bar kafe Lindi	2015	L.....P

2.3. Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025
2.3.1. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit
2.3.2. Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.
2.3.3. Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.
Për auditimin e pasqyrave financiare, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Pasqyrat financiare të vitit 2025 të shoqëruar me formatet 1-9.

2. Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj. , centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventarëve të aktiveve 2025, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2025.
5**.** Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Has në mbyllje të vitit buxhetor 2025.
6. Të tjera dokumente mbështetëse (data bazë të ndryshme ne programet "Excel" si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet te ardhurat etj.).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:
Për vitin 2025 nga njësia shpenzuese "Aparati i Bashkisë Has" për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël".
Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:
Pasqyrat Financiare janë hartuar për Degën e Thesarit Has me ***shkresën nr. 1030, datë 17.03.2026***, Dërgimi i pasqyrave financiare në mënyrë elektronike në thesar është kryer me datë,13.03.2026 dhe konfirmuar nga dega e thesarit datë 17.03.2026.
Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Akt rakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Has të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Has, si dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Has.
2.3.1. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit
Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike. Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, çka me risk të lartë për sa i përket sigurisë në saktësinë informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.
Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:
Për vitin 2025 nga verifikimi i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e Kës 6 dhe Kës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

-Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:
-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për sa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;
Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:
Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:
-Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
-Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.
-Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas Kave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmbajnë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.
Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si: faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

2.3.2. Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:
Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Has për aktivitetin ekonomiko-financiar për periudhën 01.01.2025, deri më datën 31.12.2025.
Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si

dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Totali i Aktivit për vitin 2024 është në vlerën 2,301,666,918 lekë dhe për vitin 2025 është 6,367,574,795 lekë, sipas formatit 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

Formati nr.1 Aktivi i Bilancit 2025 në lekë

Llogari	E M E R T I M I	2025	2024
	A K T I V E T	**6,367,574,795**	**2,301,666,918**
	I. Aktivet Afat shkurtra	**192,959,923**	**222,142,431**
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	**50,049,120**	**72,735,533**
520	Disponibilitete ne Thesar	50,049,120	72,735,533
	2.Gjendje Inventari qarkullues	**26,688,037**	**32,684,280**
31	Materiale	4,624,523	9,465,722
32	Inventar I imet	22,063,514	23,218,558
	3.Llogari te Arketushme	**116,722,766**	**116,722,618**
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	914,949	914,949
468	Debitorë te ndryshëm	90,027,868	89,782,727
4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	25,279,949	26,024,942
	II. Aktivet Afat gjata	**6,174,614,872**	**2,079,524,487**
20	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**4,568,516**
202	Studime dhe kërkime	0	4,568,516
21	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**5,920,050,719**	**1,808,007,498**
210	Toka, Troje, Terrene	243,697,788	1,074,183
211	Pyje plantacione	3,763,496,188	
212	Ndërtesa e Konstruksione	704,140,715	628,838,227
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,112,227,467	1,098,948,821
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	34,165,304	36,024,655
215	Mjete Transporti	30,211,742	25,561,834
218	Inventar ekonomik	21,942,603	7,390,866
24	Aktive afatgjata te dëmtuara	10,168,912	10,168,866
25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	0	**0**
	4.Investime	**254,564,153**	**266,948,473**
231	Per Aktive Afatgjata materiale	254,564,153	266,948,473

Pasqyra e pozicionit financiar (F1)
Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = lekë.

- Aktivet 6,367,574,795 lekë
- Pasivet 141,921,538 lekë
- Aktivet neto 6,225,653,257 lekë

I. AKTIVE AFATSHKURTRA

Ka 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 72,735,533 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 50,049,120 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V "Teprica në fillim të vitit ushtrimor" dhe rubrika VI "teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor" në Formatin nr.3 "Pasqyra e flukseve monetare".

- ***Gjendja e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar"*** paraqitet në pasqyrat financiare në shumën 50,049,120 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 72,735,533 lekë gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në në formatin nr.5 "pasqyra e lëvizjes në cash" e cila paraqitet në shumën 25,698,772 lekë.

Gjendja prej 50,049,120 lekë përbëhet nga rezultati veprimtarisë ushtrimore i vitit 2025 që mbartet për vitin 2026 e cila përputhet me vlerën e raportuar në pasqyrën e përformancës financiare.
Mjetet në ruajtje përbëhen nga 25,698,772 lekë, ndalesat e 5 % te garancisë së punimeve.

Në Kën 3 "Gjendja e inventarit qarkullues", të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 32, 684,037 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 26,688,037 lekë, ku diferenca në ulje në vlerën prej 5,996,243 lekë, rakordon me gjendjen e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në formatin nr.2 "Pasqyra e performancës financiare".

Këto vlera analitikisht paraqiten në gjendjet e llogarive:
- ***Gjendja e llogarisë 31 "Materiale"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 9,465,722 lekë dhe në fund të vitit 2025 në vlerën 4,624,523 lekë, me një diferencë 4,841,199 lekë e cila përfaqëson ndryshimin e gjendjes së mallrave në magazinë në vitin 2025.
- ***Gjendja e llogarisë 32 "Inventari i imët"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 23,218,558 lekë dhe në fund të vitit 2025 në vlerën 22,063,514 lekë, me një diferencë 1,155,044 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 1,155,044 lekë, përbën efektin në shpenzime e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi gjendjes së inventarit" *(pasqyra F2 – performanca financiare)*.

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve, në përputhje me udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Titullari i Bashkisë Has ka nxjerrë Urdhrin nr.54/1, datë 23.01.2026.

Llogaritë e Kës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Ka 4 "Llogari të arkëtueshme" paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **116,722,618** lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2025 në vlerën **116,222,766 lekë,** ku kemi pakësim krahasuar me vitin paraardhës i cili është rezultat i uljes së debitorëve të përbëra nga:

-Llogaria 423-429–Personeli, deficite, gjoba, paradhënie në vlerën prej 914,949 lekë, që përbëhet nga detyrime të punonjësve i pa ndryshuar nga viti i kaluar;

Konkluzion: Gjendja e llogarisë *423-429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* paraqitet në të njëjtën vlerë prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2024 dhe në fund të vitit 2025. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunat me reformën territoriale të vitit 2015. Kjo vlerë i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, dhe përbëhet nga shuma 96,451 lekë që janë detyrime të ish punonjësve pa listë emërore dhe shuma 818,498 lekë, janë fonde të ndihmës ekonomike të ish komunës te grabitura gjatë transportit në vitin 1997, pa autor. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e Kave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik"

- ***Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm"*** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 89,782,727 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 90,027,868 lekë, për taksa dhe tarifa vendore, si dhe detyrime të ndryshme.Vlera e debitorëve në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024 është rritur me 245,141 lekë.

Analiza e gjendjes dhe ndryshimet gjatë vitit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizja e llogarisë 468 debitorë të ndryshëm për vitin 2025

Nr.	**Përshkrimi**	**Vlera/lekë**
1	Gjendje e debitorëve me 01.01.2025	89,782,727
2	Shtesa e debitorëve për taksa dhe tarifa e vitit 2025	1,310,539
3	Arkëtimet e debitorëve të bizneseve te viteve te mëparshme.	4,547,924
4	Detyrime te punonjesve per sigurime e tap dhjetor 2025	3,482,526
4=1+2-3+4	Gjendja e debitorëve me 31.12.2025	**90,027,868**

Në mënyrë më të detajuar në tabelën e më poshtëme

Nr	Llogaria	Gjendja 01.01.2025	Shtesa 2025	Pakësimet 2025 2025	Gjendja 31.12.2025	Debitor
1	468	23,154,812		566,877	22,587,935	Debitorë nga KLSH
2	468	3,256,581		37,000	3,219,581	Debitorë nga APP
3	468	32,121,207	430,490	1,929,121	30,622,576	Subjekte Juridike BM
4	468	13,279,332	701,123	713,001	13,267,454	Subjekte Fizike BV
5	468	206,600			206,600	Institucione buxhetore Taksa vendore
6	468	6,030,721	129,409	240,834	5,919,296	Debitorë nga Markata Krume
7	468	595,065	49,517	19,864	624,718	Debitorë për Qira Toke
8	468	11,138,409		1,041,227	10,097,182	Debitorë Taksa e ndikimit ne infrastrukture
9	468				3,482,526	Detyrime te punonjesve per sigurime dhe tap dhjetor 2025
Totali		**89,782,727**	**1,310,539**	**4,547,924**	**90,027,868**	

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Konkluzion: Referuar analizës së llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm"* dhe lëvizjeve të gjendjes shtesa pakësime gjendja e debitorëve progresiv të vitit 2025, rezulton në vlerën 90,027,86 lekë, ku gjatë vitit 2025 janë paguar detyrime në total në vlerën 4,547,924 lekë, janë shtuar debitorë në vlerën 1,310,538 lekë, duke sjellë një vlerë të detyrimeve në fund të viti 2025, në shumën 86,545,342 lekë shtuar edhe detyrimet e punonjësve për paga dhe kontribute të muajit dhjetor 2025 në shumën 3,482,526 lekë.

- ***Gjendja e llogarisë 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"*** përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës (fonde që priten të alokohen në vitin në vijim nga buxheti i shtetit), debituar në vlerën prej 25,279,949 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e Kës së 4 të pasivit (si furnitorët, pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatim në burim) të pasqyrës financiare të pozicionit financiar.

Detyrimet në fund të vitit 2025 /lekë

Përshkrimi	Mbetja në fund të vitit 2025/lekë
Furnitorë dhe llogari te lidhura me to	818,164
Detyrime ndaj personelit për pagat dhjetor	17,580,226
Detyrime ndaj shteti për tatim page	1,141,114
Detyrime ndaj sigurimeve shoq. Për dhjetor	5,046,097
Detyrime për sig.shendetësore.	694,346
Kreditore, Parapagime	
Totali	**25,279,947**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Për sa më sipër llogaria 4342-Operacione me shtetin të drejta në vlerën 25,279,949 lekë kuadron me llogaritë e detyrimeve të furnitorëve dhe llogarive të lidhura me to dhe detyrimet e pagave dhe sigurimeve dhe tatimit mbi të ardhurat personale detyrime të dhjetorit që paguhen në janar të vitit 2026.

II. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

1.Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata Materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:
- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:
a. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave te UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.
b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:
- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr.1 "Aktivet afatgjata" në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto 6,174,614,872 lekë, nga të cilat:
- ***Gjendja e llogarisë 202 "Studime e projektime"*** në çelje të vitit 2025 gjendjet në vlerën 4,568,516 lekë (Kosto historike – amortizim i akumuluar), ndërsa në fund të vitit 2025 rezulton në vlerën 0 zero lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2025 + shtesa gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2024 + amortizimin e vitit 2025)].
Pakësimet e llogarisë 203 janë kryer sipas rekomandimit të KLSh nga auditimi i mëparshëm për objekte të marra në dorëzim përpara vitit 2025.
Pakësimet bruto te llogarisë 203 kosto historike për vlerën 1,085,000 lekë dhe amortizimi i llogaritur në vlerën e plotë 1,085,000 lekë kalojnë në llogarinë 212 në objektet përkatëse që janë marrë në dorëzim.
Si përfundim paraqitja sipas të dhënave të DFB-së, e llogarisë 202 "Studime dhe projektime" sipas formatit 7/b është si më poshtë vijon:

Shtesat dhe pakësimet e llogarisë studime projektime dhe 203 për vitin 2025 formati 7/b /lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2025	Shtesat gjatë vitit 2025	Amortizim 2025	Pakësimet viti 2025	Amortizim	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2025
9,960,627	5,127,847	4,568,516	0	0	9,960,627	5,127,847	0	0	0
1,085,000	1,085,000	0	0	0	1,085,000	1,085,000	0		

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Referuar pasqyrës aneks formati 7/b llogaria 202 "Studime dhe kërkime" është me vlerë bruto fillestare në fillim të vitit për shumën prej 9,696,363 lekë amortizim i akumuluar në vlerën 5,127,847 lekë dhe tepricë neto në fillim te vitit 2025 për vlerën 4,568,516 lekë. Për vitin 2025 është kryer sistemim veprimi në zbatim të rekomandimit të klsh-së duke kredituar llogarinë 202 per vlerën kosto historike 9,696,363 leke, duke debituar llogaritë përkatëse të aktiveve si më poshtë: Llogarinë 212 në shumën 513,400 lekë dhe llogarinë 213 në shumën 9,182,963 lekë, sipas veprave infrastrukturore janë si më poshtë vijon:

Tabela e pakësimit të llogarisë 202 dhe 203 (studime dhe kërkime/patenta,Liçenca,koncesione) lekë

Llog.	Objektet	shtesa/pakësime
213	Studim projektim rruga Tobel - Metaliaj	478,800
213	Studim projektim Planifikim teritori	100,000
213	Ujesjellesi Golaj miniere Gjeologji (Projektime)	86,432
213	Asfaltim rruga e Fshatit Nikoliq (projekt)	396,000
213	Ujesjellesi Zgjec dhe Stacioni i pompave Letaj (projektime)	400,000
213	Rikonstruksion rruga Vlahen – N/Stacioni elektrik (projekt)	397,500
213	Ndertim sifoni kanali vadites rezervuari Qarr (projekt)	297,000
213	Ndertim KUZ Lagjia Hasanaj Golaj (Projekt)	395,000
213	Studim hidro gjeologjik ujsjellesi uji i pishem Zgjec (projekt)	59,095
213	Studim Ujerat e larta Fshati Krume	400,000
213	Pergatitje projekt rehabilitim dhe sistemim i perroit te tershenes	4,938,936
213	Sistem ndriçimi tortuari Golaj (projekt)	478,200
213	Studim projektim rruga Sefoll Fajza	478,000
213	Studim projektim segmanti Bregu krumave – Pla i Pates	278,000
202	**Studime e kerkime paksim**	**8,426,963**
203	**Koncensione, Patenta e licensa e te ngjashme paksim**	**756,000**
212	Studim Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare krume	400,000
212	Studim projektim shkolla 9-vjeçare Zahrisht	399,000
212	Studime projektim koncensine e licensa (Shkolla 9-vjeçare Metaliaj)	329,000
212	Studim projektim Godina e Bashkise Has e re	470,400
202	**Studime e kerkime paksim**	**1,269,400**
203	**Koncensione, Patenta e licensa e te ngjashme paksim**	**329,000**

Burimi: Drejtoria e Financës & Buxhetit Bashkia Has

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve të Aktiveve Materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2025.

Në formatin nr.1 (Aktivi Bilancit)Aktivet afatgjata materiale paraqiten në vlerën neto 5,920,050,719 lekë. Kjo llogari sintetike paraqitet e analizuar në llogaritë e mëposhtme:

-Gjendja e llogarisë 210 "Toka, troje dhe terrene", në çelje të vitit 2024 ka qenë në shumën 1,074,183 lekë dhe në fund të vitit 2025, rezulton ne vlerën: 243,697,788 Lekë

-Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, plantacione", në çelje të vitit 2025, rezulton në vlerën zero lekë, ne

mbyllje te vitit 2025 është pasqyruar në vlerën, 3,763,496,188 ***lekë***.

-Gjendja e llogarisë nr.212 "Ndërtime e konstruksione" në çelje të vitit 2025 ka qenë në shumën 628,838,227 lekë (kosto historike, duke zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2025 është në vlerën 628,838,217 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2025 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2024 + amortizimin e vitit 2025)].

Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione" shtesa pakësime formati 7/b lekë

Kosto historike	**Amortizim i akumuluar**	**Teprica neto fillim 2025**	**Shtesat gjatë vitit 2025**	**Amortizim 2025**	**Kosto historike**	**Amortizim i akumuluar**	**Teprica neto fund vitit 2025**
966,989,607	338,151,370	628,838227	112,267,583	36,965,094	1,079,257,190	375,116,475	704,140,715

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Shtesa e llogarisë nr.212 "Ndërtime e konstruksione" për vitin 2025 ka ardhur si pasojë e pakësimit të llogarisë 202 "Studime e projektime" si dhe blerje gjate vitit 2025 apo objekte te marra ne dorzim qe ne fillim te vitit kane qene ne proces ne llogarine 231, dhe kalojne llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione".

Tabela e shtesave të llogarisë 212 Ndertesa dhe konstruksione /lekë;

Llog.	Objektet	shtesa/pakësime
212	Rikonsruksion Gjimnazi Skenderbeu(Shkolla Mesme Krume)	77,882,150
212	Supervizim Punimesh (Rikonstruksion Shkolla e Mesme Krume)	371,091
212	**Totali blerje viti 2025**	**78,253,241**
212	Mbjellje peme oborri I shkolles Golaj	326,708
212	Mbjellje peme oborri I shkolles Nikoliq	89,234
212	Rikonstruksion Gjimnazi Skenderbeu (ne proces 2024)	32,000,000
231	**Shpenzime per rritjen e aktiveve paksim 2025**	**32,415,942**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

-Gjendja e llogarisë 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore" në çelje të vitit 2025, ka qenë në shumën 1,098,948,821 **1ekë** (kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2025 rezulton me gjendje 1,112,227,467 lekë

Llogaria 213 "Rruge, rrjete, vepra ujore" shtesa pakësime formati 7/b lekë

Kosto historike	**Amortizim i akumuluar**	**Teprica neto fillim 2025**	**Shtesat gjatë vitit 2025**	**Amortizim 2025**	**Kosto historike**	**Amortizim i akumuluar**	**Teprica neto fund vitit 2025**
1,659,339,306	560,390,485	1,098,948,821	73,327,830	60,049,184	1,732,667,136	620,439,669	1,112,227,467

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Për vitin 2025 janë kapitalizuar në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore" vlera prej 49,361,824 lekë për situacionet e punimeve të objekteve të cilat janë marrë në dorëzim gjatë vitit 2025 vlera të cila kanë qenë në llogarinë 231 "punime në proces".

Shtesa e llogarisë 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore'' dhe pakësimi i llogarisë 231

Llogaria	Emërtimi	Vlera /lekë
213	Rehabilitim diga e rezervuarit Helshan	43,803,343
213	Rehabilitim ndriçimi rrugor njësia Golaj	5,558,481
	Shuma	**49,361,824**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Gjithashtu në vitin 2025 janë kapitalizuar në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore" vlera

prej 14,783,043 lekë për situacionet e punimeve të objekteve të cilat janë marrë në dorëzim gjatë vitit 2025, nga blerjet sipas tabelës së mëposhtme:

Shtesa e llogarisë 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore'' dhe pakësimi i llogarisë 231 lekë

Llog.	Emërtimi	Vlera /lekë
213	Reabilitim me qellim mbingritjen e diges se Rezervuarit Helshan 2	1,253,197
213	Supervizim punimesh"Reabilitim me qellim mbigritjen e diges se rezervuarit Helshan	705,938
213	Ndertim pusetash ujrave te zeza per zonen informale	4,610,400
213	Supervizim punimesh,Ndertim pusetash ujrave te zeza per zonen informale	99,000
213	Reabilitim dhe Sistemimi i Perroit te Tershenes	5,861,940
213	Kualidim Punimesh per Reabilitim dhe Sistemim I Perroit te Tershenes	22,968
213	Ndertim KUZ Lagje Dautaj,Fshati Golaj	1,152,000
213	Ndertim KUZ Lagje Qelaj,Fshati Helshan	1,077,600
Totali		**14,783,043**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Në vitin 2025 janë kryer sistemime kalime në llogarinë 213, "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore" nga llogaria 202 "Studime dhe kërkime" si dhe nga llogaria 203 "Koncesione, Patenta, Licenca" në shumën 9,182,963 lekë.

- Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" në çelje të vitit 2025, ka qenë në shumën 81,831,251 Lekë kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2025 është në vlerën 34,165,304 lekë. [(Teprica neto në fillim të vitit 2025 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2024 + amortizimin e vitit 2025)].

Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" shtesa pakësime formati 7/b lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2025	Shtesat gjatë vitit 2025	Amortizim 2025	Pakësimet viti 2025	Amortizim	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2025
81,831,251	45,806,596	36,024,655	1,178,400	3,037,751	3,894,333	3,894,333	79,115,318	44,950,014	34,165,304

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

-Gjendja e llogarisë 215 "Mjete transporti" në çelje të vitit 2025, ka qenë në shumën 39,732,364 lekë, kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2025 është në vlerën 30,211,742 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2025 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2024 + amortizimin e vitit 2025)].

Tabela 2/14:Llogaria 21 "Mjete transporti "shtesa pakësime formati 7/b lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2025	Shtesat gjatë vitit 2025	Amortizim 2025	Pakësimet viti 2025	Amortizim	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2025
39,732,364	14,170,530	25,561,834	5,928,000	1,278,093			45,660,364	15,448,623	30,211,741

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

-Gjendja e llogarisë 218 "Inventar ekonomik" në çelje të vitit 2025, ka qenë në shumën 5,941,538 lekë (kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2025 është në vlerën 7,390,866 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2025 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2024 + amortizimin e vitit 2025)].

Llogaria 218 "Inventar ekonomik "shtesa pakësime formati 7/b lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2025	Shtesat gjatë vitit 2025	Amortizim 2025	Pakësimet viti 2025	Amortizim	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2025
59,941778	52,550,910	7,390,866	17,263,699	2,711,962	13,711,768	13,711,768	63,493,707	41,551,105	21,942,603

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

-Në total ***llogaria 231*** punime në proces (ndërtesa konstruksione + rruge rrjete dhe vepra ujore) paraqitet në fillim të vitit 2025 në vlerën debitorë prej ***266,948,473 lekë***. Për vitin 2025 është debituar për vlerën 171,727,738 lekë dhe është kredituar për vlerën prej 184,112,058 lekë dhe rezulton me teprice debitore në fund të vitit 2025 për vlerën prej 254,564,153 lekë.
Nga krahasimi i të dhënave të thesarit me të dhënat e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit rezulton se llogaria 231, sipas thesarit për vitin 2025 është në vlerën ***254,564,153 lekë*** që rezulton e përputhur me vlerën debitore të llogarisë 231 sipas DFB në bashkinë Has, për vitin 2025.
- *Gjendja e llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* për vitin 2025 është në vlerën 0 lekë. Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës Sh. A" me NIPT M.....I, u konstatua se Bashkia Has zotëron 6.06% të aksioneve të kësaj shoqërie. Kjo shoqëri është krijuar sipas akt marrëveshjes se Bashkive Tropojë, Has dhe Kukës dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë e përfaqësuar nga AKUK me nr. 3206.prot., datë 19.07.2022. Vlera e kapitalit të kësaj shoqërie është 10,000,000 lekë ku bashkia Has zotëron ose 6,06% të tyre ose në vlerën total 606,000 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kreu 3.1, pika 31, shkronja "b", i ndryshuar. Llogaria nr. 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vetë", nuk paraqitet në situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2025 pasi nuk është regjistruar vlera e aksioneve që ka Bashkia Has në "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës Sh. A".

Tabela 2/16:Pasivi i Bilancit /lekë

Llogaria	**E M E R T I M I**	**2025**	**2024**
	PASIVET(DETYRIMET)	**141,921,538**	**135,601,348**
	I. Pasivet Afat shkurtra	**141,921,538**	**135,601,348**
	1. Llogari te Pagueshme	**51,893,670**	**135,601,348**
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	818,164	1,057,517
42	Detyrime ndaj personelit	17,580,226	17,974,332
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,141,114	1,161,785
435	Sigurime Shoqërore	5,046,097	5,121,610
436	Sigurime Shëndetësorë	694,348	709,698
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	25,698,772	18,878,730
467	Kreditorë të ndryshëm	0	0
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	914,949	90,697,676
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	**90,027,868**	**0**
470	Llogari ne pritje te ardhura per tu marre nga debitoret	90,027,868	0
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	6,225,653,257	2,166,065,570
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	6,225,653,257	2,166,065,570
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti I akumuluar	6,201,302,909	2,112,208,767
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	24,350,348	53,856,803
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta të investimeve		
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e Zhvlerësime		
105	Teprica e Granteve kapitale të Brendshme		
106	Teprica e Granteve kapitale të Huaja		
107	Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim		
109	Rezerva nga Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata		
	Të Tjera		

	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	**6,367,574,795**	**2,301,666,918**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Llogaritë e Kës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Has më 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2025, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave të investimeve.

Pasivet afatshkurtra (Detyrimet) janë në vlerën prej **141,921,538** lekë të ndara përkatësisht, si më poshtë vijon :

- ***Llogaria 401-408 "Furnitorë dhe llogari të lidhura me to"***, është në vlerën prej 818,164 lekë të cilat janë detyrime ndaj të tretëve për faturat e mbërritura pranë financës, por të pa likuiduara brenda vitit për mungesë të fondeve.

Llogaria 401-408 Furnitorë dhe llogari të lidhura me to në fund të 2025-ës/ lekë

Nr.	Vlera	Emërtimi	Furnitori
1	626,555	Energji Elektrike dhjetor 2025	F
2	28,200	kolaudim punimesh rruga Zahrisht	Xh & M SH.P.K.
3	163,409	Ndërtim ujësjellësi Krume - Zahrisht vazhdim shtesa	L SH.P.K.

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

-*Llogaria 42-Detyrime ndaj personelit*, është në vlerën prej 17,580,226 lekë ku përfshihen pagat e punonjësve për muajin Dhjetor 2025, të cilat paguhen në muajin Janar të vitit 2026.

-*Llogaria 431-Detyrime ndaj shtetit për tatim mbi të ardhurat nga paga* në masën 15% sipas Kifikimit të pagave, është në vlerën prej 1,141,114 lekë, që përfshin tatimin e pagave dhe tatimin në burim të muajit Dhjetor 2025, që paguhet në vitin pasardhës buxhetor.

-*Llogaria 435-Sigurimet shoqërore* 9,5% punëmarrësi dhe 15% punëdhënësi, si dhe sigurimet suplementare, të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe janë në vlerën prej 5,046,097 lekë.

-*Llogaria 436- Sigurimet shëndetësore* 1,7% punëmarrësi dhe 1,7% punëdhënësi, të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe janë në vlerën prej 694,348 lekë.

-*Llogaria 466-Kreditorë për mjete në ruajtje*, është në vlerën prej 25,698,772 lekë në të cilën përfshihen 5% garanci defektesh për objektet e investimeve të cilave nuk u ka mbaruar afati garancisë së punimeve të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes, por edhe garanci për të cilat nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për likuidimin e tyre. Kjo llogari është debituar gjatë vitit 2025 në vlerën 1,402,287 lekë, që përfaqëson vlerën e garancive të kthyera ndaj palëve të treta në kredi të bankës, si dhe është kredituar për vlerën 8,222,329 lekë, që përfaqëson garancitë e mbajtura nga Bashkia Has kundrejt palëve të treta, në debi të bankës.

-*Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm"* paraqitet me gjendje 0, nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit si dhe verifikimit të llogarive u konstatua se në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e vendimeve gjyqësore prej 2,208,004 lekë, vlerë e cila nuk është kontabilizuar në llogarinë e mësipërme.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2025, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, të cilat paraqiten si më poshtë:

Gjendja e llogarisë 466 kreditor për mjete në ruajtje fund 2025 lekë

Nr.	**Objekti**	**Te hyra**	**Te dala**
1	Totali Kreditore për mjete ne ruajtje 2024	18,878,730	
2	Rehabilitim per ngritjen e diges rezervuari Helshan	62,660	

3	Blerje mjet shtrim asfalti		228,000
4	Blerje kamion 3 akse		228,000
5	Ndertim i rruges Dida Geca Fshati Krume		296,446
6	Ndertim kanal me tub plastik rezervuari bera		126,659
7	Ndertim KUZ Fshati Gajrep Krume		523,182
6	Ndertim puseta te ujerave te zeza	230,520	
7	Rehabilitim perroi i tershenes	287,277	
8	Blerje mjeti zjarrfikes pik up 4*4	296,400	
9	Rikonstruksion i Gjimnazit Skenderbeu	3,193,117	
10	Rikonstruksion i Gjimnazit Skenderbeu	700,991	
11	Rikonstruksion i shkolles 9-vjeçare Sejdi Dida	1,511,622	
12	Sistemim asfaltim rrugete brendshme Fshati Golaj	1,306,504	
13	Sistemim asfaltim rrugete brendshme Fshati Golaj	633,238	
	Totali i levizjeve 2025	**8,222,329**	**1,402,287**
	Total	**25,698,772**	

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

-Llogaria 4341-Operacione me shtetin detyrime është në vlerën prej 914,949 lekë. Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Sipas informacionit analitik në këtë llogari janë kontabilizuar të drejta të Bashkisë Has për arkëtim të detyrimeve të pa paguara për detyrime të tjera individë, punonjës.

Llogaria 4341 korrespondon me llogaritë 468 dhe 423,429 si më poshtë vijon:

Llogaria	**E M E R T I M I**	**Lekë**
423/429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	914,949
470	Debitorë të ndryshëm	90,027,868

Burimi i të dhënave, Bashkia Has, përpunuar nga grupi i auditimit

Fondi i Konsoliduar

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën **6,225,653,257 lekë.** Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve me pasivet.

Fondi i konsoliduar 2025/lekë

Llogaria	**E M E R T I M I**	**2025**	**2024**
	FONDI I KONSOLIDUAR:	**6,225,653,257**	**2,166,065,570**
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	6,201,302,909	2,122,208,767
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	24,350,348	53,856,803

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

-Llogaria 101- Teprica (Fondi Akumuluar), është në vlerën prej 6,201,302,909 lekë, e përbërë nga aktivet materiale dhe jo materiale, si dhe gjendja e aktiveve qarkulluese (materialet dhe objekte inventari).

-Llogaria 85- Rezultati i veprimtarisë ushtrimore, është në vlerën prej 24,350,348 lekë (Të ardhurat – Shpenzimet), e përbërë nga fondet buxhetore të papërdorura (në debi të llogarisë 520), që trashëgohen në vitin pasardhës buxhetor.

-Auditimi i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

Analiza e llogarive të të ardhurave

Auditimi në lidhje me të ardhurat tatimore u fokusua në drejtim të rakordimit të të ardhurave sipas llojeve të tyre midis sektorit të taksave dhe tarifave vendore dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. U kryen rakordimet e të ardhurave me thesarin sipas llojeve të tyre dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrën e performancës financiare të bashkisë Has.

Nga kryqëzimi i informacionit të thesarit, sektorit të taksave dhe tarifave vendore dhe rakordimi me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit u konstatua që nuk ka devijime në pasqyrimin e të ardhurave.

-*Gjendja e llogarisë sintetike 70 "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"* është në vlerën 6,636,108 lekë, e cila kuadron me akt rakordimin me thesarin sipas kodifikimit të Thesarit.

*a. Gjendja e llogarisë 7002"Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi i vogël"*në vlerën prej 60,000 lekë.

b. *Gjendja e llogarisë* 702 *"Të ardhura nga pasuria e paluajtshme"*, në vlerën prej 1,547,177 lekë ku përfshihen të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore në vlerën 232,070 lekë dhe taksë ndërtese 1,315,107 lekë.

c. *Gjendja e llogarisë* 703*"Tatim mbi mallra dhe shërbime brenda vendit"*, në vlerën prej 5,028,931 lekë ku përfshihen:

- taksë për zënie hapëS publike 288,450 lekë,
- taksë e ndikimit në infrastrukturë 1,099,043 lekë,
- taksë therje bagëtie 248,000 lekë,
- taksë reklame 248,370 lekë,
- taksë tabele 201,205 lekë,
- taksë shfrytëzimi pyjor 699,000 lekë,
- taksë e gjelbër 225,380 lekë,
- takse pastrimi 20,792
- taksë ndriçimi 388,202 lekë,
- taksë trualli 92,834 lekë,
- tarifë uji 836,100 lekë,
- certifikate përdorimi 10,000 lekë,
- tarifë urbanistike 10,000 lekë,
- tarifë leje karburantesh 641,555 lekë,
- tarifë leje ndërtimi 20,000 lekë

Të ardhurat jo tatimore

- *Gjendja e llogarisë* 71 *"Të ardhurat jo tatimore"* në vlerën prej 12,501,329 lekë e përbërë nga:
- *Gjendja e llogarisë* 710 *"Të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia, qira objekti"* në vlerën prej 6,076,477 lekë.

-*Gjendja e llogarisë* 711*"Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare"*, në vlerën prej 6,424,852 lekë, përbëhet nga:

- *Gjendja e llogarisë* 7110 *"Tarifa shërbimesh dhe rregullatorë"* në vlerën 5,604,306 lekë
- *Gjendja e llogarisë* 7111 *"Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh"* në vlerën 113,596 lekë
- *Gjendja e llogarisë* 7113 "Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve" në vlerën 17,900 lekë
- *Gjendja e llogarisë* 7115 "Gjoba kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime" në vlerën 659,050 lekë

Grante

- *Gjendja e llogarisë* 72 **"***Grant Korrent i brendshëm"*, në vlerën prej **714,246,760** lekë në të cilen përfshihen grante nga qeveria për shpenzime, financim i pritshëm, taksat e ndara si vijon:

-*Gjendja e llogarisë* 7201 *"financim nga buxheti për njësisë e vetëqeverisjes vendore"* në vlerën

669,228,958 lekë.

-*Gjendja e llogarisë* 7204 *"pjesëmarrje e institucioneve në tatimet nacionale*" në vlerën 19,737,853 lekë.

Financim i pritshëm nga buxheti 25,279,949 lekë, janë të ardhura që priten të alokohen vitin në vazhdim.

Analiza e llogarive të shpenzimeve

Shpenzimet në total për vitin 2025 janë në vlerën ***709,033,949 lekë*** sipas Pasqyrës së Performancës Financiare për sa i përket shpenzimeve të detajuara si më poshtë:

Pasqyrimi i shpenzimeve në bilancin 2025 /lekë

B	**SHPENZIMET**	**709,033,949**	**663,520,302**
600	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJESEVE**	**245,155,632**	**215,069,105**
6001	Paga, personel i përhershëm	243,714,657	202,466,644
6002	Paga personel i Përkohshëm	1,440,975	12,602,461
6003	Shpërblime (Komisioner)		0
6009	Shpenzime të tjera për personelin		0
601	**II.KONTRIBUTE TË SIGURIMEVE**	**40,554,204**	**36,227,975**
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	36,403,746	32,501,700
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	4,150,458	3,726,275
602	**III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME**	**73,616,966**	**56,985,788**
602	Mallra dhe shërbime te tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	1,612,000	1,971,551
6021	Materiale dhe shërbime speciale	1,356,496	1,433,028
6022	Shërbime nga te tretë	22,282,147	19,230,792
6023	Shpenzime transporti	12,330,355	16,403,897
6024	Shpenzime udhëtimi	2,919,000	3,041,540
6025	Shpenzime për mirëmbajtjeje të zakonshme	21,512,331	5,627,717
6026	Shpenzime për qiramarrje	0	0
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	1,343,082	628,860
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	10,261,555	8,648,403
	V.TRANSFERIME KORENTE	**343,710,804**	**365,694,965**
604	**1.Transferime korrente te brendshme**	**3,581,375**	**2,993,890**
6040	Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë	3,581,375	2,993,890
606	**3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë**	**340,129,429**	**362,701,075**
6061	Transferta të Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pushtetit Vendor	340,129,429	362,701,075
63	***VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT***	**5,996,243**	**-10,457,531**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has/sektori i tatimeve /thesari

-*Gjendja e llogarisë* 600 *"Paga shpërblime dhe të tjera personeli"* për vitin 2025 është në vlerën 245,155,632 lekë, dhe përbëhen nga pagat bruto të punonjësve detyrime të konstatuara gjatë vitit 2025 përfshirë dhe pagat e muajit Dhjetor 2025 që paguhen në muajin Janar 2026 dhe sipas akt rakordimit me thesarin.

-*Gjendja e llogarisë* 601 "*Kontributet e sigurimeve shoqërore*" në vlerën 40,554,204 lekë përbëhet nga nën llogaria 6010 në vlerën prej 36,403,746 lekë dhe 6011 kontributet e sigurimeve shëndetësore në vlerën prej 4,150,458 lekë dhe sipas akt rakordimit me thesarin.

-*Gjendja e llogarisë* 602 *"Blerje mallra dhe shërbime"*, në vlerën 73,616,966 lekë, përbëhet nga shpenzimet e kryera gjatë vitit 2025 për mallra dhe shërbime të konstatuara për faturat e mbërritura në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit gjatë vitit 2025 dhe sipas akt rakordimit me thesarin.

Pasqyrimi i shpenzimeve të llogarisë 602 dhe nen llogarive të saj 2025 /lekë

602	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**73,616,966**
6020	Materiale zyre e te përgjithshme	1,612,000
6021	Materiale dhe shërbime speciale	1,356,496
6022	Shërbime nga te trete	22,282,147
6023	Shpenzime transporti	12,330,355

6024	Shpenzime udhëtimi	2,919,000
6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	21,512,331
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	1,343,082
6029	Shpenzime te tjera operative	10,261,555

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

- *Gjendja e llogarisë* 604 *"Transferime korrente të brendshme"* në vlerën 3,581,375 lekë përbëhet nga shpenzimet e kryera gjatë vitit 2025 që janë pagesa për ndihma financuara për familje të dëmtuara ndihma për njerëzit në nevojë etj.
- *Gjendja e llogarisë* 606 *"Transferime për buxhete familjare dhe individë"* në vlerën 340,129,429 lekë përbëhet nga shpenzimet e realizuara për ndihmën ekonomike dhe të paaftësisë nga transferta për buxhete familjare dhe individë e cila sipas rakordimit me thesarin rezulton e përputhur me të dhënat e thesarit për shpenzimet buxhetore.
- Gjithashtu, gjendja e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" është i barabartë me ndryshimin e gjendjes së Kës 3, në formatin 1 të bilancit, i cili rezulton për vitin 2025 në vlerën prej 5,996,243 lekë.

Nga testi i kontrollit për vitin 2025 në lidhje me veprimet nëpërmjet arkës dhe bankës:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet nëpërmjet arkës kryhen për të gjitha rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore, tarifave të biznesit, tarifat familjare, taksë toke, ndërtese, .. etj, dhe sipas rasteve brenda ditës apo në fund të çdo jave derdhjet e arkës bëhen në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit. Nga auditimi u konstatua se, dokumentet janë plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe kreut III pika 34 dhe 35 germa a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 *"Për limitin e arkës"*.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadron me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- Bashkia Has, gjatë periudhës objekt auditimi rezulton se ka pasur në 3-4 raste vonesa në likuidimin e faturave, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit", Udhëzimi Plotësues nr.2, datë 24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2025", pika 46.

Në tabelën e mëposhtme po paraqesim faturat e likuiduara me vonesë:

Nr	Emri Furnitorit	DataKontrates	Emërtimi i kontratës	Dt. Thesar
1	"D.-G."	26.12.2024	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore sipas u-prok nr.38 dt.26.09.2024,kont nr.4120.dt.26.12.2024.Bashkia Has	07.05.2025
2	"K. B."	30.06.2025	Blerje pjese kembimi per makineri, kont nr.2214 dt.30.06.2025, Bashkia Has	07.07.2025
3	"T. J. C."	07.07.2025	Kont nr.2334 dt. 07.07.2025 "Pastrim kanalesh dhe ushqyes rezervuari"' Bashkia HAS"	28.07.2025
4	"SH. – AL."	09.07.2025	"Rehabilitim dhe sistemim i perroit te Tersheres" kont nr.2363 dt.09.07.2025	11.08.2025
5	"2Z.K."	13.10.2025	Rikons i shkolles 9-vjecare Sejdi Dida faza I,II.III viti 2025,2026,2027,kont nr.3675 dt. 13.10.2025,f nj fituesit nr.3586 dt.07.10.2025,f nj se kont se nënshkruar dt. 13.10.2025	16.12.2025
6	"K.B."	01.10.2025	Kont nr.3517 dt.01.10.2025 me object "Blerje mjetesh zjarrefikes 4x4Pick up faza 1 vitit 2025 ,faza 2 viti 2026 Bashkia Has	08.01.2026
7	"A.- C."	14.12.2025	Kont nr.4162 dt. 14.12.2025 me objekt"Rik i shkolles 9-vjecare Sejdi Dida"' Bashkia has	08.01.2026

Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave Materiale, veprimet me magazinën.

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël është kryer sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet janë kontabilizuar saktë.
-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm janë të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga zv/Kryetari dhe Kryetari.
- Janë mbajtur të dhëna për aktivet ku ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, përllogaritur amortizimi, duke patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
- Janë hapur kartelat e zyrave për inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

3.3.3. Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.

Në zbatim të *Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, neni 74,* parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)", Pasqyrën nr. 7/b, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)", kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-daljet nga magazina etj.
Me urdhrin ***nr.54/1.prot., datë 23.01.2026*** të Kryetarit të Bashkisë Has është ngritur grupi i punës për inventarizimin e aseteve të bashkisë Has. Bazuar në të dhënat e formularëve përmbledhës të inventarëve të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë konstatuar diferenca.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. S.M. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe të hartuesit të pasqyrave financiare. Për sa më lart është mbajtur Akt konstatimi nr. 14, datë 04.05.2026.

2.4. Auditimi i prokurimeve publike për vitin 2023-2025.
2.4.1. Programi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.
2.4.2. Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.
2.4.3. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve.

Baza Ligjore:
- Ligji nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik**"**
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"
- Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"
- etj....

Në zbatim të pikës nr. 4 të programit të auditimit nr. 106/1 prot, datë 28.01.2026 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë vijon;
- Regjistrat e planifikimit dhe realizimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2024.
- Urdhrat për ngritjen e komisioneve të prokurimeve me vlera të vogla për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2024.
- Procedurat e prokurimeve me vlera të vogla me zgjedhje për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2024.
- Dokumentacion plotësues/justifikues si fatura, transaksione bankare, fletë-hyrje në magazinë etj.

<u>Pika 4</u>. Auditimi i prokurimeve publike për vitin 2023-2025.
- Programi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.
-Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.
-Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit nga grupi i auditimit është kërkuar dokumentacioni si më poshtë:
- ✓ Regjistri i parashikimit dhe realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2023, 2024 dhe 2025;
- ✓ Planifikimi buxhetor i prokurimeve;
- ✓ Dosjet e procedurave të prokurimeve;

- ✓ Procedurat e prokurimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) në faqen e APP (http://www.app.gov.al/);
- ✓ Urdhrat për emërimin e personave përgjegjes për prokurimet
- ✓ Lista investimet të marra në dorëzim dhe të përfunduara për periudhën 01.01.2023 deri me 31.12.2025.

3.4.1. Programi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Bashkia Has për vitet 2023-2025, në cilësinë e autoritetit kontraktor, në bazë të kërkesave për punë, mall dhe shërbime çdo fillim viti kalendarik ka miratuar buxhetin e saj, si dhe ka hartuar regjistrimin e parashikimit të prokurimit publik dhe e ka dërguar atë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik në përputhje me kërkesat që përcakton neni 3 dhe 4 i VKM nr. 285, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", datë 19.02.2021.

Nga verifikimi i SPE, konstatohet se regjistri i parashikimeve dhe realizimeve për periudhën objekt auditimi për Bashkinë Has është si vijon:

Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2023, sipas llojit

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi	
		Numri	Vlera (lekë pa TVSH)	Numri	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	22	1,813,333.00	24	2,017,500
2	Blerje me Vlerë të Vogël (100,000-1,000,000)	38	26,561,665.00	31	20,007,957.00
3	Procedurë e hapur e thjeshtuar	19	94,625,707.00	13	55,799,738.00
	TOTALI	**79**	**123,000,705.00**	**68**	**77,825,195.00**

Burimi i të dhënave: *Bashkia Has, përpunoi Grupi i auditimit të KLSH*

Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2024, sipas llojit

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi	
		Numri	Vlera (lekë pa TVSH)	Numri	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	5	391,666.00	18	2,090,000
2	Blerje me Vlerë të Vogël (100,000-1,000,000)	33	17,851,533.30	12	7,056,533.00
3	Sistem Dinamik i Blerjeve	1	833,333.00	0	0.00
4	Procedurë e hapur e thjeshtuar	18	66,310,569.50	11	41,470,333.17
5	Procedurë e hapur	5	263,305,936.00	4	246,838,402.00
	TOTALI	**62**	**348,693,037.80**	**45**	**297,455,268.17**

Burimi i të dhënave: *Bashkia Has, përpunoi Grupi i auditimit të KLSH*

Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2025, sipas llojit

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi	
		Numri	Vlera (lekë pa TVSH)	Numri	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	5	335,833.00	25	1,958,158.33
2	Blerje me Vlerë të Vogël (100,000-1,000,000)	33	17,811,139.00	19	11,631,761.00
4	Procedurë e hapur e thjeshtuar	17	54,208,434.00	10	30,955,358.00
5	Procedurë e hapur	1	125,968,569.17	2	135,968,569.17
	TOTALI	**56**	**198,323,975.17**	**56**	**180,513,846.50**

Burimi i të dhënave: *Bashkia Has, përpunoi Grupi i auditimit të KLSH*

Sa më sipër rezulton së për vitin 2023, nga **76** procedura prokurimi të parashikuara në regjistër, me vlerë fondi limit **123,000,705** lekë pa TVSH, janë realizuar **68** procedura me vlerë **77,825,195** pa TVSH, pra **11** procedura më pak nga parashikimi.
-Për vitin 2024 nga **62** procedura prokurimi të parashikuara në regjistër me vlerë **348,693,038** lekë pa TVSH, janë realizuar **45** procedura me vlerë **297,455,268.17** pa TVSH, **17** procedura më pak nga parashikimi.
-Për vitin 2025, për Bashkinë Has nga **56** procedura prokurimi të parashikuara në regjistër me vlerë **198,323,975.17** lekë pa TVSH, janë realizuar **56** procedura me vlerë **180,513,846.50** pa TVSH.

Mos realizimi i procedurave të parashikuar dhe mos përdorimi i fondeve buxhetore tregon mangësi në procesin e parashikimit në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu II, neni 3, pika 2, ku përcaktohet se: "Regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimin në kohë të procedurave të prokurimit publik."

Auditimi i Procedurave të prokurimit të Blerjeve me vlerë të vogël

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezulton se për vitin 2023 janë realizuar 31 procedura blerje me vlerë të vogla me fond limit 20,007,957 lekë pa TVSH.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezulton se për vitin 2024 janë realizuar 12 procedura blerje me vlerë të vogla me fond limit 7,056,533 lekë pa TVSH.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezulton se për vitin 2025 janë realizuar 19 procedura blerje me vlerë të vogla me fond limit 11,631,761.00 lekë pa TVSH.

Viti 2023

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar dhe aksesit në sistemin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) konstatohet se:

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, Bashkia Has ka realizuar 31 procedura prokurimi me vlera të vogla, me fond limit 20,007,957.00 lekë pa TVSHTVSH dhe realizuar me vlerë kontrate në shumën 18,370,741.00 lekë pa TVSHTVSH.
Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:
- Me Urdhërin nr. 65, shkresa nr. 855 prot, datë 25.09.2023 të Kryetarit të Bashkisë, "Për ngritjen e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël", është krijuar komisioni me përbërje si më poshtë:

1. Z.Sh. Kryetar
2. N.P. Anëtar
3. Y.D. Anëtar

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të audititmit nuk rezultojnë urdhëra të mëparshëm "Për ngritjen e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël"

Gjatë vitit 2023,

Bahkia Has ka realizuar
- 2 procedura prokurimi me vlera të vogla me një fond limit total në shumën 2,000,000 lekë pa TVSHTVSH duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit dhe duke mos i kryer këto procedura me tenderim. Konkretisht, dy procedura "**Blerje artikuj ushqimor për konviktin "K.**", me urdhër prokurimi nr. 24 datë 17.03.2023, me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSHTVSH dhe procedura "**Blerje Bukë për konviktin "K.**", me urdhër prokurimi nr. 25, datë 17.03.2023, me fond limit 333,125 pa TVSHTVSH. Për sa më sipër të dy këto procedura i përkasin të njëjtit objekt prokurimi, "**Blerje artikuj ushqimor për konviktin "K.**" veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 56, pika 1, "Autoriteti/enti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime, kur vlera e përllogaritur është ndërmjet kufijve nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë në vit, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 41, të LPP-së.
Pika 2. "Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi."
- 2 procedura prokurimi me vlera të vogla me një fond limit total në shumën 2,000,000 lekë pa TVSH duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit dhe duke mos i kryer këto procedura me tenderim. Konkretisht, dy procedura "**Blerje kontenier për mbledhjen e mbeturinave, faza1**", me urdhër prokurimi nr. 23 datë 17.03.2023, me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSH dhe procedura ""**Blerje kontenier për mbledhjen e mbeturinave, faza2**", me urdhër prokurimi nr. 40, datë 27.04.2023, me fond limit 1,000,000 pa TVSHTVSH. Për sa më sipër të dy këto procedura i përkasin të njëjtit objekt prokurimi, "**Blerje kontenier për mbledhjen e mbeturinave"**, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 56, pika 1, "Autoriteti/enti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime, kur vlera e përllogaritur është ndërmjet kufijve nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë në vit, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 41, të LPP-së.
Pika 2. "Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi."

Me zgjedhje nga janë audituar 4 procedura

Viti 2023					
Nr.	Objekt	Fondi limit	Vlera e kontratës	OE i shpallur fitues	Publikuar në APP
1	Blerje artikuj ushqimor për konviktin "Kososva", faza 1	1,000,000	988,150	"B. 66"	17.03.2023
2	"Mirëmbajtje, shërbime, blerje pjesë të pajisjeve kompjuterike, fotokopjimi, printimi etj"	400,000	380,000	"C. 2A"	22.05.2023
3	Blerje kontenier për mbledhjen e mbeturinave	1,000,000	964,000	"N. Sh."	30.03.2023
4	Blerje kontenier për mbledhjen e mbeturinave	1,000,000	964,000	"N. Sh."	16.11.2023
Totali		5,389,447	4,182,633		

1. Me Urdhër Prokurimi nr. 24, datë 17.03.2023, të Kryetarit të Bashkisë Has në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. A. M., znj. E.L. dhe znj. E. S. (Anëtarë), (emrat e anëtarëve janë marrë nga sistemi APP pasi nuk është vënë në dispozicion urdhër "Për "ngritjen e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël" për vitin 2023 me këtë përbërje për Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël) cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje artikuj ushqimor për konviktin "K.", faza 1** me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSHTVSH.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 27.03.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik **"B. 66"** me vlerë 988,150 lekë pa TVSHTVSH i cili është i renditur i pari në Kifikimin.
Nga auditimi u konstatuan këto problematika:

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë nuk ka dokument për nënshkrimin e deklaratës së konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 13, pika 5.
-Nuk dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar, pika 7, ku përcaktohet që: "Përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit/enti kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e references duhet të përllogarisë fondin për sasinë e mallrave, Shërbimeve, punëve që do të prokurojë në përputhje me nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme. Kjo përllogaritje do t'i shërbejnë komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për të bërë krahasimin e ofertave të paraqitura gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit."
- Një pjesë e mallrave janë marrë në dorëzim dhe i është bërë hyrje në magazinë sipas fletë-hyrjes pa numër, datë 23.05.2023, por nuk disponohet urdhër për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 42, ku përcaktohet që:" "Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues"
- Nuk disponohet dokumentacion tjetër vërtetues për marrjen në dorëzim për pjesën tjetër të mallrave të prokuruara nga ana e Bashkisë Has, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 39, "Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme."

2. Me Urdhër Prokurimi nr. 49, datë 19.05.2023, të Kryetarit të Bashkisë Has në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. A.M., znj. E.L. dhe znj. E.S. (Anëtarë), (emrat e anëtarëve janë marrë nga sistemi APP pasi nuk është vënë në dispozicion urdhër "Për "ngritjen e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël" për vitin 2023 me këtë përbërje për Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël) cili ka filluar procedurën me objekt **"Mirëmbajtje, shërbime, blerje pjesë të pajisjeve kompjuterike, fotokopjimi, printimi etj"** me fond limit 400,000 lekë pa TVSHTVSH.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 22.05.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik **"C.-2A."** me vlerë 380,600 lekë pa TVSHTVSH i cili është i renditur i pari në Kifikimin.
Nga auditimi u konstatuan këto problematika:
- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë nuk ka dokument për nënshkrimin e deklaratës së konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 13, pika 5.
-Nuk dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar, pika 7, ku përcaktohet që: "Përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit/enti kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i

prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e references duhet të përllogarisë fondin për sasinë e mallrave, Shërbimeve, punëve që do të prokurojë në përputhje me nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme. Kjo përllogaritje do t'i shërbejnë komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për të bërë krahasimin e ofertave të paraqitura gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit."
- Nuk disponohet dokumentacion për marrjen e mallrave në dorëzim veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 39, " Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme."
- Nuk disponohet urdhër për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 42, ku përcaktohet që:" "Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues".

3. Me Urdhër Prokurimi nr. 23, datë 17.03.2023, të Kryetarit të Bashkisë Has në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. A.M., znj. E. L. dhe znj. E. S. (Anëtarë), (emrat e anëtarëve janë marrë nga sistemi APP pasi nuk është vënë në dispozicion urdhër "Për "ngritjen e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël" për vitin 2023 me këtë përbërje për Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël) cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje kontenier për mbledhjen e mbeturinave"** me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSHTVSH.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 30.03.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik **"N.N.Z.K. Sh."** me vlerë 964,000 lekë pa TVSHTVSH i cili është i renditur i dyti në Kifikimin.
- Sipas të dhënave të marra nga sistemi APP, më datë 29.03.2023 rezulton se operatori ekonomik i renditur në vëndin e parë është operatori "M. K." me vlerë 944,000 lekë pa TVSH, por nuk ka asnjë proces verbal për kalimin në operatorin e rradhës.

Nga auditimi u konstatuan këto problematika:
- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë nuk ka dokument për nënshkrimin e deklaratës së konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 13, pika 5.
-Nuk dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar, pika 7, ku përcaktohet që: "Përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit/enti kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e references duhet të përllogarisë fondin për sasinë e mallrave, Shërbimeve, punëve që do të prokurojë në përputhje me nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme. Kjo përllogaritje do t'i shërbejnë komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për të bërë krahasimin e ofertave të paraqitura gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit."

- Nuk disponohet dokumentacion për marrjen e mallrave në dorëzim veptime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 39, " Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme."
- Nuk disponohet urdhër për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 42, ku përcaktohet që:" "Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues".
- Nuk disponohet asnjë proces verbal për kalimin në operatorin e rradhës veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar, pika 18, ku përcaktohet që:" Kur ofertuesi fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor të përcaktuar në "Ftesën për Ofertë, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor në "Ftesën për Ofertë", ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë. Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nëpërmjet një procesverbali të mbajtur për këtë qëllim. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor do të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm operatorët ekonomikë të renditur deri në vendin e dhjete te Kifikimit."

4. Me Urdhër Prokurimi nr. 40, datë 27.04.2023, të Kryetarit të Bashkisë Has në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. A. M., znj. E.L. dhe znj. E.S. (Anëtarë), (emrat e anëtarëve janë marrë nga sistemi APP pasi nuk është vënë në dispozicion urdhër "Për "ngritjen e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël" për vitin 2023 me këtë përbërje për Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël) cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje kontenier për mbledhjen e mbeturinave"** me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSH.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 03.05.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik **"N.N.Z.K. Sh."** me vlerë 964,000 lekë pa TVSH i cili është i renditur i treti në Kifikimin.
- Sipas të dhënave të marra nga sistemi APP, më datë 29.04.2023 rezulton se operatori ekonomik i renditur në vëndin e parë është operatori "S .&C.C." me vlerë 668,900 lekë pa TVSH, por nuk ka asnjë proces verbal për kalimin në operatorin e rradhës.
- Sipas të dhënave të marra nga sistemi APP, më datë 02.05.2023 rezulton se operatori ekonomik i renditur në vëndin e dytë është operatori "I. A." me vlerë 722,000 lekë pa TVSH, por nuk ka asnjë proces verbal për kalimin në operatorin e rradhës.

Nga auditimi u konstatuan këto problematika:
- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë nuk ka dokument për nënshkrimin e deklaratës së konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 13, pika 5.
-Nuk dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar, pika 7, ku përcaktohet që: "Përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit/enti kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i

prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e references duhet të përllogarisë fondin për sasinë e mallrave, Shërbimeve, punëve që do të prokurojë në përputhje me nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme. Kjo përllogaritje do t'i shërbejnë komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për të bërë krahasimin e ofertave të paraqitura gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit."
- Nuk disponohet dokumentacion për marrjen e mallrave në dorëzim veptime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 39, " Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme."
- Nuk disponohet urdhër për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 42, ku përcaktohet që:" "Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues"
- Nuk disponohet asnjë proces verbal për kalimin në operatorin e rradhës veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar, pika 18, ku përcaktohet që:" Kur ofertuesi fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor të përcaktuar në "Ftesën për Ofertë, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor në "Ftesën për Ofertë", ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë. Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nëpërmjet një procesverbali të mbajtur për këtë qëllim. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor do të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm operatorët ekonomikë të renditur deri në vendin e dhjete te Kifikimit."

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. F. Th. ,me detyrë Ish Zv.Kryetar i Bashkisë Has, P.C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore, N. B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës.

Viti 2024

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar dhe aksesit në sistemin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) konstatohet se:

Për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, Bashkia Has ka realizuar 12 procedura prokurimi me vlera të vogla, me fond limit 7,056,533 lekë pa TVSH dhe realizuar me vlerë kontrate në shumën 6,521,881.44 lekë pa TVSH.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:
- Me Urdhërin nr. 12, shkresa nr. 54 prot, datë 08.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë, "Për ngritjen e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël", është krijuar komisioni me përbërje si më poshtë:

1. Z. Sh. Kryetar
2. A. M. Anëtar
3. Y. D. Anëtar

- Me Urdhërin nr. 356, shkresa nr. 2558 prot, datë 30.07.2024 të Kryetarit të Bashkisë, "Për ngritjen e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël", është krijuar komisioni me përbërje si më poshtë:

1. Z. Sh. Kryetar
2. A. B. Anëtar
3. Y. D. Anëtar

Me zgjedhje nga janë audituar procedurat si më poshtë vijon;

Viti 2024					
Nr.	**Objekt**	**Fondi limit**	**Vlera**	**OE Fitues**	**Data**
1	Blerje materjale pastrimi	754,167	644,500	E. H.	01.02.2025
2	Blerje Printera	862,500	659,000	O .C.	19.07.2025
3	Blerje pajisje kompjuterike	250,000	238,000	O. C.	04.03.2024
	Totali	**1,866,667**	**1,541,500**		

1. Me Urdhër Prokurimi nr. 30, datë 20.08.2024, të Kryetarit të Bashkisë Has në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. Z. Sh. (kryetar i komisionit), z. Y.D. dhe znj. A.M. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje materjale pastrimi"** me fond limit 754,167 lekë pa TVSH.
- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 13, pika 5.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 22.08.2024, është shpallur fitues operatori ekonomik **"E. H."** me vlerë 644,500 lekë pa TVSHTVSH i cili është i renditur i pari në Kifikimin.

- **Nga auditimi u konstatuan këto problematika:**

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se nuk është argumentohet mënyra e përllogaritjes së Fondit Limit, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 76, "Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit", pika 2, "Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet".

2. Me Urdhër Prokurimi nr. 4, datë 06.02.2024, të Kryetarit të Bashkisë Has në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. Z. Sh. (kryetar i komisionit), z. Y. D. dhe znj. A .M. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje Printera"** me fond limit 862,500 lekë pa TVSH.
- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 13, pika 5.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 07.02.2025, është shpallur fitues operatori ekonomik **"O. C."** me vlerë 659,000 lekë pa TVSH i cili është i renditur i pari në Kifikimin.

- **Nga auditimi u konstatuan këto problematika:**

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se nuk është argumentohet mënyra e përllogaritjes së Fondit Limit, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 76, "Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit", pika 2, "Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet".

3. Me Urdhër Prokurimi nr. 2, datë 06.02.2024, të Kryetarit të Bashkisë Has në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. Z. Sh. (kryetar i komisionit), z. Y.D. dhe znj. A. M. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje pajisje kompjuterike"** me fond limit 250,000 lekë pa TVSH.

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 13, pika 5.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 04.03.2025, është shpallur fitues operatori ekonomik **"O. C"** me vlerë 249,500 lekë pa TVSH i cili është i renditur i dyti në Kifikimin.

Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 29.02.2024 rezulton se operatori ekonomik i renditur në vëndin e parë, "Nord Invest" me vlerë 238,000, nuk është paraqitur brenda afateve kohore.

- **Nga auditimi u konstatuan këto problematika:**

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore nr. 439/2024, datë 15.03.2024, në shumën 299,600 lekë me TVSH, e cila është likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 342, datë 04.07.2024.
-Fatura tatimore nuk është likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", neni 7, duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

Viti 2025

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar dhe aksesit në sistemin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) konstatohet se:

Për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025, Bashkia Has ka realizuar 19 procedura prokurimi me vlera të vogla, me fond limit 11,631,761 lekë pa TVSH dhe realizuar me vlerë kontrate në shumën 10,257,859.34 lekë pa TVSH.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

- Me Urdhërin nr. 1, shkresa nr. 28 prot, datë 07.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë, "Për ngritjen e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël", është krijuar komisioni me përbërje si më poshtë:

1. Z. Sh. Kryetar
2. A. M. Anëtar
3. Y. D. Anëtar

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

- Me Urdhërin nr. 49, shkresa nr. 670 prot, datë 15.06.2025 të Kryetarit të Bashkisë, "Për ngritjen e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël", është krijuar komisioni me përbërje si më poshtë:

1. Z. Sh. Kryetar
2. R. R . Anëtar
3. Y. D. Anëtar

Gjatë vitit 2025,

Bahkia Has ka realizuar

- 2 procedura prokurimi me vlera të vogla me një fond limit total në shumën 2,000,000 lekë pa TVSH duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit dhe duke mos i kryer këto procedura me tenderim.

Konkretisht, dy procedura "**Sinjalistika e qytetit Krumë**", me urdhër prokurimi nr. 26 datë 30.06.2025, me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSH dhe procedura "**Realizimi sinjalistikës së**

qytetit Krumë”, me urdhër prokurimi nr. 27, datë 30.06.2025, me fond limit 1,000,000 pa TVSH. Për sa më sipër të dy këto procedura i përkasin të njëjtit objekt prokurimi, “**Sinjalistika e qytetit Krumë**”, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 56,
pika 1, ”Autoriteti/enti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime, kur vlera e përllogaritur është ndërmjet kufijve nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë në vit, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 41, të LPP-së.
Pika 2. “Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.”

Me zgjedhje nga janë audituar 3 procedura

Viti 2025					
Nr.	**Objekt**	**Fondi limit**	**Vlera e kontratës**	**OE r fitues**	**Data**
1	Blerje materjale pastrimi	758,333	634,500	“A.”	01.02.2025
2	Blerje Printera	416,667	414,500	“E. H.”	19.07.2025
3	Dekor i Qytetit	500,000	475,400	“H.G.”	30.08.2023
Totali		**1,675,000**	**1,524,400**		

1. Me Urdhër Prokurimi nr. 3, datë 28.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë Has në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. Z .Sh. (kryetar i komisionit), z. Y.D. dhe znj. A.M. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“Blerje materjale pastrimi”** me fond limit 758,333 lekë pa TVSH.
- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 01.02.2025, është shpallur fitues operatori ekonomik **“A.”** me vlerë 634,500 lekë pa TVSH i cili është i renditur i pari në Kifikimin.
- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 48/2023, datë 02.05.2023, në shumën 204,000 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është kryer në AlfaBank me Urdhër-Shpenzim nr. 171, datë 10.05.2023.

- **Nga auditimi u konstatuan këto problematika:**

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se nuk është argumentohet mënyra e përllogaritjes së Fondit Limit, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76, “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”, pika 2, “Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

2. Me Urdhër Prokurimi nr. 20, datë 16.06.2025, të Kryetarit të Bashkisë Has në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. Z. Sh. (kryetar i komisionit), z. Y. D. dhe znj. R.R. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“Blerje Printera”** me fond limit 416,667 lekë pa TVSH.

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 13, pika 5.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 19.07.2025, është shpallur fitues operatori ekonomik **"E. H."** me vlerë 414,500 lekë pa TVSH i cili është i renditur i nënti në Kifikimin.
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 01.07.2025 rezulton se operatori ekonomik i renditur në vëndin e parë, "M. M." me vlerë 238,000, është tërhëqur me kërkesë në sistem.
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 04.07.2025 rezulton se operatori ekonomik i renditur në vëndin e dytë, "B. T." me vlerë 319,000, nuk është paraqitur brenda afateve kohore.
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 07.07.2025 rezulton se operatori ekonomik i renditur në vëndin e tretë, "G.-D." me vlerë 333,000, është tërhëqur me kërkesë në sistem.
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 10.07.2025 rezulton se operatori ekonomik i renditur në vëndin e katërt, "E. I." me vlerë 354,900, është tërhëqur me kërkesë në sistem.
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 14.07.2025 rezulton se operatori ekonomik i renditur në vëndin e pestë, "R.-T." me vlerë 378,000, është tërhëqur me kërkesë në sistem.
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 15.07.2025 rezulton se operatori ekonomik i renditur në vëndin e gjashtë, "C." me vlerë 393,000, është tërhëqur me kërkesë në sistem.
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 19.07.2025 rezulton se operatori ekonomik i renditur në vëndin e shtatë, "O.T." me vlerë 400,000 lekë, nuk është paraqitur brenda afateve kohore.
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 19.07.2025 rezulton se operatori ekonomik i renditur në vëndin e tetë, "J." me vlerë 411,000, është tërhëqur me kërkesë në sistem.
- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 48/2023, datë 02.05.2023, në shumën 204,000 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është kryer në AlfaBank me Urdhër-Shpenzim nr. 171, datë 10.05.2023.

- **Nga auditimi u konstatuan këto problematika:**

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se nuk është argumentohet mënyra e përllogaritjes së Fondit Limit, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 76, "Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit", pika 2, "Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet".

3. Me Urdhër Prokurimi nr. 43, datë 27.08.2025, të Kryetarit të Bashkisë Has në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. Z. Sh. (kryetar i komisionit), z. Y.D. dhe znj. R.R. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Dekor i Qytetit"** me fond limit 500,000 lekë pa TVSH.
- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 13, pika 5.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 30.08.2025, është shpallur fitues operatori ekonomik **"H.G."** me vlerë 475,500 lekë pa TVSH i cili është i renditur i pari në Kifikimin.

- **Nga auditimi u konstatuan këto problematika:**

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se nuk është argumentohet mënyra e përllogaritjes së Fondit Limit, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 76,

"Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit", pika 2, "Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet".

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z. Z Sh, Kryetar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, znj. A. M., Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, z. Y. D., Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, znj. A. B. Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, znj.R. R., Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël.

Për periudhën 01/01/2023 – 31/12/2025, nga Bashkia Has referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka realizuar gjithsej **36** procedura prokurimi me vlera të larta me vlerë të fondit limit 491,057 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 460,658 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 30,399 mijë lekë pa TVSH ose 6 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Vlera në mijë lek

Procedura 01/01/2023 - 31/12/2025	**Nr.**	**Vl.Fond Limit**	**Vl.Kontrate**
GJITHESEJ	**36**	**491,057**	**460,658**
-Të hapura	6	382,806	363,284
- E Hapur e Thjeshtuar	30	108,251	97,374
Sipas objekteve	**36**	**491,057**	**460,658**
-Objekte në fushën e investimeve	13	409,664	385,021
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	23	81,393	75,637

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **129** OE/BOE, nga të cilat janë s'kualifikuar **83** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE pjesëmarrës janë gjithsej **16** procedura, ndërsa procedura me 1 OE të kualifikuar janë 34 procedura.
Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe dokumentacionin elektronik të marrë nga sistemi SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit, etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura

Nga grupi i auditimit mbi bazën e riskut dhe të materialitetit nga **36** procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit prej **491,057** mijë lekë, ka vlerësuar për auditim **12** procedura me fond limit prej **425,296** mijë lekë ose **87 %** e fondit të prokuruar, nga ku kanë rezultuar disa parregullsi në shkelje apo mos zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore të LPP.
Në lidhje me investimet, është audituar zbatimi i 3 kontratave me fond limit 226,838,843 lekë pa TVSHTVSH dhe vlerë kontrate 216,022,553 lekë pa TVSH si më poshtë:;
1. Rikonstruksion i gjimnazit "Skënderbeu", Bashkia Has 97,431,542 lekë pa TVSH.
2. Rehabilitim me qëllim mbingritjen e disës së rezervuarit, Helshan 2 me fond limit 40,496,392 lekë pa TVSH.

3. Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme të Fshatit Golaj me fond limit 88,910,909 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i **12** procedurave me fond limit **425,296** mijë lekë, janë konstatuar në shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, gjithsej **12** procedura, nga të cilat:

a. Në **10** procedura kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës, ku mangësitë janë më të përhapura në procedurat e llojit për punë publike.

b. Në **9** procedura, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK.

c. Në 3 procedura, mungon oponenca teknike, në kundërshtim me nenin 6 pika 1 germa (a) të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.

d. Në 3 procedura, nuk disponohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit apo treguesit e testimit të tregut.

e. Në 1 procedurë, konkretisht me objekt *"Blerje automjetesh (Kamion vetëshkarkues, rrul me vibrim hekur – gomë"* procedura duhej ndarë në lote.

f. Në 1 procedurë prokurimi, konkretisht procedura me objekt *"Organizim i konferencave shkencore ndërkombëtare në kuadër të projekteve të Ndërkombëtarizimit" nuk është mbajtur sigurimin e ofertës, e cila është në vlerën **399,992 lekë,** si dhe të raportohet pranë APP.*

g. Në 3 procedura prokurimi, vlerësimi i ofertave është bërë përtej afatit 15 ditë të përcaktuar për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

h. Dosjet e procedurave janë të pa inventarizuara, pa numerizuar dhe pa arkivuar, në kundërshtim me *Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,* neni 21 dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8 germa (g).

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar: Neni 2, "Parimet e përzgjedhjeje"; Neni 5 "Kontratat e përziera", Neni 77, "Kërkesat për kualifikim", Neni 82, "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", Neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", Neni 98, "Anulimi i një procedure prokurimi": VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Neni 26, "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", Neni 32 Njoftimi i fituesit", Neni 39, "Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike", Neni 40 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave", Neni 41 "Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve", Neni 73 "Titullari i autoritetit/entit kontraktor", Neni 74 "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit", Neni 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", Neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", Neni 86 "Publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës". Ligji nr. 120/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Neni 6 pika 1 germa (a); Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar Neni 39, pika 1, Ligji 8402, datë 10.09.1998 ""Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim", Udhëzimi nr. 2, datë "08.05.2003 "Për Kifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", Kreu I, pika A.1", Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 17, 19, 21 dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8 germa (g).

Prokurimet Viti 2023

1. **Tenderi me objekt: "*Ndërtimi i rrugës nga aksi rrugë nacionale, Krumë, Kukës (lagja Dida) deri në lagjen Geca 7 Rada, Fshati Krumë*", me këto të dhëna:**

<table>
<tr><th colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtimi i rrugës nga aksi rrugë nacionale, Krumë, Kukës (lagja Dida) deri në lagjen Geca 7 Rada, Fshati Krumë"</th></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi :
Nr. 28, datë 24.03.2023</td><td rowspan="2">2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Nr. 28, datë 24.03.2023
- A. M. - (Person përgjegjës), Jurist
- A. M. - P. Sek rrugëve
- A. U .</td><td rowspan="2">3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 28, datë 24.03.2023
- F. Th.- (Kryetar)
- P. C. - (Anëtar)
- N. B. - (Anëtar)</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur e Thjeshtuar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)
10,965,270 - lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese:
BOE "V.G. SH.P.K." dhe "A.-2A.C." SH.P.K. me ofertë 8,719,710 Lekë pa TVSH, me lidhje kontrate datë 16.05.2023, me afat 60 ditë.</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
2,245,560 lekë</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
Data e zhvillimit: 19.06.2023
Ora 13:00</td><td>9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Has</td><td>10.Operatorët Ekonomikë
- Pjesëmarrës në tender 4 OE
- Skualifikuar 0 OE,
- Kualifikuar 4 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK,
Ka/Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK,
Ka/Nuk ka</td><td>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka</td></tr>
</table>

NJËSIA E PROKURIMIT

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has, z. L. M. me nr. 242 datë 21.03.2023, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **10,965,270 lekë** me objekt**: "*Ndërtimi i rrugës nga aksi rrugë nacionale, Krumë, Kukës (lagja Dida) deri në lagjen Geca 7 Rada, Fshati Krumë*".**

Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga A.M., A .M., A. U. - Lidhur me dosjen e procedurës, rezulton e pa inventarizuar dhe pa numerizuar, në kundërshtim me *Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*, neni 21 dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8 germa (g) ku citohet se:

"...Organizimi i brendshëm i dosjes (sistemin) përfshin renditjen e dokumenteve brenda dosjes sipas disa kritereve që janë të njëjta me ato të krijimit të njësisë së ruajtjes. Kriteri i objektit përdoret kur dosja është krijuar me koncept të gjerë dhe dokumentet grupohen me nënçështjeje. Kur volumi i dokumenteve është i konsiderueshëm dhe ka të bëjë me emra personash, përdoret edhe kriteri alfabetik, më pas bëhet numërimi i dokumenteve. Të gjitha fletët e dosjes (përveç fletëve të bardha) numërohen me laps të zi grafiti në këndin e djathtë, pa cenuar tekstin".

1. Tenderi me objekt "Ndërtimi i rrugës nga aksi rrugë nacionale Krumë – Kukës (lagje Dida) deri në lagjen Geca&Rrada, Fshati Krumë".

-Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet 2 OE "A.-2A. C." dhe "A.U." daton më 13.04.2022, ose 1 vit para datës së hapjes së tenderit. Formulari sigurimit të ofertës datë 12.04. 2023.

Sipas proces verbalit të mbajtur për miratimin e kritereve të kualifikimit datë 23.03.2023

Kriteret e kualifikimit:

-Vërtetimi i paraqitur nga OE "V.G." Dega e Tatim Taksave Vlorë, konfirmon se janë paguar detyrimet deri në vitin 2020 dhe rezulton me detyrime të pa paguara deri në 12.04.2023 në shumën 113,274 lekë, pra nuk plotëson kriterin e pagesës së detyrimeve, në kundërshtim me DST.

-Kriteret e veçanta të kualifikimit:
Kapaciteti ekonomik dhe financiar "Aftësitë teknike dhe profesionale" është kërkuar dëshmi për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë 50% e vlerës së kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 5 viteve të fundit, ose punë të ngjashme ku vlera monetare e punëve të kryera gjatë 5 viteve të fundit është 200% e vlerës limit të kontratës, në kundërshtim me neni 77 pika 1 "Kërkesat për kualifikim" i LPP nr.162/2020, i ndryshuar, ku citohet se: *"Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës"* dhe nenin 55 "Procedurë e hapur e thjeshtuar ", pika 4/a e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku citohet se: *Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:*
a) Për kontratat e punëve: "punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës" ose "punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet".
- Parashikimi në buxhetin vjetor të vitit 2023, për këtë procedurë prokurimi është 12,000,000 lekë
- Fondi limit – 10,965,000 lekë
- Oferta Fituese – 8,719,710 lekë.

Nga auditimi i kësaj procedurë konstatohet se parashikimi i fondit në buxhet dhe llogaritja e tij nga grupi i punës janë parashikuar dhe llogaritur me rezervë me një diferencë nga oferta fituese prej 3,280,290 lekë.
Grupi i punës për llogaritjen e fondit limit i përbërë nga Flamur Thaçi, N B dhe A M, sipas procesverbalit të dates 20.03.2023, kanë vepruar në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 12 "Metodat e zbatueshme për llogaritjen e vlerës së kontratës" dhe neni 13 "Studimi paraprak i tregut".

2. Tenderi me objekt "Mirëmbajtje Rrugë Rurale e Kanalizime, Bashkia Has 2023".

<table>
<tr><th colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Mirëmbajtje Rrugë Rurale e Kanalizime, Bashkia Has 2023"</th></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi :
Nr. 48, datë 16.05.2023</td><td rowspan="2">2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Nr. 28, datë 24.03.2023
- A. M. - (Person përgjegjës), Jurist
- A. M. - P. Sek rrugëve
- A.U. - Arkitekt</td><td rowspan="2">3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 28, datë 24.03.2023
- F. Th.- (Kryetar)
- P. C. - (Anëtar)
- N. B. - (Anëtar)</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur e Thjeshtuar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)
6,000,000 - lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese:
"G." SH.P.K. me ofertë 4,351,250 Lekë pa TVSH, me lidhje kontrate datë 29.06.2023, me afat 21 ditë.</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
1,648,750 lekë</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
Data e zhvillimit: 13.04.2023
Ora 13:00</td><td>9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Has</td><td>10.Operatorët Ekonomikë
- Pjesëmarrës në tender 5 OE
- Skualifikuar 0 OE,
- Kualifikuar 5 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK,
Ka/Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK,
Ka/Nuk ka</td><td>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka</td></tr>
</table>

NJËSIA E PROKURIMIT

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has, z. L. M. me nr. 242 datë 21.03.2023, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **6,000 lekë** me objekt**: "Mirëmbajtje Rrugë Rurale e Kanalizime, Bashkia Has 2023".**

Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga A. M., A. M., A.U.

- Lidhur me dosjen e procedurës, rezulton e pa inventarizuar dhe pa numerizuar, në kundërshtim me *Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*, neni 21 dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8 germa (g) ku citohet se:

"...Organizimi i brendshëm i dosjes (sistemin) përfshin renditjen e dokumenteve brenda dosjes sipas disa kritereve që janë të njëjta me ato të krijimit të njësisë së ruajtjes. Kriteri i objektit përdoret kur dosja është krijuar me koncept të gjerë dhe dokumentet grupohen me nënçështjeje. Kur volumi i dokumenteve është i konsiderueshëm dhe ka të bëjë me emra personash, përdoret edhe kriteri alfabetik, më pas bëhet numërimi i dokumenteve. Të gjitha fletët e dosjes (përveç fletëve të bardha) numërohen me laps të zi grafiti në këndin e djathtë, pa cenuar tekstin".

2. Tenderi me objekt "Mirëmbajtje Rrugë Rurale e Kanalizime, Bashkia Has 2023".

Sipas proces verbalit të mbajtur për miratimin e kritereve të kualifikimit datë 30.05.2023

-Kriteret e veçanta të kualifikimit:

Kapaciteti ekonomik dhe financiar "Aftësitë teknike dhe profesionale" është kërkuar dëshmi për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë 50% e vlerës së kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 5 viteve të fundit, ose punë të ngjashme ku vlera monetare e punëve të kryera gjatë 5 viteve të fundit është 200% e vlerës limit të kontratës, në kundërshtim me neni 77 pika 1 "Kërkesat për kualifikim" i LPP nr.162/2020, i ndryshuar, ku citohet se: *"Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës"* dhe nenin 55 "Procedurë e hapur e thjeshtuar ", pika 4/a e VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku citohet se: *Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:*

a) Për kontratat e punëve: "punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës" ose "punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet".

-Parashikimi në buxhetin vjetor të vitit 2023, për këtë procedurë prokurimi është 6,000,000 lekë
-Fondi limit – 6,000,000 lekë
- Oferta Fituese – 4,351,250 lekë.

Nga auditimi i kësaj procedurë konstatohet se parashikimi i fondit në buxhet është parashikuar me rezervë me një diferencë nga oferta fituese prej 1,648,750 lekë. Pra nuk është llogaritur fondi limit nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim.

Po kështu konstatohet se nuk janë kryer llogaritjet për fondin limit por është paraqitur në urdhrin e prokurimit si vlerë e fondit limit vlera e përcaktuar në buxhet, në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 12 "Metodat e zbatueshme për llogaritjen e vlerës së kontratës" dhe neni 13 "Studimi paraprak i tregut".

Rastet e shkeljeve sipas procedurave të vitit 2024 paraqiten si vijon:

1. **Tenderi me objekt: "*Rehabilitim trotuare përgjatë rrugës nacionale dalja Qytetit Krumë deri Rezervuari Pla*", me këto të dhëna:**

1. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitim trotuare përgjatë rrugës nacionale dalja Qytetit Krumë deri Rezervuari Pla"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 14, datë 24.04.2024	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 11/2 date 08.01.2024 1.A. B. - (Person përgjegjës)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 11/1, datë 08.01.2024 1. Z. Sh. – (Zv. Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"	2.N. P. - (Jurist) 3.E. S. - (Financier)	2. A. M. - (Juriste) 3. Y. D. – (Sek.Urbanistik)
5.Fondi Limit (pa TVSH) 19,999,560 - lekë pa TVSH	6.Oferta fituese: OE "N." SH.P.K. me ofertë 17,601,990 - Lekë, me lidhje kontrate datë 02.08.2024, me afat 60 dite	7.Diferenca me fondin limit: 2,397,570 - lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 05.06.2024	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Has	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 13 OE **b)** Skualifikuar 11 OE, **c)** Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK, Ka/Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Ka/Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has, z. M. D me nr. 11/1, datë 08.01.2024 është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga A.B., N. P. dhe E. S.

Me urdhër të Titullarit me nr. 14 datë 24.04.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **19,999,560 lekë** me objekt**: *"Rehabilitim trotuare përgjatë rrugës nacionale dalja Qytetit Krumë deri Rezervuari Pla".***

-Burimi i financimit është nga buxheti i Bashkisë Has, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak me nr. 35, datë 22.12.2023 "Buxheti i Bashkisë has për vitin 2024 dhe PBA 2024-2026"

Projekti dhe preventivi i punimeve është hartuar nga studio projektuese "M.C.E." SH.P.K. me nr. Licence N.6835/8. Nuk disponohet mënyra e administruar e këtij projekti nga Bashkia Has.

Vlerësimi i Kritereve

- Hartimi dhe argumentimi i kritereve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin pa nr. prot., datë 30.06.2022 nga NJHDT, dhe është firmosur në çdo fletë.

Mbajtja e procesverbalit është bërë në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Hartimi dhe argumentimi i kritereve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin e datës 16.05.2024 nga NJHDT dhe firmosur prej tyre, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan kritere jo në përputhje me objektin e procedurës.

1.Kërkesa e pikës **2.3.3/a e DST** e cila kërkon nga OE 35 punonjës për periudhën e 3 muajve të fundit, është kërkesë e paargumentuar teknikisht. Gjithashtu, kërkesa që punonjësit të figurojnë 3 muajt e fundit në listëpagesa nuk është në përputhje me 39, pika 6 germa (ç) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar e cila përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore, pa përcaktuar afate se kur duhet të figurojnë në listëpagesa.

2.Kërkesa e pikës **2.3.3/a/b e DST** e cila kërkon nga OE 4 inxhinier drejtues teknik në licencën e shoqërisë (ndërtim, gjeodet/topograf, elektrik dhe mjedisi), dhe 2 inxhinier staf mbështetës (strukturist, gjeodet/topograf), është kërkesë jo në përputhje me vlerën, volumin e punimeve dhe preventivit të saj. Nga analiza e preventivit dhe zërave të punimeve rezulton se nuk parashikohen

punime specifike që kërkojnë angazhimin e vazhdueshëm të një inxhinieri elektrik, inxhinieri mjedisi apo inxhinieri strukturist. Për rrjedhojë, kërkesa për disponimin e këtyre specialistëve nuk paraqitet e argumentuar teknikisht dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me realizimin e kontratës.
3.Kërkesa e pikës **2.3.3/c në DST** e cila kërkon nga OE Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt (inxhinier me eksperiencë) i cili të figurojë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimeve në objekt është në kundërshtim me pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", ku përcaktohet se drejtuesi teknik kërkohet për vepra me vlerë të plotë mbi 30 milion lekë. Në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor nuk është shoqëruar me argumentim ligjor apo teknik që justifikon vendosjen e këtij kriteri në raport me vlerën dhe kompleksitetin e kontratës.
4.Kërkesa e pikës **2.3.5 në DST** e cila kërkon nga OE të disponojë 1 impiant betoni në pronësi ose me qira, është e pa plotë. Autoriteti kontraktor ka parashikuar vetëm dy forma disponimi të këtij kapaciteti teknik, përkatësisht pronësinë ose marrjen me qira, duke mos mundësuar forma të tjera të ligjshme dhe të zakonshme të sigurimit të betonit, siç është kontrata e furnizimit me subjekte të specializuara që disponojnë impiante prodhimi.

Kriteret e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, i cili përcakton se kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
Sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga A. B., N. P. dhe E. S.
Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	BOE "M." SH.P.K. & "L.C." SH.P.K. & "Ll." SH.P.K.	14,690,970	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE "K." SH.P.K. nuk përmbush kriterin e pikës 2.2.2. Ky operator ekonomik ka paraqitur bilancet për vitet 2021, 2022, 2023 të pa konfirmuara nga organet tatimore. Gjithashtu, nuk ka paraqitur raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve. 2.OE "Ll." SH.P.K. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.7. Certifikatat Iso të paraqitura nga shoqëria "Ll." sh.p.k. kanë datë skadimi 12.09.2023. 3.OE "L.C." sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim. Shoqëria "L.C." sh.p.k, rezulton se për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur mjetin me të dhënat si më poshtë: Autobetoniere me targa AA513NR, Leje Qarkullimi DRD0661516 Shasia WJMJ4CP800C066479 NR 2981 REP NR 2349 KOL 24.05.2023 24.05.2025 I njëjti mjet është paraqitur edhe nga shoqëria "L.VII" sh.p.k: Autobetoniere me targa AA513NR, Leje Qarkullimi DRD0661516 Shasia ËJMJ4CP800C066479 NR. 13326 REP NR. 5406 KOL. 13.07.2023 13.07.2028
2	"L. VII" SH.P.K.	15,586,200	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4. Shoqëria "L.VII" sh.p.k. për plotësimin e këtij kriteri ka paraqitur: Autobetoniere me targa AA513NR, Leje Qarkullimi DRD0661516 Shasia WJMJ4CP800C066479 NR 13326 REP NR 5406 KOL 13.07.2023 13.07.2028

			I njëjti automjet është paraqitur për këtë procedurë prokurimi edhe nga shoqëria "L.C." sh.p.k, konkretisht: Autobetoniere me targa AA513NR, Leje Qarkullimi DRD0661516 Shasia ËJMJ4CP800C066479 NR 2981 REP NR 2349 KOL 24.05.2023 24.05.2025 Siç vërehet, në momentin kur shoqëria "L. VII" sh.p.k. ka nënshkruar kontratën e qerasë, mjeti tip "Autobetoniere" ka qenë tashmë me qira nga shoqëria "L.C." sh.p.k, duke e bërë të pamundur disponimin e këtij mjeti.
3	"A.-2A.C." SH.P.K.	13,999,776	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE është skualifikuar për ofertë anomalisht të ulët, pasi ky OE ka paraqitur oferte me te ulet se 25% e fondit limit oferta e paraqitur është ulur 30% e fondit limit dhe me te ulet se 85% e mesatares se ofertave (te kualifikuara), si dhe për KVO-ne, kjo anomali vërehet e dyshimte (e papërgjegjshme) duke qene se çmimet e materialeve te ndërtimit kane pësuar një rritje te konsiderueshme ne treg dhe për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 "për prokurimin publik" nr. 16/2024.
4	"R.S.M.C." SH.P.K.	14,697,900	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Ky operator ekonomik ka paraqitur ofertën ekonomike me ndryshime të mëdha në sasitë e preventivit të prokuruar nga autoriteti kontraktor.
5	BOE "M." SH.P.K. &" M." SH.P.K.	15,724,748	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.BOE nuk përmbush kriterin e përgjithshëm të kualifikimit, konkretisht nuk ka përcaktuar elementët që merr përsipër të realizojë bashkimi. 2.OE "M." SH.P.K., nuk përmbush kriterin e pikës 2.2.2. Nuk ka paraqitur raportin e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancin e vitit 2021. 3.BOE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3 për 1 inxhinier strukturist. 4.BOE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.5 për 1 impiant betoni. Asnjëri nga OE nuk ka deklaruar disponimin në pronësi ose me qira të impiantit të betonit.
6	"2N." SH.P.K.	14,000,044	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Ky operator ekonomik nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, konkretisht: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1; d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2; Pasi, këto dokumente janë paraqitur për procedurë tjetër prokurimi, jo sipas kësaj procedure prokurimi, është paraqitur i ndryshëm numri i referencës.
7	BOE "H." SH.P.K.. & "A." SH.P.K.	16,176,300	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Së pari, shoqëria "A." sh.p.k. nuk ka plotësuar sakte Formularin e Vetedeklarimit sipas Shtojca 8, pasi ka deklaruar në formularin e Vetedeklarimit se ka paraqitur oferte të pavarur dhe njëkohësisht ka deklaruar se merr pjese në këtë procedure prokurimi si bashkim operatoresh ekonomik me shoqëria "H." sh.p.k. 2.OE "H." SH.P.K. nuk plotëson kriterin e pikës 2.2.2, pasi nuk ka të konfirmuara bilancet për vitet 2021, 2022, 2023.

			3.OE “H.” SH.P.K., nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.1 për kontrata të ngjashme. Kontrata me objekt “Ndërtim rruge Malore qendër fshati Gjinaj – Stanet, Bjeshka Gjinaj dhe Rikonstruksion rrugës Gjinaj – Pus I Thate” është paraqitur fotokopje pa ngjyra, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit: Për kontratën e paraqitur me objekt “Ndërtimi i terreneve Sportive pranë Shkollës 9-vjecare Xhevdet Doda”, nuk plotëson vlerën e kërkuar sipas përqindjes në këtë procedurë prokurimi, pasi ka marr përsipër 68.867% të përfaqësimit. 4.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3. Ne formularin e vetedeklarimit Shtojca 8, ka përcaktuar numrin e punonjësve që disponon për periudhën e kërkuar: Shkurt -17 Punonjës, Mars 21 -Punonjës, Prill- 20 Punonjës. Përqindja e përfaqësimit referuar numrit të punonjësve të vetedeklaruar në formularin përkatës, që plotëson ky operator ekonomik është 55.24%, kurse sipas marrëveshjes se bashkëpunimit ka marr përsipër 68.867%. 5.OE “H.” SH.P.K., nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.5 për 1 impiant prodhim betoni. Shoqëria “H.” sh.p.k. nuk ka deklaruar se disponon impiant prodhimi betoni në pronësi apo me qira, pavarësisht faktit se ka marr përsipër realizimin e zërit të punimeve “Strukturë monolite betoni C12/15”. 6.BOE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.6. Asnjeri nga përfaqësuesit e këtij bashkimi operatoresh ekonomik nuk ka paraqitur në formularin e vetedeklarimit Shtojca 8 që ka në pronësi apo me kontrate furnizimi për materialet pllaka trotuari.
8	“K.” SH.P.K.	13,817,346	*S’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.6. Ky operator ekonomik nuk ka deklaruar në Formularin e Vetedeklarimit Shtojca 8 se disponon ne pronësi/ me kontrate furnizimi materialet pllaka trotuari. Gjithashtu, ka paraqitur fotokopje një kontrate furnizimi date 03.06.2024, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit: 2.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.5 për impiantin e betonit. Për plotësimin e këtij kriteri, ky operator ekonomik ka paraqitur kontratën e furnizimit Nr. 4090 Rep. Nr. 2404 Kol. datë 25.07.2020 me furnizuesin Shoqëria “A. – K. – B.” ASFALT. Shoqëria “A. .- K. – B.” A. sipas Ekstraktit të Historikut të kësaj kompanie, rezulton se ka të vendosura masat e sekuestros si vijon: Numri i çështjes: CN-613432-03-16 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitimi i urdhrit Nr.2133, datë 21.03.2015, lëshuar nga Shoqëria Përmbarimore ESPA është urdhëruar: Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi aksionet e palës debitore, subjekti “A. – K. – B.” A.” SH.P.K. me NUIS (NIPT)K.....N, dhe nga te drejtat qe rrjedhin nga zoterimi i ketyre 8 kuotave. Numri i çështjes: CN-130918-01-17 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitimi i urdhrit Nr.518 Prot. , datë 25.01.2017, protokolluar nga Qkb me Nr. 1099, dt. 25.01.2017, lëshuar nga Shoqëria Përmbarimore ESPA është urdhëruar: Bllokimin e kuotave/ aksioneve dhe e te drejtave qe rrjedhin

			nga zotërimi I kuotave për palën debitore, subjekti "A. – K. – B. "A." SH.P.K. me NUIS (NIPT) K.....N Numri i çështjes: CN-663866-02-18 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitim i urdhrit Nr.733 Prot., datë 05.02.2018, lëshuar nga Përmbaruesi Gjyqësor Privat "E. G.", ku është urdhëruar: Vendosja e masës së sekuestros konservative mbi kapitalin qe zotëron debitori shoqëria "A. – K. – B." A. sh.p.k, me NUIS (NIPT) – K.....N, ne mënyrë qe te mos kryhet asnjë veprim tjetërsimi apo disponim. Numri i çështjes: CN-875526-03-22 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitimi i shkresës Nr.69//5Prot., datë 23.02.2022, për Vendosjen e Masës se Sigurimit te detyrimit tatimor, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Mbledhjes se Detyrimeve Tatimore te Papaguara, Rajoni Verior, Shkodër, ku është kërkuar: Vendosjen e Barrës Siguruese mbi titujt e Pronësisë ne mënyrë qe te mos kryhen veprime tjetërsimi ndaj këtyre titujve për tatimpaguesin "A. – K. – B." A. SH.P.K. pajisur me NUIS (NIPT)- K.....N. Numri i çështjes: CN-187537-08-23 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitimi i shkresës Nr. 642/5 Prot, datë 02.08.2023 për Vendosje të Masës së Sigurimit të Detyrimit Tatimor, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Rajoni Verior, ku është kërkuar: Vendosje të masës së sigurimit të detyrimit tatimor, mbi tatimpaguesin shoqëria " A. – K. – B. " A. SH.P.K., pajisur me NUIS (Nipt)- K.....N. Vendosja e kësaj masë synon të mos lejohet tjetërsimi i titujve të pronësisë dhe të drejtat pasurore që i përkasin këtij tatimpaguesit deri në shlyerjen e detyrimeve tatimore. 3. **referuar ekstraktit të historikut tregtar të kompanisë "**K." SH.P.K., me NIPT J.....D, rezulton se mbi aksionet dhe pasuritë e paluajtshme të këtij operatori ekonomik është vendosur sekuestro konservative në dy raste, konkretisht: Me datë 07.06.2024: Numri i çështjes: CN-297983-06-24 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitimi i urdhrit nr. 370/1 Prot, Nr. 2569/1 Dosje datë 06.06.2024, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit " T.G. " , nga Përmbaruesi Gjyqësor Privat F.Sh., ku është urdhëruar: Vendosja e sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga shoqëria "K. " SH.P.K., me NIPT – J.....D. Me datë 19.04.2024: Numri i çështjes: CN-275329-04-24 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitimi i urdhrit Nr.1016 Prot.,Nr.2188 Regj date 15.04.2024, lëshuar nga Zyra e Përmbarimore Private R. B. S. ku është urdhëruar: "Vendosja e masës se sekuestros konservative mbi pasuritë e paluajtshme ne pronësi te debitorit, " K. " SH.P.K., pajisur me NUIS(NIPT)- J.....D me qellim mos tjetërsimin e tyre, si dhe moskryerjen e çdo veprimi qe do sillte ndryshime ne regjistrin tregtar.
9	"Xh." SH.P.K.	17,530,611	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. "Xh." sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, konkretisht, pika: **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:** c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

			d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2; Ky operator ekonomik ka paraqitur ofertën ekonomike me ndryshime të mëdha në sasitë e preventivit të prokuruar nga autoriteti kontraktor.
10	BOE "V.G." SH.P.K. & "I.C.C G."SH.P.K.	14,898,975	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.BOE nuk plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim, konkretisht, pika: Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet: Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit. Sipas Akt Marrëveshjes se bashkëpunimit, është bërë ndarja e përqindjeve: Ndarja e përqindjeve është si me poshtë: **1.** Shoqëria **"V. G." sh.p.k,** 10 % te pjesëmarrjes **2.** Shoqëria **"I.C.C. G." sh.p.k,** 90 % te pjesëmarrjes Sipas preventivit të punimeve është bërë ndarja për secilin zë punimesh dhe rezulton se përqindja është 50% / 50 %. Kemi mospërputhje ndërmjet ndarjes në përqindje në akt marrëveshjen e bashkëpunimit me preventivin e ndarjes së punimeve. 2.OE "I.C.C.G." SH.P.K. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3. Sipas Akt Marrëveshjes se bashkëpunimit, është bërë ndarja e përqindjeve: Ndarja e përqindjeve është si me poshtë: **1.** Shoqëria **"V. G." sh.p.k,** 10 % te pjesëmarrjes **2.** Shoqëria **"I.C.C G." sh.p.k,** 90 % te pjesëmarrjes Shoqëria "I.C.C.G." sh.p.k. nuk plotëson përqindjen e deklaruar ne akt marrëveshje 90%, pasi ka deklaruar në formularin e Vetedeklarimit Shtojca 8, se disponon 30 punonjës. 3.OE "I.C.C. G." SH.P.K. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.6. Shoqëria "I.C.C.G." sh.p.k. nuk ka deklaruar në formularin e vetedeklarimit shtojca 8 për furnizimin me pllaka trotuari, kurse sipas ndarjes se punimeve ka marr përsipër realizimin e zërit: F+V trotuar me pllaka me shtrese 6 cm beton – 1680 m2.
11	"Z." SH.P.K.	16,716,000	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.Operatori ekonomik "Z." SH.P.K. duhet të dorëzonte pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së. Pas mbarimit te afatit te përcaktuar ne njoftimin e autoritetit kontraktor është bere ri-vlerësimi ne sistemin e prokurimit.
12	"S.E." SH.P.K.	19,799,535	*Kualifikuar*
13	"N." SH.P.K.	17,601,990	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	BOE "M." SH.P.K. & "L.C" SH.P.K. & "Ll." SH.P.K.	14,690,970	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE "K." SH.P.K. nuk përmbush kriterin e pikës 2.2.2. Ky operator ekonomik ka paraqitur bilancet për vitet 2021, 2022, 2023 të pa konfirmuara nga organet tatimore. Gjithashtu, nuk ka paraqitur raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve. 2.OE "Ll." SH.P.K. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.7. Certifikatat Iso të paraqitura nga shoqëria "Ll." sh.p.k. kanë datë skadimi 12.09.2023. 3.OE "L.C." sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim. Shoqëria "L.C." sh.p.k, rezulton se për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur mjetin me të dhënat si më poshtë: Autobetoniere me targa AA513NR, Leje Qarkullimi DRD0661516 Shasia WJMJ4CP800C066479 NR 2981 REP NR 2349 KOL 24.05.2023 24.05.2025 I njëjti mjet është paraqitur edhe nga shoqëria "L. VII" sh.p.k: Autobetoniere me targa AA513NR, Leje Qarkullimi DRD0661516 Shasia WJMJ4CP800C066479 NR 13326 REP NR 5406 KOL 13.07.2023 13.07.2028
2	"L. VII" SH.P.K.	15,586,200	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4. Shoqëria "L. VII" sh.p.k. për plotësimin e këtij kriteri ka paraqitur: Autobetoniere me targa AA513NR, Leje Qarkullimi DRD0661516 Shasia WJMJ4CP800C066479 NR 13326 REP NR 5406 KOL 13.07.2023 13.07.2028 I njëjti automjet është paraqitur për këtë procedurë prokurimi edhe nga shoqëria "L.C. " sh.p.k, konkretisht: Autobetoniere me targa AA513NR, Leje Qarkullimi DRD0661516 Shasia WJMJ4CP800C066479 NR 2981 REP NR 2349 KOL 24.05.2023 24.05.2025 Siç vërehet, në momentin kur shoqëria "L. VII" sh.p.k. ka nënshkruar kontratën e qerasë, mjeti tip "Autobetoniere" ka qenë tashmë me qira nga shoqëria ""L.C. " sh.p.k, duke e bërë të pamundur disponimin e këtij mjeti.
3	"A.-2A.C." SH.P.K.	13,999,776	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE është skualifikuar për ofertë anomalisht të ulët, pasi ky OE ka paraqitur oferte me te ulet se 25% e fondit limit oferta e paraqitur është ulur 30% e fondit limit dhe me te ulet se 85% e mesatares se ofertave (te kualifikuara), si dhe për KVO-ne, kjo anomali vërehet e dyshimte (e papërgjegjshme) duke qene se çmimet e materialeve te ndërtimit kane pësuar një rritje te konsiderueshme ne treg dhe për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 "për prokurimin publik" nr. 16/2024.
4	"R.S.M.C." SH.P.K.	14,697,900	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Ky operator ekonomik ka paraqitur ofertën ekonomike me ndryshime të mëdha në sasitë e preventivit të prokuruar nga autoriteti kontraktor.
5	BOE "M." SH.P.K. & "M." SH.P.K.	15,724,748	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:*

			1.BOE nuk përmbush kriterin e përgjithshëm të kualifikimit, konkretisht nuk ka përcaktuar elementët që merr përsipër të realizojë bashkimi. 2.OE "M." SH.P.K., nuk përmbush kriterin e pikës 2.2.2. Nuk ka paraqitur raportin e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancin e vitit 2021. 3.BOE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3 për 1 inxhinier strukturist. 4.BOE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.5 për 1 impiant betoni. Asnjëri nga OE nuk ka deklaruar disponimin në pronësi ose me qira të impiantit të betonit.
6	"2N." SH.P.K.	14,000,044	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Ky operator ekonomik nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, konkretisht: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1; d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2; Pasi, këto dokumente janë paraqitur për procedurë tjetër prokurimi, jo sipas kësaj procedure prokurimi, është paraqitur i ndryshëm numri i referencës.
7	BOE "H." SH.P.K.. & "A." SH.P.K.	16,176,300	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Së pari, shoqëria "A." sh.p.k. nuk ka plotësuar sakte Formularin e Vetedeklarimit sipas Shtojca 8, pasi ka deklaruar në formularin e Vetedeklarimit se ka paraqitur oferte të pavarur dhe njëkohësisht ka deklaruar se merr pjese në këtë procedure prokurimi si bashkim operatoresh ekonomik me shoqëria "H." sh.p.k. 2.OE "H." SH.P.K. nuk plotëson kriterin e pikës 2.2.2, pasi nuk ka të konfirmuara bilancet për vitet 2021, 2022, 2023. 3.OE "H." SH.P.K., nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.1 për kontrata të ngjashme. Kontrata me objekt "Ndërtim rruge Malore qendër Fshati Gjinaj – Stanet, Bjeshka Gjinaj dhe Rikonstruksion rrugës Gjinaj – Pus I Thate" është paraqitur fotokopje pa ngjyra, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit: Për kontratën e paraqitur me objekt "Ndërtimi i terreneve Sportive pranë Shkollës 9-vjecare Xhevdet Doda", nuk plotëson vlerën e kërkuar sipas përqindjes në këtë procedurë prokurimi, pasi ka marr përsipër 68.867% të përfaqësimit. 4.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3. Ne formularin e vetedeklarimit Shtojca 8, ka përcaktuar numrin e punonjësve që disponon për periudhën e kërkuar: Shkurt -17 Punonjës, Mars 21 -Punonjës, Prill- 20 Punonjës. Përqindja e përfaqësimit referuar numrit të punonjësve të vetedeklaruar në formularin përkatës, që plotëson ky operator ekonomik është 55.24%, kurse sipas marrëveshjes se bashkëpunimit ka marr përsipër 68.867%. 5.OE "H." SH.P.K., nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.5 për 1 impiant prodhim betoni. Shoqëria "H." sh.p.k. nuk ka deklaruar se disponon impiant prodhimi betoni në pronësi apo me qira, pavarësisht faktit se ka marr përsipër realizimin e zërit të punimeve "Strukturë monolite betoni C12/15". 6.BOE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.6. Asnjeri nga përfaqësuesit e këtij bashkimi operatoresh ekonomik nuk ka

			paraqitur në formularin e vetedeklarimit Shtojca 8 që ka në pronësi apo me kontrate furnizimi për materialet pllaka trotuari.
8	"K." SH.P.K.	13,817,346	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.6. Ky operator ekonomik nuk ka deklaruar në Formularin e Vetedeklarimit Shtojca 8 se disponon ne pronësi/ me kontrate furnizimi materialet pllaka trotuari. Gjithashtu, ka paraqitur fotokopje një kontrate furnizimi date 03.06.2024, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit: 2.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.5 për impiantin e betonit. Për plotësimin e këtij kriteri, ky operator ekonomik ka paraqitur kontratën e furnizimit Nr. 4090 Rep. Nr. 2404 Kol. datë 25.07.2020 me furnizuesin Shoqëria "A. – K. – B." A. Shoqëria "A. – K. – B." A. sipas Ekstraktit të Historikut të kësaj kompanie, rezulton se ka të vendosura masat e sekuestros si vijon: Numri i çështjes: CN-613432-03-16 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitimi i urdhrit Nr.2133, datë 21.03.2015, lëshuar nga Shoqëria Përmbarimore ESPA është urdhëruar: Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi aksionet e palës debitore, subjekti "A. – K. – B. A." SH.P.K. me NUIS (NIPT) K.....N, dhe nga te drejtat qe rrjedhin nga zoterimi i ketyre 8 kuotave. Numri i çështjes: CN-130918-01-17 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitimi i urdhrit Nr.518 Prot. , datë 25.01.2017, protokolluar nga Qkb me Nr. 1099, dt. 25.01.2017, lëshuar nga Shoqëria Përmbarimore ESPA është urdhëruar: Bllokimin e kuotave/ aksioneve dhe e te drejtave qe rrjedhin nga zotërimi I kuotave për palën debitore, subjekti "A – K. – B. " A. SH.P.K. me NUIS (NIPT)K.....N. Numri i çështjes: CN-663866-02-18 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitim i urdhrit Nr.733 Prot., datë 05.02.2018, lëshuar nga Përmbaruesi Gjyqësor Privat "E. G.", ku është urdhëruar: Vendosja e masës së sekuestros konservative mbi kapitalin qe zotëron debitori shoqëria "A. – K. – B." A. sh.p.k, me NUIS (NIPT) – K.....N, ne mënyrë qe te mos kryhet asnjë veprim tjetërsimi apo disponim Numri i çështjes: CN-875526-03-22 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitimi i shkresës Nr.69//5Prot., datë 23.02.2022, për Vendosjen e Masës se Sigurimit te detyrimit tatimor, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Mbledhjes se Detyrimeve Tatimore te Papaguara, Rajoni Verior, Shkodër, ku është kërkuar: Vendosjen e Barrës Siguruese mbi titujt e Pronësisë ne mënyrë qe te mos kryhen veprime tjetërsimi ndaj këtyre titujve për tatimpaguesin "A. – K. – B. " A. SH.P.K. pajisur me NUIS (NIPT)- K.....N. Numri i çështjes: CN-187537-08-23 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitimi i shkresës Nr. 642/5 Prot, datë 02.08.2023 për Vendosje të Masës së Sigurimit të Detyrimit Tatimor, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Rajoni Verior, ku është kërkuar: Vendosje të masës së sigurimit të detyrimit tatimor, mbi tatimpaguesin shoqëria " A.. – K. – B." A. SH.P.K., pajisur me NUIS (Nipt)- K.....N.

			Vendosja e kësaj masë synon të mos lejohet tjetërsimi i titujve të pronësisë dhe të drejtat pasurore që i përkasin këtij tatimpaguesit deri në shlyerjen e detyrimeve tatimore. 3. **referuar ekstraktit të historikut tregtar të kompanisë "**K." SH.P.K., me NIPT J.....D, rezulton se mbi aksionet dhe pasuritë e paluajtshme të këtij operatori ekonomik është vendosur sekuestro konservative në dy raste, konkretisht: Me datë 07.06.2024: Numri i çështjes: CN-297983-06-24 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitimi i urdhrit nr. 370/1 Prot, Nr. 2569/1 Dosje datë 06.06.2024, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit " T.G. " , nga Përmbaruesi Gjyqësor Privat F. Sh., ku është urdhëruar: Vendosja e sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga shoqëria "K. " SH.P.K., me NIPT – J.....D. Me datë 19.04.2024: Numri i çështjes: CN-275329-04-24 Arsyet e hapjes se çështjes: Depozitimi i urdhrit Nr.1016 Prot.,Nr.2188 Regj date 15.04.2024, lëshuar nga Zyra e Përmbarimore Private R. B. S. ku është urdhëruar: "Vendosja e masës se sekuestros konservative mbi pasuritë e paluajtshme ne pronësi te debitorit, " K. " SH.P.K., pajisur me NUIS(NIPT)- J.....D me qellim mos tjetërsimin e tyre, si dhe moskryerjen e çdo veprimi qe do sillte ndryshime ne regjistrin tregtar.
9	"Xh." SH.P.K.	17,530,611	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. "Xh." sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, konkretisht, pika: **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:** c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1; d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2; Ky operator ekonomik ka paraqitur ofertën ekonomike me ndryshime të mëdha në sasitë e preventivit të prokuruar nga autoriteti kontraktor.
10	BOE "V.G." SH.P.K. & "I.C.C. G." SH.P.K.	14,898,975	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.BOE nuk plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim, konkretisht, pika: Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet: Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit. Sipas Akt Marrëveshjes se bashkëpunimit, është bërë ndarja e përqindjeve: Ndarja e përqindjeve është si me poshtë: **1.** Shoqëria **"V. G." sh.p.k,** 10 % te pjesëmarrjes **2.** Shoqëria **"I.C.C .G." sh.p.k,** 90 % te pjesëmarrjes Sipas preventivit të punimeve është bërë ndarja për secilin zë punimesh dhe rezulton se përqindja është 50% / 50 %. Kemi mospërputhje ndërmjet ndarjes në përqindje në akt marrëveshjen e bashkëpunimit me preventivin e ndarjes së punimeve. 2.OE "I.C.C.G." SH.P.K. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3. Sipas Akt Marrëveshjes se bashkëpunimit, është bërë ndarja e përqindjeve: Ndarja e përqindjeve është si me poshtë:

			1. Shoqëria **"V. G." sh.p.k,** 10 % te pjesëmarrjes **2.** Shoqëria **"I.C.C G." sh.p.k,** 90 % te pjesëmarrjes Shoqëria "I.C.C.G." sh.p.k. nuk plotëson përqindjen e deklaruar ne akt marrëveshje 90%, pasi ka deklaruar në formularin e Vetedeklarimit Shtojca 8, se disponon 30 punonjës. 3.OE "I.C.C.G." SH.P.K. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.6. Shoqëria "I.C.C.G.," sh.p.k. nuk ka deklaruar në formularin e vetedeklarimit shtojca 8 për furnizimin me pllaka trotuari, kurse sipas ndarjes se punimeve ka marr përsipër realizimin e zërit: F+V trotuar me pllaka me shtrese 6 cm beton – 1680 m2.
11	"Z." SH.P.K.	16,716,000	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.Operatori ekonomik "Z." SH.P.K. duhet të dorëzonte pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së. Pas mbarimit te afatit te përcaktuar ne njoftimin e autoritetit kontraktor është bere ri-vlerësimi ne sistemin e prokurimit.
12	"S.E." SH.P.K.	19,799,535	*Kualifikuar*
13	"N." SH.P.K.	17,601,990	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has. z. M. D. me nr. 11/1 datë 08.01.2024 është ngritur KVO e cila përbëhet nga Z. Sh. (kryetar), A. M. dhe Y. D. (anëtar). Në ketë tender kanë marrë pjesë 13 OE, janë kualifikuar 2 OE, dhe shpallur fitues OE "N." SH.P.K. me ofertë në vlerën **17,601,990 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **1,873,857 lekë.**
Vlerësimi i ofertave ka përfunduar me datë 24.06.2024, pra rreth 19 ditë pas hapjes së tyre, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 8 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirim e lartë monetar.
I renditur në vend të parë, OE "Z." SH.P.K., nuk është paraqitur brenda afatit 5 ditë pranë AK për paraqitjen e dokumentacionit, dhe është skualifikuar. Për këtë OE, rezulton se nuk është mbajtur sigurimi i ofertës në vlerën **399,992 lekë** dhe raportimi në APP, në kundërshtim me pikën 6 dhe 7 të nenit 30 "Sigurimi i ofertës" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi Personi Përgjegjës për Prokurimin zj. A. B.
Është administruar dokumentacioni i OE fitues me shkresën nr. 2320 prot., datë 05.07.2024.
Është miratuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 2132 prot., datë 18.07.2024.
Është lidhur kontrata me nr. 2602 prot., datë 02.08.2024 me afat 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK të OE fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret dhe konkretisht:
1. OE "N." SH.P.K., nuk përmbush kriterin e përgjithshëm të pikës **1/e** për faturat e energjisë elektrike. Ky OE, ka paraqitur vërtetimin me nr. 509 prot., datë 13.05.2024, sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet përfshirë muaji Prill 2024. Në fazën e parë ky kriter përmbushet nëpërmjet vetëdeklarimit, ndërkohë dokumentacioni i paraqitur pranë AK, administruar me datë 05.07.2024 duhet të paraqiste vërtetimin që muaji i fundit i likuiduar duhet të ishte Maji 2024, për të cilin nuk ka dokumentacion paraqitur.

Gjithashtu, subjekti mbështetës "2Z.C." SH.P.K., ka paraqitur vërtetimin me nr. OSHEE-2024-3414795-ZK, datë 29.05.2024, sipas të cilit ky OE ka likuiduar detyrimet përfshirë muaji Prill 2024. Në fazën e parë ky kriter përmbushet nëpërmjet vetëdeklarimit, ndërkohë dokumentacioni i paraqitur pranë AK, administruar me datë 05.07.2024 duhet të paraqiste vërtetimin që muaji i fundit i likuiduar duhet të ishte Maji 2024, për të cilin nuk ka dokumentacion paraqitur.
2. Subjekti mbështetës "2Z.C." SH.P.K., nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.3** për taksat dhe tarifat vendore. Sipas ekstraktit të QKB, ky OE rezulton se ka adresë tjetër të ushtrimit të aktivitetit në Bashkinë Përrenjas, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetim të lëshuar nga kjo bashki për taksat e vitit 2024.
3. OE "N." SH.P.K. dhe subjekti mbështetës "2Z.C." SH.P.K., rezulton se nuk kanë paraqitur vërtetimet e lëshuara nga Gjykata, Prokuroria dhe Dëshminë e Penalitetit, sipas deklarimeve të dhëna në zbatim të kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit.

Veprimet janë në kundërshtim me nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: Z .Sh (kryetar), A. M dhe Y. D (anëtar).

2. Tenderi me objekt: "*Rehabilitim me qëllim mbingritje e digës së rezervuarit Helshan 2*", me këto të dhëna:

<table>
<tr><td colspan="3">2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitim me qëllim mbingritje e digës sërezervuarit Helshan 2"</td></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi :
Nr. 26, datë 02.07.2024</td><td rowspan="2">2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Nr. 11/2 date 08.01.2024
1.A. B. - (Person përgjegjës)
2.N. P. - (Jurist)
3.E. S. - (Financier)</td><td rowspan="2">3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 11/1, datë 08.01.2024
1. Z. Sh. – (Zv. Kryetar)
2. A. M. - (Juriste)
3. Y. D. – (Sek.Urbanistik)</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"</td></tr>
<tr><td>5.Fondi Limit (pa TVSH)
40,496,391 - lekë pa TVSH</td><td>6.Oferta fituese:
BOE "A. M." SH.P.K. & "O." SH.P.K. me ofertë 37,571,057 - Lekë, me lidhje kontrate datë 20.09.2024, me afat 8 muaj.</td><td>7.Diferenca me fondin limit:
2,925,334 - lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
Data e zhvillimit: 13.08.2024</td><td>9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit</td><td>10.Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës në tender 5 OE
b) Skualifikuar 4 OE,
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>11.Ankimime AK,
Ka/Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK,
Ka/Nuk ka</td><td>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka</td></tr>
</table>

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has, z. M. D. me nr. 11/1, datë 08.01.2024 është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga A. B., N. P. dhe E. S.
Me urdhër të Titullarit me nr. 26 datë 02.07.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **40,496,391 lekë** me objekt**: *"Rehabilitim me qëllim mbingritje e digës sërezervuarit Helshan 2".***
-Burimi i financimit është nga buxheti i Buxheti i Shtetit, miratuar me vendimin nr. 306, datë 22.05.2024 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për digat, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore". Bashkëlidhur vendimit, është shtojca nr. 1, e cila përcakton ndër përfituesit e këtyre projekteve edhe Bashkinë Has për objektin "Rehabilitim me qëllim mbingritje e digës së rezervuarit "Helshan 2" me vlerë 48,595,670 lekë me TVSH.
Projekti dhe preventivi është hartuar nga studio projektuese "M.C.E" SH.P.K. me nr. Licence N.6835/8. Nuk disponohet mënyra e administruar e këtij projekti nga Bashkia Has.

Është miratuar Deklarata Paraprake për kryerje punimesh e datës 21.09.2024. Mungon Oponenca Teknike në kundërshtim me nenin 6 pika 1 germa (a) të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.

Vlerësimi i kritereve

Hartimi dhe argumentimi i kritereve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin e datës 24.07.2024 nga NJHDT, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan kritere jo në përputhje me objektin e procedurës.
1.Kërkesa e pikës **2.3.2 e DST** e cila ndër të tjera ka kërkuar për listën e artikujve të nevojshëm *Tuba çeliku, saraçineskë fi200 dhe pompë uji fuqi 20 kë,* për këto materiale kërkon të paraqitet ndër të tjera **certifikatë nga Prodhuesi** që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standardit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015, si dhe të gjitha materialet e mësipërme duhet të jenë sipas Standardeve Evropiane si dhe të prodhuara nga prodhues të certifikuar me ISO 9001 dhe / ose të pajisur me Certifikatë Konformiteti CE. Të paraqiten dëshmitë e testimeve zyrtare.
-Kjo kërkesë, vjen në kundërshtim me pikën 1 të nenit 44 "Kërkesat e cilësisë" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, i cili përcakton se kërkesat e kësaj natyre, u kërkohen ofertuesve dhe jo subjekteve të cilat nuk janë ofertues. Konkretisht, dokumentet si certifikata ISO, apo certifikata konformiteti etj., të subjekteve të cilat nuk janë ofertues, nuk mund të kërkohen nga NJP.
2.Kërkesa e pikës **2.3.3.a e DST** e cila kërkon nga OE 40 punonjës për periudhën e 3 muajve të fundit, është kërkesë e paargumentuar teknikisht. Gjithashtu, kërkesa që punonjësit të figurojnë 3 muajt e fundit në listëpagesa nuk është në përputhje me 39, pika 6 germa (ç) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar e cila përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore, pa përcaktuar afate se kur duhet të figurojnë në listëpagesa. Vendosja e një kriteri të tillë mund të krijojë barriera të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, veçanërisht për subjektet që kanë mundësi të sigurojnë fuqinë e nevojshme punëtore në momentin e zbatimit të kontratës.
3.Kërkesa e pikës **2.3.3/b e DST** e cila kërkon nga OE 5 inxhinier drejtues teknik në licencën e shoqërisë (ndërtim, gjeodet/topograf, hidroteknik, mekanik dhe gjeoteknik), të cilët të figurojnë 3 muajt e fundit në listëpagesë, nuk është në përputhje me 39, pika 6 germa (c) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar e cila përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar një listë të personelit kryesor, pa përcaktuar afate se kur duhet të figurojnë në listëpagesa. Vendosja e një kriteri të tillë mund të krijojë barriera të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, veçanërisht për subjektet që kanë mundësi të sigurojnë fuqinë e nevojshme punëtore në momentin e zbatimit të kontratës. Gjithashtu, kërkesa për 5 inxhinier drejtues teknik, është relativisht e lartë. Mund të kërkoheshin njëkohësisht si staf mbështetës.
4.Kërkesa e pikës **2.3.3/d e DST** e cila kërkon nga OE 15 punonjës të specializuar të cilët të figurojnë 3 muajt e fundit në listëpagesë, nuk është në përputhje me 39, pika 6 germa (c) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar e cila përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar një listë të personelit kryesor, pa përcaktuar afate se kur duhet të figurojnë në listëpagesa.
5.Kërkesa e pikës **2.3.3.f e DST** e cila kërkon ndër të tjera një ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, pasi nuk është në përputhje me objektin e prokurimit. Nga

shqyrtimi i objektit të kontratës, preventivit dhe zërave të punimeve nuk rezulton të parashikohen punime apo procese teknike që kërkojnë ekspertizë specifike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, apo që lidhen me projektimin, instalimin, testimin ose certifikimin e sistemeve të mbrojtjes kundër zjarrit. Për rrjedhojë, kërkesa për disponimin e këtij specialisti nuk paraqitet e nevojshme për realizimin e kontratës.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi A. B., N. P. dhe E.S.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	"Xh." SH.P.K.	31,109,300	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.1 për punë të ngjashme. Nuk përbën punë të ngjashme objekti i paraqitur nga ky operator ekonomik për plotësimin e këtij kriteri. 2.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.2 që lidhet me specifikimet teknike për Tuba çeliku, saraçineskë fi200, pompë uji fuqi 20 kë dhe dokumentacionin bashkëlidhur. Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri. 3.Nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3 për 1 inxhinier mekanik, 1 inxhinier gjeoteknik, pasi për këtë procedurë nuk lejohet mbështetja në subjekte të tjera përsa i përket stafit drejtues teknik, përcaktuar në dokumentet e tenderit. 4.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3.b për stafin teknik pasi nuk ka bërë vetëdeklarimin e tyre sipas shtojcës përkatëse. 5.Nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3.e për manovratorët pasi ka deklaruar 3 manovratorë nga 5 të kërkuar. 6.Nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3.f pasi nuk ka deklaruar në shtojcën 8, dy punonjësit e kërkuar, njëri ekspert zjarrfikës dhe tjetri ekspert për ndihmën e parë. 7.Nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3.g pasi nuk ka deklaruar mjekun e shoqërisë. 8.Nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4 për mjetet, pasi nuk ka deklaruar mjetet në formularin e vetëdeklarimit. 9.Mungon deklarata nga Administratori për vendndodhjen e mjeteve dhe pranimin për verifikimin e tyre.
2	BOE "2Z.C." SH.P.K. & "A.-2A. C."	33,714,900	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Shoqëria "2Z.C." SH.P.K. nuk plotëson kriterin pune te ngjashme, pasi: Kontrata me Bashkia Roskovec nuk është e sakte , formulari i vlerësimit përmban te dhëna jo te sakta, pasi përqindja e realizimit për shoqëria "2Z." është 70%, kurse sipas kontratës se bashkëpunimit ka marr përsipër vetëm 60%. Kontrata me Bashkia Librazhd nuk përbën pune te ngjashme, pasi është rruge. Kontrata me Bashkia Dropull, mungon certifikata e marrjes ne dorëzim te punimeve, si dhe nuk jane paraqitur te gjitha faturat tatimore te shitjes.

			2.Nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.2 për materialet Tuba çeliku, saraçineskë fi 200, pompë uji fuqi 20 kë. Per materialin Pompe uji fuqi 20 kë është paraqitur si prodhues kompania "M. G." , i cili nuk rezulton kompani prodhuese, por distributore. Mungon autorizimi nga prodhuesi për distributorin. Per këtë material mungon katalogu i përkthyer ne gjuhen shqipe. Nuk është paraqitur katalog për tubo çeliku. Dokumentacioni nga kompania "N." SH.P.K. nuk eshte i noterizuar. Nuk është prodhues, por distributor, mungon dokumenti i autorizimit nga prodhuesi. Folderi me emërtimin "Autorizim_Distributori_Tubo" është dëmtuar gjate ngarkimit dhe nuk hapet. Kjo është përgjegjësi e operatoreve ekonomike. Kompania "2Z.C." SH.P.K. nuk ka paraqitur inxhinier gjeoteknik, referuar ndarjes se punimeve, ky operator e ka te domosdoshme prezencën e këtij personeli. Kompania "2Z.C." SH.P.K. nuk ka paraqitur 1 (Nje) Teknik hidroteknik, referuar ndarjes se punimeve, ky operator e ka te domosdoshme prezencen e ketij personeli. OE nuk përmbush kriterin për mjekun. OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4 për mjetet e pajisjet. Nuk ka paraqitur mjetet si me poshtë: 1. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo me pak se 20Ton. 2. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton. 3.Kamioncina me kapacitet mbajtës deri ne 3.5. 5. Ekskavator me zinxhir me krahë te gjate mbi 10 m 6. Ekskavator me goma 7.Fadromë me goma 10.Autobot Uji 11.Autobetoniere 12.Autopompë betoni Nuk ka paraqitur kontrata noteriale përkatëse te vlefshme për këtë objekt sipas kërkesave për kualifikim. OE "2Z.C." SH.P.K. nuk ka paraqitur 1 (Një) Teknik hidroteknik, referuar ndarjes se punimeve, ky operator e ka te domosdoshme prezencën e këtij personeli.
3	"H.T.SH" SH.P.K.	0	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për këtë procedurë prokurimi.
4	"U." SH.P.K.	33,930,100	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.2 për materialet Tuba çeliku, saraçineskë fi 200, pompë uji fuqi 20 kë. Operatori ekonomik për materialet Saraçineska ka paraqitur dokumentacion nga kompania "H.", për te cilën nuk ka paraqitur certifikata Iso te vlefshme. Certifikatat Iso jane paraqitur te skaduar nga muaji Mars 2024. 2.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4 për mjetet. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mjetet Autobot uji copë 1, Autobetoniere copë 2, Autopompe betoni copë 1, Ekskavator me zinxhir me krahë te gjate mbi 10 m - 1 cope, Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton - 1 cope, Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo me pak se 20 Ton - 2 cope, Ekskavator me goma - 1 cope. Nuk

			është paraqitur kontrata noteriale përkatëse e vlefshme për këtë objekt.
5	"A. M." SH.P.K. & "O." SH.P.K.	37,571,057	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has. z. M. D. me nr. 11/1 datë 08.01.2024 është ngritur KVO e cila përbëhet nga Z .Sh. (kryetar), A. M. dhe Y. D .(anëtar). Në këtë tender kanë marrë pjesë 5 OE, është kualifikuar 1 OE, dhe shpallur fitues BOE "A. M" SH.P.K. & "O." SH.P.K. me ofertë në vlerën **37,571,057 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **2,925,334 lekë.**
- Data e hapjes së ofertave është 13.08.2024. Vlerësimi i tyre ka përfunduar me datë 01.09.2024, pra rreth 19 ditë, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 8 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirin e lartë monetar.
Është administruar dokumentacioni i OE fitues me shkresën nr. 2784 prot., datë 04.09.2024.
Është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 2994/2 prot., datë 19.09.2024.
Është lidhur kontrata me nr. 3024 prot., datë 20.09.2024.

A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret dhe konkretisht:
1. BOE nuk përmbush kriteret e pikës **2.3.2** për materialet *Tuba çeliku, saraçineskë fi 200, pompë uji fuqi 20 kë,* për të cilën kërkohet katalogu i prodhuesit sipas listës së materialeve, certifikata e prodhuesit sipas standardit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015, dhe certifikatën e konformitetit CE.
-Lidhur me katalogun, është paraqitur një katalog i prodhuesit G, i cili rezulton në gjuhë të huaj të pa përkthyer, në kundërshtim me DST ku përcaktohet se *Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.*
Mungojnë certifikatat ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015 të prodhuesit si dhe certifikata e konformitetit CE.
2. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për disa nga mjetet e deklaruara dhe konkretisht:
-Për mjetin Kamion vetëshkërkues me kapacitet mbajtës 10 – 15, është deklaruar vetëm një mjet nga OE "O." SH.P.K. me targa AA381RU, ndërkohë kërkohet 2 kamionë me këtë kapacitet;
-Nuk është deklaruar kamion me kapacitet mbajtës deri në 3.5 Ton;
-Për mjetin ekskavator me zinxhirë, nuk është bërë deklarimi i plotë për këto mjete;

B. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK të OE fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret dhe konkretisht:
3. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.2 të DST** për taksat dhe tarifat vendore 2023 dhe periudha e maturuar 2024. OE "A. M." SH.P.K., rezulton sipas ekstraktit të QKB me aktivitet në Lezhë, ndërkohë nuk ka paraqitur asnjë vërtetim nga Bashkia Lezhë për likuidimin e detyrimeve vendore. OE "O." SH.P.K., rezulton sipas dokumentacionit të paraqitur se ka kryer punime ndërtimi përgjatë vitit 2023 pranë Bashkisë Has, konkretisht për objektin *"Rehabilitim kunete dhe bazamenti i kanalit të betonit përroi i tershenes segmenti ish ura ushtrisë vazhdim drejt grykë tershenes",* por nuk rezulton se ka likuiduar detyrimet vendore pranë Bashkisë Has për vitin 2023. Veprimet janë në kundërshtim me nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 dhe nenin 98 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika 1 germa (b) të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: Z .Sh. (kryetar), A. M .dhe Y. D. (anëtar).

3. Tenderi me objekt: "*Rikonstruksion i Gjimnazit "Skënderbeu", Has*", me këto të dhëna:

<table>
<tr><td colspan="3">3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i Gjimnazit "Skënderbeu", Has"</td></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi :
Nr. 29, datë 02.07.2024</td><td rowspan="2">2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Nr. 11/2 date 08.01.2024
1.A. B. - (Person përgjegjës)
2.N. P. - (Jurist)
3.E. S. - (Financier)</td><td rowspan="2">3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 11/1, datë 08.01.2024
1. Z. Sh. – (Zv. Kryetar)
2. A. M. - (Juriste)
3. Y. D. – (Sek.Urbanistik)</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"</td></tr>
<tr><td>5.Fondi Limit (pa TVSH)
97,431,542 - lekë pa TVSH</td><td>6.Oferta fituese:
BOE "T.&J .C" SH.P.K. & "V. C." SH.P.K. me ofertë 94,500,000 - Lekë, me afat 12 muaj.</td><td>7.Diferenca me fondin limit:
2,931,542 - lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
Data e zhvillimit: 26.08.2024</td><td>9.Burimi Financimit:
82,816,810 lekë - Buxheti i Shtetit
14,614,732 lekë – Buxheti i Bashkisë Has</td><td>10.Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës në tender 5 OE
b) Skualifikuar 4 OE,
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>11.Ankimime AK,
Ka/Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK,
Ka/Nuk ka</td><td>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka</td></tr>
</table>

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has, z. M. D. me nr. 11/2, datë 08.01.2024 është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga A. B., N. P. dhe E. S.
Me urdhër të Titullarit me nr. 29 datë 31.07.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **97,431,542 lekë** me objekt**: *"Rikonstruksion i Gjimnazit "Skënderbeu", Has".***
-Burimi i financimit është nga buxheti i Buxheti i Shtetit në vlerën 82,816,810 pa TVSH lekë, përcjellë Bashkisë has me shkresën nr. 1815/5 prot., datë 27.03.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku vlera prej 32,000,000 lekë me TVSH planifikohet për vitin 2024 dhe 67,380,172 lekë me TVSH për vitin 2025. Diferenca prej 14,614,732 lekë është bashkëfinancim nga buxheti i Bashkisë Has, ku me VKB nr. 109, datë 25.09.2024, është miratuar financimi në vlerën 5,612,057 lekë për vitin 2024.
Projekti dhe Preventivi i punimeve është hartuar nga studio projektuese "S.-A." SH.P.K. me nr. licence N.7185/3. Nuk disponohet mënyra e administrimit të projektit nga Bashkia Has.
-Mungon oponenca teknike në kundërshtim me nenin 6 pika 1 germa (a) të Ligjit nr. 8402, datë

Vlerësimi i kritereve
Hartimi dhe argumentimi i kritereve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin e datës 01.08.2024 nga NJHDT, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan kritere jo në përputhje me objektin e procedurës.
1.Kërkesa e pikës **2.3.2.a e DST** e cila kërkon ndër të tjera kategorinë e licencës NP-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit), nuk është në përputhje me objektin. Nga analiza e preventivit, specifikimeve teknike dhe zërave të punimeve nuk rezulton të parashikohen punime specifike, rehabilitim mjedisor apo vepra të tjera që kërkojnë disponimin e kësaj licence të specializuar.
2.Kërkesa e pikës **2.3.3.a e DST** e cila kërkon nga OE 60 punonjës për periudhën e 3 muajve të fundit, është kërkesë e paargumentuar teknikisht. Gjithashtu, kërkesa që punonjësit të figurojnë 3 muajt e fundit në listëpagesa nuk është në përputhje me 39, pika 6 germa (ç) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar e cila përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore, pa përcaktuar afate se kur duhet të figurojnë në listëpagesa. Vendosja e një kriteri të tillë mund të krijojë barriera të panevojshme për

pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, veçanërisht për subjektet që kanë mundësi të sigurojnë fuqinë e nevojshme punëtore në momentin e zbatimit të kontratës.
3.Kërkesa e pikës **2.3.3.b e DST** e cila kërkon nga OE të kenë pjesë të stafit drejtues teknik 1 inxhinier mjedisi, është jo në përputhje me objektin e prokurimit. Nga dokumentacioni teknik i procedurës nuk rezulton të parashikohen punime që kërkojnë ekspertizë të specializuar në fushën e inxhinierisë së mjedisit.
4.Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST** e cila kërkon certifikatën ISO 3834-2: 2021 "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim", nuk përputhet me natyrën, volumin e punimeve.
5.Kërkesa e pikës **2.3.6 e DST** e cila kërkon nga OE të jetë i pajisur me licencë për Mbrojtjen nga Zjarri Kodi 1.2.A, është kërkesë e cila duhet të mundësohej disponimin i kësaj licence edhe me kontraktim. Mënyra e përmbushjes së këtij kriteri vetëm nëpërmjet disponimit të drejtpërdrejtë të licencës nga operatori ekonomik nuk rezulton i domosdoshëm për garantimin e realizimit të kontratës, për sa kohë që i njëjti rezultat mund të sigurohet edhe përmes bashkëpunimit me subjekte të licencuara.
6.Kërkesa e pikës **2.3.8 e DST** e cila ndër të tjera ka kërkuar për listën e artikujve të nevojshëm *si Pllaka gress porcelan, pllaka mermeri, kasëtë hidroplastike, dyer etj.*, për këto materiale kërkon të paraqitet ndër të tjera **certifikatë nga Prodhuesi** që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standardit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015.
-Kjo kërkesë, vjen në kundërshtim me pikën 1 të nenit 44 "Kërkesat e cilësisë" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, i cili përcakton se kërkesat e kësaj natyre, u kërkohen ofertuesve dhe jo subjekteve të cilat nuk janë ofertues. Konkretisht, dokumentet si certifikata ISO, etj., të subjekteve të cilat nuk janë ofertues, nuk mund të kërkohen nga NJP.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë A. B., N. P. dhe E. S.

<u>Vlerësimi i ofertave</u>

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	"A.C." SH.P.K.	97,170,901	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.1** për xhiron vjetore. Vlera e xhiros e paraqitur nga operatori ekonomik nuk plotëson vlerën e kërkuar ne DST. 2.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.1/a për punë të ngjashme. Ky operator ekonomik ka paraqitur kontrata, vlera e te cilave nuk plotëson shumen e kërkuar në kërkesat për kualifikim. 3.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.2 për licencat, pasi nuk disponon licencën e zbatimit për pikat NP-2, NP-3, NP-12, NS-4, NS-8, NS-12. 4.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.3 për numrin e punonjësve. Sipas formularit të vetëdeklarimit ka deklaruar 22 punonjës. 5.OE nuk plotëson kriterin për 3 manovratoër. Ka deklaruar 2 manovratorë nga 3 të kërkuar. 6.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.3.g për 1 ekspert për ndihmën ndaj emergjencave, dhe 1 përgjegjës për sigurinë

			dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Nuk ka deklaruar disponimin e tyre. 7.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.4 për mjete/pajisje, pasi nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit mjetet e kërkuara. 8.OE nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.6 për licencën për mbrojtjen nga zjarri Kodi 1.2.A pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për disponimin e saj. 9.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.7, pasi nuk ka paraqitur grafikun e punimeve. 10.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.8 pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.
2	"M." SH.P.K.	96,849,585	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës. 2.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.2 për xhiron pasi nuk plotëson shumën e kërkuar. 3.OE nuk plotëson kriterin për punët e ngjashme. Ky operator ekonomik ka paraqitur kontrata, vlera e te cilave nuk e ploteson shumen e kerkuar per plotesimin e ketij kriteri. 4.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.3 për numrin e punonjësve. Ka deklaruar 24 punonjës nga 60 të kërkuar. 5.OE nuk plotëson kriterin për 1 inxhinier hidroteknik. 6.OE nuk ka përcaktuar Drejtuesin Teknik të punimeve. 7.OE nuk plotëson kriterin për stafin e specialistëve të kërkuar pasi nuk ka përcaktuar në formular se disponon këtë personel. 8.OE nuk ka deklaruar se disponon 2 manovrator. 9.OE nuk ka deklaruar 2 specialistët e kërkuar ekspert për ndihmën e parë, dhe përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. 10.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.4 pasi nuk ka deklaruar një numër të lartë mjetesh dhe pajisjesh. 11.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.5 pasi nuk ka paraqitur certifikatat ISO të kërkuara. 12.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.6 pasi nuk ka paraqitur licencën për mbrojtjen nga zjarri Kodi 1.2.A. 13.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.8 pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e këtij kriteri.
3	"2N." SH.P.K.	77,608,151	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.8. -Për materialin "Pllaka gress porcelan" ka paraqitur dokumentacion nga kompania "B." sh.p.k. e cila rezulton se është distributor i kompanise turke A. S. S. V.E. T. A.S. Nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi për distributorin e autorizuar apo marreveshje zyrtare bashkepunimi të kompanise prodhuese me kompanine "B." SH.P.K.. Gjithashtu nuk është paraqitur katalogu për materialin pllaka gress porcelan në gjuhen shqipe, por në anglisht, ne kundërshtim me kerkesat e percaktuara ne Dokumentat Standarte te Tenderit, Seksioni 4, pika 4.7 gjuha ne te cilen pergatitet oferta, si dhe Shtojca 7 kriteret e pergjithshme per kualifikim "Nese gjuha e perdorur ne procedure eshte gjuha shqipe, atehere dokumentet e gjuhes se huaj duhet te shoqerohen nga nje perkthim i noterizuar ne shqip.

			-Për materialin "Pllaka mermeri" ka paraqitur dokumentacion nga kompania "B." sh.p.k. e cila rezulton se eshte distributor i kompanise turke A. S. S .V.E. T. A.S. Nuk eshte paraqitur autorizim nga prodhuesi per distributorin e autorizuar apo marreveshje zyrtare bashkepunimi e kompanise prodhuese me kompanine "B." SH.P.K.. Gjithashtu nuk eshte paraqitur katalogu per materialin pllaka mermeri ne gjuhen shqipe, por ne anglisht, ne kundershtim me kerkesat e percaktuara ne Dokumentat Standarte te Tenderit, Seksioni 4, pika 4.7 gjuha ne te cilen pergatitet oferta, si dhe Shtojca 7 kriteret e pergjithshme per kualifikim "Nese gjuha e perdorur ne procedure eshte gjuha shqipe, atehere dokumentet e gjuhes se huaj duhet te shoqerohen nga nje perkthim i noterizuar ne shqip. -Për materialin "Kasete shkarkimi" ka paraqitur dokumentacion nga kompania "B." sh.p.k. e cila rezulton se eshte distributor i kompanise "V.". Nuk eshte paraqitur autorizim nga prodhuesi per distributorin e autorizuar apo marreveshje zyrtare bashkepunimi e kompanise prodhuese me kompanine "B." SH.P.K.. Gjithashtu nuk eshte paraqitur katalogu per materialin Kasete shkarkimi ne gjuhen shqipe, por ne anglisht, ne kundershtim me kerkesat e percaktuara ne Dokumentat Standarte te Tenderit, Seksioni 4, pika 4.7 gjuha ne te cilen pergatitet oferta, si dhe Shtojca 7 kriteret e pergjithshme per kualifikim "Nese gjuha e perdorur ne procedure eshte gjuha shqipe, atehere dokumentet e gjuhes se huaj duhet te shoqerohen nga nje perkthim i noterizuar ne shqip. -Për materialin "Dritare duralumini plastike" ka paraqitur deklarate nga I. T.. Nuk eshte paraqitur autorizim nga prodhuesi "L." per distributorin e autorizuar apo marreveshje zyrtare bashkepunimi e kompanise prodhuese me I.T. Nuk eshte paraqitur deklarate nga prodhuesi per materiale te prodhuara sipas standartit te konformitetit CE apo certifikimet Iso. -Për materialin "Dyer d-alumini/plastike me 1/2 xham" ka paraqitur deklarate nga I. T.. Nuk eshte paraqitur autorizim nga prodhuesi "L." per distributorin e autorizuar apo marreveshje zyrtare bashkepunimi e kompanise prodhuese me I. T.. Nuk eshte paraqitur deklarate nga prodhuesi per materiale te prodhuara sipas standartit te konformitetit CE apo certifikimet Iso. -Për materialin "Dyer te brendshme" ka paraqitur deklarate nga I. T. Nuk eshte paraqitur autorizim nga prodhuesi "L." per distributorin e autorizuar apo marreveshje zyrtare bashkepunimi e kompanise prodhuese me I. T.. Nuk eshte paraqitur deklarate nga prodhuesi per materiale te prodhuara sipas standartit te konformitetit CE apo certifikimet Iso. Ky operator ekonomik per materialin "Dyer te jashtme" ka paraqitur deklarate nga I.T. Nuk eshte paraqitur autorizim nga prodhuesi "L." per distributorin e autorizuar apo marreveshje zyrtare bashkepunimi e kompanise prodhuese me I. T.. Nuk eshte paraqitur deklarate nga prodhuesi per materiale te prodhuara sipas standartit te konformitetit CE apo certifikimet Iso. -Për materialin "Parket druri" ka paraqitur dokumentacion nga kompania "B." sh.p.k. e cila rezulton se eshte distributor

			i kompanise “C.” Nuk eshte paraqitur autorizim nga prodhuesi per distributorin e autorizuar apo marreveshje zyrtare bashkepunimi e kompanise prodhuese me kompanine “B.” SH.P.K.. Gjithashtu nuk eshte paraqitur katalogu per materialin Parket druri ne gjuhen shqipe, por ne anglisht, ne kundershtim me kerkesat e percaktuara ne Dokumentat Standarte te Tenderit, Seksioni 4, pika 4.7 gjuha ne te cilen pergatitet oferta, si dhe Shtojca 7 kriteret e pergjithshme per kualifikim “Nese gjuha e perdorur ne procedure eshte gjuha shqipe, atehere dokumentet e gjuhes se huaj duhet te shoqerohen nga nje perkthim i noterizuar ne shqip. -Për materialin “Hekur betoni periodik ø ÷ 10mm” ka paraqitur autorizim nga kompania “Sh.” SH.P.K., i cili rezulton sipas ekstraktit te shoqerise, objekti i aktivitetit se eshte distributor dhe jo prodhues. Nuk eshte paraqitur autorizim nga prodhuesi apo marreveshje zyrtare me kompanine prodhuese, nuk jane paraqitur certifikimet iso te materialit apo deklarate konformiteti nga prodhuesi. -Për materialin “Tubo çeliku zingato” ka paraqitur dokumentacion nga kompania “a”, e cila rezulton sipas ekstraktit te shoqerise, objekti i aktivitetit se eshte distributor dhe jo prodhues. Nuk eshte paraqitur autorizim nga prodhuesi apo marreveshje zyrtare me kompanine prodhuese, nuk jane paraqitur certifikimet iso te materialit apo deklarate konformiteti nga prodhuesi. Ky operator ekonomik per materialin “Pomp e mbrojtjes kunder zjarrit” ka paraqitur dokumentacion nga kompania “N.”, e cila rezulton sipas ekstraktit te shoqerise, objekti i aktivitetit se eshte distributor dhe jo prodhues. Nuk eshte paraqitur autorizim nga prodhuesi apo marreveshje zyrtare me kompanine prodhuese, nuk jane paraqitur certifikimet iso te materialit apo deklarate konformiteti nga prodhuesi. -Për materialin “Kaldaje çeliku” ka paraqitur dokumentacion nga kompania “H.S.”, e cila rezulton sipas ekstraktit te shoqerise, objekti i aktivitetit se eshte distributor dhe jo prodhues. Nuk eshte paraqitur autorizim nga prodhuesi apo marreveshje zyrtare me kompanine prodhuese, nuk jane paraqitur certifikimet iso te materialit apo deklarate konformiteti nga prodhuesi. 2.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.4 për mjetin autovinç. Për këtë mjet është deklaruar kontrate qeraje, e cila nuk është e vlefshme për gjithë afatin e parashikuar të realizimit të punimeve.
4	“A. M.” SH.P.K. & “B.-I.” SH.P.K.	84,395,386	*S’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. BOE ”A. M.” & ”BE. – I.S.” SH.P.K nuk ploteson kriterin 2.3.8 Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë: - Pllaka gress porcelan - është paraqitur autorizim nga kompania “B.I.”. Nuk eshte paraqitur katalogu, certifikatat iso si dhe autorizim / marrëveshje zyrtare nga prodhuesi për shoqërinë “B.I.”. - Pllaka mermeri, Dritare duralumini plastike, Dyer d-alumini/plastike me ½ xham, Dyer te brendshme , Dyer te jashtme si dhe parket druri– është paraqitur autorizim nga kompania “S.”. Nuk është paraqitur katalogu, certifikatat

			iso, deklarate konformiteti, si dhe autorizim / marreveshje zyrtare nga prodhuesi për shoqërinë "S." . - Boje hidroplastike cilësi e pare, Hekur betoni periodik ø ÷ 10mm – është paraqitur kontrate me Z. B. M. Nuk eshte paraqitur katalogu, certifikatat iso si dhe autorizim / marreveshje zyrtare nga prodhuesi per Z. B. M.- Bordura betoni 15X25cm – mungon katalogu, - Automat magneto-termik - eshte paraqitur autorizim nga kompania "S.". Nuk është paraqitur katalogu, certifikatat iso, deklarate konformiteti, si dhe autorizim / marrëveshje zyrtare nga prodhuesi për shoqërinë "S." . - Pomp e mbrojtjes kundër zjarrit, kaldaje çeliku - është paraqitur autorizim nga kompania "A". Nuk është paraqitur katalogu, certifikatat iso, deklarate konformiteti, si dhe autorizim / marrëveshje zyrtare nga prodhuesi per shoqërinë "A.". 2. BOE "A. M." & "BE. – IS." SH.P.K nuk ploteson kriterin 2.3.3. Shoqëria "A. M." sh.p.k. e ka te angazhuar personelin e deklaruar për plotësimin e këtyre kritereve ne një procedure tjetër pranë Bashkia Has. 3.BOE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.4 për mjetet Autopompë betoni, autobetoniere, pasi nuk i ka deklaruar këto mjete shtojcën nr. 8.
5	"T.&J. C." SH.P.K. & "V. C." SH.P.K.	94,500,000	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has. z. M. D. me nr. 11/1 datë 08.01.2024 është ngritur KVO e cila përbëhet nga z. Z. Sh. (kryetar), A. M. dhe Y. D. (anëtar). Në këtë tender kanë marrë pjesë 5 OE, është kualifikuar 1 OE, dhe shpallur fitues BOE "T.&J. C." SH.P.K. & "V. C." SH.P.K. me ofertë në vlerën **94,500,000 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **2,931,542 lekë.**
- Data e hapjes së ofertave është 26.08.2024. Vlerësimi i tyre ka përfunduar me datë 15.09.2024, pra rreth 20 ditë, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 8 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirim e lartë monetar. Mangësitë e mësipërme, janë përgjegjësi e anëtarëve të KVO dhe Titullarit të AK.
Është administruar dokumentacioni i OE fitues me shkresën nr. 2997 prot., datë 23.09.2024.
Është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 3127/1 prot., datë 01.10.2024.
Është lidhur kontrata me nr. 3152 prot., datë 02.10.2024.

A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret dhe konkretisht:
1. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** për certifikatën ISO 3834-2: 2021 "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim". Të dy OE kanë paraqitur këto certifikata të cilat rezultojnë pa akreditimin përkatës nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues. Konkretisht OE "V. C." SH.P.K. e ka paraqitur certifikatën e lëshuar nga subjekti A.Q.S. Cert ndërsa OE "T.&J." C. e ka paraqitur certifikatën të lëshuar nga subjekti E-Cert. Asnjëri nga këto dy subjekte nuk ka akredimin përkatës për lëshimin e certifikatës së mësipërme.
2. Subjekti "V.C." SH.P.K. i cili është subjekt mbështetës i OE "V. C.", nuk ka paraqitur dokumente sipas vetëdeklarimit të dhënë në formularin përkatës. Mungojnë vërtetimet nga gjykata, prokuroria, dëshmi penaliteti, vërtetimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vërtetimet nga Njësitë e vetëqeverisjes vendore për likuidimin e detyrimeve, vërtetimin nga OSHEE për

likuidimin e energjisë elektrike.

Veprimet janë në kundërshtim me nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 dhe nenin 98 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika 1 germa (b) të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: Z .Sh. (kryetar), A. M. dhe Y. D. (anëtar).

4. Tenderi me objekt: "*Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme, Fshati Golaj*", me këto të dhëna:

<table>
<tr><td colspan="3">4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme, Fshati Golaj"</td></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi :
Nr. 42, datë 01.10.2024

4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"</td><td>2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Nr. 11/2 date 08.01.2024
1.A. B. - (Person përgjegjës, juriste)
2.R. R.- (Jurist)
3.E. S. - (Financier)</td><td>3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 11/1, datë 08.01.2024
1. Z. Sh. – (Zv. Kryetar)
2. A. M. - (Juriste)
3. Y. D. – (Sek.Urbanistik)</td></tr>
<tr><td>5.Fondi Limit (pa TVSH)
88,910,909 - lekë pa TVSH</td><td>6.Oferta fituese:
BOE "Sh. – Al." SH.P.K. & "O." SH.P.K. me ofertë 83,951,496 - Lekë, me lidhje kontrate datë 02.12.2024, me afat 12 muaj.</td><td>7.Diferenca me fondin limit:
4,959,413 - lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
Data e zhvillimit: 29.10.2024</td><td>9.Burimi Financimit:
Buxheti i Bashkisë Has
Viti 2024 – 19,761,039.8 lekë;
Viti 2025 – 33,000,000 lekë;
Viti 2026 – 55,932,051 lekë</td><td>10.Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës në tender 6 OE
b) Skualifikuar 4 OE,
c) Kualifikuar 2 OE</td></tr>
<tr><td>11.Ankimime AK,
Ka/Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK,
Ka/Nuk ka</td><td>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka</td></tr>
</table>

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has, z. M. D. me nr. 11/2, datë 08.01.2024 është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga A. B., R. .Rdhe E .S.
Me urdhër të Titullarit me nr. 42 datë 01.10.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **88,910,909 lekë** me objekt**: *"Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme, Fshati Golaj".***
-Burimi i financimit është nga të ardhurat e Bashkisë Has, miratuar me vendimin e Këshilli të Bashkisë me nr. 12, datë 30.09.2024 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026". Financimi planifikohet të ndahet në 3 vite, ku për vitin 2024 vlera është 19,761,039.8 lekë, për vitin 2025 është në vlerën 33,000,000 lekë dhe për vitin 2026 vlera është 55,932,051 lekë.
Projekt – preventivi janë hartuar nga studio projektuese "G.&L.C." Nuk disponohet mënyrë se si është administruar nga bashkia ky projekt.

Është miratuar Deklarata Paraprake për kryerje punimesh sipas lejes me datë 02.12.2024. Mungon Oponenca Teknike, në kundërshtim me nenin 6 pika 1 germa (a) të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar.

<u>Vlerësimi i kritereve</u>
Hartimi dhe argumentimi i kritereve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin e datës 11.10.2024 nga NJHDT, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan kritere jo në përputhje me objektin e procedurës.

1.Kërkesa e pikës **2.3.3.a e DST** e cila kërkon nga OE 60 punonjës për periudhën e 3 muajve të fundit, është kërkesë e paargumentuar teknikisht. Gjithashtu, kërkesa që punonjësit të figurojnë 3 muajt e fundit në listëpagesa nuk është në përputhje me 39, pika 6 germa (ç) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar e cila përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore, pa përcaktuar afate se kur duhet të figurojnë në listëpagesa. Vendosja e një kriteri të tillë mund të krijojë barriera të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, veçanërisht për subjektet që kanë mundësi të sigurojnë fuqinë e nevojshme punëtore në momentin e zbatimit të kontratës.
2.Kërkesa e pikës **2.3.3.b e DST** e cila kërkon nga OE të kenë pjesë të stafit drejtues teknik 1 inxhinier mjedisi, është jo në përputhje me objektin e prokurimit. Nga dokumentacioni teknik i procedurës nuk rezulton të parashikohen punime që kërkojnë ekspertizë të specializuar në fushën e inxhinierisë së mjedisit.
3.Kërkesa e pikës **2.3.3.h e DST** e cila kërkon nga OE të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë ose të kontraktuar nga jashtë, dhe në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili prej tyre të ketë mjekun, është kërkesë e paargumentuar dhe jo në përputhje me VKM-në nr. 632, datë 15.07.2015 e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 15.07.2011 "Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1 ku përcaktohet se:
"Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë vijon:
"6.Punëdhënësit e grupeve "A." dhe "B.", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C." dhe "D.", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.
Gjithashtu, sqarohet se kjo kërkesë duhet të plotësohet nëpërmjet Formularit të Vetëdeklarimit, ndërkohë që NJP nuk e ka përcaktuar këtë detaj.
4.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon ndër të tjera 2 kontejner stacionar dhe 1 rimorkiator mjetesh në pronësi ose me qira, janë jo në përputhje. Në lidhje me kërkesën për disponimin e 2 kontejnerëve stacionarë, nga analiza e objektit të kontratës dhe zërave të punimeve nuk rezulton të jetë argumentuar nevoja teknike për posedimin e tyre si kriter kualifikimi. Kontejnerët stacionarë nuk përbëjnë mjete apo makineri ndërtimi që përdoren drejtpërdrejt në procesin e realizimit të punimeve rrugore dhe as nuk ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në kapacitetin teknik të operatorit ekonomik për ekzekutimin e kontratës. Për më tepër, autoriteti kontraktor nuk ka paraqitur argumente teknike që të justifikojnë nevojën për disponimin e dy kontejnerëve, duke e bërë këtë kërkesë joproporcionale në raport me objektin e prokurimit.
Gjithashtu, kërkesa për rimorkiatorin në pronësi ose me qira, duhet të mundësonte edhe opsionin e kontratës së shërbimit, pasi rimorkiatori nuk është mjet që ka proces te drejtpërdrejt në ndërtimin e rrugës, pasi shërben vetëm për transportimin e mjeteve.
5.Kërkesa e pikës **2.3.6 e DST** e cila kërkon nga OE të disponojnë Licencën Kodi III.2.B "Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte", është kërkesë e cila nuk duhej të kufizohej me disponimin e saj domosdoshmërisht nga OE, por të mundësohej edhe nëpërmjet kontraktimit, pasi objekti kryesor i procedurës është asfaltimi i rrugës.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë A. B., R. R. dhe E. S.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	"A.I. C."	0	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. OE nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i paraqitur nga ky operator ekonomik nuk është sipas formatit të miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publike dhe të publikuar në SPE nga Autoriteti Kontraktor. 2.OE nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3. Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës. Gjithashtu, nuk ka paraqitur Ofertën Ekonomike, mungon Shtojca 1, 2 si dhe preventivi i punimeve. 3.OE nuk plotëson kërkesat për punë të ngjashme. Kontrata e paraqitur me objekt "Mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Qendror dhe Verilindor – Kontrata B (330 Km)" është kontratë shërbimi dhe jo punë publike. 4.OE nuk plotëson kriteret për numrin e fuqisë punëtore pasi nuk e ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit. 5.OE nuk ka deklaruar një inxhinier ndërtimi profili infrastrukturë. 6.OE nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit stafin prej 16 punonjës të kualifikuar. 7.OE nuk plotëson kriterin për mjekun. 8.OE nuk plotëson kriterin për mjetet dhe makineritë për të cilat nuk ka kryer deklarimin përkatës. 9.OE nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: **2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B "Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte". Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B "Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte". 10.OE nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: **2.3.7** Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë: - Tuba çeliku 2500 mm - Tuba te brinjezuar HDPE SN8 - Bordura betoni Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin për plotësimin e këtij kriteri. 11.OE nuk ka paraqitur grafikun e punimeve. 12.OE nuk ka paraqitur deklaratën se është dakord me mënyrën e financimit.
2	"A.-2A. C."	73,374,114	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE nuk plotëson kërkesën për punë të ngjashme. Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt "Objekt thertore 1 kat & impiant fotovoltaik 150 kw & Pajisje" me investitor "N. S." PF. Ky objekt rezulton se nuk përbën "pune te ngjashme". Zërat e preventivit te objekti qe prokurohet janë te ndryshëm nga

			objekti qe operatori ekonomik ka paraqitur si pune te ngjashme. **(Referuar Vendimit 611/2020 te KPP). (Referuar Vendimit 539/2023 te KPP).** Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt "Rikonstruksioni rruga varrezave Kuc" me investitor Bashkia Himare, me vlere 2,281,583 Leke. Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt "Rikonstruksioni rruge te brendshme me beton" me investitor Bashkia Selenice, me sipermarres BOE "A.-2A. C." sh.p.k. 25% dhe "Sh." sh.p.k. 75%, per te cilin nuk jane paraqitur faturat tatimore dhe nuk eshte paraqitur Kontrata e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE. Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt "Ndertim rruge e rrugica me beton" me investitor Bashkia Selenice, me sipermarres BOE "A.-2A .C." sh.p.k. 95% dhe "B." sh.p.k. 5%, per te cilin nuk kane firmosur 2 anetare te grupit te marrjes ne dorezim, si dhe nuk eshte paraqitur kontrata e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE. Ky operator ekonomik ka paraqitur kontratën me objekt "Punime shtese tek tregu i gjësë se gjalle" me investitor Bashkia Korçë. Ky objekt rezulton se nuk përbën "pune te ngjashme". Zerat e preventivit te objekti qe prokurohet janë te ndryshëm nga objekti qe operatori ekonomik ka paraqitur si pune te ngjashme. **(Referuar Vendimit 611/2020 te KPP). (Referuar Vendimit 539/2023 te KPP).** Gjithashtu nuk kane firmosur 2 anëtarë te grupit te marrjes ne dorëzim ne aktin e marrjes ne dorëzim. Ky operator ekonomik ka paraqitur kontratën me objekt "Postblloku nr.1 zyra e informacionit dhe rikonstruksion rruge ne Rep. Usht, nr.1040, Zall-Herr Tirane" me investitor Komanda e Forcës Tokësore, për te cilin mungon situacioni përfundimtar, është paraqitur fotokopje pa ngjyra. Ky objekt rezulton se është realizuar ne bashkëpunim me shoqërinë "Sh." SH.P.K. e cila nuk ka firmosur ne aktin e marrjes ne dorëzim. Mungon Akti i kolaudimit, pasi është paraqitur fotokopje pa ngjyra. Nuk është paraqitur kontrata e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE. Ky operator ekonomik ka paraqitur kontratën me objekt NSHP, sistemim i territorit te ndërmarrjes per NSHP viti 2023" me investitor Bashkia Vlore, me vlere 13,986,133 Leke. Ky operator ekonomik ka paraqitur kontratën me objekt "Rikonstruksion i rrugës Mirake – Gjovac, Nj. Ad. Polis" me investitor Bashkia Librazhd, me sipërmarrës BOE "A.-2A.C." sh.p.k. 50.13% dhe "2Z.C." sh.p.k. 49.87%. Shoqeria "A.-2A.C." sh.p.k. nuk ka paraqitur faturat tatimore, ne kundërshtim me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt "Sistemim, asfaltim i rrugeve ekzistuese te aksit rrugore Letan – Bixelle, per te cilin nuk ka paraqitur faturat tatimore,

			ne kundershtim me kerkesat e percaktuara nga autoriteti kontraktor. 2.OE nuk plotëson kërkesën për mjekun e shoqërisë. 3.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.4 për mjetet autovinç, autobot uji, fabrikë për prodhimin e materialeve inerte…, impiant për prodhimn e betonit. Ky operator ekonomik nuk ploteson kriterin qe kontrata noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës. Afati i realizimit te punimeve eshte percaktuar nga autoriteti kontraktor prej 12 muaj. Data e zhvillimit te procedures se prokurimit eshte 29/10/2024. Minimalisht afati i vlefshmerise se kontrates se qerase duhet te jete data 29/10/2025. Sa me siper, ky operator nuk ka arritur te plotesoj kerkesat per disponimin e makinerive / pajisjeve sa me siper. 4.OE nuk disponon Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B "Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte". Licenca LN-2888-09-2021 ne objektin e saj nuk perfshin grumbullimin e mbetjeve inerte por vetem transportimin e tyre.
3	BOE "D." SH.P.K. & "B. H." SH.P.K.	64,691,941	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Sipas marrëveshjes se bashkëpunimit, shoqëria "B. H." sh.p.k. ka marr përsipër 62% dhe "D." sh.p.k. 38%. Sipas preventivit te ndarjes se punimeve shoqëria "D." sh.p.k. ka marr përsipër realizimin e punimeve me vlere 23,498,714 Leke pa TVSH, ose 36% dhe vlera e ofertës është 64,691,941 Leke pa TVSH. Pra kemi një përllogaritje gabim te përqindjes se pjesëmarrjes te shoqërisë "D." SH.P.K. Nuk është bere e sakte ndarja e punimeve, pasi kemi mospërputhje te sasisë totale te preventivit me sasitë qe ka marr përsipër te realizoj shoqëria "D." sh.p.k. 2.Se dyti, ka gabim ne përcaktimin e çmimit sipas shtojca 1, konkretisht shuma e shprehur me fjale e tejkalon dhjetëfishin e fondit limit: Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: **77,630,329 lekë.** 3.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.2.2 pasi bilancin e vitit 2023 e ka paraqitur të pakonfirmuar. 4.OE "D." SH.P.K. nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.1 për punë të ngjashme. Ky operator ekonomik ka paraqitur kontratën me objekt: "Rikonstruksion i rrugës Malqene – Nj. A Uimisht" me autoritet kontraktor Bashkia Kukës. Sipas kontrates se sipërmarrjes dhe aktit te kolaudimit rezulton se është realizuar nga BOE "C. R. 2008" SH.P.K. 70% dhe "D." SH.P.K. 30%. Ne formularin e vlerësimit është deklaruar se punimet jane realizuar 100% nga shoqëria "D." SH.P.K. Ky dokument nuk përmban te dhëna te sakta. Ky operator ekonomik gjithashtu ka paraqitur kontratën me objekt: "Asfaltim i rrugës se Fshatit BuSH.A.t" me autoritet kontraktor Bashkia Kukës. Sipas kontratës se sipërmarrjes dhe aktit te kolaudimit rezulton se është realizuar nga BOE "C.R. 2008" SH.P.K. 70% dhe "D." SH.P.K. 30%. Ne formularin e vlerësimit eshte deklaruar se punimet jane realizuar 100% nga shoqëria " D." SH.P.K.. Ky dokument nuk përmban te dhëna te sakta. Kurse kontrata me objekt "Uji i pastër ne Gjakove dhe Kukes Rehabilitimi i kolektorit te ujerave te zeza (KUZ) ne

			qytetin e Kukësit- Bashkia Kukës“ nuk përbën pune te ngjashme. Zërat e preventivit te objekti qe prokurohet jane te ndryshëm nga objekti qe operatori ekonomik ka paraqitur si pune te ngjashme. **(Referuar Vendimit 611/2020 te KPP). (Referuar Vendimit 539/2023 te KPP).** 5.BOE nuk plotëson kriterin për mjekun e shoqërisë. 6. Se gjashti, nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: **2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte” Shoqëria “ D.” SH.P.K. nuk disponon këtë licence. Nuk lejohet mbështetja pasi është licence personale qe lidhet me ushtrimin e veprimtarisë nga vete subjekti. Shoqëria “B. H.” SH.P.K. ka paraqitur Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për transport i mbetjeve inerte”, pra ky subjekt nuk ka te parashikuar ne objektin e saj dhe grumbullimin e mbetjeve inerte, ne kundershtim me kerkesat per kualifikim.
4	“M.” SH.P.K.	78,426,404	*S’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE nuk ka paraqitur Formulari Përmbledhës te Vetedeklarimit sipas formatit Shtojca 8 te miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publike dhe te publikuar nga Autoriteti Kontraktor ne DST. Gjithashtu, ky operator ekonomik nuk ka paraqitur Shtojca 1 dhe Shtojca 2. Preventivi i paraqitur ka gabime ne oferte ne masën -3.3%. Vlera e dhënë sipas preventivit është 78,426,404.2 Leke pa TVSH Vlera e korrigjuar është 75,820,175.63 Leke pa TVSH Diferenca ne preventivin e korrigjuar është – 2,606,228.57 Leke pa TVSH 2.OE nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës. 3.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.1 për punë të ngjashme. Për kontratën me objekt “Rikonstruksioni i Infrastruktures Rrugore te Bllokut qe kufizohet nga Rrugët “D.N.” – “P.V.” – “Gjok Doci”,)”, e realizuar nga sipërmarrësit e punimeve B.O.E “E.” sh.p.k. 1% & “A.-Sh.” sh.p.k. 59% & “M.” sh.p.k. 40% me vlerë të realizuar 139,989,949 Lekë pa TVSH është kontrate sherbimi dhe jo sipërmarrje, për më teper nuk është paraqitur: Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë <u>edhe Kontratën e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.</u> Për kontratën me objekt “LOTI III Mirëmbajtje me performance Tirane – Dajt – Qafe Molle – Bize, Qafë Priskë – Shkallë – Shëngjergj, Uzina eTraktorit – Lanabregas , Sauk – Farkë (93.1 km) (Punime Rehabilitimi)”, e realizuar nga sipermarresit e punimeve B.O.E “Xh.” sh.p.k. 49% & “A.-Sh.” sh.p.k. 1% & “M.” sh.p.k. 50% me vlerë të realizuar 69,223,589 Lekë pa TVSH është kontrate sherbimi dhe jo sipërmarrje, për më teper nuk është paraqitur akt kolaudimi dhe Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë <u>edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve</u>

			shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE. 4.OE nuk plotëson kriterin prej 60 punonjës. Në formularin e vetëdeklarimit ka deklaruar 50 punonjës. 5.OE nuk plotëson kriterin për 1 inxhinier mjedisi, pasi nuk e ka deklaruar në formular këtë inxhinier. 6.OE nuk ka paraqitur deklaratën për drejtuesin teknik të punimeve. 7.OE nuk plotëson kriterin për stafin e kualifikuar të cilat nuk i ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit. 8.OE nuk ka deklaruar 3 Automakinistë. 9.OE nuk ka paraqitur tabelën e plotësuar me të dhënat e stafit të kërkuar. 10.OE nuk ka deklaruar në formularin përmbledh një ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave. 11.OE nuk ka paraqitur dokumentacion për disponimin e mjekut. 12.OE nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës disponimin e mjeteve dhe makinerive. 13.OE nuk ploteson kriteret e vecanta per kualifikim, konkretisht: **2.3.7** për artikujt - Tuba celiku 2500 mm - Tuba te brinjezuar HDPE SN8 - Bordura betoni Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi shoqeruar me dokumentacionin teknik te kerkuar nga autoriteti kontraktor per materialet sa me siper. 14.OE nuk ka paraqitur grafikun e punimeve. 15.OE nuk ka shprehur dakordësi për mënyrën e financimit të projektit.
5	"F." SH.P.K.	87,093,842	*Kualifikuar*
6	BOE "Sh." – "Al." SH.P.K. & "O." SH.P.K.	83,951,496	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has. z. M. D. me nr. 11/1 datë 08.01.2024 është ngritur KVO e cila përbëhet nga Z. Sh. (kryetar), A .M. dhe Y. D. (anëtar). Në këtë tender kanë marrë pjesë 6 OE, janë kualifikuar 2 OE, dhe shpallur fitues BOE "Sh. – Al." SH.P.K. & "O." SH.P.K. me ofertë në vlerën **83,951,496 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **4,959,413 lekë.**
Është administruar dokumentacioni i OE fitues me shkresën nr. 39 prot., datë 18.11.2024.
Është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 3811/2 prot., datë 27.11.2024.
Është lidhur kontrata me nr. 3846 prot., datë 02.12.2024.

A.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret dhe konkretisht:

1. OE "O." SH.P.K., nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023 dhe këstet e maturuara të vitit 2024. Ky OE ka paraqitur vërtetim për likuidimin e detyrimeve në Bashkisë Tiranë, Kamëz dhe Krujë. OE rezulton se ka deklaruar si punime të ngjashme kontratat e lidhura me Bashkinë Has me objekt *"Rehabilitim kunete dhe bazamenti i kanalit përroi i Tershenes, segmenti rrugor Komisariat – Ujësjellës – Lumi Kruma, Bashkia Has"*, e realizuar përgjatë vitit 2023, kontratën me objekt *"Rehabilitim kunete dhe*

bazamenti i kanalit të betonit përroi i Tershenes, segmenti ish Ura e Ushtrisë, vazhdim drejt grykë Tershenes" e realizuar përgjatë vitit 2023. Pavarësisht se ky OE ka kryer punime pranë Bashkisë Has, rezulton se nuk ka hapur Nip-t sekondar, duke shmangur njëkohësisht detyrimet për taksat vendore pranë kësaj bashkie.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: Z Sh (kryetar), A. M. dhe Y. D. (anëtar).

5. Tenderi me objekt: "*Blerje karburant për nevojat e Bashkisë për vitin 2024*", me këto të dhëna:

<table>
<tr><td colspan="3">5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburant për nevojat e Bashkisë për vitin 2024"</td></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi :
Nr. 5, datë 06.02.2024</td><td rowspan="2">2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Nr. 11/2 datë 08.01.2024
1.A. B. - (Person përgjegjës)
2.N. P. - (Jurist)
3.E. S. - (Financier)</td><td rowspan="2">3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 11/1, datë 08.01.2024
1. Z. Sh. – (Zv. Kryetar)
2. A. M. - (Jursite)
3. Y. D. – (Sek.Urbanistik)</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur e Thjeshtuar"</td></tr>
<tr><td>5.Fondi Limit (pa TVSH)
8,875,000 - lekë pa TVSH</td><td>6.Oferta fituese:
OE "V. P." SH.P.K. me ofertë me marzh fitmi 11 lekë/ litër, me lidhje kontrate datë 02.08.2024, me afat 12 muaj.</td><td>7.Diferenca me fondin limit:
0 - lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
Data e zhvillimit: 21.02.2024</td><td>9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Has</td><td>10.Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës në tender 2 OE
b) Skualifikuar 0 OE,
c) Kualifikuar 2 OE</td></tr>
<tr><td>11.Ankimime AK,
Ka/Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK,
Ka/Nuk ka</td><td>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka</td></tr>
</table>

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has. z. M. D. me nr. 11/2 datë 08.01.2024, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga A. B., N. P. dhe E. S.
Me urdhër nr. 5, datë 06.02.2024 të Titullarit, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **8,875,000 lekë** me objekt**: *"Blerje karburant për nevojat e Bashkisë për vitin 2024".***
-Burimi i financimit është nga buxheti i Bashkisë Has, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.
Lidhur me përcaktimin e fondit limit, në dosje nuk disponohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me pikën 2 germa (ç) të të nenit 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2025 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, i cili përcakton se,

2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:
ç) vlerën dhe mënyrën e përllogaritjes së vlerës, në përputhje me parashikimet e LPP-së dhe parashikimet në këto rregulla;

dhe pikës 2 të nenit 76 të VKM-së nr. 285 cituar më sipër e cila përcakton se,

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Vlerësimi i kritereve
Hartimi dhe argumentimi i kritereve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin nr. e datës 08.02.2024 nga NJHDT dhe firmosur prej tyre, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan kritere jo në përputhje me objektin e procedurës.
1.Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST** e cila kërkon nga OE të paraqesë licencë për tregtim karburantesh të llojit III/A, rezulton jo në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", pika 2 germa (a), e cila përcakton se,

2. Licenca "Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse", me kodin VIII.1.A, përfshin tri llojet e veprimtarive, si më poshtë vijon: a) Lloji "A": tregtimi me shumicë i naftës bruto e nënprodukteve të saj të kategorive 0, II, III, IV e V, me përjashtim të nënprodukteve që destinohen për furnizimin e mjeteve të fluturimit ajror;

Sa më sipër, kjo licencë është për OE që tregtojnë me shumicë dhe jo me pakicë siç është objekti i procedurës objekt prokurimi.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 3 të nenit 40 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë A.B, N.P dhe E. S.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	"S." SH.P.K.	8,875,000	*Kualifikuar*
2	"V. P." SH.P.K.	11% marzh fitmi	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has. z. M. D. me nr. 11/1 datë 09.01.2023 është ngritur KVO e cila përbëhet nga Z. Sh. (kryetar), A. M. dhe Y. D. (anëtar). Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE, të cilët janë kualifikuar, dhe shpallur fitues OE "V. P." SH.P.K. me ofertë me marzh fitimi **11 lekë/litër**.
-Data e hapjes së ofertave është 21.02.2024. Mungon procesverbali i hapjes së ofertave dhe vlerësimi i tyre, sipas kërkesave të nenit 80 "Hapja e ofertave", pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, i cili ndër të tjera përcakton se, Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Personi përgjegjës për prokurimin, anëtar i njësisë së prokurimit është përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Mungon Raporti përmbledhës, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 84 të VKM-së nr. 285 cituar më sipër.

A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues, rezulton se përmbush kriteret e vendosura.

6. Tenderi me objekt: "*Blerje automjetesh*" Kamion vetëshkarkues, Rrul me vibrim hekur - gomë, me këto të dhëna:

6. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje automjetesh" Kamion vetëshkarkues, Rrul me vibrim hekur - gomë**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 15, datë 26.04.2024	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 11/2 date 08.01.2024 1.A. B. - (Person përgjegjës)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 11/1, datë 08.01.2024 1. Z. Sh. – (Zv. Kryetar)

4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur e thjeshtuar"	2.N. P. - (Jurist) 3.E. S. - (Financier)	2. A. M. - (Juriste) 3. Y. D. – (Sek.Urbanistik)
5.Fondi Limit (pa TVSH) 7,666,666 - lekë pa TVSH	6.Oferta fituese: OE "O." SH.P.K. me ofertë 7,600,000 - Lekë, me lidhje kontrate datë 13.06.2024, me afat 60 dite	7.Diferenca me fondin limit: 66,666 - lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 23.05.2024	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Has	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 3 OE **b)** Skualifikuar 2 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Ka/Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Ka/Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has, z. M. D. me nr. 11/1, datë 08.01.2024 është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga A. B., N. .P dhe E. S.
Me urdhër të Titullarit me nr. 15 datë 26.04.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **7,666,666 lekë** me objekt**: *"Blerje automjetesh"* Kamion vetëshkarkues, Rrul me vibrim hekur - gomë.**
- Referuar kësaj procedure, rezulton se janë kërkuar 2 mjete të cilat janë të tipeve të ndryshme. Duke u vendosur si pjesë e një procedurë të vetme për blerje mallrash, OE që disponojnë njërin nga mjetet, u pamundësohet marrja pjesë në procedurë për të paraqitur ofertat e tyre, pra duhet që procedura të ndahej me lote, ku çdo OE t'i mundësohej paraqitja e ofertës për secilin lot. Mos ndarja në lote, është veprim në kundërshtim me Nenin 2 "Qëllimi", Nenin 3 "Parime të përgjithshme" të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, Nenit 42 "Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote", Neni 74, pika 3 germa b "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës për prokurimet, zj. A. B.
- Burimi i financimit është nga buxheti i Bashkisë Has, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak me nr. 58, datë 29.01.2024 "Për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2024".
Në dosje gjendet një procesverbal i datës 23.04.2024, mbajtur nga NjP, sipas të cilit për përllogaritjen e FL janë bazuar në informacionin mbi çmimet e tregut si dhe referuar çmimeve të INSTAT. Nuk ka asnjë tregues tjetër të këtij testimi, duke mos përcaktuar njëkohësisht vlerën për secilin mjet që ka dal nga kjo përllogaritje, në kundërshtim me nenin 2, pika 2 germa (ç) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Vlerësimi i kritereve
Hartimi dhe argumentimi i kritereve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin e datës 09.05.2024 nga NJHDT dhe firmosur prej tyre, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

A. Lidhur me specifikimet teknike të vendosura, rezulton se për mjetin kamion vetëshkarkues 3 akse, është kërkuar që pesha. e mjetit të jetë 26000 kg. Përcaktimi fiks 26000 kg, është i papërshtatshëm, pasi së pari është përcaktuar një vlerë fikse e peshës së mjetit, ndërkohë që edhe përcaktimi i peshës së mjetit nuk është tregues/specifikim cilësor dhe që i shërben procedurës, pasi qëllimi kryesor i tij duhet të jetë kapaciteti mbajtës dhe jo pesha e tij. Ky specifikimin është në kundërshtim me nenin 36 pika të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

B. Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan kritere jo në përputhje me objektin e procedurës.
1.Kërkesa e pikës **2.3.2 e DST** e cila kërkon nga OE të ketë të punësuar staf inxhinierik 1 (një) Inxhinier Mekanik drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik, është kërkesë jo në përputhje me objektin e procedurës, pasi kontrata është për blerje mallrash, dhe jo shërbimesh.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 3 të nenit 40 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë A. B., N. P. dhe E. S.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	"S. 32." SH.P.K.	7,580,000	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.Operatori Ekonomik "S. 32." sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim. Për mjetin e ofertuar tip "Kamion" operatori ekonomik ka paraqitur vetëm Vërtetim përkthimi. Për këtë dokument mungon "Vërtetim Njësimi me Origjinalin" i dokumentit të përkthyer në gjuhen shqipe. Mjeti i ofertuar nuk është i targuar. Dokumenti i paraqitur në gjuhen shqipe nuk shoqërohet me asnjë dokument të origjinës me vule lidhëse nga noteri apo përkthyesi. 2.Për mjetin e ofertuar tip "Rrul me vibrim hekur gome" nuk është paraqitur asnjë dokumentacion i vlefshëm i cili tregon të dhënat teknike të mjetit të propozuar nga operatori ekonomik. Konkretisht mungon dokumenti i pronësisë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhen shqipe si gjuhe e ofertës. 3.OE nuk plotëson kriterin e pikës 2.2.2. OE nuk ka paraqitur Bilancin e vitit 2022 sipas përcaktimeve të DST. Bilanci i Vitit 2022 rezulton se janë paraqitur fotokopje, pa ngjyra, të pa njësuara me origjinalin fletët me numër rendor 4, 6, 10, 16, 18, 20, 22. Ky fakt e bën të pamundur nga ana e autoritetit kontraktor të vlerësoj drejtë dhe saktë bilancin për vitin 2022 dhe të dhënat e paraqitura në këtë bilance. Gjithashtu, në kundërshtim me parashikimet e germës "c" të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar, ky operator ekonomik nuk ka paraqitur Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar për bilancet e vitit 2022 dhe 2023. 4.OE nuk plotëson kriterin e pikës pika 2.*d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2.* Ky operator ekonomik ka paraqitur format të ndryshëm nga Dokumentet e Tenderit për Shtojcën Nr. 2. 5.OE nuk plotëson kriterin për 1 inxhinier mekanik. për plotësimin e këtij kriteri ka paraqitur një kontrate bashkëpunimi të nënshkruar me Z. A. B. Sipas certifikimit të paraqitur, rezulton se Z. A. B. ka përfunduar vetëm kursin 3 vjeçare në Sistemin e Edukimit në Distance, në profilin Logjistike Prodhimi. Pra, jo në Inxhinieri Mekanike, ashtu siç është parashikuar në Kërkesat për Kualifikim nga AK. Për më tepër, ky operator ekonomik nuk ka arritur të provoj

			se Z. B. është drejtues teknik në licencën e shoqërisë, pasi nuk ka paraqitur këtë dokument. Ne CV e Z. B. rezulton e deklaruar se është "i punësuar pranë Servis B" duke filluar nga viti 2014 e deri tani. Kjo na bën të dyshojmë se nëse Z. B. është i punësuar në një subjekt tjetër të ndryshëm nga shoqëria "S. 32." sh.p.k. atëherë ai nuk mund të jetë Drejtues Teknik në këtë subjekt.
2	"A. M." SH.P.K.	7,640,000	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* OE nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e Kritereve për Kualifikim.
3	"O." SH.P.K.	7,600,000	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has. z. M. D. me nr. 11/1 datë 08.01.2024 është ngritur KVO e cila përbëhet nga Z .Sh. (kryetar), A. M. dhe Y. D. (anëtar). Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE, është kualifikuar 1 OE, dhe konkretisht i shpalluri fitues OE "O." SH.P.K. me ofertë në vlerën **7,600,000 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **66,666 lekë.**
-Data e hapjes së ofertave është 24.05.2024. Vlerësimi i tyre është bërë me datë 27.05.2024.
Është administruar dokumentacioni me shkresën nr. ekstra prot., datë 03.06.2024.
Është mbajtur raporti përmbledhës me nr. 1895 prot., datë 10.06.2024 i miratuar nga Titullari.
Është lidhur kontrata me nr. 1954 prot., datë 13.06.2024 me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Me urdhër nr. 12, datë 02.07.2025 është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave i përbërë nga I. M., A. R. dhe A. P.
Me procesverbalin e datës 11.07.2025 është bërë akti i marrjes në dorëzim të mallrave.
Është lëshuar fatura tatimore me nr. 18/2024, datë 24.06.2024, likuiduar me USH nr.347, datë 08.07.2024 dhe nr. 412, datë 02.09.2024.

A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur të OE fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret dhe konkretisht:
1. OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.2.2 për dokumentacionin shoqërues të mjetit Rrul me vibrim hekur – gomë, konkretisht skedat/katalogët e paraqitur, pasi i gjithë dokumentacioni sa sipër është në gjuhë të huaj të papërkthyer. Në Kriteret e Përgjithshme Kualifikuese përcaktohet qartë se *Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.*
Veprimet janë në kundërshtim me nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 dhe nenin 98 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika 1 germa (b) të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: Z. Sh. (kryetar), A. M. dhe Y. D. (anëtar).

<u>Inventarizimi i dosjeve</u>
- Lidhur me dosjen e procedurave të mësipërme, rezultojnë të pa inventarizuara dhe pa numerizimin përkatës, në kundërshtim me *Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,* neni 21 dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8 germa (g) ku citohet se:

"...Organizimi i brendshëm i dosjes (sistemin) përfshin renditjen e dokumenteve brenda dosjes sipas disa kritereve që janë të njëjta me ato të krijimit të njësisë së ruajtjes. Kriteri i objektit përdoret kur dosja është krijuar me koncept të gjerë dhe dokumentet grupohen me nënçështjeje. Kur volumi i dokumenteve është i konsiderueshëm dhe ka të bëjë me emra personash, përdoret edhe kriteri alfabetik, më pas bëhet

numërimi i dokumenteve. Të gjitha fletët e dosjes (përveç fletëve të bardha) numërohen me laps të zi grafiti në këndin e djathtë, pa cenuar tekstin".

(Më hollësisht trajtuar në Akt Konstatimin nr. 10, datë 04.05.2026)

Rastet e shkeljeve sipas procedurave të vitit 2025 paraqiten si vijon:

7. Tenderi me objekt: "*Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Sejdi Dida", Krumë*", me këto të dhëna:

7. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Sejdi Dida", Krumë"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 31, datë 31.07.2025	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 48 date 17.03.2025 1.E. R.- (Person përgjegjës) 2.A.G. - (Jurist) 3.E .S. - (Financier)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 49, datë 26.06.2025 1. Z. Sh. – (Zv. Kryetar) 2. R. R .- (Juriste) 3. Y. D. – (Sek.Urbanistik)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"		
5.Fondi Limit (pa TVSH) 125,968,569 - lekë pa TVSH	6.Oferta fituese: BOE "2Z.C." SH.P.K. & "A.-2A.C." SH.P.K. me ofertë 119,780,675- Lekë, me lidhje kontrate datë 13.10.2025 me afat 12 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 6,187,894 - lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 03.09.2025	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit & Buxheti i Bashkisë Has	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 5 OE **b)** Skualifikuar 4 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Ka/Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Ka/Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has, z. M. D. me nr. 48, datë 17.03.2025 është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga E. R., A. G. dhe E. S.

Me urdhër të Titullarit me nr. 31 datë 31.07.2027, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **125,968,569 lekë** me objekt**: *"Rikonstruksion i shkolles 9-vjeçare "Sejdi Dida", Krumë".***

- Burimi i financimit është nga Buxheti i Shtetit dhe Buxhetit i Bashkisë Has miratuar dhe bazuar në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me Nr. 2174/1 Prot, date 09.04.2025 "Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objekte shkollore të arsimit para universitar dhe programit për Sportin", si dhe ne Vendimin e Këshillit Bashkiak "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB-në "Për Miratimin e PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit për vitin 2025".

Vlera e plotë e projektit është në vlerën 151,162,283 lekë, nga të cilat 22,674,342 lekë është pjesa që do financohet nga NJQV (15% e projektit).

Për vitin 2025 planifikohen të likuidohen 30,232,457 lekë me TVSH dhe për vitet 2026 – 2027, planifikohen 120,929,826 lekë me TVSH.

Me urdhër nr. 1900 prot., datë 09.06.2025 të Titullarit, është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe llogaritjen e fondit limit i përbërë nga N.B., A. U dhe E. S.

Ky komision, ka hartuar një procesverbal të datës 13.08.2025 sipas të cilit për përllogaritjen e fondit limit, janë bazuar në çmimet e vendosura sipas manualit të tenderimit, përcaktuar në VKM nr. 216., datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimit e manualit të çmimeve për zërat e punimeve nga projektuesi shoqëria "2 ED." SH.P.K. me datë 13.082025 nga sistemi i integruar i çmimeve me e-Albania.

- Është kryer Oponenca Teknike, përcjellë Bashkisë Has me shkresën nr. 752/2 prot., datë 30.06.2025 nga Instituti i Ndërtimit.

- Me vendimin nr. 52, datë 15.12.2025 “Për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh”, është miratuar deklarata për kryerje punimesh.

Vlerësimi i kritereve

Hartimi dhe argumentimi i kritereve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin e datës 26.09.2025 nga NJHDT, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

A. Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan kritere jo në përputhje me objektin e procedurës.

1. Kërkesa e pikës **2.3.2 e DST** e cila kërkon ndër të tjera kategorinë e licencës NP-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit), nuk është në përputhje me objektin. Nga analiza e preventivit, specifikimeve teknike dhe zërave të punimeve nuk rezulton të parashikohen punime specifike të inxhinierisë së mjedisit, rehabilitimit mjedisor apo veprave të tjera që kërkojnë disponimin e kësaj licence të specializuar.

2. Kërkesa e pikës **2.3.3.a e DST** e cila kërkon nga OE 50 punonjës për periudhën e 3 muajve të fundit, është kërkesë e paargumentuar teknikisht. Gjithashtu, kërkesa që punonjësit të figurojnë 3 muajt e fundit në listëpagesa nuk është në përputhje me 39, pika 6 germa (ç) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar e cila përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore, pa përcaktuar afate se kur duhet të figurojnë në listëpagesa. Vendosja e një kriteri të tillë krijon barriera të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, veçanërisht për subjektet që kanë mundësi të sigurojnë fuqinë e nevojshme punëtore në momentin e zbatimit të kontratës.

3. Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon nga OE të kenë pjesë të stafit drejtues teknik 10 inxhinierë, është numër relativisht i lartë, pasi edhe objekti është rikonstruksion i objektit ekzistues dhe jo ndërtim i ri. Kërkesa për 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier ndërtimi profili strukturist janë të dublikuara, pasi do mjaftonte njëri prej tyre. Kërkesa për 1 inxhinier mjedisi është jo në përputhje me objektin, pasi nuk ka asnjë proces pune që lidhet me inxhinierinë e mjedisit. Kërkesa për 1 arkitekt nuk përputhet me objektin, pasi projekti është i miratuar dhe i jepet për zbatim inxhinierit të ndërtimit. Për rrjedhojë, kërkesa për një arkitekt nuk argumentohet me detyra specifike, të veçanta apo shtesë që do të kryhen gjatë fazës së zbatimit të kontratës.

4. Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST** e cila kërkon stafin teknik të nevojshëm për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera të plotësohen edhe të dhënat sipas tabelës së më poshtme:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesit ne certifikate / diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certefikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi është institucion privat)
1					
2					

Kjo kërkesë është e tepërt, pasi për stafin e kërkuar, përcaktohet qartë plotësimi nëpërmjet Formularit të Vetëdeklarimit, i cili është edhe mënyra e përcaktuar në rregullat e LPP. Nuk është kriter që i shërben procedurës.

5.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST** e cila kërkon nga OE ndër të tjera edhe 1 rimorkiator në pronësi ose me qira, duhej të mundësohej edhe nëpërmjet kontratës së shërbimit, pasi rimorkiatori nuk është mjet që shërben drejtpërdrejtë në procesin e punës.

6.Kërkesa e pikës **2.3.9 e DST** e cila kërkon nga OE 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni e vendosur jo më larg se 40 km nga objekti (në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi), është kërkesë e paargumentuar lidhur me distancën e përcaktuar prej 40 km. Autoriteti kontraktor nuk ka paraqitur

argumente teknike, specifika të veçanta të punimeve apo kushte të tjera objektive që të provojnë se furnizimi me beton nuk mund të realizohet në mënyrë efektive nga impiante të vendosura përtej kësaj distance. Cilësia, koha e transportit dhe parametrat teknikë të betonit mund të garantohen nëpërmjet teknologjive të prodhimit, mjeteve të transportit dhe masave të kontrollit të cilësisë, pavarësisht vendndodhjes së impiantit, për sa kohë respektohen kërkesat e projektit dhe standardet teknike në fuqi.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi anëtarët e NJP E R, A. G. dhe E. S.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	"N." SH.P.K.	125,813,702	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.Nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës. 2.Në Formularin Përmbledhës te Vetedeklarimit sipas Shtojca 8, operatori ekonomik nuk ka deklaruar se disponon Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist 1 (nje), Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik 1 (nje), Teknik Elektronik 1 (një), Elektricist 1 (një), Punonjës Gipsi 1 (nje), Specialist Dur Alumini 1 (një), Marangoz 1 (nje), Automakinist 1 (një), punonjës të trajnuar për punime në lartësi 1 (një). 3. Ne Formularin Përmbledhës te Vetedeklarimit sipas Shtojca 8, operatori ekonomik nuk ka deklaruar se disponon Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton 2 (dy) cope, Kamionçina me kapacitet mbajtëse 3.5 - 5 ton 2 (dy) cope, Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma) 1 (një) cope. 4. Operatori ekonomik per materialet Bojërat dhe Gipsin, Materialet e termoizolimit, hidroizoluese, Materialet Elektrike, Materialet Hidraulike, Makineri dhe Pajisjet e Kondicionimit nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Operatori ekonomik për materialet Kaldaje çeliku, Element radiatori alumin, Tub Cu te përkulshëm me termoizolim, Instalimet e sistemit te ajrit për ventilimin dhe rrjeti i shpërndarjes se tubave, Dritare plastike nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor.
2	"Z." SH.P.K.	125,826,204	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Shoqëria "Z." sh.p.k. ne Formularin Përmbledhës te Vetëdeklarimit sipas Shtojca 8, nuk ka deklaruar se disponon Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik 1 (një), Inxhinier Elektronik 1 (nje), Teknik Elektronik 1 (një), Bojaxhi 1 (një), Hidroizolues 1 (nje), Punonjës Gipsi 2 (dy), Punonjës Fasade 1 (një), Specialist Dur Alumini 2 (dy), Specialist kondicionimi 1 (nje), Marangoz 1 (një), punonjës të trajnuar për punime në lartësi 2 (dy). 2. Ne Formularin Përmbledhës te Vetëdeklarimit sipas Shtojca 8, operatori ekonomik nuk ka deklaruar se disponon Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton 2 (dy) cope. Operatori ekonomik për materialet Bojërat dhe Gipsin, Materialet e termoizolimit, hidroizoluese, Materialet Elektrike, Materialet Hidraulike, Makineri dhe Pajisjet e

			Kondicionimit nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. 3. Operatori ekonomik per materialet Kaldaje çeliku, Element radiatori alumin, Tub Cu te përkulshëm me termoizolim, Instalimet e sistemit te ajrit për ventilimin dhe rrjeti i shpërndarjes se tubave, Dritare plastike nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur grafikun e punimeve.
3	"Xh." SH.P.K. & "B.-I ."SH.P.K.	115,865,693	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Shoqëria "Xh." SH.P.K. nuk disponon Licence e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B "Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte". Referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër realizimin e zërave transport mbeturinash nga prishje te brendshme, transport dheu me auto deri 5 km etj. Ne Marrëveshjen e Bashkëpunimit, Neni 2 Kushtet e Kontratës palët kane parashikuar: Bashkimi i Operatoreve Ekonomike Shoqëria "B.-I." sh.p.k. & Shoqëria "Xh." sh.p.k. & "I./ D." sh.p.k. Për shoqërinë "I. / D." sh.p.k. nuk është paraqitur asnjë dokumentacion për këtë procedure prokurimi. Ne marrëveshjen e bashkëpunimit është përcaktuar se kjo marrëveshje lidhet me qellim pjesëmarrjen ne procedurën e prokurimit qe do te zhvillohet me date 25.08.2025, kurse ne fakt procedura e prokurimit është zhvilluar me date 03.09.2025, Neni 1 Objekti dhe Qëllimi i Kontratës. 2. Operatoret ekonomike kane bere ndërhyrje ne preventivin e prokuruar nga autoriteti kontraktor, duke ndryshuar sasitë e prokuruara, konkretisht, për zërin e punimeve F.V Hidrantë etj. nga 6 cope te prokuruara nga autoriteti kontraktor janë deklaruar 140 cope për tu realizuar nga shoqëria Xh sh.p.k. Gjithashtu, per zërin e punimeve F.V. Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 1" x 9 mm, i veshur me flete PVC, shoqëria "Xh." sh.p.k. ka deklaruar se do te realizoj 130 cope, kurse autoriteti kontraktor ka prokuruar 122 cope. etj. Pra, oferta ekonomike e paraqitur nga BOE "Xh." sh.p.k. & "B.-I." sh.p.k. nuk plotëson kriteret për ligjshmërinë e vlefshmërisë se saj. 3. Shoqëria "Xh." sh.p.k. ne Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate" nuk ka deklaruar numrin e punonjësve qe disponon për muajin Korrik 2025. Procedura e prokurimit është zhvilluar me date 03.09.2025 dhe muaji Korrik 2025 ka afatin maksimal te deklarimit ne organet tatimore brenda datës 20 Gusht 2025, pra para datës se zhvillimit te procedurës se prokurimit. 4. Shoqëria "Xh." sh.p.k. ne Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, nuk ka përcaktuar gjeneralitetet e plota te administratorit/ortakut te shoqërisë. 5. Shoqëria "B.-I." sh.p.k. ne Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 nuk ka përcaktuar cili nga anëtarët e bashkimit te operatoreve ekonomik do te jete

			përfaqësuesi, duke deklaruar 2 anëtarët e bashkimit si përfaqësues. Pra, nuk ka përcaktuar drejt rolin qe ka ne këtë bashkim operatoresh ekonomik secili nga anëtarët e tij pjesëmarrës. 6. Shoqëria "Xh." sh.p.k. për plotësimin e kriterit "pune te ngjashme", ka paraqitur dokumentacion për kontratën me objekt "Vilat e Kompleksit Dardania ne Tale nga C11 – C44". Kjo kontrate rezulton se është realizuar nga shoqëria "Xh." sh.p.k. ne cilësinë e nënkontraktorit për shoqërinë "M. I." sh.p.k. e cila rezulton ne cilësinë e kontraktorit, referuar dokumentacionit shoqërues Proces Verbal Marrje ne Dorezim Objekti etj. Situacioni përfundimtar i punimeve rezulton se nuk është firmosur nga Mbikëqyrësi i Punimeve, ne kundërshtim me Ligjin nr.8402 datë 10.9.1998 "Kontrolli dhe disiplinimi i Punimeve te Ndërtimit". Sipas kontratës se sipërmarrjes rezulton se afati i realizimit te punimeve është 11 muaj (Neni 3), kurse sipas Formularit te Vlerësimit dhe dokumentacionit shoqërues rezulton se afati i punimeve ka zgjatur me shume se 24 muaj. Për këtë mungon amendamenti i kontratës për shtyrjen e afatit te punimeve. Gjithashtu ne kontratën e sipërmarrjes është bashkëlidhur preventivi i punimeve me çmimet përkatëse, kurse ne situacionin përfundimtar janë vendosur zëra te tjerë te punimeve me çmime te ndryshuara nga preventivi fillestare. Leje për kryerje punimesh është paraqitur fotokopje pa ngjyra, jo ne formën e kërkuar nga ligji. Gjithashtu, ne kërkesat për kualifikim, autoriteti kontraktor ka kërkuar se: …. për punët e ngjashme të realizuara si nenkontraktor duhet të paraqitet edhe kontrata e nën kontraktimit ku përcaktohen zërat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit. 7.Shoqëria "Xh." sh.p.k. nuk ka deklaruar ne Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 se disponon inxhinier elektronik drejtues teknik, referuar tabelës për ndarjen e punimeve rezulton se ka marr përsipër realizimin e zërave te punimeve për te cilët është e domosdoshme prania e inxhinierit elektronik, konkretisht F.V Njësi e brendshme VRF kasete 4-rruge 90x90 cm, Fuqi Ftohje 7.1 kË dhe ne Ngrohje 8.0kË;R32-R410A Dim:258x950x950 mm, F.V Kapaku i njësisë se brendshme kasete 4-rruge për seritë PLP etj. 8.Gjithashtu, ky operator ekonomik nuk ka deklaruar se disponon staf inxhinierik drejtues teknik Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist, Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik dhe Arkitekt megjithëse ka marr përsipër realizimin e punimeve për te cilat është e domosdoshme prania e tyre. 9. Shoqëria "Xh." sh.p.k. për drejtuesin teknik te objektit Ing. L. M. nuk ka deklaruar se disponon dokumentacionin Librezë pune; Kontratë pune e vlefshme; Diplomë. -Bashkimi i operatoreve ekonomik Shoqëria "B.-I." sh.p.k. & "Xh." sh.p.k. nuk disponon Teknik Elektronik diplome shkolle e mesme. Shoqeria "Xh." sh.p.k. ka deklaruar B. E. e cila rezulton me profesion inxhiniere. 11.Bashkimi i operatoreve ekonomik Shoqëria "B.-I." sh.p.k. & "Xh." sh.p.k. nuk disponon Teknik Gjeometër/Topograf diplome shkolle e mesme. Shoqeria "B.-IS." sh.p.k. ka deklaruar E. A. cila rezulton me profesion inxhiniere.

			- Shoqëria “Xh” sh.p.k. nuk disponon asnjë punonjës te kualifikuar me profesionin hidraulik, referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër realizimin e zërave te punimeve Tub kanalizimi pvc, Tub PVC me gote dhe gomine etj. - Shoqëria “Xh.” sh.p.k. nuk disponon asnjë punonjës te kualifikuar me profesionin Suvatues/murator, referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër realizimin e zërave te punimeve Suvatim muri nga brenda, Suvatim tavani, Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva., Veshje fasade me pllake terakote, etj. - Shoqëria “Xh.” sh.p.k. nuk disponon asnjë punonjës te kualifikuar me profesionin pllakashtrues, referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër realizimin e zërave te punimeve Shtrese me pllaka grez porcelanato, Shtrese pllaka gres porcelan (WC) dhe veshje muri, Shtrese me pllaka graniti t=3cm etj. - Shoqëria “Xh.” sh.p.k. nuk disponon asnjë punonjes te kualifikuar me profesionin bojaxhi, referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr persiper realizimin e zerave te punimeve Lyerje me boje hidroplastike cilesi e larte (Lyerje muri brenda), Lyerje me boje hidroplastike cilesi e larte (Lyerje tavani) etj. - Shoqëria “Xh.” sh.p.k. nuk disponon asnjë punonjës te kualifikuar me profesionin hidroizolues, referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër realizimin e zërave te punimeve Hidroizolim me emulsion dhe 2 duar bitum per dyshemene, Hidroizolim me emulsion dhe 2 bitum ËC dysheme dhe 70 cm mur etj. - Shoqëria “Xh.” sh.p.k. nuk disponon asnjë punonjës te kualifikuar me profesionin punonjës gipsi, referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër realizimin e zërave te punimeve Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm ne ËC. - Shoqëria “Xh.” sh.p.k. nuk disponon asnjë punonjës te kualifikuar me profesionin punonjës fasade, referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër realizimin e zërave te punimeve Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva, Veshje fasade me pllake terakote. - Shoqëria “Xh.” sh.p.k. nuk disponon asnjë punonjës te kualifikuar me profesionin saldator, referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër realizimin e zërave te punimeve saldimi. - Shoqëria “Xh.” sh.p.k. nuk disponon asnjë punonjës te kualifikuar me profesionin specialist kondicionimi, referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër realizimin e zërave te punimeve F.V Tub bakri i termoizoluar për instalim pajisje kondicionimi, MAKINERI DHE PAJISJE KONDICIONIMI (HVAC) etj. - Shoqëria “B.-I.” sh.p.k. nuk disponon asnjë punonjës te kualifikuar me profesionin specialist IT, referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër realizimin e zërave te punimeve Instalimi I sinjalizimit akustik, Instalimi i Telefonisë dhe Internetit etj. - Shoqëria “B.-I.” sh.p.k. nuk disponon asnjë punonjës te kualifikuar me profesionin marangoz, referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër realizimin e zërave te punimeve përkatës.

			10. Asnjeri nga anëtarët e bashkimit te operatoreve ekonomike veç e veç apo edhe bashkërisht nuk ka arritur te deklaroje se disponon 3 (tre) punonjës ne lartësi. Shoqëria "Xh." sh.p.k. ka marr përsipër realizimin e punimeve ne lartësi, por nuk ka deklaruar se disponon punonjës ne lartësi. Xh.T. është deklaruar nga shoqëria "B.-I." sh.p.k. si suvatues. Punonjësi K. M. është deklaruar nga shoqëria "B.-I." sh.p.k. si bojaxhi. Punonjësi D. M. është deklaruar nga shoqëria "B.-I." sh.p.k. si elektricist. 11. Bashkimi i operatoreve ekonomik "Xh." sh.p.k. & "B.-I." sh.p.k. nuk plotëson kriterin për disponimin e mjetit Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma) – cope 1. Nga 2 qe ka kërkuar autoriteti kontraktor, është paraqitur vetëm 1 mjet me dokumentacion te rregullt nga shoqëria "B.-I." sh.p.k. 12. Bashkimi i operatoreve ekonomik "Xh." sh.p.k. & "B.-I." sh.p.k. nuk plotëson kriterin per disponimin e mjetit Autovinç me Kosh, kjo pasi për mjetin me targa AB638JV nuk është përcaktuar kohëzgjatja e kontratës se qirasë. 13. Shoqëria "B.-I." sh.p.k. nuk ka deklaruar ne Formularin Përmbledhës te Vetedeklarimit sipas shtojca 8 kontratën e furnizimit me shoqëria "K. I." sh.p.k. Kontrata e furnizimit Nr. 141 Prot., date 01.09.2025 me shoqërinë S. – G. C. P. A. sh.p.k. nuk është deklaruar ne Formularin Përmbledhës te Vetedeklarimit sipas shtojca 8. Kjo kontrate është lidhur vetëm me shoqërinë "Xh." sh.p.k. kurse shoqëria "B.-I." sh.p.k. referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër punime bojëra dhe gipse. Kontrata e furnizimit Nr. 145 Prot. date 02.09.2025 me shoqërinë "D." sh.p.k. nuk është deklaruar ne Formularin Përmbledhës te Vetedeklarimit sipas shtojca 8. Kjo kontrate është lidhur vetem me shoqerine "Xh." sh.p.k. kurse shoqëria "B.-I." sh.p.k. referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër punime termoizolimi, hidroizolimi. Kontrata e furnizimit Nr. 142 Prot. date 02.09.2025 me shoqërinë "M.-E." sh.p.k. nuk është deklaruar ne Formularin Përmbledhës te Vetedeklarimit sipas shtojca 8. Kjo kontrate është paraqitur fotokopje, jo origjinale, e lidhur vetëm me shoqërinë "Xh." sh.p.k. i gjithë dokumentacioni është paraqitur ne gjuhe te huaj, jo ne shqip. Shoqëria "B.-I." sh.p.k. referuar tabelës se ndarjes se punimeve ka marr përsipër punime termoizolimi, hidroizolimi. Kontrata e furnizimit me furnitorin shoqëria "D." sh.p.k. me date 03.09.2025 nuk është deklaruar ne Formularin Përmbledhës te Vetedeklarimit sipas shtojca 8 nga asnjeri prej anëtarëve te bashkimit te operatoreve ekonomike. Për me tepër është paraqitur si përfaqësues i BOE Z. M. I., për te cilin nuk është paraqitur asnjë prokure përfaqësimi. Kontrata e furnizimit me furnitorin shoqëria "I. G." sh.p.k. me date 03.09.2025 nuk është deklaruar ne Formularin Përmbledhës te Vetedeklarimit sipas shtojca 8 nga asnjeri prej anëtarëve te bashkimit te operatoreve ekonomike. Për me tepër është paraqitur si përfaqësues i BOE Z. M. I., për te cilin nuk është paraqitur asnjë prokure përfaqësimi. 14. Mungon certifikate iso 9001 për prodhuesin. Shoqëria "B.-I." sh.p.k. dhe "Xh." sh.p.k. nuk ka deklaruar ne Formularin Përmbledhës te Vetedeklarimit sipas shtojca 8

			kontratat e furnizimit për materialet. Mungon certifikate iso 9001 për prodhuesit E, Fondital, Isoclima. Për materialet Dritare plastike është paraqitur autorizim nga shoqëria E sh.p.k. per te cilën nuk është paraqitur dëshmi te testimeve zyrtare, certifikate iso 9001 për prodhuesin.
4	"2Z.C." SH.P.K. & "A-2A C."	119,780,675	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has. z. M. D. me nr. 49 datë 26.06.2025 është ngritur KVO e cila përbëhet nga Z. Sh. (kryetar), R. Rdhe Y. D (anëtar). Në ketë tender kanë marrë pjesë 4 OE, është kualifikuar 1 OE, dhe shpallur fitues BOE "2Z.C." SH.P.K. & "A. & 2A. C." SH.P.K. me ofertë në vlerën **119,780,675 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **6,187,894 lekë.**
- Data e hapjes së ofertave është 03.09.2025. Vlerësimi i tyre ka përfunduar me datë 17.09.2025, në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 8 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirin e lartë monetar.
Dokumentacioni është dorëzuar pranë AK me shkresën nr. 3387 prot., datë 23.09.2025.
Është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 3683 prot., datë 13.10.2025.
Është lidhur kontrata me nr. 3675 prot., datë 13.10.2025.

A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret dhe konkretisht:

1. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për detyrimet për taksat dhe tarifat vendore.
- OE "2Z.C." SH.P.K., nuk ka paraqitur vërtetimin për këstet e maturuara për vitin 2025 për taksave vendore në bashkitë Kurbin, Tiranë, Kamëz dhe Konispol si dhe pagesën e taksave për vitin 2024 në bashkinë Prrenjas, në të cilët ka ushtruar dhe ushtron aktivitet për vitet 2024 – 2025;
- OE "A. 2A. C." SH.P.K., nuk ka paraqitur vërtetimet për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 në bashkitë Mallakastër, Kavajë, Dimal dhe Lezhë, ndërkohë që ushtron aktivitet pranë këtyre bashkive sipas ekstraktit të QKB.

2. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.10 të DST**. Për bojërat dhe gipsin dhe materialet hidraulike, mungojnë certifikatat ISO 9001 të prodhuesit.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 dhe nenin 98 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika 1 germa (b) të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: Z .Sh. (kryetar), R. R dhe Y. D (anëtar).

8. Tenderi me objekt: "*Rehabilitim dhe Sistemim i Përroit të Tërshënës*", me këto të dhëna:

8. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitim dhe Sistemim i Përroit të Tërshënës"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 21, datë 14.05.2025	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 48 date 17.03.2025 1.E. R.- (Person përgjegjës) 2.A. G. - (Jurist) 3.E .S. - (Financier)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 49, datë 26.06.2025 1. Z. Sh. – (Zv. Kryetar) 2. R. R - (Juriste) 3. Y. D – (Sek.Urbanistik)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur e thjeshtuar"		
5.Fondi Limit (pa TVSH) 4,833,333 - lekë pa TVSH	6.Oferta fituese: OE "Sh.-Al." SH.P.K. me ofertë 4,787,950 - Lekë, me lidhje kontrate datë 09.07.2025 me afat 60 ditë.	7.Diferenca me fondin limit: 45,383 - lekë pa TVSH

8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 05.06.2025	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Has	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 5 OE **b)** Skualifikuar 4 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Ka/Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Ka/Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has, z. M. D. me nr. 48, datë 17.03.2025 është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga E .R, A. G dhe E .S.
Me urdhër të Titullarit me nr. 21 datë 14.05.2021, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **4,833,333 lekë** me objekt**: *"Rehabilitim dhe Sistemim i Përroit të Tërshënës".***
- Burimi i financimit është nga Buxheti i Shtetit dhe Buxhetit i Bashkisë Has miratuar me vendimin nr. 137, datë 23.12.2024. Me shkresën nr. 126 prot., datë 16.04.2025 të Kryetarit të Bashkisë Has *Kërkesë për Risistemim Buxheti brenda programit,* i është drejtuar Degës së Thesarit Has për risistemim të llogarive, ku hiqet objekti i prokurimit me objekt *Rehabilitim kunete Lumi Krumë,* dhe shtohet objekti i prokurimit *Rehabilitim dhe sistemim i përroit të Tershenes.*
Preventivi i punimeve është bërë nga studio projektuese "M.C.E." SH.P.K.. Nuk administrohet mënyra e përftuar e këtij projekti.

Vlerësimi i kritereve
Hartimi dhe argumentimi i kritereve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin e datës 22.05.2025 nga NJHDT, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

A. Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan kritere jo në përputhje me objektin e procedurës.
1. Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon nga OE të kenë pjesë të stafit drejtues teknik 3 inxhinierë drejtues teknik në licencën e shoqërisë, është numër relativisht i lartë në raport me volumin, vlerën dhe tipologjinë e punimeve.
Gjithashtu, në vijim kërkesa për përcaktimin e drejtuesit teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës, është kërkesë në kundërshtim me pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" i cili përcakton se,

2.1. Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

Vlera e investimit është 7 herë me vogël për të kërkuar drejtuesin teknik në kantier.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi anëtarët e NJP E. R, A.G dhe E. S.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	"RR. G."SH.P.K.	4,747,050	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. OE nuk plotëson, kriteret e veçanta për kualifikim, pika, 2.2.2. Bilanci i vitit 2024 nuk është i konfirmuar nga Administrata Tatimore.

			2. OE nuk plotëson, kriteret e veçanta për kualifikim, pika, 2.3.2. Ky operator ekonomik ka paraqitur Licencën e zbatimit NZ. 5958/7 e cila është e vlefshme deri me date 07.03.2025. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit është data: 05/06/2025. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 60 Ditë nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit. Kjo licence nuk është e vlefshme për këtë procedure prokurimi. 3. OE nuk plotëson, kriteret e veçanta për kualifikim, pika, 2.3.6. Ne formularin e vetedeklarimit shtojca 8, nuk ka shënuar nëse disponon makineri e mjete. Gjithashtu, nuk ka deklaruar se disponon "Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 Ton" – 1 cope. Ka deklaruar se disponon Prozhektorë ndriçimi natën 2 cope, kurse ne kërkesat per kualifikim autoriteti kontraktor ka kërkuar minimum 3 cope. Ka deklaruar se disponon Komplet i ndihmës së shpejtë 4 cope, kurse ne kërkesat për kualifikim autoriteti kontraktor ka kërkuar minimum 5 cope.
2	"T.&J.C." SH.P.K. & "M." SH.P.K.	4,421,500	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.BOE nuk plotëson, kriteret e veçanta për kualifikim, pika, 2.3.2. Asnjeri nga anëtarët e bashkimit te operatoreve ekonomike nuk disponon licencën e zbatimit për kategoritë: N.P. – 5 A Punime nëntokësore, ura e vepra arti; N.P. – 9 A Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikimi; 2.BOE nuk plotëson, kriteret e veçanta për kualifikim, pika, 2.3.6. Bashkimi i Operatoreve ekonomik nuk plotëson kriterin për disponimin e mjetit ekskavator me goma, pasi nuk kane deklaruar ne formularin e vetedeklarimit shtojca 8 te dhënat e mjetit , te tilla si targa e mjetit, numri i lejes se qarkullimit, numri i Shasisë etj. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mësipërme, mjete të cilat i ka deklaruar në Formularin e vetëdeklarimit por që janë pa targa. Referuar nenit 47 "Kifikimi i mjeteve rrugore" pika 1, e ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet: 1."Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod", Kifikohen si vijon: k) mjete teknologjike Ne nenin 58, pika 1 dhe 2, parashikohet: 1."Mjetet teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë".2. "Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, mjetet teknologjike ndahen në: a) mjete që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut". Ndërsa në nenin 113 pika 2 e këtij ligji parashikohet: "Për të qarkulluar në rrugë mjetet teknologjike me goma, duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit". Në VKM Nr.153 datë 07.04.2000 "Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në nenin 282 "Regjistrimi dhe vendosja e targës e makinave (Neni 113 i Kodit Rrugor)", pika 1, parashikohet: "Makinat, te cilat lejohen të qarkullojnë ne rruge sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen

			pranë degës se DRShTRr-se rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes se qarkullimit dhe të targës të atij që deklarohet pronar i mjetit." Referuar pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe kreut V, seksioni III, neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku citohet: AK kërkon mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën" si dhe bazuar ne përcaktimet ligjore te ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Njësia e Prokurimit është shprehur qartazi ne kërkesat e DST për llojin e mjetit qe kërkon, ne mënyrë qe plotësimi i kësaj pike te mos jete konfuze për OE. (Referuar Vendimit 225/2023 te KPP).
3	"D.C." SH.P.K.	3,714,360	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. OE nuk plotëson, kriteret e veçanta për kualifikim, pika, 2.3.6. nuk plotëson kriterin për disponimin e mjetit ekskavator me goma, pasi nuk ka deklaruar ne formularin e vetedeklarimit shtojca 8 te dhënat e mjetit, te tilla si targa e mjetit, numri i lejes se qarkullimit, numri i Shasisë etj. 2. Operatori ekonomik nuk plotëson, kriteret e veçanta për kualifikim, pika, 2.3 Kapaciteti Teknik 2.3.1. Për plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik ka paraqitur kontratën me objekt "Rehabilitimi i kanalit Shtoder (vazhdim)". Për këtë kontrate, nuk është paraqitur kontrata e nën kontraktimit pas shpalljes fitues te operatoreve ekonomike, sipas kontratës se sipërmarrjes me date 01.11.2023, por është paraqitur kontrata para pjesëmarrjes ne procedurën e prokurimit. Mungon shkresa mbi miratimin zyrtare te nënkontraktonit. Sipas kontratës baze te sipërmarrjes pagesat dhe faturat do te lëshohen nga përfaqësuesi i BOE "S." SH.P.K., kurse shoqëria "D. C." SH.P.K. ka paraqitur faturat e lëshuara për Bordin e Kullimit ne kundërshtim me përcaktimet ligjore. Ky operator ekonomik, ka paraqitur faturat tatimore fotokopje. Referuar akt kolaudimi dhe certifikatës për marrjen ne dorëzim te punimeve, është paraqitur "D. C." SH.P.K. si sipërmarrësi i punimeve, ndërkohë rezulton se është nënkontraktor.
4	"O." SH.P.K.	4,067,500	*S'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Operatori ekonomik pas shqyrtimit te dokumentacionit fizik te dorëzuar pranë zyrës se protokollit te autoritetit kontraktor, rezulton se nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të kualifikuar, si më poshtë: Teknik Topograf 1 (një); Betonues 2 (dy); Specialist Ndërtimi 2 (dy). Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit, ndërsa për shoferet/ manovratoret kur mjetet disponohen me qira drejtuesit e mjeteve mund te disponohen me kontrate pune, së bashku me mjetet e marra me qira, pa pasur nevoje te jene te përfshirë ne listepagesat e operatorit ekonomik ofertues.

			Për punonjësit e kualifikuar te paraqitet Certifikatat/diplomat/dëshmi te lëshuara nga institucione publike /private te licencuara sipas ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R.SH., i ndryshuar. Ky operator ekonomik për punonjësit sa me sipër nuk ka paraqitur Certifikatat/diplomat/dëshmi te lëshuara nga institucione publike /private te licencuara sipas ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R.SH., i ndryshuar. Gjithashtu, rezulton se për mjetin tip autobetoniere nuk ka paraqitur dokumentacion te vlefshëm certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit jo te vlefshme.
5	"Sh." – Al SH.P.K.	4,787,950	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has. z. M. D. me nr. 49 datë 26.06.2025 është ngritur KVO e cila përbëhet nga Z. Sh. (kryetar), R.R dhe Y. D. (anëtar). Në ketë tender kanë marrë pjesë 4 OE, është kualifikuar 1 OE, dhe shpallur fitues OE "Sh.-Al." SH.P.K. me ofertë në vlerën **4,787,950 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **45,383 lekë.**
05.06.09.2025. Vlerësimi i tyre ka përfunduar me datë 15.06.2025, në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 8 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirim e lartë monetar.
Dokumentacioni është dorëzuar pranë AK me shkresën nr. 2130 prot., datë 24.06.2025.
Është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 2392 prot., datë 11.07.2025.
Është lidhur kontrata me nr. 2367 prot., datë 09.07.2025.

A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret dhe konkretisht:
1. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** për taksat vendore. Ky OE rezulton sipas ekstraktit të QKB me adresë në Durrës, ndërkohë nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për likuidimin e detyrimeve vendore pranë kësaj bashkie.
Gjithashtu, ky OE, rezulton se përgjatë vitit 2024 ka realizuar kontratë në Bashkinë Has, konkretisht kontratën me objekt *"Sistemim Asfaltim i rrugëve te brendshme Fshati Golaj"*, ndërkohë nuk rezulton të ketë likuiduar detyrimet pranë kësaj bashkie.
2. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6** për mjetet me targa AB372BN, AA346VG, Autobetoniere AJMT43 pasi rezultojnë të angazhuara njëkohësisht në procedurën me objekt *"Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme, Fshati Golaj".*
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 dhe nenin 98 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika 1 germa (b) të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: Z. Sh (kryetar), R. R dhe Y. D (anëtar).

9. Tenderi me objekt: "*Ndërtim pusetash ujërave të zezë për zonën informale*", me këto të dhëna:

9. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim pusetash ujërave të zezë për zonën informale"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr. 10, datë 14.05.2025	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 48 date 17.03.2025 1.E. R.- (Person përgjegjës)	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 49, datë 26.06.2025 1. Z. Sh. – (Zv. Kryetar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur e thjeshtuar"	2.A. G. - (Jurist) 3.E. S. - (Financier)	2. R. R. - (Juriste) 3. Y. D. – (Sek.Urbanistik)

5.Fondi Limit (pa TVSH) 4,150,000 - lekë pa TVSH	6.Oferta fituese: BOE "V.G." SH.P.K. & "A." SH.P.K. me ofertë 3,842,000 - Lekë, me lidhje kontrate datë 11.07.2025 me afat 60 ditë.	7.Diferenca me fondin limit: 308,000 - lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 16.06.2025	9.Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë Has	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 1 OE **b)** Skualifikuar 0 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Ka/Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Ka/Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has, z. M. D. me nr. 48, datë 17.03.2025 është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga E. R, A. G dhe E. S.
Me urdhër të Titullarit me nr. 10 datë 14.05.2025, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **4,150,000 lekë** me objekt**: *"Ndërtim pusetash ujërave të zezë për zonën informale".***
- Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Has miratuar me vendimin nr. 16, datë 24.02.2025.
Administrohet preventiv i punimeve i hartuar nga subjekti "A." SH.P.K.
Me urdhër nr. 1582 prot., datë 14.05.2025 të Titullarit, është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe llogaritjen e fondit limit i përbërë nga Z. Sh., I. L. dhe D. B.
Ky komision, ka hartuar një procesverbal të datës 14.05.2025 sipas të cilit për përllogaritjen e fondit limit, janë bazuar në çmimet e vendosura sipas manualit të tenderimit, përcaktuar në VKM nr. 216., datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimit e manualit të çmimeve për zërat e punimeve".

Vlerësimi i kritereve
Hartimi dhe argumentimi i kritereve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin e datës 26.05.2025 nga NJHDT, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan përgjithësisht në përputhje me objektin e procedurës.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	BOE"V.G." SH.P.K. & "A." SH.P.K.	3,842,000	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has. z. M. D. me nr. 49 datë 26.06.2025 është ngritur KVO e cila përbëhet nga Z. Sh. (kryetar), R. R dhe Y.D. (anëtar). Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar, dhe shpallur fitues BOE "V. G." SH.P.K. & "A." SH.P.K. me ofertë në vlerën **3,842,000 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **308,000 lekë.**
Hapja e ofertave është bërë me datë 16.06.2025, vlerësimi i të cilës ka përfunduar me datë 19.06.2025, në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 8 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirim e lartë monetar.
Dokumentacioni është dorëzuar pranë AK me shkresën nr. 2149 prot., datë 25.06.2025.
Është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 2393 prot., datë 11.07.2025.

Është lidhur kontrata me nr. 2311 prot., datë 04.07.2025.

A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në SPE, rezulton se BOE nuk përmbush të gjitha kriteret dhe konkretisht:
1. OE "V. G." SH.P.K., i cili ka marrë përsipër angazhimin në masën 54.7% të punimeve, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.2 të DST për** kategoritë e licencës NP-9 dhe NS-8. Në licencën e shoqërisë nuk i disponon këto dy kategori.

A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, rezulton se BOE nuk përmbush disa nga kriteret dhe konkretisht:
2. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për 2 betonues. Janë deklaruar punonjësit M .B. dhe E.L., punonjës të OE "A." SH.P.K. Dëshmitë/certifikatat e paraqitura, rezulton se janë lëshuar për specialist ndërtimi, dhe jo për betonues.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 dhe nenin 98 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika 1 germa (b) të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: Z. Sh (kryetar), R. R. dhe Y. D. (anëtar).

10. Tenderi me objekt: "*Blerje mjeti zjarrfikës 4X4 pick-up – 2 copë*", me këto të dhëna:

<table>
<tr><td colspan="3">10. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje mjeti zjarrëfikës 4X4 pick-up – 2 copë"</td></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi :
Nr. 25, datë 23.06.2025</td><td rowspan="2">2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Nr. 48 date 17.03.2025
1.E. R.- (Person përgjegjës)
2.A..G. - (Jurist)
3.E. S. - (Financier)</td><td rowspan="2">3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 49, datë 26.06.2025
1. Z. Sh. – (Zv. Kryetar)
2. R. R - (Juriste)
3. Y .D.. – (Sek.Urbanistik)</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"</td></tr>
<tr><td>5.Fondi Limit (pa TVSH)
10,000,000 - lekë pa TVSH</td><td>6.Oferta fituese:
OE K B me ofertë 9,880,000 - Lekë, me lidhje kontrate datë 01.10.2025 me afat 30 ditë.</td><td>7.Diferenca me fondin limit:
120,000 - lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
Data e zhvillimit: 29.08.2025</td><td>9.Burimi Financimit:
Buxheti i Bashkisë Buxheti i Shtetit</td><td>10.Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës në tender 1 OE
b) Skualifikuar 0 OE,
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>11.Ankimime AK,
Ka/Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK,
Ka/Nuk ka</td><td>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Ka/Nuk ka</td></tr>
</table>

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has, z. M D me nr. 48, datë 17.03.2025 është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga E. R., A .G.dhe E. S.
Me urdhër të Titullarit me nr. 25 datë 23.06.2025, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **10,000,000 lekë** me objekt**: *"Blerje mjeti zjarrëfikës 4X4 pick-up – 2 copë".***
E S nuk ka firmosur deklaratën e konfliktit të interesit.
- Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Shtetit, miratuar me VKM nr. 127, datë 28.02.2025 "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2025 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore". Vlerë e financimit për bashkinë Has është në vlerën 12,000,000 lekë me TVSH, nga të cilat vlera e financimit për vitin 2025 është në vlerën 6,720,000 lekë me TVSH, dhe diferenca për vitin 2026.

Vlerësimi i kritereve

Hartimi dhe argumentimi i kritereve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin e datës 17.08.2025 nga NJHDT, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

A. Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan përgjithësisht në përputhje me objektin e procedurës.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	"K. B."	9,880,000	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë Has. z. M. D. me nr. 49 datë 26.06.2025 është ngritur KVO e cila përbëhet nga Z. Sh. (kryetar), R .R. dhe Y. D. (anëtar). Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar, dhe shpallur fitues subjektin "K. B." me ofertë në vlerën **9,880,000 lekë** me diferencë nga fondi limit në vlerën **120,000 lekë.**

Hapja e ofertave është bërë me datë 29.08.2025, vlerësimi i të cilës ka përfunduar me datë 12.09.2025, në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 8 të VKM-së 285, datë 19.05.2021 e cila përcakton afatin 15 ditë të vlerësimit për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Dokumentacioni është dorëzuar pranë AK me shkresën nr. 3501 prot., datë 30.09.2025.

Është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 3550 prot., datë 03.10.2025.

A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK, rezulton se BOE nuk përmbush disa nga kriteret dhe konkretisht:

1. OE nuk përmbush kriterin për energjinë elektrike. Është paraqitur vërtetimi me nr. OSHEE-2025-5569809-EY, datë 24.07.2025 sipas të cilit ky subjekt ka likuiduar detyrimet deri me këtë datë përfshirë faturën e muajit Qershor 2025. Në kushtet kur ky subjekt ka dorëzuar dokumentacionin me në Shtator 2025, duhej likuiduar detyrimet e muajit Korrik 2025.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 dhe nenin 98 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika 1 germa (b) të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: *Z. Sh. (kryetar), R. R. dhe Y. D. (anëtar).*

Me urdhër nr. 45, datë 24.12.2025 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave i përbërë nga A. R., F. D. dhe I. M.

Është bërë marrja në dorëzim e mallit me procesverbalet e datës 31.12.2025 dhe 14.01.2026, nga komisioni i mësipërm, bërë hyrje në magazinë me FH nr. 43, datë 31.12.2025 dhe nr. 1, datë 14.01.2024.

Është lëshuar fatura tatimore me nr. 1/2026, datë 14.01.2026.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga Bashkia Has janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1589/4 prot., datë 31.07.2026, të administruara në KLSH me shkresën me nr. 106/7 prot., datë 04.08.2026:

Pretendimi i subjektit dhe qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, ato rezultojnë se janë të njëjtat observacione të paraqitura dhe trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit, duke mos sjell asnjë pretendim ose dokumentacion tjetër justifikues për pretendimet e paraqitura. Në kushtet kur këto pretendime janë të njëjta, grupi i auditimit sqaron se ato janë trajtuar një herë dhe nuk pranohen duke mos ndryshuar qëndrimin e

audituesve lidhur me gjetjet që lidhen me procedurat e prokurimit publik.

2.4.3. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave /punëve dhe shërbimeve.

Mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Has, në bazë të Programit të Auditimit nr. 106/1 prot., datë 28.01.2026, i ndryshuar; mbajtur më datë 04.05.2026, "Mbi Auditimin Financiar dhe Përputhshmërie"për periudhën nga data 01.01.2023-31.12.2025. Nga auditimi i zbatimit të kontratave të punëve publike për subjektin Bashkia Has për periudhën objekt auditimi 01.01.2023-30.12.2025, rezulton se:

Referuar regjistrit të realizimit të kontratave të punimeve gjatë vitit 2023 është realizuar 4 kontrata zbatimi punimesh me fond limit 24,965,270 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 20,210,553 lekë pa TVSH si më poshtë:

Nr.	Objekti i Zbatuar	Lloji i Procedurës	F.Limit	Vl.Kontratës	Op.Ekonomik	Vlerësuar për auditim/arsyet e mos auditimit të dosjes
1	Ndertim I rruges nga Aksi Rruge Nacionale Krume - Kukes, Lagjia Dida - Geca - Rada	E hapur e thjeshtuar	10,965,270	8,719,710	OE "V. G." SH.P.K.	Jo
2	Hapja e kanalit Kullues, mirembajtje e rruges, Segmenti Rrugor Gjinaj - Domaj - Pogaj	E hapur e thjeshtuar	2,666,667	2,498,260	OE "P. G." SH.P.K.	Jo
3	Vazhdim i rehabilitim kunete dhe bazamentit i kanalit te betonit perroi i tershenes segmenti rrugore komisariat - Ujesjelles-lumi Kruma"	E hapur e thjeshtuar	5,333,333	4,641,333	OE "P.-V." SH.P.K.	Jo
4	Mirembajtje Rruge Rurale e Kanalizime Bashkia Has	E hapur e thjeshtuar	6,000,000	4,351,250	OE "G." SH.P.K.	Jo
	Vlera totale e objekteve		**24,965,270**	**20,210,553**		

Referuar regjistrit të realizimit të kontratave të punimeve gjatë vitit 2024 janë realizuar 9 kontrata zbatimi punimesh me fond limit 261,332,547 lekë pa TVSHTVSH dhe vlerë kontrate 246,549,683 lekë pa TVSH si më poshtë:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Lloji i Procedurës	F.Limit	Vl.Kontratës	Op.Ekonomik	Vlerësuar për auditim/arsyet e mos auditimit të dosjes
1	Rehabilitim trotuari pergjate rruges nacionale dalje Qyteti Krume deri Rezervuari Pla	E hapur-Pune	19,999,560	17,601,990	OE "N." SH.P.K.	Jo
3	Rehabilitim me qellim mbingritjen e diges se Rezervuarit Helshan 2	E hapur-Pune	40,496,392	37,571,057	BOE "A. M.&O." SH.P.K.	Po
4	Rikonstruksion i Gjimnazit"Skenderbeu"Has	E hapur-Pune	97,431,542	94,500,000	BOE "T.&J. C.&V." SH.P.K.	Po
5	Sistemim Asfaltim i rrugeve te brendshme Fshati Golaj	E hapur-pune	88,910,909	83,951,496	BOE "Sh.-Al. &O." SH.P.K.	Po

6	Ndertimi i tre urave Fshati Nikoliq Lagje Ngjec-Pec	E hapur e thjeshtuar - Pune	3,000,000	2,352,900	OE “E. H.” SH.P.K.	Jo
7	Pastrim kanalesh+Ushqyes Rezervuari, viti 2024	E hapur e thjeshtuar - Sherbime	4,500,000	4,049,415	OE “P.” SH.P.K.	Jo
8	Shpenzime mirembajtje vepra ujore	E hapur e thjeshtuar - Pune	4,750,000	4,411,825	OE “V. G.” SH.P.K.	Jo
9	Kanal me tub plastik Rezervuari Bera	E hapur e thjeshtuar	2,244,144	2,111,000	OE “O.” SH.P.K.	Jo
	Vlera totale e objekteve		**261,332,547**	**246,549,683**		

Referuar regjistrit të realizimit të kontratave të punimeve gjatë vitit 2025 janë realizuar 4 kontrata zbatimi punimesh me fond limit 261,332,547 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 246,549,683 lekë pa TVSH si më poshtë:

Nr.	Objekti i Zbatuar	Lloji i Procedurës	F.Limit	Vl.Kontratës	Op.Ekonomik	Vlerësuar për auditim/arsyet e mos auditimit të dosjes
1	Rehabilitim dhe Sistemim i Perroit te Tershenes	E hapur e thjeshtuar	4,833,333	4,787,950	OE “SH. – AL.” SH.P.K.	Jo
2	Rikonstruksion i shkolles 9-vjeçare "Sejdi Dida", Krumë	E hapur	125,968,569	119,780,675	B.O.E “2Z. & A.-2A. C.” SH.P.K.	Jo/Ne proces pune
3	Ndertim pusetash ujrave te zeza per zonen informale	E hapur e thjeshtuar	4,150,000	3,842,000	B.O.E “V. G.” SH.P.K. & A." SH.P.K.	Jo
4	pastrim kanalesh dhe Ushqyres Rezervuari	E hapur e thjeshtuar	3,750,000	3,390,400	OE “T.&J.” SH.P.K.	Jo
	Vlera totale e objekteve		**138,701,902**	**131,801,025.4**		

Sa mësipër nga kontratat e mundshme për tu audituar me vlerë totale të kontratave **278,780.5 mijë lekë pa TVSH,** janë përzgjedhur për tu audituar **3 kontrata** zbatimi punimesh me vlerë totale **216,022.5 mijë lekë pa TVSH**, ose **77%** e vlerës totale të kontratave të mundshme për tu audituar.

Në mënyrë të detajuar situata e çdo kontrate paraqitet si vijon:
1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***“Rikonstruksion i gjimnazit “Skënderbeu”, Bashkia Has*** rezultoi se: Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës së sipërmarrjes publike me nr.3152 prot., datë 02.10.2024, lidhur midis AK Bashkia Has dhe Kontraktorit BOE “T.&J.C.” SH.P.K. & “V.C.” SH.P.K. sipas licencave respektive NZ.4933/17 dhe NZ.8802/3. Vlera e kontratës është 113,400,000 lekë me TVSH. Për këtë objekt nuk është lëshuar një leje rikonstruksioni por është hartuar vetëm një deklaratë për kryerje punimesh. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.3814 prot., datë 27.11.2024, midis AK Bashkia Has dhe Mbikëqyrësit BOE “S.-A.” SH.P.K.&”2 E.”SH.P.K., sipas liçensave respektive për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit Nr: MK.4146/5 dhe Nr: MK.3630/1. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.4269 prot., datë 20.11.2025, midis AK Bashkia Has dhe Kolaudatorit OE “A.-C.”sh.p.k, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh Nr: MK.4517. -Nga kontrolli i dokumentacioni tekniko-ligjor vënë në dispozicion rezultoi se: Dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve është kryer më datë 02.12.2024. Njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 12.12.2023. Afati i kontratës është parashikuar 12 muaj. Për këtë

objekt punimet kanë përfunduar sipas afateve kontraktuale. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 02.12.2025. Akti i kolaudimit është hartuar në datë 16.12.2025 ndërsa certifikata e marrjes në dorëzim të përkohëshëm të punimeve është mbajtur në datë 20.12.2025. - Në dosjen teknike nuk janë shoqëruar me certifikata cilësietë gjitha materialet e përdorura, gjithashtu mungojnë testimet dhe provat laboratorike, provat nën ngarkesë linjave, provat në lidhje me sistemin antizjarr, prova e tokëzimit etj. Kuadri i sinjalizimit të zjarrit nuk ishte vendosur në punë. Në dosjen teknike administrohet libreza e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar. -Nga kontrolli teknik i punimeve në terren u konstatuan gjithashtu disa diferenca midis volumeve të punës të situacionuara me punimet faktike në terren, si dhe volume të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatimit/projekt-preventivin e rishikuar si më poshtë:

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"2.209/b-Ulluk shkarkimi vertikal me baker"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 99.8ml Gjatë kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune nuk ishte kryer me ulluk vertikal bakëri. Në kohën e tenderimit ky zë pune sipas portalit të çmimeve SIM ka qënë në cmimin 2,643.67 lekë/ml; ndërsa zëri ulluk vertikal xingato ka qënë në çmimin 1,021.7 lekë/ml. Gjatë procesit të tenderimit në ofertën e tijë Kontraktori është ulur 2% në cmimin e zërit të ullukut vertikal bakrit, nëse e aplikojmë këtë ulje tek cmimi i ullukut xingato do të kemi 98%*1021.7 lekë/ml=1004.8 lekë/ml x 99.8ml= 100281.3 lekë. Pasi kryejmë zbritjen midis vlerës së raportuar me vlerën e llogaritur 259480lekë-100281.3= **159,199 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"2.212/b-Ulluk shkarkimi horizontal me baker 33cm"*i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 143.2ml. Gjatë kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune nuk ishte kryer me ulluk horizontal bakëri. Në kohën e tenderimit ky zë pune sipas portalit të çmimeve SIM ka qënë në cmimin 3,052.13 lekë/ml; ndërsa zëri ulluk horizontal xingato ka qënë në çmimin 1,195.97 lekë/ml. Gjatë procesit të tenderimit në ofertën e tijë Kontraktori është ulur 6% në cmimin e zërit të ullukut horizontal të bakrit, nëse e aplikojmë këtë ulje tek cmimi i ullukut xingato do të kemi 94%*1,195.97 lekë/ml=1,120.7 lekë/ml x 143.2 ml= 160,482 lekë. Pasi kryejmë zbritjen midis vlerës së raportuar me vlerën e llogaritur 409,552 lekë-160,482= **249,070 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"2.206-Kasete shkarkimi"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 8 copë. Gjatë kontrollit në terren u konstatua se ishte vendosur një ulluk horizontal perimetral për ujërat e çatisë, pra nuk ishin përdorur kaseta shkarkimi, sepse shkarkimi bëhej me varangë direkt në ullukun horizontal. Kjo sasi prej 8 copë vlerën **15,600 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize*"2.324a Plintues pllaka grez"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 1068.9ml, referuar analizës teknike të çmimit plituesi duhet të realizohet me lartësi 10cm, gjatë kontrollit në terren u konstatua se plintuesi ishte realizuar me lartësi 8 cm. Nga verifikimi i analizës së çmimit të këtij zëri pune, sipas manualit (2.324/a), rezulton se çmimi i nënzërit material në këtë zë pune, është 65 % e të gjithë zërit të punës. Nga rillogaritja, çmimi i këtij zëri pune është përkatësisht 2,175 lekë/ml (65%*2500 lekë/ml *8cn/10cm+35%*2,500 lekë/ml) ose 325 lekë/ml më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 20 lekë/ml (për sasinë e plintuseve prej 1,068.9 ml), llogaritet në vlerën **347,393 lekë pa TVSH, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve dhe përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"2.196/c-Hidroizolim WC me dy shtresa mapej - ose ekuivalent me të në - dysheme + muret"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 250.9 m2, gjatë kontrollit të librezave të masave u konstatuan disa lapsuse në llogaritjen e këtij volumi (

pasi sasia e veshjes + sasia e shtrimit të pllakave në tualetë rezulton 238m2). Si rrjedhojë rezultuan diferenca në vlerën **19,200 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"2.404/1-Lyerje brenda me Boje hidroplastike cilesi e pare"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 4504.2m^2, gjatë kontrollit në terren u matën lartësitë e kateve Hk0=2.9m, Hk1=2.9m, Hk2=2.75m, ku u konstatuan se në librezat e masave këto lartësi janë raportuar më të mëdha sesa fakti si dhe nuk janë kryer zbritjet e lartësisë së veshjes së pllakave në tualete. Për rrjedhim rezultuan diferenca në sasinë (4504.2-4160)=344 m^2 dhe në vlerën **137,680 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"Analize-1-Lyerje me Boje vaji brezi deri = 1m ambjente te brendshme"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 1124.2m^2, gjatë kontrollit të librezave të masave këto lartësi janë raportuar më të mëdha sesa fakti, pasi në terren u matën lartësitë e lyerjes ku në korridore rezultoi lyerja 90cm dhe në Ka 65cm. Për rrjedhim rezultuan diferenca në sasinë 810 m^2 dhe në vlerën **157,100 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"Analize F.V. Ndriçuesa luminishent, FL 4x18w, IP 20"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 260 copë, gjatë kontrollit në terren u konstatua se ndriçuesit ishin në sasin 230 copë, pra me diferencë prej 30 copë, e cila përbën vleën **180,000 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"Analize-F.V. Ndricues tip prozhektor 150Ẇ per palestren"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 25 copë, jatë kontrollit në terren u konstatua se ishin vendosur vetëm 11 ndriçues. Rrjedhimisht diferenca prej 25-11 copë përbëjnë vlerën **280,000 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik**
-Në lidhje me kapitullin "*Sinjalistika & kodi indeksimit"* kapitull i cili është raportuar në situacionin përfundimtar në vlerën 223,046 lekë pa TVSH. Gjatë kontrollit në terren u konstatua se nuk ishin vendosur asnje tablë sinjalizuese ne lidhje me fikset hidrantët daljet e emergjenecës etj. Komplet vlera e këtijë kapitulli prej **223,046 lekë pa TVSH do të konsiderohet si dëm ekonomik**
Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Has në vlerën 1,768,287 lekë pa TVSH.
Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve BOE "S.-A." SH.P.K.&"2. E."SH.P.K., në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk kanë zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". *(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi nr. 06, datë 04.05.2026, dorëzuar me protokoll në Bashkisë Has).*

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Rehabilitim me qëllim mbingritjen e disës së rezervuarit, Helshan 2", Bashkia Has*** ku rezultoi se: Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës së sipërmarrjes publike me nr. 3024 prot., datë 20.09.2024, lidhur midis AK Bashkia Has dhe Kontraktorit BOE "A .M."SH.P.K. & "O."SH.P.K., sipas licencave respektive NZ.2802/32 dhe NZ.4511/11. Vlera e kontratës është 45,085,269 lekë me TVSH. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 8 muaj nga nënshkrimi i sajë. -Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.3379 prot., datë 21.10.2024, lidhur midis AK Bashkia Has dhe Mbikëqyrësit BOE "A.-V." SH.P.K.&"A.Sh.E." SH.P.K., sipas licencave respektive për mbikëqyrje kolaudim punimesh Nr: MK.1618/5 dhe Nr: MK.2463/7. -Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.2658 prot., datë 31.07.2025, midis AK Bashkia Has dhe

Kolaudatorit OE "A.-C."sh.p.k , me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh nr.MK.4517. Akti i kolaudimit është hartuar në datë 14.08.2025 ndërsa certifikata e marrjes në dorëzim të përkohëshëm të punimeve është mbajtur në datë 15.08.2025. Për këtë objekt është hartuar vetëm një deklaratë paraprake për kryerje punimesh datë 21.09.2024, pra nuk është aplikuar për leje ndërtimi. -Nga kontrolli i dokumentacioni tekniko-ligjor i vënë në dispozicion të GA rezultoi se: Dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve është kryer më datë 02.12.2024. Njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 02.12.2024. Për këtë objekt punimet kanë përfunduar sipas afateve kontraktuale. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 02.12.2025. Në dosjen teknike administrohet libreza e masave përfundimtare e cila përgjithësisht korrespondon me situacionin përfundimtar. -Librezat e masave janë hartuar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit"* dhe udhëzimet nr.1 datë 16.06.2011, dhe nr.3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar*, pasi ato nuk janë të sqaruara analitikisht, përmbajnë gabime dhe nuk janë shoqëruara me vizatime dhe skica ilustruese për çdo zë pune.
-Nga kontrolli teknik i punimeve në terren u konstatuan gjithashtu disa diferenca midis volumeve të punës të situacionuara me punimet faktike në terren, si dhe volume të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatimit/projekt-preventivin e rishikuar si më poshtë:
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"1.39/p-Parapet b/a parafabrikat"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 147m3, gjatë kontrollit në terren si dhe librezave të masave u konstatua se ky zë pune nuk ishte kryer me beton arme parafabrikat por me beton të derdhur në vend. Gjithashtu u konstatua se ky zë pune nuk është llogaritur në mënyrë korrekte. Konkretisht në librezën e masave është raportuar 191.4m x0.77m2=147.38 m3 ndërsa nëse bëjm llogaritjet korrekte sipas projektit do të kemi: për bazamentin e murit (pjesa horizontale) 191.4mx0.9x0.3m=51.7m3, ndërsa për murin (pjesa vetikale) 191.4mx1.3mx0.3=74.6m3 pra në total 126.3m3. Për rrjedhim do të kei një diferencë prej 20.7 m3 midis sasisë të raportuar dhe sasisë së llogaritur në vlerën **312.570 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize "*3.212/d-Shtrese stabilizanti t = 20 cm ne kuroren e diges"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 758 m^2, gjatë kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune nuk ishe kryer me stabilizant por në kurorën e digës u konstatua vendosja vetëm e shtresës së çakëllit. Për rrjedhim vlera e volumeve të raportuara por të pa kryera është **575,701 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
-Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punes të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt ose punime të llogaritura jo sipas projektit te zbatimit, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Has në vlerën 888,271 lekë pa TVSH.
Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve BOE "A. – V." SH.P.K.&"A.Sh.E." SH.P.K., në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". *(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi nr. 07 datë 04.05.2026, dorëzuar me protokoll në Bashkisë Has).*

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: ***"Sistemim asfaltim i rrugëve të mbrendshme Fshatit Golaj ", Bashkia Has*** ku rezultoi se: Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës së sipërmarrjes publike me nr. 3846 prot., datë 02.12.2024, lidhur midis AK Bashkia Has dhe Kontraktorit BOE " Sh.-Al."SH.P.K.& "O."SH.P.K., sipas licencave respektive NZ.4574/23 dhe NZ.4511/11. Vlera e kontratës është 100,741,795 lekë me

TVSH. -Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj nga nënshkrimi i sajë. -Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.4675 prot., datë 22.12.2025, lidhur midis AK Bashkia Has dhe Mbikëqyrësit OE "XH.&M." SH.P.K, sipas licencës për mbikëqyrje kolaudim punimesh Nr: MK.1322/9. -Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.4675 prot., datë 22.12.2025, midis AK Bashkia Has dhe Kolaudatorit OE "2H."sh.p.k, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh nr:MK.4380/2. Akti i kolaudimit është hartuar në datë 26.12.2025 ndërsa certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm të punimeve është mbajtur në datë 06.03.2026. Për këtë objekt është hartuar vetëm një deklaratë paraprake për kryerje punimesh datë 21.09.2024, pra nuk është aplikuar për leje ndërtimi. -Nga kontrolli i dokumentacioni tekniko-ligjor i vënë në dispozicion të GA rezultoi se: Dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve është kryer më datë 31.12.2024. Njoftimi i fillimit të punimeve nga mbikëqyrësi, procesverbali i fillimit të punimeve si dhe akti i piketimit, janë realizuar më datë 31.12.2024. Për këtë objekt punimet kanë përfunduar sipas afateve kontraktuale. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 22.12.2025.

-Në projektin e rishikuar mungojnë detajet teknike dhe vizatimet e profilet tërthore, detajet e mureve dhe të kanalit anësor. Në dosjen teknike nuk janë shoqëruar me certifikata cilësie materialet e përdorura, gjithashtu mungojnë testimet dhe provat laboratorike për të gjitha shtresat rrugore. Në dosjen teknike administrohet libreza e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.-Librezat e masave janë hartuar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit"* dhe udhëzimet nr.1 datë 16.06.2011, dhe nr.3 datë 15.02.2001 *"Për mbikeqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar*, pasi ato nuk janë të sqaruara analitikisht, përmbajnë gabime dhe nuk janë shoqëruara me vizatime dhe skica ilustruese për çdo zë pune.

-Nga kontrolli teknik i punimeve në terren u konstatuan gjithashtu disa diferenca midis volumeve të punës të situacionuara me punimet faktike në terren, si dhe volume të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatimit/projekt-preventivin e rishikuar si më poshtë:

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"3.158/4a-Transport dheu me auto deri 4.0 km"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 7,695 m3, gjatë kontrollit të librezave të masave në këtë sasi nuk është kryer zbritja e volumeve të mbushjes 340m3 nga volumi total I gërmimeve 7,941 m3. Rrjedhimisht kjo sasi 340m3 përbën vlerën **95,200 lekë pa TVSH do të quhet vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana Kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"3.212/b-Shtrese stabilizant t=10cm(Ndertim bankine b=50cm)"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 4,804 m2, gjatë kontrollit të librezave të masave në këtë sasi nuk është kryer zbritja e hyrje-daljeve të shtëpive dhe pronave private, dhe tortuarit anësor, në sasinë 670m2. Rrjedhimisht kjo sasi 670m2 përbën vlerën **288,100 lekë pa TVSH do të quhet vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana Kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"3.618-FV Bordura betoni 20x35 cm"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 426ml, gjatë kontrollit në terren u konstatua se bordurat ishin realizuar me përmasa të tjera 25x15cm. Raporti përmasave të borudrave 25x15 me 20x35 është 54% dhe nëse e aplikojmë këtë % tek çmimi i ofertuar për realizimin e bordurave, ky cmim do të kaloj nga1600 lekë/ml në 857 lekë/ml. Rrjedhimisht vlera e bordurave kalon nga 681,600 lekë në 365,142.86 lekë pa TVSH, dhe diferenca midis vlerave do të përbëj vlerën **316,457.14 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të konsiderohet si dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"2.261/a-Nenshtrese rere"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 34 m3, gjatë kontrollit të librezave të masave në këtë sasi u konstatua se

në analizën teknike të çmimit për zërin *"3.620-Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka"* është e përfshirë 0.03m3/m2 trotuar i cili përbën 20.64m3 rërë të përfshirë në çmimin e vendosjes së tortuarit. Rrjedhimisht vlera,e 20.64m3 llogaritet **30,960 lekë pa TVSH, vlerë e cila do të quhet si vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana Kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"3.158/4a-Transport dheu me auto deri 4.0 km"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 48 m3, gjatë kontrollit të librezave të masave u konstatua se në llogaritjen e këtij zëri duhet të ishtë përfshirë vetëm sasia e ardhur nga gërmimet pra 29m3. Diferenca midis 48m3-29m3 përbën vlërën **5,320 lekë pa TVSH do të quhet vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana Kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"3.954-FV tabela rrugore treguese 60x20cm"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 3 copë gjatë kontrollit në terren rezultuan 2 tabela të vendosura. Diferenca prej 1 copë në vlerën **4,342 lekë pa TVSH do të konsiderohet si dëm ekonomik.**
-Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punes të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt ose punime të llogaritura jo sipas projektit te zbatimit, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Has në vlerën 740,379 lekë pa TVSH.
Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve OE "XH.&M." SH.P.K., në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit". *(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi nr. 07 datë 04.05.2026, dorëzuar me protokoll në Bashkisë Has).*

2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit7
2.5.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.
2.5.2. Auditimi mbi përllogaritjen dhe arkëtimin e taksave për pajisje me leje ndërtimi.
Bashkia Has ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 15.04.2021. Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2025 Duke ju referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Has, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 31.12.2025, janë zhvilluar aplikimet dhe miratimet për lejet e ndërtimit të paraqitura në tabelën e mëposhtme:
Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Has, janë miratuar 17 leje ndërtimi, ndër të cilat leje për ndërtim të ri/ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2 janë miratuar 3 leje, leje ndërtimi për ndërtim deri në 250 m^2 janë miratuar 9 leje, ndërsa leje për ndryshim destinacioni janë miratuar 6 leje ndërtimi.
Në aneksin nr. 3 pasqyrohen përmbledhja e listës së lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Has, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2025:

<u>Mbi auditimin e lejeve të ndërtimit</u>
Nga auditimi, janë konstatuar mangësi në lejet e mëposhtme:

1. <u>Sipas regjistrit elektronik nr. 109</u> në emër të zhvilluesit M. M., me datë aplikimi 20.12.2022, për objektin: *"K. A." – "Z.", HAS".*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

1. Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore, në kundërshtim me pikën 1, germa (ë) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

2. Projekti Arkitektonik, nga inxhinier A. Sh., mungon licenca e projektuesit dhe kopje e policës së sigurimit të projektuesve për mbulimin e përgjegjësive profesionale;
- Projekti Elektrik, inxhinier B. D., mungon licenca e projektuesit dhe kopje e policës së sigurimit të projektuesve për mbulimin e përgjegjësive profesionale;
- Projekti Hidrosanitar, inxhinier E.H., mungon licenca e projektuesit dhe kopje e policës së sigurimit të projektuesve për mbulimin e përgjegjësive profesionale;
- Projekti i instalimeve ngrohje - ftohje, inxhinier E. H., mungon licenca e projektuesit dhe kopje e policës së sigurimit të projektuesve për mbulimin e përgjegjësive profesionale;
- Projekti i mbrojtjes nga zjarri, inxhinier E.H., mungon licenca e projektuesit dhe kopje e policës së sigurimit të projektuesve për mbulimin e përgjegjësive profesionale;
- Projekti Konstruktiv, nga inxhinier A. Sh., mungon licenca e projektuesit dhe kopje e policës së sigurimit të projektuesve për mbulimin e përgjegjësive profesionale;
- Projekti i eficienës së energjisë, inxhinier E. H., mungon licenca e projektuesit dhe kopje e policës së sigurimit të projektuesve për mbulimin e përgjegjësive profesionale.
Mangësitë e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 15 pika 1 germa (ë, g) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

3. Kartela e pasurisë së paluajtshme nuk është e rifreskuar 3 muajt e fundit. Referuar Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" Neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6, VKM-së nr. 457. Datë 29.06.2022, Neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 45 germa (c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jetë e rifreskuar 3 muajt e fundit, referuar datës së aplikimit. Nga auditimi, rezulton se kartela është e datës 18.10.2021, ndërkohë që aplikimi është i datës 05.04.2022.
-Gjithashtu, sipas kartelës së lëshuar, ajo rezulton me kufizime, pasi sipas përshkrimi ajo është e bllokuar deri në momentin e shlyerjes së TNI-së, pra rezulton se ka kufizime mbi pronën.

2. <u>Sipas regjistrit elektronik nr. 125</u> në emër të zhvilluesit A. K., me datë aplikimi 20.05.2023, për objektin: *"Objekt banimi dy katesh me papafingo".*
1. Është bërë njoftimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë e cila është likuiduar nga aplikuesi, por nuk dokumentohet mënyra e përllogaritjes së taksës dhe në njoftimin për pagesën e saj nuk përcaktohet vlera që duhet paguar.
Lidhur me mangësitë e mësipërme, për miratimin e lejes në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, ngarkohen me përgjegjësi U.H. – përllogaritësi i TNI, N.B. – Drejtues, A.U. Kontrollues, Nëpunës – B. H., dhe Kryetari i Bashkisë Has - z. L. M.

3. <u>Sipas regjistrit elektronik nr. 171</u> në emër të zhvilluesit A.M., me datë aplikimi 05.11.2024, për objektin: *"Banesa njëfamiljare 2K".*
Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:
1. Konstatohet mangësi me planvendosjen. Rezulton se gjurma e objektit pasqyron vetëm konturet nuk por evidentohet objekti.
2. Kartela e pasurisë së paluajtshme nuk është e rifreskuar 3 muajt e fundit. Referuar Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" Neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6, VKM-së nr. 457. Datë 29.06.2022,

Neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 45 germa (c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jetë e rifreskuar 3 muajt e fundit, referuar datës së aplikimit. Nga auditimi, rezulton se kartela është e datës 27.03.2024, ndërkohë që aplikimi është i datës 05.11.2024.
3. Në faturën për arkëtim rezulton se është përcaktuar vlera për tu paguar, ndërkohë nuk evidentohet mënyra e përllogaritur por vetëm vlera prej 41,124 lekë. Sipas paketës fiskale të Bashkisë Has, TNI për tipologjinë e ndërtimit të mësipërm është në masën 1% të vlerës së investimit. Sipas preventivit të punimeve, rezulton në vlerën **8,299,118 lekë.** Referuar masës 1% të përcaktuar në paketën fiskale, Institucioni duhej të përllogariste pagesën në masën 1% të kësaj vlere, ose **82,991 lekë.** Vlera prej 41,867 lekë, e cila nuk është përllogaritur, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Has.

4. <u>Sipas regjistrit elektronik nr. 185</u> në emër të zhvilluesit M. J., me datë aplikimi 17.04.2025, për objektin: *"Njësi Akomodimi dhe Shërbimi Bar-Restorant me zhvillues Shoqërinë Agroturizëm J-Bashkia Has".*

1. Është bërë njoftimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë e cila është likuiduar nga aplikuesi, por nuk dokumentohet mënyra e përllogaritjes së taksës dhe në njoftimin për pagesën e saj nuk përcaktohet vlera që duhet paguar.

5. <u>Sipas regjistrit elektronik nr. 189</u> në emër të zhvilluesit M. LL., me datë aplikimi 07.06.2025, për objektin: *"Njësi Akomodimi dhe Shërbimi Bar-Restorant me zhvillues Shoqërinë Agroturizëm J-Bashkia Has".*

1. Nuk administrohet kërkesa për t'u pajisur me leje ndërtimi sipas formatit të përcaktuar, në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (a) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
2. Konstatohet mangësi me planvendosjen. Sipas hartës së paraqitur në pasaportën e njësisë me nr. HS_UB_A1_1/31, rezultojnë disa objekte brenda parcelës, të cilat nuk janë pasqyruar në planvendosje.
3. Në faturën për arkëtim rezulton se është përcaktuar vlera për tu paguar, ndërkohë nuk evidentohet mënyra e përllogaritur por vetëm vlera prej 55,203 lekë TNI dhe 5,000 lekë tarifë vendore për leje ndërtimi.
Lidhur me mangësitë e mësipërme, për miratimin e lejes në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, ngarkohen me përgjegjësi D.Ç. - përllogaritës i TNI, N.B. – Drejtues, A.U. Kontrollues, Nëpunës – B. H., dhe Kryetari i Bashkisë Has - z. M. D.

2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)
2.6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi dhe mbi procedurat e ndjekura lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.

<u>Organizimi dhe funksionimi i IMTV Bashkia Has</u>
1.Përshkrimi i situatës.
Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Burimeve Njerëzore në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, rezulton se në strukturën e miratuar me

urdhër 95, datë 01.02.2023 është përcaktuar një pozicion Kryeinspektor territori pjesë e Sektorit të Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, ndërsa për secilën nga Njësitë Administrative Golaj, Fajza dhe Gjinaj nga një inspektor territori.
Në strukturën e miratuar me urdhër nr. 581, datë 22.06.2023, është përcaktuar një pozicion Kryeinspektor territori pjesë e Sektorit të Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, ndërsa për secilën nga Njësitë Administrative nga një inspektor territori.
Në strukturën e miratuar me urdhër nr. 35, datë 15.01.2024, rezulton një pozicion pune si inspektor territori (qendër), vendosur poshtë sektorit të planifikimit të territorit, por pa përcaktuar në varësi të kujt është ky punonjës, ndërsa për Njësitë Administrative ka nga një inspektor territorit.
Në strukturën e miratuar me urdhër nr. 12, datë 14.01.2025, rezulton një pozicion pune pjesë e Drejtorisë së Mbrojtjes Civile, por pa përcaktuar në varësi të cilit sektor është ky punonjës, ndërsa për Njësitë Administrative ka nga një inspektor territorit.

Sa më sipër, rezulton se kjo strukturë nuk ka organizim dhe nuk funksionon sipas kërkesave të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* i cili përcakton se,

Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse.

-Për periudhën objekt auditim 01.01.2023 deri 31.12.2025, Inspektorët e Territorit në Bashkinë Has janë si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Arsimi	Data e emërimit	Data e largimit nga puna
1	A.M.	Insp Qendër	IT	01.12.2022	13.02.2024
2	K. L.	Insp.Qendër	Biologji – Kimi	12.03.2024	16.07.2025
3	B. Q.	Insp.Qendër	I Mesëm	04.08.2025	Vijim
4	B. U.	Insp.Golaj	Mjekësi Veterinare	09.08.2023-01.07.2025	10.05.2024 Vijim
5	A. Gj.	Insp.Golaj	I Mesëm	05.07.2024	01.07.2025
7	A. B.	Insp.Golaj	Histori-Gjeografi	Janar 2023	Deri 14.07.2023
8	M.H.	Insp.Fajza	I Mesëm	Janar 2023	Korrik 2023
9	J. S.	Insp.Fajza	Drejtësi	12.12.2023	Vijim
10	G. Th.	Insp.Gjinaj	Adm.Biznes	12.10.2023	11.11.2024
11	F. D.	Insp.Gjinaj	Financë - bankë	11.11.2024	Vijim

Për sa më sipër, konstatohet se IMTV Bashkia Has, përgjatë periudhës objekt auditimi, ka rekrutuar pjesën më të madhe të stafit në në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"* i cili përcakton se:

Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

Thuajse gjithë inspektorët e cituar më sipër me përjashtim të një punonjësi me arsim për drejtësi, nuk kanë arsimimin e duhur për të ushtruar detyrën e inspektorit. Mungesa e stafit të kualifikuar, sidomos atij inxhinierik përbën mungesë cilësore për mbarëvajtjen e punës së inspektoratit, pasi

nuk kanë kualifikimet e nevojshme për të kryer akte kontrolli apo për të përcaktuar dhe përshkruar teknikisht situatat e konstatuara gjatë inspektimit.

3.6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi dhe mbi procedurat e ndjekura lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025, rezulton se secili nga Inspektorët sipas Njësive ka mbajtur praktikat e veta të konstatimit. Grupit të auditimit ju vu në dispozicion një dosje, në të cilën rezulton se në të gjitha rastet, procesverbali i konstatimit është në format A4 me të dhëna sipas modelit të procesverbalit të konstatimit, por i mungojnë të dhënat e numrit serial, pra nuk disponohet një bllok me të dhënat serial por janë fletë formati A4 të plotësuara me përshkrimin e situatës.

Në aneksin nr. 4 paraqiten dosjet me të dhënat e kundërvajtjeve për Bashkinë Qendër si dhe për Njësitë Administrative.

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025, janë mbajtur **160 procesverbale konstatimi** për subjekte që lidhen me shkelje për ndërtimet pa leje, nga të cilat rezulton se Bashkia Has ka aplikuar vetëm shkresë për njoftimin e subjektit kundërvajtës për pezullimin e punimeve, ndërkohë rezulton se në asnjë rast nuk është shoqëruar me vendim për vendosjen e gjobës, në kundërshtim me nenin 52 pika 1 germa (e) të ligjit nr. 107 "Për planifikimin e territorit" i ndryshuar, i cili përcakton se:

"Kundërvajtjet administrative"

e.Kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror, kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi...

Dhe pikës 5, 6, 7 të VKM nr. 894, datë 04.1.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore".

-Pavarësisht se Institucioni ka përcjellë njoftimet për pezullimin e punimeve, në asnjë rast nuk është shoqëruar me vendimin e pezullimit, veprim ky në kundërshtim me nenin 5 germa (ç) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"* i cili përcakton se:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:
ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

dhe pikës 5 të VKM nr. 894, datë 04.1.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore".

-Në asnjë nga rastet e evidentuara më sipër, Institucioni nuk ka nxjerr vendim për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm, veprim në kundërshtim me nenin 5 germa (d) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"* i cili përcakton se:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:
d) vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm;

Nenit 52, pika 6 e Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin e territorit" i ndryshuar, i cili përcakton se:

"Vendimi për prishjen e ndërtimeve përmban edhe detyrimin e prishjes së menjëhershme të ndërtimit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit"

si dhe pikën 1 germa (b.iv) të VKM nr. 894, datë 04.1.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore", i cili përcakton se,

*Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore, përfshin në kontrollin e tij punimin /zhvillimin/ndërtimin e një objekti të ri, **prishjen e objektit**, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore e nëntokësore, si dhe prishjen e objekteve që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.*

-Në praktikat e mësipërme, ka rezultuar gjithashtu në të gjitha rastet se Institucioni, nuk ka përcjellë kallëzime penale ndaj shtetasve/ subjekteve kundërvajtës, sipas përcaktimeve të nenit 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 cituar më sipër, i cili përcakton se,
Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

-Nga kontrolli i dokumentacionit, u konstatua se konstatimet e vitit 2023 nuk dispononinfotot e kundërvajtjeve, të cilat janë të nevojshme për pasqyrimin e faktit, ndërsa për vitet 2024 – 2025 disponohen. Mungesa e fotografive në konstatimet e kundërvajtjes për vitin 2023, është veprim në kundërshtim me nenin 41 "Të drejta të tjera të inspektorit", germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton se:

Inspektori, brenda objektit dhe qëllimit të inspektimit, ka edhe këto të drejta
a)të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjediseve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjediseve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit.

1. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se në mungesë edhe të strukturës së Inspektimit dhe personelit pa arsimin përkatës, nuk kanë miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar dhe nenin 51 "Inspektimi" të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore".
2. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se mungon informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar.
3.Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se Institucioni, për periudhën objekt auditimi nuk ka miratuar planet mujore të punës, veprim ky në kundërshtim me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore".

2.7. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.

2.7.1. Auditim mbi statusin e pronave të transferuara me VKM dhe rregjistrimin e tyre në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës.

2.7.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likujdimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

Në zbatim të pikës nr. 7 të programit të auditimit nr. 106/1 prot, datë 28.01.2026, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë;

- Lista e pasurive të paluajtshme të transferuar në Bashkinë Has;
- Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruar në kadastër;
- Inventari i fondit pyjor;
- Kontratat e lidhura për dhënien me qira të fondit pyjor;

I. PASURITË E PALUAJTSHME

Sipas ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*", që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t'u transferoheshin. Më poshtë janë VKM "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Has dhe të ish Komunave*".

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se, Bashkia Has ka 4 Njësi Administrative si dhe Bashkia Has (Bashkia Qëndër).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- Për **Bashkinë Has** (Bashkia Qendër) është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Has (Krumë), me VKM nr. 946 datë 02.09.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Krumë, (aktualisht Bashkia Has), të Qarkut të Kukësit", sipas lidhjes një, që i bashkangjitet këtij vendimi.

Lista me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë dhe përfundon me numrin rendor 383 (treqind e tetëdhjetë e tre).

- Për ish Komunën dhe aktualisht **Njësinë Administrative Gjinaj** është miratuar lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në ish komunën Gjinaj, me VKM nr. 792, datë 16.11.2006 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Gjinaj" të qarkut të Kukësit, sipas propozimit të Këshillit të komunës Gjinaj.

Lista me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 319 (treqind e nëntëmbëdhjetë).

- Për ish Komunën dhe aktualisht **Njësinë Administrative Golaj** është miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish komunës Golaj, me VKM nr. 105, datë 03.02.2008 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish komunës Golaj" të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes një që i bashkangjitet këtij vendimi.

Lista përfundon me numrin rendor 493 (katërqind e nëntëdhjetë e tre).

- Për ish Komunën dhe aktualisht **Njësinë Administrative Fajza** është miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të

të ish komunës Fajza, me VKM nr. 425, datë 08.04.2008 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish komunës Fajza" të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes një që i bashkangjitet këtij vendimi.
Lista përfundon me numrin rendor 229 (dyqind e njëzetë e nëntë).

Konkluzion:
Në lidhje me tre ish-komunat, konkretisht Njësia Administrative Gjinaj, Njësia Administrative Golaj dhe Njësia Administrative Fajza, rezulton se me vendime të Këshillit të Ministrave të vitit 2008 janë miratuar listat paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, për t'u transferuar në pronësi ose në përdorim të këtyre njësive vendore, sipas lidhjeve përkatëse bashkëlidhur vendimeve.
Nga auditimi konstatohet se nga ana e Bashkisë Has nuk është ndjekur procedura për përfundimin e këtij procesi, pasi mungon korrespondenca institucionale me ish-Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike pranë Ministrisë së Brendshme, për miratimin përfundimtar të listave të pronave që ndodhen brenda juridiksionit të këtyre njësive administrative.
Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën", kjo agjenci është shkrirë dhe kompetencat e saj i kanë kaluar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në këto kushte, Bashkia Has duhej të vijonte procedurat përkatëse pranë Drejtorisë Vendore të ASHK Kukës, për përfundimin e procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave publike në pronësi ose përdorim të saj.
Megjithatë, rezulton se Bashkia Has nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për vijimin e këtyre procedurave, duke mos realizuar transferimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike brenda juridiksionit të saj, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 67 të ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën", si dhe me nenin 37 të ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".
Konkluzion:
Bashkia Has nuk ka përgatitur dhe administruar dokumentacionin tekniko-ligjor të nevojshëm për pasuritë publike, duke mos realizuar evidentimin e tyre sipas zonave kadastrale dhe hartimin e hartave përkatëse (plan rilevime), në funksion të përfundimit të procesit të transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 3 të nenit 67 të ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën", ligjin nr. 72/2012, si dhe VKM nr. 782, datë 07.10.2020.
Bashkia Has, përmes strukturave përgjegjëse financiare, nuk ka planifikuar dhe përllogaritur në buxhet fondet e nevojshme për realizimin e plan rilevimeve, si dhe për procedurat e regjistrimit dhe pajisjes me certifikatë pronësie pranë ASHK-së. Kjo ka sjellë mosrealizimin e regjistrimit të pronave në pronësi/përdorim të Bashkisë, duke kufizuar ushtrimin e të drejtave mbi këto pasuri dhe duke penguar zhvillimin e territorit. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Në tabelën e mëposhtëme po paraqesim numërin e pronave të transferuara në pronësi, litën paraprake sipas VKM-ve si dhe sa nga këto prona janë pajisur me çertifikatë pronësie.

Nr.		***VKM***		***Në përdorim Në numër***	***Në pronësi Në numër***	***Reegjistruar***	***Nga këto Çertifikuar***
		Numër	***Datë***				
1.	Bashkia Has	268	02.09.2009	18	250	53	33
2.	Nj.A. Gjinaj	319	16.11.2006		319		
3.	Nj.A. Golaj	339	03.02.2008	38	301		
4.	Nj.A. Fajza	67	08.04.2008	8	59		

Në tabelën e mëposhtëme po paraqesim pronat e pajisura me çertifikatë pronësie

Nr.	Zona Kadastrale	Nr. Pasuri	Lloji	Sip. m²	Pronësi/ Përdorim	Vëndi	Data
1	2282. KR-C-3	**4/167**	Truall	472	Përdorim	Qyteti Krumë	10.04.2017
2	2282. KR-D-3	**1/81-ND**	Ndërtesë	100	Përdorim	Qyteti Krumë	13.12.2018
3	2282. KR-D-4	**4/80-N1**	Njësi	77.85	Përdorim	Qyteti Krumë	02.09.2009
4	2282. KR-D-3	**4/209**	Shesh	1148	Pronësi	Qyteti Krumë	11.04.2017
5	2282. KR-D-3	**4/210**	Shesh	506	Pronësi	Qyteti Krumë	21.02.2022
6	2282. KR-D-3	**4/191**	Shesh	592	Pronësi	Qyteti Krumë	21.02.2022
7	2282. KR-D-3	**4/38**	Shesh	754	Pronësi	Qyteti Krumë	21.02.2022
8	2282. KR-D-3	**4/212**	Shesh	62	Pronësi	Qyteti Krumë	21.02.2022
9	2282. KR-D-3	**4/35**	Shesh	704	Pronësi	Qyteti Krumë	21.02.2022
10	2282. KR-D-3	**4/213**	Shesh	355	Pronësi	Qyteti Krumë	21.02.2022
11	2282. KR-D-4	**4/171**	Shesh	1026	Pronësi	Qyteti Krumë	09.07.2025
12	2282. KR-D-4	**4/225**	Shesh	14	Pronësi	Qyteti Krumë	10.07.2025
13	2282. KR-D-4	**4/78**	Shesh	1050	Pronësi	Qyteti Krumë	09.07.2025
14	2282. KR-D-4	**4/57**	T. Sportiv	3557	Pronësi	Qyteti Krumë	27.06.2019
15	2282. KR-D-4	**4/114**	Shesh	760	Pronësi	Qyteti Krumë	27.06.2019
16	2282. KR-D-4	**4/79**	Shesh	172	Pronësi	Qyteti Krumë	09.07.2025
17	2282. KR-D-4	**4/100**	Shesh	95	Pronësi	Qyteti Krumë	09.07.2025
18	2282. KR-D-4	**4/102**	Shesh	154	Pronësi	Qyteti Krumë	09.07.2025
19	2282. KR-D-4	**4/103**	Shesh	105	Pronësi	Qyteti Krumë	09.07.2025
20	2282. KR-D-4	**4/109**	Shesh	175	Pronësi	Qyteti Krumë	09.07.2025
21	2282. KR-D-4	**5/47**	Shesh	495	Pronësi	Qyteti Krumë	09.07.2025
22	2282. KR-D-4	**5/49**	Shesh	317	Pronësi	Qyteti Krumë	09.07.2025
23	2282. KR-D-4	**5/52**	Shesh	423	Pronësi	Qyteti Krumë	09.07.2025
24	2282. KR-D-4	**5/77**	Shesh	406	Pronësi	Qyteti Krumë	09.07.2025
25	2282. KR-D-4	**5/55**	Shesh	217	Pronësi	Qyteti Krumë	09.07.2025
26	2282. KR-D-4	**5/65**	Shesh	259	Pronësi	Qyteti Krumë	07.02.2022
27	2282. KR-D-3	**5/66**	Rrugë	169	Pronësi	Qyteti Krumë	07.02.2022
28	2282. KR-D-3	**5/67**	Shesh	255	Pronësi	Qyteti Krumë	07.02.2022
29	2282. KR-D-4	**5/345**	Shesh	81	Pronësi	Qyteti Krumë	07.02.2022
30	2282. KR-D-3	**5/273**	Shesh	296	Pronësi	Qyteti Krumë	07.02.2022
31	2282. KR-D-3	**5/22**	Shesh	1379	Pronësi	Qyteti Krumë	30.06.2021
32	2282. KR-D-3	**5/299**	Shesh	271	Pronësi	Qyteti Krumë	07.02.2022
33	2282. KR-D-3	**4/249**	Shesh	298	Përdorim	Qyteti Krumë	02.10.2019

Konkluzion:
Nga totali prej 993 pasurish të transferuara në pronësi të Bashkisë Has me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM), rezulton se vetëm 53 pasuri janë regjistruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK) Kukës.
Nga këto 53 pasuri të regjistruara, Bashkia Has ka aplikuar dhe është pajisur me certifikatë pronësie vetëm për 33 pasuri. Ndërkohë, për 20 pasuri të tjera, të cilat rezultojnë të regjistruara në emër të Bashkisë, nuk është kryer aplikimi për pajisje me certifikatë pronësie, si dhe për sigurimin e dokumentacionit përkatës (kopje kartele dhe harte).
Kjo situatë tregon për mangësi në ndjekjen e procedurave administrative nga ana e Bashkisë Has për plotësimin e dokumentacionit të pronësisë, duke krijuar pasiguri juridike mbi administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive.

Bashkia Has ka vetëm një kontratë nr 832, datë 18.04.2023 për dhënie me qira të objektit me numër pasurie **4/80-N1,** ndërtesë me sipërfaqe 88.96 m2 për një total prej 360,000 lekë në vit apo 30,000 lekë në muaj.
Likujdimet nga ana e subjektit, për vitet objekt auditimi, 2023,2024 dhe 2025, janë kryer konformë kontratës.

- **Pyjet dhe Kullotat**, në bazë të **VKM nr. 433 datë 08.06.2016** "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", sipas pikës nr. 42 të VKM-së, si dhe sipas shtojcës nr. 40 bashkëlidhur këtij vendimi e cila përmban sipërfaqet pyjore dhe kullosore, sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të Bashkisë Has, listë e cila fillon me nr. rendor 1 (një) dhe mbaron me nr. rendor 1242 (Një mijë e dyqind e dyzetë e dy). Totali i sipërfaqes së transferuar është **34.210.85 ha,** sipërfaqe e cila i përket 1242 ngastra.

Gjithashtu në bazë të **VKM nr. 684 datë 02.09.2020** "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 433, datë 08.06.2016", "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", të ndryshuar, pika d) saktëson se numri rendor për sipërfaqet pyjore dhe kullësore 186 (një qind e tetëdhjetë e gjashtë), zëvendësohet me 281 (dyqind e tetëdhjetë e një). Ky saktësim është kryer pas regjistrimit të pasurive pyje dhe kullota të kryera si rrjedhojë e projektit të Ministrisë e Mjedisit dhe Turizmit në bashkëpunim me Bankën Botërore" për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave".

Në mënyrë të përmbledhur po paraqesim ndryshimet që janë bërë në Fondin Pyjor/Kullosor, për pronat e transferuar në pronësi të bashkisë Has me VKM 433, datë 08.06.2016 si dhe ndryshimet me **VKM nr. 684 datë 02.09.2020** "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 433, datë 08.06.2016", "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive"

Lloji	**VITI**	
	Sip Ha sipas VKM 433	**Sip Ha sipas VKM 684**
	Datë 08.06.2020	**Datë 02.09.2020**
Pyje	25109.5	25763.39
Kullote	8458.4	7544.65
Shkembore	5.25	552.05
Inproduktive	606.8	
Djerr	24.6	
Sip Boshe	1	
Kenete/Moçal	5.3	
Totali	**34,210.85 ha/1242 ngastra**	**33,860.09 ha/1209 ngastra**

Në Bashkinë Has, sipërfaqet pyjore dhe kullosore janë ndarë në 4 ekonomi pyjore dhe kullosore si më poshtë vijon;

Nr.	**ID ekonomisë Pyjore/kullosore**	**Emërtimi i ekonomisë pyjore/kullosore**
1	KU 26	EP Krumë
2	KU 25	EP Helshan
3	KU 41	EP Tregtan
4	KU 39	EP Tejdrini i Bardhë

Të katër ekonomitë pyjore janë të pajisura me **plane menaxhimi të miratuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** Urdhrin nr.329 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, date 26.10.2022, "Pér miratimin e planeve të mbarështrimit të ekonomive pyjore Helshan, Krumë, Tregtan dhe Tejdrini i Bardhë, Bashkia Has. Këto plane mbarështrimi janë **miratuar nga Këshilli Bashkiak** me VKB nr. 27, datë 30.03.2022 dhe **janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 03/11, datë 12.04.2022**.

Pasuritë e transferuara në pronësi të Bashkisë Has, pjesë përbërëse e fondit pyjor/kullosor, të cilat janë të regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Kukës janë ndarë në 1209 ngastra por nga këto vetëm 37 pasuri janë pajisur me certifikatë pronësie.
Në tabelën e mëposhtëme po paraqesim pasuritë pyje/kullota të pajisura me certifikatë pronësie

Pasuritë e pajisura me certifikatë pyjet dhe kullotat deri në vitin 2025					
Nr.	**Nr. Pasurisë**	**Zona Kadastrale**	**Lloji i Pasurisë**	**Sipërfaqja në m2**	**Data e Çertifikatës**
1	367	2760	Shkëmbore	59,153	14.10.2025
2	366	2760	Shkëmbore	71,620	14.10.2025
3	365	2760	Kullotë	91,769	14.10.2025
4	364	2760	Pyll	78,845	14.10.2025
5	336	2760	Pyll	295,161	14.10.2025
6	335	2760	Kullotë	14,429	14.10.2025
7	338	2760	Pyll	75,993	14.10.2025
8	20	3911	Pyll	647,733	20.10.2025
9	20	2910	Pyll	240,905	20.10.2025
10	1	3911	Pyll	411,843	20.10.2025
11	78	2674	Kullotë	427,238	20.10.2025
12	70	2674	Pyll	811,112	30.10.2025
13	1010	1950	Pyll	12,558,647	01.11.2025
14	51	1788	Pyll	613,810	11.11.2025
15	49	1788	Pyll	723,348	11.11.2025
16	211	3749	Kullotë	657,925	04.11.2025
17	208	3794	Kullotë	5,508,434	04.11.2025
18	210	3794	Kullotë	1,213,661	04.11.2025
19	209	3794	Shkëmbore	140,813	04.11.2025
20	211	3794	Kullotë	657,925	04.11.2025
21	44	2283	Pyll	910,129	08.08.2024
22	53	2283	Pyll	167,284	07.02.2025
23	546	1740	Shkëmbore	2,145,795	25.04.2025
24	565	1740	Pyll	1,548,285	24.04.2025
25	546/3	1740	Kullotë	277,634	16.06.2025
26	546/2	1740	Kullotë	433,799	16.06.2025
27	565/1	1740	Kullotë	62,267	16.06.2025
28	81	3085	Pyll	79,303	07.02.2025
29	6	3012	Pyll	86,855	26.11.2024
30	9	3012	Pyll	224,201	26.11.2024
31	1	3012	Pyll	2,558,149	26.11.2024
32	343	2760	Pyll	283,457	10.08.2024
33	455	3073	Pyll	129,258	23.05.2023
34	348/1	2760	Pyll	258,831	16.06.2023
35	25/3	2950	Kullotë	5,304,400	27.12.2024
36	32	2950	Kullotë	2,986,000	24.01.2025
37	40	3085	Kullotë	354,655	31.10.2025
TOTALI				**43,110,666**	

<u>Subjektet që kanë në përdorim fondin pyjor/kullosor i cili është në pronësi të Bashkisë Has</u>

Në tabelat e mëposhtëme po paraqesim subjektet që kanë në përdorim fondin pyjor/kullosor i cili është në pronësi të Bashkisë Has, specifikimet e kontratave në lidhje me sipërfaqet e marra në përdorim, kohëzgjatjen e tyre sipas subjekteve si dhe detyrimin vjetor dhe progresiv për secilin subjekt për periudhën objekt auditimi 2023-2025.

Lista e subjekteve të cilët kanë marrë në përdorim sipërfaqe fond pyjor për vitin 2023

2023										
Nr	**Subjekti**	**Kontrata**	**Data**	**Sip(ha)**	**Afati/Vite**	**Aktiviteti**	**Qira/vit**	**Detyrimi(2023)**	**Paguar(2023)**	**Progresive**
1	"F." SH.P.K.	Nr. 03	2015	0.63	9	HEC	465,000.00	465,000.00		**3,171,900.00**
2	"E. C"	Nr. 557	10.03.2023	0.78	1	Shesh Depozitimi	156,940.00	156,940.00	156,940.00	**0.00**
3	Fabrika e Pasurimit te Kromit "P."	Nr. 71	29.07.2019	10.16	10	Shesh Depozitimi	827,515.00	827,515.00	827,515.00	**0.00**
4	"O. A" SH.A.	Nr. 4063/6	01.11.2021	0.03	9	Antena	261,500.00	261,500.00	261,500.00	**0.00**
5	"A. T." SH.A.	Nr. 1836	09.12.2019	0.02	9	Antena	160,000.00	160,000.00	160,000.00	**0.00**
6	"V. A"	Nr. 3126	19.06.2019	0.03	9	Antena	369,500.00	369,500.00	369,500.00	**739,000.00**
7	"V. M"	Nr. 22	01.07.2019	7.048	6	Shesh Depozitimi	549,744.00	549,744.00	549,744.00	**0.00**
8	"V. M"	Nr. 23	01.07.2019	0.05	6	Shesh Depozitimi	100,000.00	100,000.00	100,000.00	**0.00**
9	"N." 2004		2023	0.5	1	Shesh Depozitimi	39,000.00	39,000.00	39,000.00	**0.00**
10	"N." 2004		2023		1	Shesh Depozitimi	100,000.00	100,000.00	100,000.00	**0.00**
11	"V. M. A."	Nr. 2621	15.12.2020	0.672	Akt marrveshje	Shesh Depozitimi	52,416.00	52,416.00	52,416.00	**0.00**
12	"K." SH.P.K.	Nr. 654	25.03.2022	0.25	10	Gurore	110,000.00	110,000.00	110,000.00	**0.00**
13	"F. B."	Nr. 868	20.04.2023	0.1	10	Fond pyjor	82,500.00	82,500.00	82,500.00	**0.00**
14	"F. K."	Nr. 1109	18.05.2022	0.6303	10	Fond pyjor	47,903.00	47,903.00	47,903.00	**0.00**
15	"E. G. E"	Nr. 1395	06.10.2022	7.25	10	Fond pyjor	1,522,500.00	1,522,500.00	1,522,500.00	**0.00**
16	"F. K."	Nr. 2261	19.10.2022	0.41	10	Fond pyjor	33,825.00	33,825.00	33,825.00	**0.00**
							TOTAL	**4,878,343.00**	**4,413,343.00**	**3,910,900.00**

Lista e subjekteve të cilët kanë marrë në përdorim sipërfaqe fond pyjor për vitin 2024

2024											
Nr	**Subjekti**	**Kontrata nr/datë**	**Data**	**Sip(ha)**	**Afati/Vite**	**Aktiviteti**	**Qira/vit (Lekë)**	**Progres (2023)**	**Detyrimi (2024)**	**Paguar (2024)**	**Progres (2024)**
1	'F." SH.P.K.	Nr. 03	2015	0.63	9	HEC		**3,171,900.00**	0.00	91,350.00	**3,080,550.00**
2	Fabrika e Pasurimit te Kromit "P."	Nr. 71	29.07.2019	10.16	10	Shesh Depozitimi	827,515.00	**0.00**	827,515.00	827,515.00	**0.00**
3	"O .A ." SH.A.	Nr. 4063/6	01.11.2021	0.03	9	Antena	261,500.00	**0.00**	261,500.00	261,500.00	-
4	"A. T." SH.A.	Nr. 1836	09.12.2019	0.02	9	Antena	160,000.00	**0.00**	160,000.00	160,000.00	**0.00**

5	"V. A."	Nr. 3126	19.06.2019	0.03	9	Antena	369,500.00	**739,000.00**	369,500.00	739,000.00	**369,500.00**
6	"V. M."	Nr. 22	01.07.2019	7.048	5	Shesh Depozitimi	549,744.00	**0.00**	549,744.00	549,744.00	**0.00**
7	"V. M."	Nr. 23	01.07.2019	0.05	5	Shesh Depozitimi	100,000.00	**0.00**	100,000.00	100,000.00	**0.00**
8	"V. M. A."	Nr. 1655	20.05.2024	1.723	1	Shesh Depozitimi	42,791.00	**0.00**	42,791.00	42,791.00	**0.00**
9	"K. I." SH.P.K.	Nr. 654	25.03.2022	0.25	10	Gurore	110,000.00	**0.00**	110,000.00	110,000.00	**0.00**
10	"F. B."	Nr. 868	20.04.2023	0.1	10	Fond pyjor	82,500.00	**0.00**	82,500.00	82,500.00	**0.00**
11	"F. K."	Nr. 1109	18.05.2022	0.6303	10	Fond pyjor	47,903.00	**0.00**	47,903.00	47,903.00	**0.00**
12	"E. G. E"	Nr. 1395	06.10.2022	7.25	10	Fond pyjor	1,522,500.00	**0.00**	1,522,500.00	1,522,500.00	**0.00**
13	"Pj. E." SH.P.K.	Nr. 2070	25.06.2024	6.76	10	Fond pyjor	1,189,760.00	**0.00**	1,189,760.00	1,189,760.00	**0.00**
14	"P. P." SH.P.K.	Nr. 3897	05.12.2024	77.37	10	Fond pyjor	13,617,120.00	**0.00**	13,617,120.00	0.00	**13,617,120.00**
15	"Sh." ISP	Nr. 3787	25.11.2024	0.0054	1	Fond pyjor	45,475.00	**0.00**	45,475.00	45,475.00	**0.00**
16	"H." SH.P.K.	Nr. 308	24.01.2024	20	1	Fond pyjor	3,520,000.00	**0.00**	3,520,000.00	0.00	**3,520,000.00**
17	"F. K."	Nr. 2261	19.10.2022	0.41	10	Fond pyjor	33,825.00	**0.00**	33,825.00	33,825.00	**0.00**
							TOTAL	**3,910,900.00**	**22,480,133.00**	**5,803,863.00**	**20,587,170.00**

Lista e subjekteve të cilët kanë marrë në përdorim sipërfaqe fond pyjor për vitin 2025

2025											
Nr	**Subjekti**	**Kontrata**	**Data**	**Sip(ha)**	**Afati/ Vite**	**Aktiviteti**	**Qira/vit (Lekë)**	**Progres (2024)**	**Detyrimi (2025)**	**Paguar (2025)**	**Progres (2024)**
1	"F." SH.P.K.	Nr. 03	2015	0.63	9	HEC		3,080,550.00	0.00	91,350.00	**2,989,200.00**
2	Fabrika e Pasurimit te Kromit "P."	Nr. 71	29.07.2019	10.16	10	Shesh Depozitimi	827,515.00	0.00	827,515.00	827,515.00	**0.00**
3	"O. A." SH.A.	Nr. 4063/6	01.11.2021	0.03	9	Antena	261,500.00	-	261,500.00	261,500.00	-
4	"A. T." SH.A.	Nr. 1836	09.12.2019	0.02	9	Antena	160,000.00	0.00	160,000.00	160,000.00	**0.00**
5	"V. A."	Nr. 3126	19.06.2019	0.03	9	Antena	369,500.00	369,500.00	369,500.00	628,120.00	**110,880.00**
6	"V. M."	Nr. 22	01.07.2019	7.048	6	Shesh Depozitimi	549,744.00	0.00	549,744.00	549,744.00	**0.00**
7	"V. M."	Nr. 23	01.07.2019	0.05	6	Shesh Depozitimi	100,000.00	0.00	100,000.00	100,000.00	**0.00**
8	"K. I." SH.P.K.	Nr. 654	25.03.2022	0.25	10	Gurore	110,000.00	0.00	110,000.00	110,000.00	**0.00**
9	"F. B."	Nr. 868	20.04.2023	0.1	10	Fond pyjor	82,500.00	0.00	82,500.00	82,500.00	**0.00**
10	"F. K"	Nr. 1109	18.05.2022	0.6303	10	Fond pyjor	47,903.00	0.00	47,903.00	47,903.00	**0.00**
11	"E. G. E."	Nr. 1395	06.10.2022	7.25	10	Fond pyjor	1,522,500.00	0.00	1,522,500.00	1,522,500.00	**0.00**
12	"P. E." SH.P.K.	Nr. 2070	25.06.2024	6.76	10	Fond pyjor	1,189,760.00	0.00	1,189,760.00	1,189,760.00	**0.00**
13	"P. P." SH.P.K.	Nr. 3897	05.12.2024	77.37	10	Fond pyjor	13,617,120.00	13,617,120.00	13,617,120.00	0.00	**13,617,120.00**
14	"H." SH.P.K.	Nr. 308	24.01.2024	20	1	Fond pyjor	3,520,000.00	3,520,000.00	3,520,000.00	0.00	**3,520,000.00**
14	"F. K."	Nr. 2261	19.10.2022	0.41	10	Fond pyjor	33,825.00	0.00	33,825.00	33,825.00	**0.00**
15	"2R. G."	Nr. 2525	21.07.2025	2	1	Gurore	192,000.00	0.00	192,000.00	192,000.00	**0.00**
TOTAL								**20,587,170.00**	**22,583,867.00**	**5,796,717.00**	**20,237,200.00**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezulton se subjektet që kanë në përdorim fondin pyjor/kullosor në pronësi të bashkisë Has, sipas tabelës së mësipërme, kanë akumuluar një debi progresive për vitin 2023 për një total prej 3,910,900 lekë, për vitin 2024 një debi progresive prej 20,587,170 lekë dhe për vitin 2025 një debi progresive prej 20,237,200 lekë.

Vlen të theksohet se për detyrimet ndër vite, nga ana e Bashkisë Has, nuk janë llogaritur kamat vonesa për venesat mbi likujdimet e detyrimeve nga ana e subjekteve debitorë.

- ***Kontrata ndërmjet subjektit "F." Sh.P.K dhe Bashkisë Has.***

Nga dokumentacioni vënë në dispozicion të grupit të auditimit është konstatuar se debia e krijuar deri vitin 2023, nga subjektet që kanë marrë në përdorim fondin pyjor/kullosor i cili është në pronësi të bashkisë Has, vjen si pasojë e subjektit debitor "F." Sh.P.K, subjekt i cili ka akumuluar një debi prej **3,171,900 lekë** deri datë 31.12.2023.

Nga auditimit konstatohet se ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Kukës dhe subjektit "F."Sh. P. K. është lidhur kontrata nr. 03 prot., datë 12.01.2015.

Me anë të kësaj kontrate qiradhënësi i jep në përdorim qiramarrësit një sip. prej 0.63 ha, pjesë e Ekonomisë Pyjore Krumë, për një afat 9 vjeçar duke nisur që nga data e lidhjes së kontratës 12.01.2015 dhe për një total prej 491,000 lekë për vitin e parë dhe 465,000 lekë për 8 (tetë) vitet e ardhshme, vlerë e llogaritur sipas studimit tekniko ekonomik të kryer nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Kukës, datë 01.12.2024, për dhënien në përdorim të Fondit pyjor dhe kullososr në pronësi publike, për ndëretimin e HEC-it nga ana e subjektit "F." Sh.P.K.

Gjithashtu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive", ku sipas pikës nr. 1 të VKM citohet, "Sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas listave të inventarit, infrastruktura mbështe tëse e tyre, asetet, arkivi dhe protokolli, aktualisht, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mjedisit, si edhe sipërfaqet e fondit pyjor e kullosor publik dhe infrastruktura mbështetëse e tyre, që i janë transferuar ish-komunave e bashkive, transferohen në pronësi të bashkive." Dhe sipas pikës mr. 2 të VKM citohet, "Të drejtat dhe detyrimet e personave fizikë/ juridikë të fituara me kontratat ekzistuese për marrjen në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor vazhdojnë deri në përfundimin e tyre, sipas parashikimeve kontraktore dhe legjislacionit në fuqi.", pra detyrimet e qiramarrësit si dhe të qiradhënësit duhet të qëndronin të pandryshueshme si për sipërfaqen e marrë në përdorim nga ana e subjektit "F." Sh.P.K. prej 0.63 ha dhe si për qiranë vjetore 465,000 lekë/vit.

Por konstatohet se nga ana e Bashkisë Has, me shkresën nr. 03 prot, datë 01.06.2016, është nënshkruar një aneks kontratë qiraje ku çmimi qirasë vjetore, për të njëjtën sipërfaqe dhe me të njëjtat parametra studimor, vendoset në 91,350 lekë/vit, çmim i pabazuar në asnjë studim tekniko-ekonomik dhe i paargumentuar, nga ana e Bashkisë Has.

Gjithashtu duhet theksuar se Aneks-Kontrata ndërmjet subjektit "F." Sh.P.K dhe Bashkisë Has, është nënshkruar datë 01.06.2016 ndërsa VKM nr 433, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive" është më datë 08.06.2026, pra kontra është nënshkruar para daljes së VKM nr. 433, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive" që do të thotë se është nënshkruar para transferimit të pyjeve dhe të kullotave publike në pronësi të Bashkive.

Në tabelën e mëposhtëme po paraqesim pagesat e kryera nga ana e subjektit "F." Sh.P.K. gjatë periudhës 2015-2025 si dhe detyrimin e akumuluar.

Pagesat e kryera nga subjekti "F." Sh.P.K. si dhe detyrimi progresiv për periudhën 2015-2025.

Viti	Qira/Vit	Pagesa/Vit	**Debi Progresive**
2015	491,000	491,000	**0**
2016	465,000	91,350	**373,650**
2017	465,000	91,350	**747,300**
2018	465,000	91,350	**1,120,950**
2019	465,000	91,350	**1,494,600**
2020	465,000	91,350	**1,868,250**
2021	465,000	91,350	**2,241,900**
2022	465,000	0	**2,706,900**
2023	465,000	0	**3,171,900**
2024	0	91,350	**3,080,550**
2025	0	91,350	**2,989,200**

Aktualisht subjekti "F." Sh.P.K vazhdon veprimtarinë edhe pas mbarimit të kontratës dhe është në process gjyqsor me Bashkinë Has.

- ***Kontrata ndërmjet subjektit "P. P." Sh.P.K dhe Bashkisë Has.***

Nga dokumentacioni vënë në dispozicion të grupit të auditimit është konstatuar se me shkresë nr 3897 prot, datë 05.12.2024, është firmosur një kontratë ndërmjet subjektit "P. P." Sh.P.K dhe Bashkisë Has për dhënien me qira të një sipërfaqe prej 77.37 ha, fond pyjor në pronësi të Bashkisë Has, sipërfaqe e cila do të përdorej nga ana e qiramarrësit për qëllime studimi të territorit për ndërtimin e një Centrali Fotovoltaik, "P. P. S.". Kjo kontratë është lidhur ndërmjet palëve për një afat 10 vjecar dhe për një total 13,617,120 lekë/vit. Çmimi i qirasë është bazuar në relacionin shpjegues nr. 3500 prot, datë 30.10.2024 të përpiluar nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor në Bashkinë Has si dhe VKM nr. 559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore."
Subjekti "P. P." Sh.P.K rezulton se nuk ka përmbushur termat e Kontratës mbi pagesën e qirasë, neni nr. 4, "Pagesa dhe regjimi i saj" pika 2, ku specifikohet se "pagesa e qirasë do të bëhet sipas kushteve të kësaj kontrate me bazë vjetore brenda 10 ditëve nga firmosja e kësaj kontrate", neni nr.5, "Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit", pika 1, "Qiramarrësi ka të drejtë të fillojë procedurat për zgjidhje të njëanshme në rast se qiramarrësi nuk kryen pagesën vjetore dhe në rast se nuk kryen pagesat e kamatëvonesave për një periudhë tre mujore" si dhe neni nr. 6 i kësaj kontrate, "Të drejtat dhe detyrimet e Qiramarrësit", pika 2, gërma c) ku citohet, "Qiramarrësi ka për detyrë të shlyejë në kohë dhe në mënyrë korrekte vlerën e qirasë të përcaktuar në kontratë".
Nga ana e Bashkisë Has është bërë njoftim për pagesë detyrimi (Pagesë Fond Pyjor Kullosor) me anë të shkresës nr. 1429/2 prot, datë 30.04.2025 por nuk është vazhduar me kërkesë për bllokimin e llogarive të subjektit debitor "P. P." Sh.P.K, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni nr. 90, "Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit", pika 1 ku citohet, "Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore, nëpërmjet një urdhri me shkrim, të lëshuar nga drejtori i drejtorisë përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të papaguara apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, apo titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore, i kërkon çdo banke shqiptare të nivelit të dytë, sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat me postë rekomande ose në

rrugë elektronike, ku tatimpaguesi ka llogari në emër të vet, të bllokojë një shumë, e cila duhet të jetë më e vogla ndërmjet: a) shumës që kërkohet të mbahet; b) shumës, që rezulton në atë çast në llogarinë bankare të tatimpaguesit.
Shuma e bllokuar kalon për llogari të administratës tatimore sipas procedurës së përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.", si dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, të Ministrit të Financave, pika 90, "Urdhëri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit"
Me shkresën nr. 4483 prot., datë 10.12.2025, "Njoftim për zgjidhje kontrate të qirasë" është njoftuar subjekti "P. P." Sh.P.K, si dhe për dijeni Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për zgjidhjen e kontratës ndërmjet "P. P." Sh.P.K, dhe Bashkisë Has për arsye të mosrespektimit të kontratës nga ana e subjektit, për mospagesë të qirasë.

- ***<u>Kontrata ndërmjet subjektit "H." Sh.P.K dhe Bashkisë Has.</u>***

Nga dokumentacioni vënë në dispozicion të grupit të auditimit është konstatuar se me shkresë nr 308 prot, datë 24.01.2024, është firmosur një kontratë ndërmjet subjektit "H." Sh.P.K dhe Bashkisë Has për dhënien me qira të një sipërfaqe prej 20 ha, fond pyjor në pronësi të Bashkisë Has, sipërfaqe e cila do të përdorej nga ana e qiramarrësit për qëllime studimi të territorit për ndërtimin e një Impianti Fotovoltaik. Kjo kontratë është lidhur ndërmjet palëve për një afat 5+5 vjecar dhe për një total 3,520,000 lekë/vit. Çmimi i qirasë është bazuar në relacionin shpjegues nr. 3500 prot, datë 30.10.2024 të përpiluar nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor në Bashkinë Has si dhe VKM nr. 559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.
Subjekti "H." Sh.P.K rezulton se nuk ka përmbushur termat e Kontratës mbi pagesën e qirasë, neni nr. 4, "Pagesa dhe regjimi i saj" pika 2, ku specifikohet se "pagesa e qirasë do të bëhet sipas kushteve të kësaj kontrate me bazë vjetore", neni nr.5, "Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit", pika 1, "Qiramarrësi ka të drejtë të fillojë procedurat për zgjidhje të njëanshme në rast se qiramarrësi nuk kryen pagesën vjetore dhe në rast se nuk kryen pagesat e kamatëvonesave për një periudhë tre mujore" dhe neni nr. 6 i kësaj kontrate, "Të drejtat dhe detyrimet e Qiramarrësit", pika 2, gërma c) ku citohet, "Qiramarrësi ka për detyrë të shlyejë në kohë dhe në mënyrë korrekte vlerën e qirasë të përcaktuar në kontratë".
Nga ana e Bashkisë Has me shkresën 273 prot., datë 27.01.2025, është bërë njoftimi për zgjidhje të njëanshme të kontratës ndërmjet subjektit "H." Sh.P.K dhe Bashkisë Has për dhënien me qira të një sipërfaqe prej 20 ha, fond pyjor në pronësi të Bashkisë Has për mospagesë të detyrimeve të subjektit në mospërputhje me termat e kontratës.
Gjithashtu është bërë njoftim për pagesë detyrimi (Qera Fond Pyjor Kullosor) me anë të shkresës nr. 2262 prot, datë 08.07.2025 si dhe është vazhduar me kërkesë për bllokimin e llogarive të subjektit debitor "H." Sh.P.K, me shkresën nr. 2358 prot, datë 08.07.2025, shkresë që u është dërguar Bankave të nivelit të dytë si më poshtë vijon;
Bankës Raiffeisen Bank, Dega Has
Bankës Kombëtare Tregtare, Dega Kukës
Bankës Union Bank, Dega Kukës
Bankës Credins Bank, Dega Kukës
Bankës Tirana Bank, Dega Kukës
Aktualisht subjekti "H." Sh.P.K është në process gjyqsor me Bashkinë Has.

Në tabelat e mëposhtëme po paraqesim subjektet apo personat fizik që kanë marrë me qira tokat bujqësore në pronësi të Bashkisë Has, specifikimet e kontratave në lidhje me sipërfaqet e marra me qira, kohëzgjatjen e tyre si dhe detyrimin vjetor dhe progresiv për periudhën objekt auditimi 2023-2025.

Tokat bujqësore të pandara me kontratë qiraje gjatë vitit 2023 si dhe debia progresive.

2023										
Nr	**Subjekti**	**Kontrata**	**Data**	**Sip(ha)**	**Afati**	**Aktiviteti**	**Qira/vit (Lekë)**	**Detyrimi (2023)**	**Paguar (2023)**	**Progresive (2023)**
1	"K. G."	Nr. 4	05.01.2021	8	30 vjeçar	Toke bujqesore	48,000	48,000	48,000	**0**
2	"K. N."	Nr. 794	11.12.2020	1.1607	30 vjeçar	Toke bujqesore	6,964	6,964	6,964	**0**
3	"S. Xh."		16.03.2021	2.15	30 vjeçar	Toke bujqesore	12,900	25,800	0	**25,800**
4	"S. N."		01.02.2021	1.5	30 vjeçar	Toke bujqesore	9,000	9,000	9,000	**0**
5	"A. M."	Nr. 1227	15.06.2023	8.96	10 vjeçar	Toke bujqesore	53,739	53,739	0	**53,739**
6	"E. I."	Nr. 624	21.03.2023	8.69	1 vjecar	Toke bujqesore	58,140	58,140	0	**58,140**
7	"E. I."	Nr. 623	21.03.2023	10.4	1 vjecar	Toke bujqesore	62,400	62,400	0	**62,400**
8	"G. I."	Nr. 621	31.03.2023	32.528	5 vjecar	Toke bujqesore	19,517	19,517	0	**19,517**
9	"G. I."	Nr. 621/1	21.03.2023	8.7582	1 vjecar	Toke bujqesore	52,549	52,549	0	**52,549**
10	"S. G."	Nr. 962	04.05.2023	4.5696	1 vjecar	Toke bujqesore	27,418	27,418	27,418	**0**
							TOTAL	**363,527**	**91,382**	**272,145**

Tokat bujqësore të pandara me kontratë qiraje gjatë vitit 2024 si dhe debia progresive.

2024											
Nr	**Subjekti**	**Kontrata**	**Data**	**Sip(ha)**	**Afati**	**Aktiviteti**	**Qira/vit (Lekë)**	**Progresive (2023)**	**Detyrimi (2024)**	**Paguar (2024)**	**Progresive (31.12.2024)**
1	"K. G."	Nr. 4	05.01.2021	8	30 vjeçar	Toke bujqesore	48,000		48,000		**48,000**
2	"K. N."	Nr. 794	11.12.2020	1.1607	30 vjeçar	Toke bujqesore	6,964		6,964		**6,964**
3	"S. Xh."		16.03.2021	2.15	30 vjeçar	Toke bujqesore	12,900	**25,800**	12,900		**38,700**
4	"S. N."		01.02.2021	1.5	30 vjeçar	Toke bujqesore	9,000		9,000	9,000	-
5	"A .M."	Nr. 1227	15.06.2023	8.96	10 vjeçar	Toke bujqesore	53,739	**53,739**	53,739		**107,478**
6	"E. I."	Nr. 624	21.03.2023	8.69	1 vjecar	Toke bujqesore	58,140	**58,140**			**58,140**
7	"E. I."	Nr. 623	21.03.2023	10.4	1 vjecar	Toke bujqesore	62,400	**62,400**			**62,400**
8	"G. I."	Nr. 621	31.03.2023	32.528	5 vjecar	Toke bujqesore	19,517	**19,517**	19,517		**39,034**
9	"M. L."	Nr. 1171	03.04.2024	10	1 vjecar	Toke bujqesore	60,000		60,000		**60,000**
10	"P. Xh."	Nr. 1157	02.04.2024	10	1 vjecar	Toke bujqesore	60,000		60,000		**60,000**
11	"H .Xh."	Nr. 1172	03.04.2024	10.3	1 vjecar	Toke bujqesore	61,800		61,800		**61,800**

12	“F. V.”	Nr. 2046	21.06.2024	1	10 vjecar	Toke bujqesore	6,000		6,000	6,000	-
13	“T. A.”	Nr. 2042	21.06.2024	1	10 vjecar	Toke bujqesore	6,000		6,000	6,000	-
14	“K. V.”	Nr. 2041	21.06.2024	1	10 vjecar	Toke bujqesore	6,000		6,000	6,000	-
15	“Sh. D.”	Nr. 2045	21.06.2024	1	10 vjecar	Toke bujqesore	6,000		6,000	6,000	-
16	“F. A.”	Nr. 2043	21.06.2024	1	10 vjecar	Toke bujqesore	6,000		6,000	6,000	-
17	“A. A.”	Nr. 2044	21.06.2024	1	10 vjecar	Toke bujqesore	6,000		6,000	6,000	-
							TOTAL	**219,596**	**367,920**	**45,000**	**542,516**

Tokat bujqësore të pandara me kontratë qiraje gjatë vitit 2025 si dhe debia progresive.

2025											
Nr	**Subjekti**	**Kontrata**	**Data**	**Sip(ha)**	**Afati**	**Aktiviteti**	**Qira/vit (Lekë)**	**Progresive (2024)**	**Detyrimi (2025)**	**Paguar (2025)**	**Progresive (31.12.2025)**
1	“K. G.”	Nr. 4	05.01.2021	8	30 vjeçar	Toke bujqesore	48,000	**48,000**	48,000	48,000	**48,000**
2	“K. N.”	Nr. 794	11.12.2020	1.1607	30 vjeçar	Toke bujqesore	6,964	**6,964**	6,964	13,928	-
3	“S. Xh.”		16.03.2021	2.15	30 vjeçar	Toke bujqesore	12,900	**38,700**	12,900	25,800	**25,800**
4	“S. N.”		01.02.2021	1.5	30 vjeçar	Toke bujqesore	9,000	-	9,000	9,000	-
5	“A. M.”	Nr. 1227	15.06.2023	8.96	10 vjeçar	Toke bujqesore	53,739	**107,478**	53,739	27,000	**134,217**
6	“E. I.”	Nr. 624	21.03.2023	8.69	1 vjecar	Toke bujqesore	58,140	**58,140**			**58,140**
7	“E. I.”	Nr. 623	21.03.2023	10.4	1 vjecar	Toke bujqesore	62,400	**62,400**			**62,400**
8	“G. I.”	Nr. 621	31.03.2023	32.528	5 vjecar	Toke bujqesore	19,517	**39,034**	19,517		**58,551**
9	“G. I.”	Nr. 621/1	21.03.2023	8.7582	1 vjecar	Toke bujqesore	52,549	**52,549**			**52,549**
10	“M. L.”	Nr. 1171	03.04.2024	10	1 vjecar	Toke bujqesore	60,000	**60,000**			**60,000**
11	“P. Xh.”	Nr. 1157	02.04.2024	10	1 vjecar	Toke bujqesore	60,000	**60,000**			**60,000**
12	“H.Xh.”	Nr. 1172	03.04.2024	10.3	1 vjecar	Toke bujqesore	61,800	**61,800**			**61,800**
13	“F. V.”	Nr. 2046	21.06.2024	1	10 vjecar	Toke bujqesore	6,000	-	6,000	6,000	-
14	“T. A.”	Nr. 2042	21.06.2024	1	10 vjecar	Toke bujqesore	6,000	-	6,000	6,000	-

15	"K. V."	Nr. 2041	21.06.2024	1	10 vjecar	Toke bujqesore	6,000	-	6,000	6,000	-
16	"Sh. D."	Nr. 2045	21.06.2024	1	10 vjecar	Toke bujqesore	6,000	-	6,000		**6,000**
17	"F. A."	Nr. 2043	21.06.2024	1	10 vjecar	Toke bujqesore	6,000	-	6,000		**6,000**
18	"A. A."	Nr. 2044	21.06.2024	1	10 vjecar	Toke bujqesore	6,000	-	6,000		**6,000**
19	"R. R."	Nr. 2772	11.08.2025	2	1 vjecar	Toke bujqesore	12,000	-	12,000	12,000	-
							TOTAL	**595,065**	**198,120**	**153,728**	**639,457**

Sukurse shihet edhe nga tabelat e mësipërme debia progresive për vitin 2025 ka arritur në 639,457 lekë.
Duhet theksuar se nga ana e Bashkisë Has nuk janë marrë masat për likujdimin e këtyre detyrimeve nga ana e qiramarrësve veprime këto jo në përputhje me

Këto veprime janë në mospërputhje me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, ku përcaktohet që: "Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit", Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni nr. 05, "Rregulla të përbashkëta për taksat vendore", pika ç), ligtji nr. 9920, datë19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, Kreu XI, "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar", neni nr. 88-104

3.8. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve, është si më poshtë:

- Detyrat e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën e KLSH-së, nr. 466/8, datë 11.09.2025
- Korespodenca shkresore e ndjekur nga Bashkia Has dhe KLSH.
- Dokumentacioni shoqërues dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve.
- Dokumentacioni i mbajtur nga Këshilli Drejtues për këtë qëllim, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:
-Bashkia Has ka dërguar brenda afatit 20 ditor, kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa "j", të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", sipas shkresës përcjellë në KLSH me nr. 3549.Prot, datë 03.10.2025.

-Bashkia Has, ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të neni 30, pika 2, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
Realizimi i rekomandimeve në mënyrë të detajuar pasqyrohet si më poshtë vijon:
Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016*"Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacioni që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH*".
Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Has për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "*Mbi auditimin e përputhshmërisë*" trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin **nr.134, datë 11.09.2025**, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 466/8 Prot, datë 11.09.2025 verifikohet se:

-Bashkia Has, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ka nxjerrë plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH dhe me shkresën nr.3549, datë 03.10.2025 "Program Pune, për zbatimin e detyrave të lëna të nga KLSH" ka dërguar kthimin e përgjigjes mbi zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin *15 germa "j", të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH paraqitet:

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse janë lënë **13 masa gjithsej**, nga të cilat **10** Masa Organizative, **1** masë për *eliminim e efekteve negative*, **1** masë për uljen e borxhit si dhe **1** masë disiplinore.
Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:
-Nga 10 masa organizative të rekomanduara, pranuar 100% nga subjekti. Nga këto janë zbatuar 3 masa, janë në proces 5 masa dhe 2 masa pazbatuar.
-Nga 1 masë për eliminim e efekteve negative, pranuar 100% nga subjekti, e cila nuk është zbatuar.
- Nga 1 masë për uljen e borxhit tatimor, pranuar 100% nga subjekti, rezulton e pa zbatuar.
- Masat disiplinore, nuk janë dhënë nga titullari i institucionit, rezultojnë të pazbatuara.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

I. Bashkia Has ka dërguar brenda afatit 20 ditor, kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa "j", të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", sipas shkresës përcjellë në KLSH me nr. 359/10.Prot, datë 12.06.2024.
II. Bashkia Has, ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr.1000, datë 13.03.2026, në zbatim të neni 30, pika 2, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

III. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak Has, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:
Bashkia Has ka hartuar planin e veprimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 3549.Prot, datë 03.10.2025 *"*Plan veprimi, për zbatimin e detyrave të lëna", por nuk ka raportuar rregullisht pranë Këshillit Bashkiak, veprime këto në kundërshtim me *Ligjin*

nr. 68/2017, datë 27.04.2017,"Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 50, pika 5, ku përcaktohet që: "Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë".

IV. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Has, janë rekomanduar gjithsej:

- **10** masa organizative,
- **1** masë për uljen e borxhit
- **1** masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.
- **1** masë disiplinore.

V. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Has, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Masat	Rekomanduar	Pranuar
Masa organizative	**10**	**10**
Masa për eliminimin e efekteve negative	**1**	**1**
Masa për uljen e borxhit tatimor	**1**	**1**
Masa disiplinore	**1**	**1**
Totali	**13**	**13**

VI. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga Bashkia Has:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces	Pjesërisht të zbatuar
Masa Organizative	10	3	2	5	
Masa për EEE	1		1		
Masa për Uljen e Borxhit	1		1		
Masa Disiplinore	1	1			
Total	**13**	**3**	**4**	**6**	

Nga verifikimi i dokumentacionit, në lidhje me *zbatimin e rekomandimeve të ri kërkuara* konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- ✓ Nga **3 masa organizative** të rekomanduara, pranuar 100% nga subjekti. Nga këto është **zbatuar 1 masë**, janë **në proces 2 masa**.
- ✓ **1 masë shpërblim dëmi** në vlerën **265,845 lekë**, pranuar 100% nga subjekti, **rezulton e pazbatuar**.
- ✓ Nga **2 masa për uljen e borxhit tatimor,** pranuar 100% nga subjekti, **rezultojnë 2 në proces.**
- ✓ **Nga 2 masa për eliminimin e efekteve negative,** pranuar 100% nga subjekti, **rezultojnë 2 pa zbatuar**.
- ✓ **Nga 2 masa për arkëtimin e detyrimeve nga taksat dhe qiradhënia,** pranuar 100% nga subjekti, **rezulton 1 në proces në shumën 44,002,268 lekë** dhe **1 e pa zbatuar në shumën 1,207,337 lekë.**

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces	Pjesërisht të zbatuar
Masa Organizative	3	1		2	
Masa për EEE	2		2		
Shpërblim dëmi	1		1		

Masa për Uljen e Borxhit	2			2	
Arketimin e detyrimeve	2		1	1	
Total	**10**	**1**	**4**	**5**	

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Has dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të merren masa për:

-Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, regjistrit të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.

-Vlerësimin e mundësisë së riskut për mashtrime dhe të kryhen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve, në mënyrë që vlerësimi i riskut të mashtrimit të bëhet pjesë integrale e procesit të menaxhimit të riskut.

1.2 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Has dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të merren masa për: Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike.

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakant në strukturën e Njësisë së Auditit të Brendshëm, me qëllim bërjen funksionale të kësaj njësie auditimi për përmbushjen e misionit të saj, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Has, të marrë masa për ndjekjen e afateve të raportimit financiar, në mënyrë që pasqyrat financiare të përgatiten, siglohen dhe dorëzohen në kohën e duhur.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat për të shqyrtuar dokumentacionin financiar të ish-komunës Gjinaj, me qëllim analizimin dhe identifikimin e të drejtave të konstatuara për arkëtim në vlerën prej 914,949 lekë, si dhe
të marrë hapat e nevojshëm për realizimin e mbledhjes së këtij detyrimi.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Has të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet".

8.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has në bashkëpunim me drejtorinë e Buxhetit, taksave dhe tarifave vendore të marrë masa për hartimin e një regjistri gjithëpërfshirës me të dhëna të sakta të numrit të familjeve, adresave të tyre me qëllim planifikimin e saktë të taksave për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës.

-Titullari i Bashkisë Has, të marrë masa që në vendimin e Këshillit Bashkiak të planifikojë sipas një regjistri taksat e tokës bujqësore, taksën e truallit dhe tarifën e gjelbërimit, për maksimizimin e të ardhurave si një nga funksionet bazë të pushtetit vendor.

C. **MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH**.

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës/Sektori i Tatim Taksave të analizojnë situatën e debitorëve progresivë dhe atyre të krijuar rishtazi dhe të nxjerrë përgjegjësitë e punonjësve për mos arkëtim të të ardhurave të planifikuara, në moszbatim të detyrave sipas funksioneve përkatëse.

-Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Has të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën 19,321,716 lekë, debi të krijuara në vitin 2024.
-Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Sektorin juridik, të ri analizojë të gjithë debitorët e Bashkisë Has deri në 31.12.2024, në vlerën 89,782,727 lekë, duke verifikuar dërgimin e masave shtrënguese ndaj subjekteve, monitorimin e akt- marrëveshjeve dhe respektimin e detyrimeve nga subjektet debitorë dhe në rast të shkeljeve të vazhdojnë me konfiskimin e pasurive siç parashikon ligji tatimor.

C.1 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit të Bashkisë Has, në vlerën 108,455 lekë, shpenzime përmbarimore mbi pagesat e kryera për vendimet gjyqësore për gjyqe fituesit e larguar nga puna.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave duke pasur parasysh:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm u konstatua se Bashkia Has nuk ka ngritur një sistem efektiv, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me nenin 8 pikën 8/a të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar.
Megjithëse nga titullari i Bashkisë Has është ngritur Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA-së 2025-2027, ka rezultuar se në dosje ishte vetëm 1 dokumentim i mbledhjes së kryer nga GMS, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK.
-Procesi i vlerësimit për 20 punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil nuk është kryer sipas formularit tip një herë në 6 muaj (ose dy herë në vit) sikurse përcaktohet në nenin 62 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil". Nuk ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.
-Për vitin 2025, janë kërkuar të kryhen 83 tema trajnimi sipas nevojave të drejtorive dhe sektorëve dhe është kryer vetëm 1 temë trajnimi "Për Shërbimin Civil" nga sektori Burimeve Njerëzore.
-Bashkia Has nuk disponon një regjistër të detajuar për regjistrimin e trajnimeve të kryera nga nëpunësit e institucionit por parashikohen fonde në buxhet për trajnime në fusha të ndryshme.
Bashkia Has megjithëse ka hartuar një strategji risku, nuk disponon ende procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk, veprime në kundërshtim me nenin 12 pika dhe nenin 21 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar.

-Titullari i Bashkisë Has për vitin 2025 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK. Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.
-Evidentohet se Bashkia Has nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.
Mungojnë hartat dhe manualet e proceseve të punës, duke sjellë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar; VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020 *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit";* Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike";* Manualin e MFK-së, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.1, faqe 19-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe grupi i menaxhimit strategjik, të marrë masa për:
-përfundimin e strategjisë së menaxhimit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, si edhe miratimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave.
-për evidentimin e nevojave të stafit për trajnim, si dhe hartimin e planit vjetor për trajnimin e punonjësve, me qëllim ngritjen e nivelit profesionale të tyre, si edhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2025, Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 2 (dy) audituesi *(deri në tetor 2025 dhe më pas me 1 audites)* në kundërshtim me strukturën organizative të miratuar nga Titullari i Bashkisë me *Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 136, datë 23.12.2024,"Për Numrin e Punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, Njësive Administrative dhe Kifikimin e Pagave të Administratës dhe Punonjësve të Tjerë për vitin 2025 - Bashkia Has"*
-Nga verifikimi i dokumentacionit Njësia e Auditit të brendshëm, gjatë vitit 2025 ka funksionuar vetëm me një audites të pa certifikuar pasi nuk ka plotësuar periudhën 2 vjecare në auditim. në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" nenet 11, "Punësimi i Auditit të Brendshëm".
-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";*
-Për vitin 2025, janë planifikuar për t'u audituar 5 subjekte, ose 20% e subjekteve nga të cilat mbulon me auditim Bashkia Has, plani i auditimeve është realizuar në masën 80%, ose 1 angazhim auditimi pa u realizuar. Referuar realizimit të angazhimeve për vitin 2025, konstatohet se janë audituar 12% e subjekteve nga të cilat mbulon me auditim Bashkia Has.
Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm rezultoi se, nga 25 njësi në varësi të Bashkisë Has, gjatë periudhës së audituar nuk janë audituar 22 prej tyre. Mbulimi i kufizuar me auditim lidhet me mungesën e burimeve njerëzore, pasi prej muajit tetor 2025 në Njësinë e Auditit të Brendshëm është në detyrë vetëm një audites. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.1, faqe 33-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakant në strukturën e Njësisë së Auditit të Brendshëm, me

qëllim funksionimin e kësaj njësie me profesionalizëm për përmbushjen e misionit të saj, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë.

2.2. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm, në periudhën në vijim të marrë masa për realizimin e misioneve të planifikuara, si edhe planifikimin e misioneve me risk që kjo njësi vendore ka, deri në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për hartimin e PBA-së për periudhën 2025-2027, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Has janë ndjekur dhe realizuar fazat e përgatitjes duke filluar me ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhrin nr.3, datë 16.01.2025 dhe ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit, ekipeve të menaxhimit të programeve, miratimin e tavaneve buxhetore, miratimin me VKB nr. 137, datë 23.12.2024, "Buxheti i Bashkisë Has për vitin 2025 dhe PBA vitit 2025-2027", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr.2/34, datë 08.01.2025.

-Nga Këshilli Bashkiak, Bashkia Has nuk është marrë asnjë vendim për kalendarin orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore të vitit 2025, të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027, në kundërshtim me nenin 33, të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; Kreu VII "Përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit"

- Nuk është hartuar udhëzimi i brendshëm për PBA, i cili duhet të hartohet brenda 5 ditëve nga miratimi i tavaneve buxhetore, në kundërshtim me Ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; neni 35 "Udhëzim për përgatitjen e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore".

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.2, faqe 40-51 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Has dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa për hartimin e udhëzimeve të brendshme për hartimin e PBA dhe ndjekjen e fazave për përgatitjen e projekt buxhetit, me qëllim realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve mbi baza reale.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2024-2025, në territorin e Bashkisë Has janë evidentuar 5 subjekte të pajisura me autorizim bazë për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të hidrokarbureve. Nga auditimi i dosjeve të subjekteve, "S." shpk, "D. H." shpk, "V. P." shpk, "G. Sh." shpk dhe "D. M." shpk, të cilët ushtrojnë aktivitetin "Tregtimi me pakicë i karburanteve dhe lëndëve djegëse" rezulton se subjektet nuk kanë paraqitur dokumentacionin ligjor, teknik dhe mjedisor, por vetëm NIPT. Ushtrimi i aktivitetit nga këto subjekte dhe pajisja me autorizimin nga Bashkia është kryer në kundërshtim me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 "*Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre"* dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*". *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.2, faqe 51-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Has dhe Drejtoria Juridike, të marrë masa për të plotësuar me dokumentacionin ligjor, teknik dhe mjedisor dosjet e subjekteve "S." shpk, "D. H." shpk, "V. P." shpk, "G.Sh." shpk dhe "D.M." shpk, të cilët ushtrojnë aktivitet me objekt "tregtimi i hidrokarbureve", si edhe kontratat në të ardhmen me subjekte të reja, të nënshkruhen me plotësimin e gjithë dokumentacionit ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Has, u konstatuan 6 subjekte, persona fizik, L. G. me nipt M.....E, E. N. me nipt M.....F, D. G. me nipt L.....P, M. A. me nipt M.....B, A. I. me nipt L.....J dhe B. R. me nipt L.....P, të cilët

janë të regjistruar në QKB dhe të pajisur me NIPT por nuk kanë shlyer detyrimet për taksat vendore. Përllogaritja e detyrimit të këtyre subjekteve, nuk është kryer nga sektori i tatim taksave, pasi këto subjekte, megjithëse janë të regjistruar në QKB, pas kontrolleve në terren nga ana e strukturave përkatëse të Bashkisë, rezultojnë se nuk ushtrojnë aktivitet. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.2, faqe 51-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të kryej procedurat ligjore për kalimin në status pasiv të subjekteve, persona fizik, L. G. me nipt M.....E, E. N . me nipt M.....F, D. G. me nipt L.....P, M.A. me nipt M.....B., A.I. me nipt L.....J dhe B. R. me nipt L.....P, të cilët nuk ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Has.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has, Sektori i Tatim Taksave nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë rimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre, si edhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitorë ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifat e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifën e gjelbërimit, detyrimet për këto taksa dhe tarifa nuk evidentohen në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme por arkëtohen rast pas rasti në momentin që qytetarët paraqiten pranë Bashkisë për marrje vërtetimesh, shërbime/procedura të ndryshme nga institucioni. Bashkia Has nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet, por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësive administrative për të marrë shërbime të ndryshme.

-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitore nuk ka regjistër. Në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Has nuk ekziston një regjistër i unifikuar për të gjitha familjet, ku të evidentohen në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme tarifimet për çdo vit.

-Si rezultat, procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitore dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë.

-Bashkia Has për periudhën 2024-2025 nuk ka dërguar shkresa zyrtare me lista dhe vlera të subjekteve në Policinë Bashkiake ose institucione të tjera.

-Gjatë viteve 2024-2025, nuk janë ndërmarrë masa shtrënguese administrative për vjeljen e debitorëve, si bllokim llogarie bankare, sekuestro, bllokim aktiviteti ose njoftime për bllokim.

-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon regjistër të veçantë dhe të përditësuar për subjektet e mbyllura dhe me status pasiv. Mosndjekja në mënyrë të plotë e këtyre detyrimeve përbën veprime në kundërshtim me përcaktimet në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, Kreu XI *"Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të pa paguar*", VKB nr. 33, datë 22.12.2023 dhe VKB nr.135, datë 23.12.2024, "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has*". *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.2, faqe 51-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Has në bashkëpunim me Zyrën e Gjendjes Civile dhe Policinë Bashkiake, të marrë masa për evidentimin e numrit të familjeve që kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore si edhe marrjen e masave shtrënguese për familjet që janë debitore ndaj bashkisë, me qëllim vjeljen e taksave vendore dhe rritjen e të ardhurave për përmirësimin e shërbimeve.

-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të hartoj një regjistër të veçantë dhe të përditësuar për subjektet e mbyllura dhe me status pasiv.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Has vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2025 është 191,609 lekë, si në raportimin në MFE ashtu dhe në rakordimet me Degën e Thesarit, në kundërshtim me përcaktimet në ligjin nr.48, datë 24.04.2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare*" neni 6 "Afati". Në raport me shpenzimet e vitit të cilat janë në shumën 450,253 mijë lekë detyrimet zënë 0.04%, pra bashkia nuk është me vështirësi financiare. Nga auditimi konstatohet se janë hapur procese gjyqësore nga 28 ish punonjës të larguar nga puna, nga të cilët 1 punonjës ka përfunduar procesin gjyqësor për kthim në pozicionin e mëparshëm dhe shlyerjen e detyrimit në shumën 2,208,004 lekë, detyrim i cili rezulton i pakontabilizuar. Nga ana e Bashkisë Has me shkresën nr.4617, është dërguar praktika për shlyerjen e detyrimit, datë 17.12.2025, drejtuar Ministrisë së Pushtetit Vendor, për të cilën ende nuk është kthyer përgjigje. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.2, faqe 51-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 191,609 lekë, si edhe të planifikojë detyrimet nga vendimet gjyqësore duke hartuar plan të detajuar shlyerje për këtë qëllim, dhe të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" dhe verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se kjo llogari paraqitet me gjendje 0 dhe nuk është pasqyruar e kontabilizuar vlera prej 2,208,004 lekë, që i përket detyrimeve të përcaktuara nga vendimet gjyqësore në favor të punonjësve të larguar nga puna, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.3, faqe 62-7, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has të marrë masa për njohjen dhe pasqyrimin në kontabilitet të vlerës 2,208,004 lekë, si edhe të detyrimet që do të shtohen nga punonjës të tjerë gjyqfitues.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2026

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 423-429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" rezultoi se kjo llogari paraqitet me të njëjtën vlerë prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2024, ashtu edhe në fund të vitit 2025. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të Aparatit të Bashkisë Has me ato të ish-komunave, në kuadër të reformës territoriale të vitit 2015, dhe i përket bilancit të ish-Komunës Gjinaj. Nga analiza e përbërjes së kësaj vlere rezultoi se 96,451 lekë përfaqësojnë detyrime të ish-punonjësve, për të cilat nuk disponohet listë emërore, ndërsa 818,498 lekë përfaqësojnë fonde të ndihmës ekonomike të ish-Komunës Gjinaj, të grabitura gjatë transportit në vitin 1997, për të cilat nuk është identifikuar autori, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.3, faqe 62-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa të shqyrtojë dokumentacionin financiar të ish-komunës Gjinaj, mbi bazë të së cilës të analizojë dhe të përcaktojë të drejtat e konstatuara për arkëtim në vlerën 914,949 lekë , duke përcaktuar personat përgjegjës material me shumat përkatëse, që i kanë detyrim Bashkisë për kthim. Nëse është e pamundur Bashkia Has të ndjekë hapat ligjorë për njohjen ose jo të këtij detyrimi dhe më pas të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has për vitet 2023-2025, në cilësinë e autoritetit kontraktor, në bazë të kërkesave për punë, mallra dhe shërbime çdo fillim viti kalendarik ka miratuar buxhetin e saj, si dhe ka hartuar regjistrimin e parashikimit të prokurimit publik dhe e ka dërguar atë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik në përputhje me kërkesat që përcakton neni 3 dhe 4 i VKM nr. 285, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", datë 19.02.2021.
Sa më sipër rezulton së për vitin 2023, nga **79** procedura prokurimi të parashikuara në regjistër, me vlerë fondi limit **123,000,705** lekë pa TVSH, janë realizuar **68** procedura me vlerë **77,825,195** pa TVSH, pra **11** procedura më pak nga parashikimi.
- Për vitin 2024 nga **62** procedura prokurimi të parashikuara në regjistër me vlerë **348,693,038** lekë pa TVSH, janë realizuar **45** procedura me vlerë **297,455,268.17** pa TVSH, **17** procedura më pak nga parashikimi.
- Për vitin 2025, për Bashkinë Has nga **56** procedura prokurimi të parashikuara në regjistër me vlerë **198,323,975.17** lekë pa TVSH, janë realizuar **56** procedura me vlerë **180,513,846.50** pa TVSH.
Mos realizimi i procedurave të parashikuar dhe mos përdorimi i fondeve buxhetore tregon mangësi në procesin e parashikimit në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu II, neni 3, pika 2.
(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.4, faqe 77-143, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve të marrë masa për hartimin sa më real të regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik për punë, mallra ose shërbime sipas nevojave të institucionit

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit për blerjet me vlerë të vogël është konstatuar se:
- Në 4 raste, gjatë vitit 2023 nuk disponohet urdhër për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 42.
- Në 4 raste, gjatë vitit 2023 nuk disponohet dokumentacion për marrjen e mallrave në dorëzim veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, pika 39, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.
- Në 1 rast, gjatë vitit 2025 u konstatua copëzim i fondit, pasi janë zhvilluar 2 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me fond limit total në shumën 2,000,000 lekë pa TVSH, duke shmangur procedurat normale të prokurimit, nëpërmjet copëtimit të fondit limit dhe moskryerjes së këtyre procedurave me tenderim. Konkretisht, për procedurën "Sinjalistika e qytetit Krumë", me urdhër prokurimi nr. 26, datë 30.06.2025, me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSH, dhe procedurën "Realizimi i sinjalistikës së qytetit Krumë", me urdhër prokurimi nr. 27, datë 30.06.2025, me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSH. Të dyja procedurat kanë të njëjtin objekt, "Sinjalistika e qytetit Krumë", dhe janë zhvilluar veçmas, duke shmangur zhvillimin e procedurës së prokurimit sipas vlerës së plotë të fondit limit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 56, pika 1 dhe pika 2.- Në 10 raste të procedurave të prokurimit për blerjet me vlerë të vogël të kryera gjatë vitit 2023-2025, nuk argumentohet përllogaritja e fondit limit veprime këto jo në përputhje me përcaktimet ligjore të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 76, "Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit", pika 2.

- Në 1 rast fatura tatimore nuk është likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare". *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.4, faqe 77-143, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve të marrë masa që për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël që zhvillon, të argumentojë hartimin e fondit limit, të administrohet procesverbali për marrjen në dorëzim të mallrave, punëve apo shërbimeve, procesverbali konstatues paraprak për ato rastet kur nevojitet, ngritja e grupeve për marrjen në dorëzim të punëve, mallrave apo shërbimeve të përbërë nga punonjës kompetent dhe me njohuri sipas fushave përkatëse të procedurave të zhvilluara.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të procedurave të prokurimit në Bashkinë Has, është konstatuar se të gjitha dosjet e audituara, të cilat përmbajnë dokumentacionin fizik të prokurimit (përfshirë procesverbalet e përgatitjes së procedurës, dokumentet e tenderit, dokumentacionin e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj.), në tërësi ose në raste të veçanta, nuk janë të pajisura me inventar të brendshëm për përmbajtjen e tyre dhe nuk kanë të kryer numerizimin përkatës të dokumenteve. Mungesa e inventarit të brendshëm të dosjes dhe mosnumerizimi i dokumentacionit krijojnë risk për cenimin e transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe rrezikun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit apo të çdo dokumenti që është pjesë e procesit të prokurimit.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të PP" i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat", nenet 21, 58, 59 dhe 60 të Normave Teknike-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, Vendimin nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar për administrimin e dokumenteve në autoritetet publike të RSH", neni 8, germa (g), si dhe me Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.4, faqe 77-143, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Has, në cilësinë e Titullari të AK, të nxjerrë një urdhër pune për Njësinë e Prokurimit (*personi i autorizuar*) në bashkëpunim me Zyrën e Protokoll - Arkivin të Institucionit, për arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura në të gjitha fazat e tij.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit me objekt "Blerje karburant për nevojat e Bashkisë për vitin 2024", me vlerë kontrate 8,875 mijë lekë, dhe "Blerje automjetesh (Kamion vetëshkarkues, rrul me vibrim hekur-gomë)", me vlerë kontrate 7,600 mijë lekë, rezultoi se, megjithëse për përllogaritjen e fondit limit janë mbajtur procesverbale, në dokumentacion nuk disponohen të dhëna që dokumentojnë metodologjinë e përdorur, burimet e informacionit, testimin e tregut, ofertat orientuese apo elemente të tjera mbi të cilat është përcaktuar vlera e fondit limit.

Për pasojë, fondi limit nuk rezulton i mbështetur në një analizë të dokumentuar dhe të verifikueshme të tregut, duke mos krijuar gjurmë auditimi mbi mënyrën e vlerës së përllogaritur.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 1, pika 2, germat (a, b), neni 34, pika 2, VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, "Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 2, Kreu IV, neni 12 dhe neni 76, pika 2, neni 16 pika 2 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.4, faqe 77-143, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, të marrë masa për dokumentimin e plotë dhe të gjurmueshëm të procesit të përllogaritjes së fondit limit për procedurat e prokurimit. Krahas mbajtjes së procesverbaleve, të përcaktohet metodologjia e përdorur për përllogaritjen, burimet e informacionit, ofertat e marra gjatë testimit si dhe çdo dokument tjetër mbështetës.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt "*Rehabilitim me qëllim mbingritje e digës së rezervuarit Helshan 2*", "*Rikonstruksion i Gjimnazit "Skënderbeu", Has*" dhe "*Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme, Fshati Golaj*", rezulton se nuk është aplikuar dhe pajisur me oponencën teknike, veprim në kundërshtim me nenin 6 pika 1 germa (a) të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.4, faqe 77-143, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, të marrë masa që për investimet publike në fushën e ndërtimit, të sigurojë kryerjen e oponencës teknike të projekteve nga institucionet ose subjektet e autorizuara për këtë qëllim, përpara miratimit dhe zbatimit të tyre.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2025 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 10 raste për procedura të realizuara nga Bashkia Has me fond limit **425,296** mijë lekë pa TVSH, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim si më poshtë:

Në procedurat e prokurimit për vitin 2023 me objekt,

- *"Ndërtimi i rrugës nga aksi rrugë nacionale, Krumë, Kukës (lagja Dida) deri në lagjen Geca 7 Rada, Fshati Krumë"*
- *"Mirëmbajtje Rrugë Rurale e Kanalizime, Bashkia Has 2023"*

Në procedurat e audituara për vitin 2024 me objekt,

-*"Rehabilitim trotuare përgjatë rrugës nacionale dalja Qytetit Krumë deri Rezervuari Pla*;
-"*Rehabilitim me qëllim mbingritje e digës së rezervuarit Helshan 2*";
-"*Rikonstruksion i Gjimnazit "Skënderbeu", Has*";
-"*Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme, Fshati Golaj*";
-Blerje karburant për nevojat e Bashkisë për vitin 2024"
"*Blerje automjetesh*" Kamion vetëshkarkues, Rrul me vibrim hekur – gomë;

dhe në procedurat e audituara për vitin 2025 me objekt,

-"*Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Sejdi Dida", Krumë*";
-"*Rehabilitim dhe Sistemim i Përroit të Tërshënës*";

rezultoi se disa prej kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional nuk janë në përputhje me projektin dhe preventivin e punimeve. Është kërkuar drejtues teknik me kohë të plotë për investime nën 30 milionë lekë, licenca për mbrojtjen nga zjarri të palidhura me objektin e prokurimit, si dhe mjete e pajisje të panevojshme për zbatimin e kontratës, si kontejnerë stacionarë dhe impiant betoni me përcaktim distance. Kërkesat e mësipërme janë jo në përputhje me ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 2, 21, 77, si dhe neni 39, 40, 74 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.4, faqe 77-143, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), në procedurat e prokurimit, të marrë masa për përzgjedhjen e zyrtarëve

pjesëmarrës në proces, duke siguruar që ata të jenë të kualifikuar dhe të trajnuar. Gjithashtu Njësia e Prokurimit të marrë masa që kërkesat, specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit të argumentohen teknikisht dhe ligjërisht, të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit publik të zhvilluara nga Bashkia Has përgjatë periudhës 01.01.2023 deri më 31.12.2025, në 9 raste me vlerë totale të lidhjes së kontratave prej 379,612 mijë lekë, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së disa prej kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST si më poshtë:
Në procedurat e audituara për vitin 2024 me objekt,
-*"Rehabilitim trotuare përgjatë rrugës nacionale dalja Qytetit Krumë deri Rezervuari Pla*;
-"*Rehabilitim me qëllim mbingritje e digës së rezervuarit Helshan 2*";
-"*Rikonstruksion i Gjimnazit "Skënderbeu", Has*";
-"*Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme, Fshati Golaj*";
"*Blerje automjetesh*" Kamion vetëshkarkues, Rrul me vibrim hekur – gomë;
dhe në procedurat e audituara për vitin 2025 me objekt,
-"*Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Sejdi Dida", Krumë*";
-"*Rehabilitim dhe Sistemim i Përroit të Tërshënës*";
-Ndërtim pusetash ujërave të zezë për zonën informale";
-"*Blerje mjeti zjarrfikës 4X4 pick-up – 2 copë*";
Mangësitë e konstatuara konsistonin në mungesën e dokumenteve të kërkuara sipas vetëdeklarimit, evidentimin e operatorëve ekonomik debitorë pranë njësive të vetëqeverisjes vendore ku kishin realizuar kontrata punimesh, paraqitjen e certifikatave ISO pa akreditimin përkatës, si dhe në mosdeklarimin e saktë të mjeteve. Kualifikimi në kushtet e mos përmbushjes së kritereve të veçanta, është veprim në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2023, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2, neni 3, nenin 87 pika 3*",* neni 92. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.4, faqe 77-143, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Has, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të operatorëve ekonomikë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në dokumentet e procedurës, të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla në vijimësi.
16.2. Rekomandimi: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë vlerësimit të ofertave të procedurave prokuruese, të marrë masa, që të pranohen oferta, kur përputhen plotësisht specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara kur komisioni e vlerëson si devijime të vogla, të cilat të specifikohen në raportet përmbledhëse të procedurave prokuruese, duke mbajtur në konsiderate parimet e ekonomicitetit dhe eficiensës, bazuar kritereve të vlerësimit të çmimit më të ulët.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik me objekt "*Rehabilitim trotuare përgjatë rrugës nacionale dalja Qytetit Krumë deri Rezervuari Pla*", "*Rehabilitim me qëllim mbi ngritjen e digës së rezervuarit Helshan 2*" dhe "*Rikonstruksion i Gjimnazit "Skënderbeu", Has*", ka rezultuar vonesë në përfundimin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave nga KVO, i përcaktuar 15 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, duke sjellë vonesa të paargumentuara të procesit, veprim në kundërshtim me nenin 82, pika 1 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.*2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.4, faqe 77-143, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
17.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Has, personat e ngarkuar si anëtarë të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave, të marrin masa për kryerjen e vlerësimit të ofertave brenda afatit, ky jo vetëm si detyrim ligjor, por për të shmangur çdo vonesë të paargumentuar që lidhet me shpenzimin e planifikuar nga Bashkia Has.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan disa mangësi si më poshtë:
- Në 5 raste nuk evidentohet mënyra e përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, por përcaktohet vetëm vlera. Nga verifikimi rezulton se vlera e përllogaritur në 4 raste është e saktë, megjithatë mungon dokumentimi i metodologjisë dhe elementëve të përdorur në përllogaritje, ndërsa në 1 rast është bërë përllogaritja gabim në vlerën 41,867 lekë.
- Në 2 raste kartela e pasurisë nuk është e rifreskuar 3 muajt e fundit;
- Në 2 raste ka mangësi në planvendosjen e paraqitur, ku në një rast rezultoi se gjurma e objektit pasqyron vetëm konturet por nuk evidentohet objekti, ndërsa në një rast sipas hartës së paraqitur në pasaportën e njësisë me nr. HS_UB_A1_1/31, rezultojnë disa objekte brenda parcelës, të cilat nuk janë pasqyruar në planvendosje;
- Në një rast mungojnë licencat e projektuesve dhe policat e sigurimit të projektuesve për mbulimin e përgjegjësive profesionale, si dhe mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore;
- Në një rast nuk administrohet kërkesa për t'u pajisur me leje ndërtimi sipas formatit të përcaktuar. Mangësitë e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 1, germa (a, c, ë, g) të nenit 15, neni 45 germa (c), Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6, VKM-së nr. 457. Datë 29.06.2022, Neni 18 dhe 21. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.5, faqe 149-151, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
18.1. Rekomandimi: Sektori i Urbanistikës, të marrë masa që para miratimit të lejeve të ndërtimit, të verifikohet dhe dokumentohet plotësisht përmbushja e të gjitha kërkesave ligjore dhe procedurale, përfshirë përllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, përditësimin e dokumentacionit kadastral, saktësinë e planvendosjeve, licencimin e projektuesve dhe administrimin e kërkesave sipas formatit të përcaktuar, me qëllim garantimin e ligjshmërisë së procesit.

Në vijimësi

19. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore mbi veprimtarinë e IMTV Bashkia Has, u konstatua se ka ushtruar funksionet e veta jo në përputhshmëri të plotë me detyrimet që përcakton ligji, si vijon:
- Në strukturën organizative të Bashkisë Has, rezulton se nuk është ngritur Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, por aktualisht janë 4 punonjës në cilësinë e inspektorit, pranë secilës njësi administrative, por pa strukturë dhe pa Kryeinspektor.
- Nga 11 punonjës inspektor që kanë punuar ose punojnë aktualisht, vetëm njëri prej tyre ka arsimin e duhur, ndërsa gjithë të tjerët nuk kanë arsimin e nevojshëm për këtë pozicion pune;
-Për periudhën objekt auditimi janë mbajtur **160 procesverbale** konstatimi për ndërtimet pa leje nga ku rezulton se:
- Në të gjitha rastet nuk janë aplikuar masat administrative për subjektet kundërvajtës (gjoba, pezullim, prishje e ndërtimeve) në kundërshtim me nenin 5 germa (b, ç, d) të Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar;

-Për vitin 2025 janë 84 raste për të cilat mungon masa administrative e gjobës. Në aktet e mbajtura për këto konstatime, mungojnë të dhënat e detajuara të kundërvajtjes për përllogaritjen e gjobave si dhe nuk përcaktohet tipologjia e objektit nëse është për banim apo për qëllime fitimi.
- Nuk ka asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi;
- Mungojnë planet vjetore dhe mujore të punës;
- Nuk ka kallëzime penale për subjekte/shtetas që kanë kryer ndërtime pa leje;
- Në procedurat e mbajtura për vitin 2023 mungojnë fotografitë e kundërvajtjes;
- Për periudhën objekt auditimi, nuk disponohej informacioni periodik 3 – mujor drejtuar IKMT për masat e marra. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 4, neni 5 germat (a, dh, f), neni 11 të Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar, Ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, neni 51, neni 52 pika 1 germa (e). *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.6, faqe 151-154, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Has, të marrë masa për ngritjen e një strukture funksionale të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit dhe caktimin e Kryeinspektorit për kryerjen e funksioneve administrative të kësaj strukture, si dhe të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në Inspektorat, ky jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Bashkisë Has i janë transferuar në pronësi apo përdorim, *me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM), një total prej 993 pasurish nga të cilat vetëm për 33 pasuri është marrë certifikata e pronësisë.*

Procesi i regjistrimit të pronave të Bashkisë Has në regjistrat zyrtarë të pasurive të paluajtshme mbetet i papërfunduar. Mungesa e certifikatave të pronësisë për 97% të pronave të transferuara në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Has, krijon një situatë të pasigurt juridike, situatë e cila cenon transparencën dhe ligjshmërinë në administrimin e pasurisë publike, si dhe kufizon aftësinë e Bashkisë Has për të ushtruar të drejtat e saj ligjore mbi këto pasuri, përfshirë përdorimin, mirëmbajtjen, zhvillimin apo dhënien në funksion të interesit publik, veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 20/2020, Kreu IV, "Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike, shtetërore", nenet 36-46. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.7, faqe 154-166, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1. Rekomandimi: Bashkia Has të intensifikojë përpjekjet për përfundimin e procesit të regjistrimit të pronave publike në regjistrat zyrtarë të pasurive të paluajtshme, duke aplikuar për pajisjen me certifikatave të pronësisë për të gjitha pasuritë e transferuara në pronësi të Bashkisë Has.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 466/8, datë 11.09.2025 rezulton se, nga Bashkia Has është respektuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për marrjen e masave në zbatimin e rekomandimeve, përcjellë me shkresën nr. 3549.Prot, datë 03.10.2025, në zbatim të shkronjës "j" të nenit 15 te ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH" si edhe afati 6- mujor përcjellë me shkresën nr.1000, datë 13.03.2026, në zbatim të pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve.

-Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Nga Kontrolli i lartë i Shtetit janë rekomanduar 13 masa gjithsej, nga të cilat 10 "Masa Organizative", 1 masë për "Eliminimin e efekteve negative", 1 masë për "Uljen e borxhit" si dhe 1 masë "Disiplinore".
Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:
- Nga 10 masa organizative të rekomanduara, pranuar 100% nga subjekti. Nga këto janë zbatuar 2 masa, janë zbatuara pjesërisht 6 masa të cilat janë rikërkuar në audimin e kryer në Bashkinë Has në bazë të programit të auditimit nr. 106/1, datë 28.01.2026 dhe 2 masa pazbatuara nga të cilat një masë është rikërkuar në aludimin e kryer në Bashkinë Has në bazë të programit të auditimit nr. 106/1, datë 28.01.2026.
- Nga 1 masë masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, me efekt mungesë të ardhurash, pranuar 100% nga subjekti, e cila nuk është zbatuar por është rikërkuar në aludimin e kryer në Bashkinë Has në bazë të programit të auditimit nr. 106/1, datë 28.01.2026.
- Nga 1 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, pranuar 100% nga subjekti, rezulton e pa zbatuar.
- Masa disiplinore, rezulton e zbatuar . *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.8, faqe 166-170, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Has të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet.

C.1 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit të Bashkisë Has, në vlerën 108,455 lekë, shpenzime përmbarimore mbi pagesat e kryera për vendimet gjyqësore për gjyqe fituesit e larguar nga puna.

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15, germat b) dhe c) "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së" dhe mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", nga ana e Titullarit të njësisë publike Bashkisë Has, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësisht, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **3,438,804 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *"Rikonstruksion i gjimnazit "Skënderbeu", Bashkia Has* me nr.3152 prot., datë 02.10.2024, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Has dhe Operatorit Ekonomik BOE "T.&J. C." SH.P.K. & "V.C." SH.P.K, me vlerë kontrate 113,400,000 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj nga data e njoftimit në Bashkinë Has. Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm rezultuan diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren si më poshtë:

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize *"2.209/b-Ulluk shkarkimi vertikal me bakër"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 99.8ml Gjatë kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune nuk ishte kryer me ulluk vertikal bakër. Në kohën e tenderimit ky zë pune sipas portalit të çmimeve SIM ka qenë në çmimin 2,643.67 lekë/ml; ndërsa zëri ulluk vertikal xingato ka qenë në çmimin 1,021.7 lekë/ml. Gjatë procesit të tenderimit në ofertën e tij. Kontraktori është ulur 2% në çmimin e zërit të ullukut vertikal bakrit, nëse e aplikojmë këtë ulje tek çmimi i ullukut xingato do të kemi 98%*1021.7 lekë/ml=1004.8 lekë/ml x 99.8ml= 100281.3 lekë. Pasi kryejmë zbritjen midis vlerës së raportuar me vlerën e llogaritur 259480lekë-100281.3= **159,199 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

- Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"2.212/b-Ulluk shkarkimi horizontal me bakër 33cm"*i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 143.2ml. Gjatë kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune nuk ishte kryer me ulluk horizontal bakëri. Në kohën e tenderimit ky zë pune sipas portalit të çmimeve SIM ka qenë në çmimin 3,052.13 lekë/ml; ndërsa zëri ulluk horizontal xingato ka qenë në çmimin 1,195.97 lekë/ml. Gjatë procesit të tenderimit në ofertën e tij. Kontraktori është ulur 6% në çmimin e zërit të ullukut horizontal të bakër, nëse e aplikojmë këtë ulje tek çmimi i ullukut xingato do të kemi 94%*1,195.97 lekë/ml=1,120.7 lekë/ml x 143.2 ml= 160,482 lekë. Pasi kryejmë zbritjen midis vlerës së raportuar me vlerën e llogaritur 409,552 lekë-160,482= **249,070 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

- Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"2.206-Kasete shkarkimi"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 8 copë. Gjatë kontrollit në terren u konstatua se ishte vendosur një ulluk horizontal perimetral për ujërat e çatisë, pra nuk ishin përdorur kaseta shkarkimi, sepse shkarkimi bëhej me varangë direkt në ullukun horizontal. Kjo sasi prej 8 copë vlerën **15,600 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize*"2.324a Plintues pllaka grez"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 1068.9ml, referuar analizës teknike të çmimit plituesi duhet të realizohet me lartësi 10cm, gjatë kontrollit në terren u konstatua se plintuesi ishte realizuar me lartësi 8 cm. Nga verifikimi i analizës së çmimit të këtij zëri pune, sipas manualit (2.324/a), rezulton se çmimi i nënzërit material në këtë zë pune, është 65 % e të gjithë zërit të punës. Nga rillogaritja, çmimi i këtij zëri pune është përkatësisht 2,175 lekë/ml (65%*2500 lekë/ml *8cn/10cm+35%*2,500 lekë/ml) ose 325 lekë/ml më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 20 lekë/ml (për sasinë e plintuseve prej 1,068.9 ml), llogaritet në vlerën **347,393 lekë pa TVSH, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori i punimeve dhe përbën dëm ekonomik.**

- Në lidhje me zërin e punës me nr. analize *"2.196/c-Hidroizolim WC me dy shtresa mapej - ose ekuivalent me të në - dysheme + muret"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 250.9 m2, gjatë kontrollit të librezave të masave u konstatuan disa lapsuse në llogaritjen e këtij volumi (pasi sasia e veshjes + sasia e shtrimit të pllakave në tualete rezulton 238m2). Si rrjedhojë rezultuan diferenca në vlerën **19,200 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

- Në lidhje me zërin e punës me nr. analize *"2.404/1-Lyerje brenda me Boje hidroplastike cilësi e pare"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 4504.2m^2, gjatë kontrollit në terren u matën lartësitë e kateve Hk0=2.9m, Hk1=2.9m, Hk2=2.75m, ku u konstatuan se në librezat e masave këto lartësi janë raportuar më të mëdha sesa fakti si dhe nuk janë kryer zbritjet e lartësisë së veshjes së pllakave në tualete. Për rrjedhim rezultuan diferenca në sasinë (4504.2-4160)=344 m^2 dhe në vlerën **137,680 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr. analize *"Analize-1-Lyerje me Boje vaji brezi deri = 1m ambiente te brendshme"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 1124.2m^2, gjatë kontrollit të librezave të masave këto lartësi janë raportuar më të mëdha sesa fakti, pasi në terren u matën lartësitë e lyerjes ku në korridore rezultoi lyerja 90 cm dhe në Ka 65 cm. Për rrjedhim rezultuan diferenca në sasinë 810 m^2 dhe në vlerën **157,100 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

- Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"Analize-F.V. Ndriçuesa luminishent, FL 4x18w, IP 20"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 260 copë, gjatë kontrollit në terren u konstatua se ndriçuesit ishin në sasinë 230 copë, pra me diferencë prej 30 copë, e cila përbën vlerën **180,000 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"Analize-F.V. Ndriçues tip prozhektor 150Ẇ për palestrën"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 25 copë, gjatë kontrollit në terren u konstatua se ishin vendosur vetëm 11 ndriçues. Rrjedhimisht diferenca prej 25-11 copë përbëjnë vlerën **280,000 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me kapitullin "*Sinjalistika & kodi indeksimit"* kapitull i cili është raportuar në situacionin përfundimtar në vlerën 223,046 lekë pa TVSH, gjatë kontrollit në terren u konstatua se nuk ishin vendosur asnjë tabelë sinjalizuese ne lidhje me fikset hidrantët daljet e emergjencës etj. Komplet vlera e këtij kapitulli **prej 223,046 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.** Në total rezultuan diferenca me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Has në vlerën **1,768,287 lekë pa TVSH**.

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve BOE "S.-A." SH.P.K. &"2 E." SH.P.K., në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.4, faqe 143-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Has, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **1,768,287 lekë pa TVSH** nga shoqëria BOE "T.&J. C." SH.P.K. & "V. C." SH.P.K, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

Brenda datës 31.12.2026

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *"Rehabilitim me qëllim mbingritjen e digës së rezervuarit, Helshan-2", Bashkia Has* me nr. 3024 prot., datë 20.09.2024, lidhur midis AK Bashkia Has dhe Kontraktorit BOE "A. M." SH.P.K. & "O." SH.P.K., sipas licencave respektive NZ.2802/32 dhe NZ.4511/11, me vlerë kontrate 45,085,269 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 8 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit. Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm rezultuan diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren si më poshtë:

- Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"1.39/p-Parapet b/a parafabrikat"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 147m3, gjatë kontrollit në terren si dhe librezave të masave u konstatua se ky zë pune nuk ishte kryer me beton arme parafabrikat por me beton të derdhur në vend. Gjithashtu u konstatua se ky zë pune nuk është llogaritur në mënyrë korrekte. Konkretisht në librezën e masave është raportuar 191.4m x0.77m2=147.38 m3 ndërsa nëse bëjmë llogaritjet korrekte sipas projektit do të kemi: për bazamentin e murit (pjesa horizontale) 191.4mx0.9x0.3m=51.7m3, ndërsa për murin (pjesa vertikale) 191.4mx1.3mx0.3=74.6m3 pra në total 126.3m3. Për rrjedhim kemi një diferencë prej 20.7 m3 midis sasisë të raportuar dhe sasisë së llogaritur në vlerën **312.570 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**
- Në lidhje me zërin e punës me nr.analize "*3.212/d-Shtrese stabilizant t = 20 cm në kurorën e digës"* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 758 m^2, gjatë kontrollit në terren u konstatua se ky zë pune nuk ishte kryer me stabilizant por në kurorën e digës u konstatua vendosja vetëm e shtresës së çakëllit. Për rrjedhim vlera e volumeve të raportuara por të pa kryera është **575,701 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**
Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt ose punime të llogaritura jo sipas projektit te zbatimit, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Has në vlerën 888,271 lekë pa TVSH.
Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve BOE "A. – V." SH.P.K. & "A.Sh.E." SH.P.K., në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.4, faqe 143-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Has, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **888,271 lekë pa TVSH,** nga shoqëria BOE "A. M." SH.P.K. & "O." SH.P.K, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *"Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme të Fshati Golaj", Bashkia Has* me nr. 3846 prot., datë 02.12.2024, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Has dhe Operatorit Ekonomik BOE "Sh.-A." SH.P.K.& "O" SH.P.K., sipas licencave respektive NZ.4574/23 dhe NZ.4511/11, me vlerë kontrate 100,741,795 lekë me TVSH Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj kalendarike nga data e njoftimit në Bashkinë Has. Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit të punimeve në terren për objektin e mësipërm rezultuan diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara me punimet faktike në terren si më poshtë:
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"3.158/4a-Transport dheu me auto deri 4.0 km"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 7,695 m3, gjatë kontrollit të librezave të masave në këtë sasi nuk është kryer zbritja e volumeve të mbushjes 340m3 nga volumi total I gërmimeve 7,941 m3. Rrjedhimisht kjo sasi 340m3 përbën vlerën **95,200 lekë pa TVSH, vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana Kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**
-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"3.212/b-Shtrese stabilizant t=10cm (Ndërtim bankine b=50cm)"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 4,804 m2, gjatë kontrollit të librezave të masave në këtë sasi nuk është kryer zbritja e hyrje-daljeve të shtëpive dhe pronave private, dhe trotuarit anësor, në sasinë 670m2. Rrjedhimisht kjo sasi 670m2 përbën vlerën **288,100 lekë pa TVSH vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana Kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"3.618-FV Bordura betoni 20x35 cm"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 426ml, gjatë kontrollit në terren u konstatua se bordurat ishin realizuar me përmasa të tjera 25x15cm. Raporti përmasave të bordurave 25x15 me 20x35 është 54% dhe nëse e aplikojmë këtë % tek çmimi i ofertuar për realizimin e bordurave, ky çmim do të kaloj nga1600 lekë/ml në 857 lekë/ml. Rrjedhimisht vlera e bordurave kalon nga 681,600 lekë në 365,142.86 lekë pa TVSH, dhe diferenca midis vlerave do të përbëj vlerën **316,457.14 lekë pa TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"2.261/a-Nënshtresë rëre"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 34 m3, gjatë kontrollit të librezave të masave në këtë sasi u konstatua se në analizën teknike të çmimit për zërin *"3.620-Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka"* është e përfshirë 0.03m3/m2 trotuar i cili përbën 20.64m3 rërë të përfshirë në çmimin e vendosjes së trotuarit. rrjedhimisht vlera e 20.64m3 llogaritet **30,960 lekë pa TVSH, vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana Kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**

- Në lidhje me zërin e punës me nr. analize *"3.158/4a-Transport dheu me auto deri 4.0 km"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 48 m3, gjatë kontrollit të librezave të masave u konstatua se në llogaritjen e këtij zëri duhet të ishte përfshirë vetëm sasia e ardhur nga gërmimet pra 29m3. Diferenca midis 48m3-29m3 përbën vlerën **5,320 lekë pa TVSH, vlerë e përfituar padrejtësisht nga ana Kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik.**

- Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *"3.954-FV tabela rrugore treguese 60x20cm"* raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 3 copë gjatë kontrollit në terren rezultuan 2 tabela të vendosura. Diferenca prej 1 copë në vlerën **4,342 lekë pa TVSH vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt ose punime të llogaritura jo sipas projektit te zbatimit, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Has në vlerën 740,379 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve OE "XH.&M." SH.P.K., në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet kontraktuale dhe ligjore të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.4, faqe 143-149, Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Has, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **740,379 lekë pa TVSH,** nga shoqëria BOE " Sh." SH.P.K. & "O." SH.P.K, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejes së ndërtimit për subjektin "A. M.", Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim.

Në faturën për arkëtim rezultoi se është përcaktuar vlera për tu paguar, ndërkohë nuk evidentohet mënyra e përllogaritur por vetëm vlera prej 41,124 lekë. Sipas paketës fiskale të Bashkisë Has, TNI për tipologjinë e ndërtimit të mësipërm është në masën 1% të vlerës së investimit. Sipas preventivit të punimeve, rezultoi në vlerën **8,299,118 lekë.** Referuar masës 1% të përcaktuar në paketën fiskale, Institucioni duhej të përllogariste pagesën në masën 1% të kësaj vlere, ose **82,991 lekë.** Vlera prej 41,867 lekë, e cila nuk është përllogaritur, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Has, veprim në kundërshtim me pikën 5.2 të Paketës Fiskale, miratuar me vendimin nr. 33, datë 22.12.2023 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2024". *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.5, faqe 151-154, të Raportit Përfundimtar*

të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Sektori i Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për njoftim detyrimin ndaj subjektit "A. M." dhe për arkëtimin e shumës **41,867 lekë,** e cila rezulton nga përllogaritja e pasaktë e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe përbën të ardhur të paarkëtuar për buxhetin e Bashkisë Has.

Menjëherë

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të korrespondencës zyrtare të bashkisë me ASHK- Drejtoria Has dhe pagesat e kryera nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë (TNI), lidhur me ecurinë e pagesave të kryera nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit, rezulton se gjatë vitit 2024 janë legalizuar 39 objekte me një vlerë totale të detyrimit prej 1,698,702 lekë. Nga kjo vlerë janë arkëtuar 408,081 lekë gjatë vitit 2024 dhe 46,695 lekë gjatë vitit 2025. Për vitin 2025 nuk rezultuan legalizime të reja.

Si rrjedhojë, vlera 1,243,926 lekë, (1,698,702 lekë - 408,081 lekë - 46,695 lekë) përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5*. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.2, faqe 51-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë masa për dërgimin periodik të informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitore për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 1,243,926 lekë, detyrim për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e legalizuara.

Brenda datës 31.12.2026

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2024-2025, në territorin e Bashkisë Has janë evidentuar 5 subjekte të pajisura me autorizim bazë për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të hidrokarbureve nga të cilat 3 subjekte rezultojnë debitorë. Në total, nga autorizimet e dhëna, detyrimi total i subjekteve ndaj Bashkisë Has është në vlerën 8,020,000 lekë, nga të cilat është arkëtuar shuma 3,813,000 lekë dhe mbetet për t'u arkëtuar detyrimi në vlerën 4,207,000 lekë. Detyrimet e papaguara, sipas subjekteve, paraqiten si më poshtë: "S." shpk, detyrimi 1,000,000 lekë, paguar 200,000 lekë, debia 800,000 lekë;

"V. P." shpk, detyrimi 1,000,000 lekë, paguar 800,000 lekë, debia 200,000 lekë;

"G. Sh." shpk, detyrimi 1,000,000 lekë, paguar 800,000 lekë, debia 200,000 lekë;

Gjithashtu rezultojnë edhe 4 subjekte debitorë të cilat rezultojnë të mbyllura.

"E." shpk, detyrimi 1,000,000 lekë, paguar 100,000 lekë, debia 900,000 lekë;

"K.L." shpk, detyrimi 1,000,000 lekë, paguar 293,000 lekë, debia 707,000 lekë;

Xh. P." shpk, detyrimi 1,000,000 lekë, paguar 600,000 lekë, debia 400,000 lekë;

"H." shpk, detyrimi 1,000,000 lekë, paguar 0 lekë, debia 1,000,000 lekë;

Nga të dhënat konstatohet se nga Bashkia Has nuk është aplikuar saktë taksa për rinovim të lejes së autorizimit për subjektet të cilat tregtojnë karburante ku detyrimi ligjor për lëshimin e

autorizimit është 1,000,000 lekë. Në 7 raste të licencimit të pikave të shitjes me pakicë të karburanteve dhe nënproduktet e tyre, nga Bashkia Has janë lëshuar autorizime për licencim apo rinovim licence kundrejt pagesave nga subjektet në vlerën 200,000 lekë, pra në masën prej 1/5 e tarifës së miratuar për licencim prej 1,000,000 lekë për pikat e karburanteve. Gjithashtu, për subjektin **"D.M." sh.p.k.**, që ushtron aktivitetin e tregtimit të gazit, rezultoi se autorizimi është lëshuar kundrejt pagesës prej **20,000 lekë**, në vend të detyrimit të përcaktuar prej **100,000 lekë**. Për rrjedhojë, Bashkia Has nuk ka siguruar administrimin dhe arkëtimin e plotë të detyrimeve që lidhen me pajisjen/rinovimin e autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të hidrokarbureve, duke krijuar **të ardhura të munguara në shumën 4,207,000 lekë**., detyrime të cilat rezultojnë të përfshira në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm" e cila në fund të vitit 2025 ka qenë në vlerën* ***90,027,867 lekë.*** *Këto veprime* janë në mospërputhje me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre*", të ndryshuar, neni 4. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.2, faqe 51-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Taksave, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Has, të marrë masa konkrete për **evidentimin, ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve të papaguara në vlerën 4,207,000 lekë**, duke ndjekur të gjithë hapat dhe procedurat e përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi.

2.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Taksave, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Has, për subjektet që vijojnë të ushtrojnë aktivitetin, të sigurohet **arkëtimi i plotë i tarifave/detyrimeve për autorizimin ose rinovimin e tij**, sipas vlerave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe të merren masa për të parandaluar përsëritjen e rasteve të arkëtimit të pjesshëm të detyrimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se deri në vitin 2025, Bashkia Has ka likuiduar katër punonjës në vlerën 1,178,279 lekë për zbatimin e vendimeve gjyqësore për punonjës të larguar nga puna, si dhe një tarifë përmbarimore në vlerën 31,200 lekë, për një total prej 1,209,479 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ dhe rëndon situatën ekonomike të institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.2, faqe 51-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Kryetari Bashkisë Has, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Juridike, të marrë masa që vendimet për largimet nga puna të punonjësve të jenë të argumentuara ligjërisht si dhe të shoqëruara me procedurat e ndjekura për shkeljet e evidentuara, me qëllim shmangien e kostove shtesë nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore dhe tarifave përmbarimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave vendore, si dhe i informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Has, u konstatua se në fund të vitit 2024 vlera e debitorëve ishte 63,371,335 lekë, ndërsa në fund të vitit 2025 ishte 60,737,826 lekë. Këto detyrime i përkisnin bizneseve, individëve dhe familjarëve për taksën e ndërtesës, taksën e tabelës, taksën e truallit, taksën e reklamës, taksën për zënien e hapësirës publike, tarifat e pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifën e veterinarisë, tarifat e qirasë për objekte, toka, pyje, dru zjarri etj. Mos arkëtimi dhe mos ndjekja në mënyrë të plotë e këtyre detyrimeve përbën veprime në kundërshtim me përcaktimet në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, Kreu XI *"Mbledhja me forcë*

e detyrimit tatimor të pa paguar", VKB nr. 33, datë 22.12.2023 dhe VKB nr.135, datë 23.12.2024, "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has*", me Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar neni 9 pika1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin nr.2, faqe 51-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Taksave, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët,
duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2025 në vlerën progresive 60,737,826 lekë, e përbërë nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për biznesin e vogël në shumën 13,267,454 lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për biznesin e madh në shumën 30,622,576 lekë;
- Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 206,600 lekë;
- Detyrime nga Kryefamiljarë të pajisur me leje legalizimi në shumën 10,097,182 lekë;
- Detyrime nga qiratë e tregut (markata) në shumën 5,919,296 lekë;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore të pandarë në vlerën 624,718 lekë.

Brenda datës 31.12.2026

E. MASA DISIPLINORE

E.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

E.1.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"*, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Has**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a) "Vërejtje" neni 58 shkronja (a), për 8 punonjës si më poshtë

1. Znj A. M., me detyrë Specialiste në Sektorin Juridik, për mangësitë në procedurat e prokurimit, në cilësinë e anëtarit të KVO;
2. Z. Y. D., me detyrë Inspektor i Pronave, për mangësitë në procedurat e prokurimit, në cilësinë e anëtarit të KVO;
3. Z. N.B., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës, për mangësitë në procedurat e prokurimit, në cilësinë e anëtarit të KVO;
4. Znj. A. B., me detyrë Përgjegjëse në Sektorin Juridik, për mangësitë në procedurat e prokurimit, në cilësinë e anëtarit të NJP;
5. Znj. E. S., me detyrë Specialiste Finance, për mangësitë në procedurat e prokurimit, në cilësinë e anëtarit të NJP;
6. Znj R. R., me detyrë Specialiste për Administrimin e HRMIS dhe administrata.al, për mangësitë në procedurat e prokurimit, në cilësinë e anëtarit të NJP dhe KVO;
7. Znj. E. R., me detyrë Përgjegjëse në Sektorin Juridik, për mangësitë në procedurat e prokurimit, në cilësinë e anëtarit të NJP;
8. Z. A. G., me detyrë Specialist Jurist, për mangësitë në procedurat e prokurimit, në cilësinë e anëtarit të NJP;

E.1.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, nenin 37 *"Masa Disiplinore" të ligjit nr.* 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" si dhe kontratës individuale dhe kolektive të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Has**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a) "Vërejtje", për punonjësin;

1. Z.Sh., me detyrë Zv. Kryetar i Bashkisë Has, për mangësitë në procedurat e prokurimit, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT